



KOMANDA E DOKTRINËS DHE STËRVITJES

REVISTA USHTARAKE

**Organ teoriko-shkencor
i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes**

Nr. 3/2012

Tiranë, Shtator 2012

Bordi i Botimit të Revistës Ushtarake
Miratuar me Urdhër të Ministrit të Mbrojtjes Nr. 1538, datë 18.08.2010

Kryetar

Gjeneral Brigade Bardhyl Hoxha, Komandant i KDS

Anëtar

Kolonel ® Thimi Hudhra

Kolonel Dr. Agim Sula

Gjen. Major ® Prof. Dr. Ruzhdi Gjatoja

Gjen. Major ® Prof. Dr. Kostaq Karoli

Kryeredaktor

Pano Hallko

Redaktore

Silvana Markgjonaj

Operatore

Lindita Kuçana

Art design

Teuta Mullisi

ISSH 2227-8133 (Print), ISSN 2227-8141 (Online)

Copyright © 2011 nga Qendra e Analizave të Mbrojtjes (QAM) të Komandës së Doktrinës dhe Stërviçjes).

Copyright © 2011 by the Center for Defence Analyses (CDA) of the Albanian Training and Doctrine Command.

Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në Revistën Ushtarake janë tërësisht të autorit/autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë politikat apo pozicionet zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm dhe Komandës së Doktrinës dhe Stërviçjes.

Autori/Autorët e shkrimeve të Revistës Ushtarake nuk do të jenë subjekt i ndëshkimit për shprehjen e lirë të qëndrimeve e pozicioneve të tyre individuale edhe sikur përmbajtja e tyre të mos jetë në përputhje me qëndrimet zyrtare të institucionit të mbrojtjes.

Njëkohësisht, autori/autorët mbajnë përgjegjësi për shtrembërimet e fakteve, si dhe kopjimet e pareferuara të krijimeve dhe mendimeve të autorëve të tjerë.

Ky botim i Revistës Ushtarake gjendet në website <http://www.tradoc.mil.al/>

Në rast se nuk mund të merrni informacionin që kërkoni në internet lutemi të kërkoni një kopje të tij në adresën: e-mail: revistaushtarake@aaf.mil.al ose gam@aaf.mil.al

Komanda e Doktrinës dhe Stërviçjes

Qendra e Analizave të Mbrojtjes

Dega e Botimeve

Shtypur: Shtator 2012

PËRMBAJTJA

RUBRIKA E PARË: Struktura e Re e FA

Transformimi dhe Integrimi i FA _____	6
Fjala e Zotit Arben Imami, Ministër i Mbrojtjes, në Konferencën e 5-të të NATO-s për Transformimin dhe Integrimin e FA-ve	
Integrimi i plotë në NATO, një sfidë serioze _____	9
Material i Drejtorisë J5	
Koncepti Strategjik i Strukturës së Re të FASH _____	16
Gjeneral Brigade Sander Lleshi, Zëvendësshef i Shtabit të Përgjithshëm të FASH	
Struktura e Re dhe sfidat e KDS-së _____	30
Gjeneral Brigade Bardhyl Hoxha, Komandant i KDS	
Për një Koncept të C2 të Strukturës së Re të FASH _____	36
Kolonel ® Thimi Hudhra, Kolonel Piro Ahmetaj	

RUBRIKA E DYTË: Analiza, Sinteza dhe Vlerësime të Sigurisë

Efekti psikologjik i luftës dhe trajtimi i tij _____	49
Gjeneral Major Viktor Bërdo, Zëvendësshef i Shtabit të Përgjithshëm të FASH	
Kapacitetet rajonale të emergjencave, në frymën “Smart Defence” _____	58
Gjeneral Brigade Abaz Lleshi, Komandant i BMR	
Qendra e rëndësës në operacionet COIN _____	67
Kolonel Riza Zaja, Nënkolonel Dëfrim Haxhia	
Qendra e Simulimit, një Aftësi e Re Stërvitore _____	75
Dee Esplin	
Menaxhimi i Dijeve, domosdoshmëri në kohën e informacionit _____	81
Dr. Gaço Tanku, Nënkolonel MSc. Editson Zarka	

RUBRIKA E TRETË: “Pranvera Arabe”

Aspekte ligjore të ndërhyrjes ushtarake në Libi _____ 92
Kolonel Dr. Agim Q. Sula

Siria, nyja Gordiane _____ 102
Kolonel ® Zeno Jahaj

Bashkësia ndërkombëtare dhe kriza në Libi _____ 107
Plator Kalakula

RUBRIKA E KATËRT: Shkrime Historike

Akademia Ushtarake, vatër shkencore e formimit të oficerit _____ 116
Kolonel Dr. Edmond Braneshi

100 vjetori i Pavarësisë dhe Çështja Kombëtare _____ 123
Pano Hallko

Përmbledhja në anglisht _____ 138

Kujtesë për bashkëpunëtorët e Revistës Ushtarake _____ 145

RUBRIKA E PARË

Struktura e Re e FA

“Rishikimi i bazës konceptuale të FA ka qenë dhe mbetet një ndër elementët më të rëndësishëm të procesit të transformimit të tyre. Ky rishikim i është nënshtruar një diskutimi dhe konsultimi intensiv brenda FA dhe me partnerët tanë në NATO. Konferenca e V e Integritetit shënoi një moment kulmor në këtë kontekst. Ajo i konfirmoi seriozitetin e punës së bërë deri tani si dhe hapi perspektiva të tjera për vijimin e punës për hartimin e koncepteve të tjera në shërbim të zhvillimit dhe perfeksionimit të mëtejshëm të FA”- nënvizon në artikullin e tij, Gjeneral Brigade Sandër Lleshi, Zëvendëseshëf i Shtabit të Përgjithshëm.

Një nga përfundimet e studimit të Gjeneral Lleshit është: “Bashkëvendosja e seksioneve të SHT pranë njërive përkatëse të FA mundëson një angazhim më eficient të personelit mësimdhënës të SHT. Kjo krijon mundësinë që trupa mësimdhënëse e SHT, të mund të angazhohet edhe në detyra të karakterit stërvitor apo operacional pranë njësisë ku është vendosur. Pra siguron ndërthurjen optimale mes përvojës mësimdhënëse dhe asaj stërvitore dhe operationale, e cila shkon në favor të një arsimimi dhe përgatitjeje më të mirë të personelit.”

Komandanti i KDS-së, Gjeneral Brigade Bardhyl Hoxha, vjen me një vizion të tijin për çështjet e strukturës në Forcën që ai drejton.-”Koha kërkon që përgatitja profesionale të përmirësohet vazhdimisht, mësimet e nxjerra të përdoren për të dritësuar objektivat tona për të ardhmen, baraspesha e duhur mes koncepteve akademike dhe realitetit operacional, të realizohen në një program arsimor efektiv për personelin e FA .”-nënvizon ai.

Ndërsa në shkrimin studimor të Kol ® Thimi Hudhra-Shef i Qendrës së Analizave të Mbrojtjes, paraqiten në thellësi variantet e mundshme të funksionimit të strukturës C2, duke arritur në përfundimin se... “Strukturat janë diagrama të vdekura; është personeli ai, që i bën këto struktura të gjalla dhe funksionale. Edhe struktura më e mirë mund të dështojë nëse nuk ka personel cilësor dhe procedura të sakta veprimi, por edhe struktura më e keqe mund të funksionojë me sukses kur ka cilësi profesionale, vullnet të aktorëve të saj dhe procedura pune të përpikta.”

Transformimi dhe Integrimi i FA

Fjala e Zotit Arben Imami, Ministër i Mbrojtjes, në Konferencën e 5-të të NATO-s për Transformimin dhe Integrimin e FA-ve

Mirë se vini në konferencën e pestë të integrimit në Shqipëri. Është kënaqësia ime t'ju uroj të gjithëve mirëseardhjen në Tiranë! Një mirëseardhje e veçantë shkon për të ftuarit tanë nga NATO, nga Komanda e Aleancës për Transformim, Komanda e Aleancës për Operacionet, Komanda e Forcës së Bashkuar, Napoli, duke ju falënderuar për praninë tuaj në këtë konferencë, si edhe për mbështetjen tuaj të vazhdueshme. Të gjithë ne bëhemi më të vetëdijshëm që procesi i integrimit kalon në procesin e vështirë të vendimmarrjes, duke mbujtur mentalitet, mënyra të ndryshme planifikimi dhe ritëm të ndryshëm reagimi. Si rrjedhojë, ne e vlerësojmë vërtet asistencën që po iu jepet Forcave tona të Armatosura në të gjitha fushat e integrimit, qoftë kjo në themelet bazë të doktrinës, në kapacitetet ushtarake ose inkuadrimit strukturor të gjithë organizimit tonë.

Integrimi ka qenë dhe mbetet një proces kompleks, i cili ka kërkuar shumë kohë dhe një sasi të madhe të burimeve. Megjithatë, ne jemi shumë krenarë për progresin që kemi arritur në këto tre vitet e fundit të reformave gjithëpërfshirëse. Përfitoj nga rasti të falënderoj të gjithë personelin ushtarak dhe civil për durimin, këmbënguljen dhe vullnetin e tij të palëkundur për të kryer të gjitha reformat e nevojshme. Falë tyre, Forcat e Armatosura shqiptare janë të krahasueshme me Forcat e tjera të Armatosura të Aleancës, në lidhje me prioritetet, vizionin dhe përfshirjen. Ato janë duke shkuar drejt interoperabilitetit dhe zhdërvjelltësisë.

Rezultati i çdo force të armatosur matet vetëm nga përgjegjësia e ushtarakëve të saj. Dhe ushtarakët tanë janë duke punuar shumë mirë, siç na kanë informuar komandantët e NATO-s. Ata janë të aftë, të motivuar dhe të gatshëm për më shumë.

Qysh nga konferenca e fundit e integrimit të ACT në Tiranë, ne besojmë se kemi ndërmarrë disa hapa mjaft të mirë progresivë, unë madje ndonjëherë i quaj "kërcime" në lidhje me ndryshimin e rëndësishëm që ato sjellin lidhur me efikasitetin dhe rezultatet. Prej tyre, do të doja të përmendja punën për Rishikimin e Strategjisë së Mbrojtjes, Planifikimin e Mbrojtjes, Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Standardizimin, Logjistikën, Mësimet e Nxjerra, Arsimimin dhe

Trajnimin, Legjislacionin, demilitarizimin e municioneve dhe materialeve të tepërta, etj. Rishikimi i disa dokumenteve të rëndësishme strategjike si Strategjia Kombëtare e Sigurisë dhe Strategjia Kombëtare Ushtarake, që po vijon, do të vazhdojë paralelisht me rekomandimet e procesit SDR.

Ne kemi kushtuar një kujdes të veçantë në çështjet që shqetësojnë menaxhimin e personelit dhe kemi adresuar disa çështje kritike, duke marrë masat konkrete.

Unë mund të përmend disa prej tyre:

- Strategjia e Integruar e Burimeve Njerëzore;
- Baza e të dhënave të personelit (procesi po vijon dhe është duke përfunduar);
- Rregullorja e Rekrutimit;
- Rregullorja e Trajnimit;
- Procedurat e Rekrutimit;
- Procedurat në rast fatkeqësie (SOP, Standard Operation Procedure-Procedura Standarde për Operacionet.
- Procedura për përzgjedhjen e personelit që shkon për studime dhe kualifikime jashtë vendit;
- Procedura për përzgjedhjen e personelit që shkon në mision;
- Rregullorja e gradimit të personelit;
- Rregullorja e avancimit në gradë (në vijim) bazuar në dy parime, transparenca dhe objektiviteti.

Gjithashtu, ne kemi kushtuar interesin tonë në çështje që lidhen me orientimin në të ardhmen të çdo force të armatosur dhe kemi hartuar politika në lidhje me to:

- Barazia Gjinore;
- Mbështetja psikologjike dhe sociale;
- Zhvillimi i ambientit (në vijim);
- Instituti për studime strategjike;
- Libra për mendimin strategjik;
- Ristrukturimi i bibliotekave;
- Struktura e Marrëdhënieve me Publikun; Qendra e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes; ristrukturimi i Bandës së Ushtrisë, aktivitete publike kulturore, aktivitete kulturore dhe sportive për familjet e personelit ushtarak.

Përveç tyre, dua t'ju siguroj të gjithëve që shqetësimet që kanë dalë nga konferenca e fundit, janë adresuar seriozisht nga strukturat e FASH. Lidhja e vazhdueshme që kemi pasur me ACT dhe KFB Napoli, nëpërmjet telekonferencave mujore dhe takimeve të tjera, kanë qenë gjithashtu shumë të rëndësishme për procesin.

Ne mendojmë se tani jemi të gatshëm të përmbushim kërkesat në një mënyrë të menduar shumë mirë dhe realiste, që e bën atë akoma më të lehtë për ne zhvillimin e një programi pune dhe përcaktimin e afateve të qarta kohore për implementimin e paketës së re të mbrojtjes, në përputhje me kushtet paraprake të Samitit të Çikagos, si dhe duke pasur parasysh parimet e përbashkëta të Shpërndarjes së Drejtë të Detyrimeve dhe Sfidës së Arsyeshme.

Gjithashtu, ne jemi përfshirë në procesin e zbatimit të strukturës së re të koma-

ndimit të NATO-s dhe kemi përcaktuar nivelet tona të ambicies për pjesëmarrjen në këtë strukturë, ndërsa përmirësimet ligjore po vihen në zbatim për të përmbushur kërkesat e dislokimit. Vitin e kaluar kemi punuar seriozisht me projektet që do të vihen në zbatim në kuadër të “*Smart Defence*”, me qëllim identifikimin e projekteve reale domethënëse për FASH dhe për bashkëpunimin rajonal, ide të cilat janë diskutuar gjithashtu me Gjeneralin *Abrial*, gjatë vizitës së tij në Tiranë. Shqipëria dhe vendet e saj fqinje në rajon duket se ndajnë interesa të përbashkëta në fusha si vëzhgimi bregdetar në Detin Adriatik, vëzhgimi i hapësirës ajrore dhe projekte rajonale për emergjencat civile, në të cilat ne jemi përqendruar.

Koncepti ku mbështetet “*Smart Defence*” dhe koncepti i rishpërndarjes së burimeve për të arritur në kohët kur ka më pak misione ndërkombëtare dhe në rastin tonë specifik, në fund të vitit 2013, viti i mbylljes së procesit të demontimit të municioneve të tepërta, ka bërë që të mendojmë seriozisht si të arrijmë më të mirën e kapaciteteve tona, me më pak burime, në kohën e kufizimeve financiare, por edhe si të ndërhyjmë në shkurtimet buxhetore me projekte të rëndësishme modernizimi. Kjo do të na bëjë të mendojmë rreth rëndësisë së zhvillimit të planifikuesve të mirë të së ardhmes brenda Forcave tona të Armatosura.

Siç pata mundësi të shikoj, axhenda e kësaj konference është shumë e pasur dhe trajton shumicën e çështjeve të rëndësishme me të cilat FASH përballet dhe unë besoj se ajo do të japë një vizion real se si duket të vazhdojmë t’i trajtojmë ato në të ardhmen e afërt. Unë pres që sindikatat të diskutojnë me realizëm çështjet përkatëse që, në përfundim, kjo konferencë të japë rekomandimet e duhura në rrugën përpara nesh.

Jam i bindur se kjo konferencë do të arrijë pritjet e saj në hartimin e planit të veprimtimit dyvjeçar, të konsoliduar dhe të përcaktuar mirë.

Veç punës së madhe, ju nxis që të gjeni kohën për të eksploruar dhe shijuar shumëllojshmërinë e argëtimeve që ofron Tirana.

Në përfundim, më lejoni t’ju falenderoj përsëri për prezencën tuaj këtu dhe teksa i uroj sukses konferencës, pres me padurim të dëgjoj rezultatet e diskutimeve tuaja.

Faleminderit!

Integrimi i plotë në NATO, një sfidë serioze

Material i Drejtorisë J5

Pak fjalë për integrimin

Anëtarësimi në NATO është një nga arritjet historike të Shqipërisë dhe fryt i përpjekjeve të vazhdueshme për t'u integruar në këtë organizatë, të cilat filluan që me anëtarësimin në Pfp, në vitin 1994. Ky anëtarësim shënoi realizimin e një prej objektivave më madhorë të lidërshiptit politik dhe ushtarak të vendit tonë, në periudhën post komuniste dhe hapi dyert e një epoke të re transatlantike. Pjesëmarrja me të drejta të plota në një Aleancë kaq të fuqishme, historikisht e suksesshme dhe e qëndrueshme, pjesë e të cilës janë vende nga më të zhvilluarat në planet, përveç përfitimeve, shtronte edhe një sërë sfidash për Shqipërinë. Qysh në momentin e marrjes së ftesës, nga NATO u bë e qartë se një sërë sfidash dilnin para Forcave tona të Armatosura, për të qëndruar denjësisht në krah të ushtrive më moderne të kohës.

“Ftesa jonë për Shqipërinë dhe Kroacinë për të filluar bisedimet për t’iu bashkuar Aleancës shënon fillimin e një kapitulli të ri për Ballkanin Perëndimor dhe tregon rrugën përpara drejt një të ardhmeje në të cilën ky rajon i stabilizuar do të jetë plotësisht i integruar në institucionet euro-atlantike dhe në gjendje të japë një kontribut të rëndësishëm për sigurinë ndërkombëtare”. (NAC, Samiti i Bukureshtit, 03 Prill 2008)

Të jesh plotësisht i integruar në institucionet Euro-Atlantike dhe të jesh në gjendje për të dhënë kontribute për sigurinë ndërkombëtare, do të thotë të jesh i ndërveprueshëm me aleatët dhe të kesh kapacitetet e duhura për këtë ndërveprim.

Menjëherë pas anëtarësimit në Aleancë, vendet e reja anëtare duhet të kalojnë nëpër procesin e pranimit-integrimit, proces që realizon integrimin e plotë në këtë organizatë. Bazuar në procedurat e miratuara, është pikërisht ACT (Komanda e Transformimit të Aleancës) që udhëheq këtë proces në nivel strategjik. ACT, nëpërmjet këtij roli, synon të sigurojë mbështetjen e NATO-s për vendet e reja anëtare për transformimin e mëtejshëm të Forcave të tyre të Armatosura dhe përmbushjen e angazhimeve të tyre në Aleancë.

Objektivi i fundmë i këtij procesi është një Shqipëri plotësisht e integruar dhe e aftë për marrjen e plotë të përgjegjësiave brenda Komandës së NATO-s dhe

strukturave të saj, duke patur burime të zhvilluara mjaftueshëm, kapacitetet infrastrukturore dhe kapacitete për vend pritës e mbështetës. Për më tepër, vendet e reja duhet të kenë miratuar plane për të plotësuar certifikimin dhe afirmimin e forcave të përcaktuara në Paketën e Kapaciteteve.

Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet FASH dhe ACT, në procesin e integrimit, është bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit që është nënshkruar nga të dy palët, në dhjetor 2010 dhe që ka për qëllim të identifikojë dhe të zgjidhë çështjet përparësore të transformimit. Në këtë kontekst, ACT-FASH, që në momentet e para të bashkëpunimit, identifikuan gjashtë fusha integrimi, në të cilat vendi ynë duhet të bënte progres për realizimin e integrimit të plotë. Fushat e identifikuara përfshijnë aspekte të sigurisë dhe informacionit, emërimin e përfaqësuesve tanë në shtabet e NATO-s, integrimin në sistemin e mbrojtjes ajrore të NATO-s, zhvillimin e sistemit të planifikimit kombëtar sipas sistemit të planifikimit të mbrojtjes kolektive të NATO-s, zhvillimin e sistemit të stërvitjes sipas standardeve të NATO-s, integrimin e rrjetit C2 në rrjetin e NATO-s. Fushat e identifikuara të integrimit janë rrjedhojë logjike e Objektivave të Forcës, implementimi i të cilave sjell natyrshëm transformimin dhe integrimin e plotë të FASH në NATO.

Në funksion të realizimit të progresit në këto fusha integrimi, bashkëpunimi me ACT ka konsistuar në aktivitete të tilla si seminare, *workshop-e*, plane trajnimi, bisedime dypalëshe, takime, telekonferenca. Çdo vit, FASH planifikon aktivitete me Komandën e Bashkuar në Napoli, Shkollën e NATO-s në Oberammergau, Komitetet dhe Grupet e Punës në NATO, që synojnë të çojnë më tej procesin e integrimit.

Konferenca e 5-të e Integrimit në NATO

Konferencat janë veprimtari vjetore që zhvillohen zakonisht në vendin tonë dhe kanë për qëllim të analizojnë procesin e integrimit, të venë në dukje progresin e bërë dhe të shtrojnë rrugën përpara për përmbylljen e procesit. Në përfundim të konferencave, ACT publikon një raport përfundimtar në të cilin parashtron çështjet kritike të integrimit dhe jep rekomandime e ofron mbështetje për zgjidhjen e tyre. Rekomandimet e dhëna nga ACT kanë përbërë edhe bazën për hartimin e planeve vit pas viti, zbatimi i të cilave ka sjellë zhvillime pozitive në këtë proces. Në kuadër të këtyre planeve vjetore bashkëpunimi, në datat 27-28 qershor 2012, u zhvillua në vendin tonë Konferenca e Pestë e Integrimit të FA në NATO.

Qëllimi i konferencës ishte të identifikonte progresin e FASH në përpjekjet e veta për arritjen e integrimit të plotë në NATO, duke synuar përcaktimin e një vizioni të qartë për Integrimin deri në vitin 2014.

FASH vinin në këtë veprimtari pas një viti intensiv veprimtarish dhe koordinimi me ACT. Rekomandimet e Konferencës së 4-të përbënë themelet e një pune voluminoze që filloi me analizimin e hollësishëm, përcaktimin e çështjeve kritike dhe përpilimin e një matrice me 43 aktivitete, që i adresoheshin zgjidhjes së këtyre çështjeve. Si asnjë vit më parë, u monitorua nga ACT realizimi i kësaj matrice, nëpërmjet telekonferencave mujore, gjatë të cilave raportoheshin

aktivitetet e realizuara dhe koordinohet puna për muajin në vazhdim. Si rrjedhojë e kësaj pune, FASH vinte në këtë konferencë me një sërë veprimtarish të realizuara dhe me shumicë faktesh për të raportuar. Zv.Shëfi i SHSHP për Operacionet, Gjeneral Brigade Sandër Lleshi, ishte bashkëdrejtuesi i Konferencës. Datave të zhvillimit të konferencës iu parapriu realizimi i dy provave reale të punimeve në KDS. Materialet e përgatitura nga Drejtuesit e Sindikatave pjesëmarrëse u panë e u përmirësuan disa herë derisa erdhën në formatin përfundimtar. Kjo punë përgatitore jo vetëm që i shërbeu përgatitjes së aktivitetit në detaje, por ajo çka është më e rëndësishmja, përgatiti pjesëmarrësit me tematikën që do të diskutohej nëpër sindikata.

Kjo veprimtari e rëndësishme pati vëmendjen maksimale të personaliteteve të larta të Ministrisë së Mbrojtjes, Komisionit Parlamentar të Sigurisë dhe Mbrojtjes, Ministrisë së Jashtme dhe Presidencës. Komanda e Aleancës për Transformimin (ACT) u përfaqësua, në këtë konferencë, me një ekip ekspertësh të fushave të ndryshme nga të gjithë komponentët e komandave të NATO-s (SHAPE, Napoli, Izmir dhe Madrid). Ekipi i NATO-s drejtohej nga Gjeneral Major *Jon B. Lilland*, Ndihmësshëf i Shtabit për Planifikimin në ACT.

Në seancën plenare, gjatë fjalës përshëndetëse, Ministri i Mbrojtjes Zoti Arben Imami theksoi impenjimin e FASH në procesin e integritit të plotë me vetëdijen se do të jetë një proces i gjatë që do të kërkojë shumë energji dhe kohë: “Në ndjehemi krenarë për progresin që Forcat tona të Armatosura kanë bërë në vitet e fundit. Megjithatë mbetet shumë për të bërë dhe nuk ka asnjë dyshim që ne do të vazhdojmë në këtë proces. Unë besoj fort se çelësi i suksesit është bashkëpunimi dhe puna e vazhdueshme e njerëzve nën uniformë”, vlerësoi ndër të tjera Ministri Imami. Në vazhdim të fjalës së tij, Ministri i Mbrojtjes përshkroi një sërë veprimtarish të rëndësishme të FASH, në periudhën midis dy konferencave, ku një vend të veçantë zuri impenjimi i FASH në misionet ndërkombëtare të NATO-s, procesi i transformimit të FASH, puna e bërë për demontimin e municioneve të tepërta dhe përfshirja në projektet e nismës “*Smart Defence*”.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Gjeneral Major *Jon B. Lilland*, pasi bëri një përshkrim të strukturës së ACT dhe paraqiti anëtarët e ekipit që kryesonte, ritheksoi qëllimin kryesor të kësaj konference: vënien e piketave për hartimin e një plani dyvjeçar integrimi që do të mund të plotësonte integrimin e plotë të Shqipërisë në Aleancë. Në bazë të këtij plani edhe ACT do të hartonte një plan mbështetës në funksion të realizimit me sukses të tij. Qëllimi i kësaj konference, sigurisht që ishte në përputhje dhe pjesë e qëllimit që procesi i integritit ka në vetvete nga këndvështrimi i NATO-s: Të sigurojë mbështetjen e Aleancës për vendet e reja anëtare, për transformimin e mëtejshëm të Forcave të tyre të Armatosura dhe realizimin e angazhimeve të tyre specifike në NATO, me qëllim që të arrijnë pranimin dhe integrimin e plotë në Aleancë dhe të zhvillojnë një plan të miratuar që do të mund të realizonte në mënyrë të suksesshme paketën e kapaciteteve.

Prezantimi kryesor i veprimtarisë integruese të FASH ishte produkt i një pune të gjatë konsultimesh midis aktorëve kryesorë të kësaj konference, nën drejtimin e Gjeneral Brigade Sandër Lleshi, Zv/SHSHPFA për Operacionet. Fokusi kryesor

në këtë prezantim ishte nxjerrja në pah e progresit të realizuar dhe puna intensive e bërë nga personeli i FA, që nga Konferenca e Katërt e Integritimit. Në mënyrë të veçantë, puna e bërë për Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes, Strategjinë e Sigurisë Kombëtare dhe Strategjinë e Re Ushtarake, përbënin domethënien e harmonizimit të dokumenteve strategjike të sigurisë së vendit tonë me dokumentet e NATO-s. Janë pikërisht këto dokumente, që ne planëzojmë të miratohen në fund të këtij viti dhe në fillim të vitit 2013, që do të sigurojnë busullën orientuese dhe do të shtrijnë rrugën e integritimit për vitet e ardhshme.

Ndër zhvillimet më të rëndësishme gjatë këtij viti u listuan arritje të tilla si: Hartimi i Strategjisë së re të Menaxhimit të Personelit, Ndërtimi i Sistemit të Automatizuar të Dhënave të Personelit, Ndërtimi i Qendrës së Simulimit në KDS, Ndërtimi i Anijes së Parë Ushtarake në Shqipëri, etj. Arritjet dhe puna e bërë gjatë këtij viti ka ndikuar dukshëm edhe në progresin e vënë në dukje në të gjashtë fushat e integritimit. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i paraqitur në këtë brifing ishte edhe përfshirja ambicioze, me projekte konkrete, e FASH në nismën e NATO-s “*Smart Defence*” si dhe angazhimet e FASH, bazuar në detyrimet që përcaktoi Samiti i Çikagos.

Konferenca u përshëndet edhe nga Kryetari i Komisionit të Sigurisë Kombëtare të Parlamentit të RSH, Z. Leonard Demi i cili, në fjalën e tij, konfirmoi mbështetjen unanime politike, në funksion të proceseve integruese të FASH në NATO. Gjithashtu u theksua përfshirja e Komisionit të Sigurisë në analizimin e Përfundimeve të Konferencës së Katërt të Integritimit si dhe në bashkëpunimin e vazhdueshëm ndërmjet Komisionit dhe MM/SHPFA.

Në pjesën e dytë të ditës u vazhdua me prezantimet në sindikatat e integritimit: Sindikata e Drejtuesve Kryesorë, Sindikata e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Planifikimit, Stërvitjes Kolektive dhe Logjistikës. Axhenda e Konferencës ishte konceptuar në mënyrë të tillë që drejtuesit e sindikatave të mbanin nga një prezantim gjithëpërfshirës të ecurisë në sindikatë që do të përbënte “brumin” e diskutimeve për pjesëtarët e tyre dhe do të qartësonte piketat e bashkëpunimit për planin 2 vjeçar. Në të gjitha prezantimet u vu në dukje qëndrimi serioz ndaj rekomandimeve të Konferencës së Katërt të Integritimit, progresi i bërë nga sindikatat përkatëse si dhe rruga për të ardhmen.

Diskutimet në sindikata që u zhvilluan në ditën e dytë të konferencës, u përqendruan kryesisht në vizionin për të ardhmen. Zhvillimi i dy provave paraprake kishte ndihmuar diskutantët të orientoheshin realisht në diskutimet e tyre dhe të sqaronin çështje të veçanta në bisedimet “kokë më kokë” me ekspertët e NATO-s. Më konkretisht, sipas sindikatave u nxorën në pah zhvillimet e mëposhtme:

Në **Sindikatën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore**, përfaqësuesit e NATO-s vlerësuan se Strategjia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për periudhën 2011-2015 dhe programi i implementimit janë një hap shumë i rëndësishëm për procesin e MBNJ. U theksua domosdoshmëria e hartimit të një plani të integruar, promovimi i kësaj strategjie në të gjitha strukturat e MM dhe SHPFA dhe hartimi i një programi të hollësishëm zbatimi. Profesionalizmi i ekipit të FA-së që drejton procesin e MBNJ është jetik dhe, në këtë kontekst, u konsiderua e rëndësishme vazhdimësia

e personelit në pozicionet e menaxhimit të personelit. Sfida e MBNJ mbetet të caktojë “njeriun e duhur” në vendin e duhur që do të përmbushet nëpërmjet funksionimit të sistemit të automatizuar të personelit.

Në **Sindikatën e Planifikimit të Mbrojtjes**, pothuajse i gjithë diskutimi u fokusua në çështjet që “shqetësojnë” palën tonë për zbatimin e paketës së re të kapaciteteve dhe koordinimin me ACT, për bashkëveprimin e mëtejshëm FASH-ACT, për përpilimin e një plani 2 vjeçar të integritit. Për sa më sipër, u përpilua një program masash dhe veprimtarish që synonte të fillonte sa më shpejt organizimin e punës për marrjen e paketës së re të kapaciteteve, analizimin dhe detajimin e detyrave për t’iu përgjigjur kërkesave të tyre. Vlerësimi serioz që do t’i bëhet kësaj pakete do të shërbejë, në mënyrë të veçantë, për përfaqësuesit e FASH që do të marrin pjesë në konsultimet e përbashkëta Shqipëri-NATO që do të zhvillohen në nëntor 2012, në Tiranë. Gjithashtu, nga ana jonë, u konsiderua shumë i rëndësishëm zhvillimi i një kursi në vendin tonë nga ACT për njohjen e Planifikimit të Mbrojtjes së NATO-s, kurs që mund të zhvillohet në shtator 2012, në Tiranë. Zhvillimi i integritit në fushën e planifikimit varet shumë edhe nga përvoja dhe ekspertiza e njerëzve që janë përfshirë në degët e planifikimit të FASH (J-5, G-5, S-5). Në këtë kontekst, u ra dakord që ky personel të jetë i njëjtë, të paktën edhe për dy vitet e ardhshme.

Në **Sindikatën e Stërvitjes Kolektive** u vu theksi në vazhdimin e punës për Certifikimin dhe Afirmimin e njësive të deklaruara në NATO. Ekspertët e ACT premtuan se do të asistojnë në procesin e certifikimit të njësive të përcaktuara tashmë për në muajin shtator. Në përmbushje të detyrave të integritit, në fushën e stërvitjes do të vazhdojë puna për përgatitjen dhe gjetjen e një njësie “*mother unit*” për njësinë e Forcave Speciale (SOTU), do të vazhdojë hartimi i planit të trajnimit për Qendrën e re të Simulimit, konsolidimi i stërvitjes së përbashkët dhe të kombinuar dhe marrja e asistencës nga NATO për trajnimin e nënoficerëve. Përsa i përket stërvitjes së Forcave Ajrore, do të hartohet një plan trajnimi për personelin e Forcave Ajrore që do të caktohet të punojë në CRC, SAR si dhe do të vijojë puna për përmirësimin e infrastrukturës së bazave ajrore. I rëndësishëm u konsiderua vazhdimi i aplikimit të konceptit “*Train the trainers*” i cili ul koston dhe shton efikasitetin. Në kuadër të stërvitjes së Forcave Detare, do të vazhdojë aplikimi i stërvitjeve detare me forcat e NATO-s për të ruajtur nivelin e ndërveprueshmërisë, caktimi i oficerëve me mision “*on board*” në anijet e NATO-s dhe trajnimi i nënoficerëve të FD për realizimin e misioneve të “*boarding-ut*”.

Nga diskutimet e zhvilluara në **Sindikatën e Logjistikës** u arrit në përfundimin se në periudhën midis dy konferencave është realizuar progres, nëpërmjet zbatimit të rekomandimeve të ACT dhe realizimit të objektivave kombëtare për integrimin e plotë në NATO. Anëtarët e sindikatës identifikuan sfidat e transformimit, specifikuan sfidat e komunitetit logjistik dhe u fokusuan në veprimtaritë në të ardhmen, duke konsideruar si më të rëndësishme:

- Implementimin e plotë të sistemit të informatizimit logjistik;
- Vazhdimin e procesit të modernizimit në pajisje të FA;
- Standardizimin e pajisjeve;

- Implementimin e STANAG-ve të NATO-s;
- Vazhdimin intensiv të stërvitjes, trajnimit dhe eksplorimit të zgjidhjeve shumëkombëshe, në kuadrin e “Mbrotjtjes së Zgjuar”.

Mbas dhënies së përfundimeve nga çdo drejtues sindikate, Gjeneral Major *Jon B. Lillard*, drejtuesi i ekipit të NATO-s, falënderoi palën shqiptare për organizimin e veprimtarisë dhe progresin e realizuar në fushat e integrimit. Ai theksoi se NATO po punon për shtrirjen e Sistemit të ri të Procesit Planëzimit për Mbrotjtjen (NDPP) në të gjithë vendet anëtare. Një këtë kontekst, ai shprehu mbështetjen e NATO-s për FA në këtë proces, nëpërmjet organizimit të një kursi për NDPP në Tiranë. Gjeneral *Lillard* theksoi gjithashtu nevojën e vazhdimësisë së përfaqësimit të FA në takimet e grupeve të punës të këtyre niveleve me të njëjtët persona. Kjo është tepër e rëndësishme për të siguruar koherencën dhe finalizimin e procesit të integrimit në dy vitet në vazhdim. Në Planin dyvjeçar të Integrimit do të përfshihen afate konkrete edhe për certifikimin e afirmimin e njësive të deklaruara në NATO si dhe për programet e implementimit të Strategjisë së re të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Në fund ai konfirmoi mbështetjen e plotë që do t'i japë NATO Shqipërisë dhe Forcave të saj të Armatosura, në një vit kaq të rëndësishëm siç është 100 Vjetori i Pavarësisë së vendit.

Në përfundim të Konferencës, ShShP të FA, Gjeneral Gjunkshi, falënderoi ekipin e NATO-s për kontributin e dhënë në këtë veprimtari dhe mbështetjen që po i japin FASH në procesin e rëndësishëm të integrimit të plotë në NATO. Duke vlerësuar arritjet e kësaj Konference, ai theksoi se FA të RSH do të përmbushin me profesionalizëm të lartë misionet përkrah aleatëve si dhe do të angazhohen, në mënyrë të vazhdueshme, për finalizimin e procesit të integrimit.

ShShP të FA, Gjeneral Gjunkshi theksoi se FA të RSH do të përmbushin me profesionalizëm të lartë misionet përkrah aleatëve si dhe do të angazhohen, në mënyrë të vazhdueshme, për finalizimin e procesit të integrimit.

Përfundime

Konferenca e 5-të e Integrimit të FASH në NATO, edhe pse ishte konferenca vjetore e radhës, pati rëndësinë e saj të jashtëzakonshme në lidhje me progresin në procesin e integrimit. Organizimi dhe zhvillimi i saj, mendojmë se duhet të shërbejë si model edhe për organizimin e veprimtarive të tjera. Puna paraprake që u realizua nën drejtimin e SHSHPFA dhe koordinimi i vazhdueshëm me ACT i shërbeu jashtëzakonisht zhvillimit me sukses të veprimtarisë. Pjesëmarrja e gjerë e specialistëve të Forcave dhe Drejtorive në MM/SHPFA i shërbeu “gjithëpërfshirjes” dhe kuptimit të rëndësishëm nga gjithsecili se Procesi i Integrimit nuk është përgjegjësi vetëm e lidërshit politik e ushtarak, por merr rëndësi jetike tek angazhimi i individit të përzgjedhur në njësi dhe forca.

Siç u theksua edhe më lart, FA kishin çfarë të tregonin në këtë konferencë dhe kjo për arsye të punës intensive njëvjeçare për realizimin në kohë të veprimtarive të parashikuara në Matricën e hartuar për përmbushjen e rekomandimeve të Konferencës paraardhëse. Kjo mënyrë pune duhet të vazhdojë edhe për dy vitet e

ardhshme që do të jenë tepër të rëndësishme për përmbylljen e procesit të integritimit.

Konferenca e 5-të e Integritimit ia arriti qëllimit dhe i përmbushi objektivat e saj. Rekomandimet e parashtruara në këtë raport, që pasqyrojnë në mënyrë të plotë përfundimet e sindikatave, shërbyen për hartimin e Planit 2 vjeçar të Integritimit, zbatimi i të cilit ka filluar që në muajin korrik. Në përcaktimin e veprimtarive të këtij plani u fokusua në faktin që ato të ishin të matshme, të realizueshme dhe ndikuese në integrim. Një ndër blloqet kryesore të këtij plani është Paketa e re e Kapaciteteve, analizimi, studimi dhe zbërthimi i të cilës në plane konkrete implementimi do të shtrojë, në mënyrë të qartë, rrugën për të ardhmen e FASH. Vetë implementimi me sukses i kësaj pakete të re kapacitetesh do të sillte, në mënyrë të konsiderueshme, integrimin e plotë në NATO.

Për sa më sipër, kemi të drejtë të themi se Konferenca i dha një shtysë të fortë procesit të integritimit. Por për të gjithë duhet të jetë e qartë se puna nuk mbaron këtu. Pjesëmarrja në një Aleancë historike që është vazhdimisht në transformim e bën edhe më sfidues dhe të vështirë procesin e integritimit. Për këtë do të nevojiten kohë, energji dhe kapacitete financiare, por mbi të gjitha angazhim i të gjithë aktorëve pjesëmarrës në këtë proces të rëndësishëm për FASH.

Koncepti Strategjik i Strukturës së Re të FASH

Gjeneral Brigade Sandër Lleshi,
Zëvendësshef i Shtabit të Përgjithshëm të FA

Trajtesë e shkurtuar. *Miratimi i Konceptit të Ri Strategjik të NATO-s në Samitin e Lisbonës i hapi rrugë shumë proceseve të rëndësishme në fushën e rishikimit strategjik në vende të ndryshme të Aleancës. Orientimi i ri strategjik i NATO-s, në përballje me sfidat dhe mundësitë e të ardhmes ka krijuar një perspektivë dhe një kuadër të plotë referues për përshtatjen e strategjive kombëtare. Shqipëria ka tashmë jo vetëm shansin, por dhe detyrimin për të përshtatur dokumentet e karakterit strategjik, të cilat datojnë përpara anëtarësimit në NATO, me dokumentet aktuale të Aleancës. Ky proces shumë i rëndësishëm është tashmë në fazën e përfundimit.*

Vetë përfshirja e Shqipërisë në Aleancën e Atlantikut të Veriut përbën një ndër ato ndryshime themelore strategjike, të cilat imponojnë gjithashtu një rikonceptim të të gjithë sistemit të sigurisë dhe të mbrojtjes kombëtare. Anëtarësimi në NATO ka sjellë automatikisht zbatimin e Traktatit të Uashingtonit, me të gjitha efektet e tij edhe për Shqipërinë. Në këto kushte, siguria dhe mbrojtja e vendit konsiderohen pjesë përbërëse e sistemit të sigurisë dhe mbrojtjes së përgjithshme të NATO-s, si në kuptim të përfitimeve legjitime prej kësaj përfshirjeje, ashtu dhe në atë të detyrimeve për angazhim në shërbim të Aleancës.

Ndryshime të rëndësishme kanë ndodhur në mjedisin e sigurisë rajonale e globale, ndërkohë që edhe FA kanë realizuar transformime të mëdha. Ato tashmë janë shndërruar në një forcë të re, profesioniste, të vogël dhe të mbështetur në parime e koncepte të reja e, mbi të gjitha, në një forcë të angazhuar gjerësisht në misionet si brenda ashtu dhe jashtë vendit.

Të gjithë këta faktorë të ndryshuar përbëjnë bazën mbi të cilën është mbështetur procesi i rishikimit strategjik të mbrojtjes në FA, proces i cili zhvillohet me ndihmën e drejtpërdrejtë të SHBA dhe në koordinim të vazhdueshëm me NATO-n.

Kjo analizë, synon të paraqesë disa prej çështjeve më të rëndësishme konceptuale që lidhen me të ardhmen e këtij procesi.

Parime të përgjithshme

Integrimi i plotë në NATO ka sjellë me vete edhe domosdoshmërinë për ta konceptuar sigurinë dhe mbrojtjen e vendit, jo më si një çështje të veçuar dhe thjesht kombëtare, por si pjesë e një sistemi dhe e një procesi më të gjerë, i cili zhvillohet në kontekstin e NATO-s.

Në kushtet e reja të krijuara, siguria dhe mbrojtja e Shqipërisë nuk konsiderohet më vetëm si një detyrim i izoluar kombëtar, por si një angazhim kompleks kombëtar dhe ndërkombëtar. Për mbrojtjen e Shqipërisë tashmë llogariten edhe kapacitetet e NATO-s, të cilat aktivizohen si plotësim i detyrimeve të të gjitha vendeve anëtare, në kuadër të Traktatit të Uashingtonit. Po kështu, edhe kapacitetet mbrojtëse të Shqipërisë llogariten për t'u angazhuar në shërbim të sigurisë e të mbrojtjes së Aleancës, përkatësisht vendeve aleate, duke u bazuar në të njëjtat parime dhe detyrime.

Hapja progresive e Shqipërisë ndaj zhvillimeve globale, integrimi i saj në strukturat ekonomike, politike dhe kulturore, rajonale e globale, sjell me vete, në mënyrë të pashmangshme, një kompleks sfidash, shansesh dhe rreziqesh, me mundësi potenciale të ndryshme ndikimi edhe për sigurinë e mbrojtjen e vendit. Në ndryshim me periudhën e Luftës së Ftohtë, kur rreziqet e dukshme dhe relativisht lehtësisht të llogaritshme përbënin problemin themelor për sigurinë dhe mbrojtjen e vendit, sot problemin themelor e paraqesin ato lloj rreziqesh të cilat nuk mund të identifikohen lehtësisht, nuk mund të parashikohen lehtësisht e as nuk mund të përballohen lehtësisht.

Mjedisi i sotëm strategjik karakterizohet, si kurrë ndonjëherë më parë, nga e panjohura dhe nga mundësitë e zhvillimeve krejtësisht të paparashikueshme. Skena e sigurisë botërore po bëhet përditë e më tepër e ndikuar edhe prej aktorëve të rinj, të cilët, si kurrë më parë, arrijnë të krijojnë probleme apo rreziqe për sigurinë e përgjithshme, probleme të cilat nuk janë domosdoshmërisht në përpjesëtim të drejtë me madhësinë apo fuqinë konvencionale të autorëve të tyre.

Pamundësia e identifikimit dhe e parashikimit të duhur të rreziqeve të ardhshme detyron që strukturat e sigurisë dhe ato të mbrojtjes të orientohen drejt krijimit të kapaciteteve shumëvlerëshe, të cilat duhet të jenë të afta që, në kohën më të shkurtër të mundshme, të reagojnë me efikasitet dhe sukses ndaj rreziqeve të panjohura. Profili i ardhshëm i FA duhet të mbajë në konsideratë këta faktorë të rinj strategjikë.

Profili i ri i FA

Misioni i Forcave të Armatosura është sanksionuar në Kushtetutën e RSH e cila, në Nenin 12 të saj, përcakton se *“Forcat e Armatosura sigurojnë pavarësinë e vendit, si dhe mbrojnë tërësinë territoriale dhe rendin e tij kushtetues”*.

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, pas anëtarësimit të plotë të vendit në NATO, konceptohen, ndërtohen dhe përdoren edhe si një forcë e Aleancës.

Anëtarësimi në NATO ka krijuar parakushtet politike dhe strategjike për krijimin e një FA moderne, efikente dhe modeste në përmasa e në kosto.

Anëtarësimi në NATO ka krijuar parakushtet politike dhe strategjike për krijimin e një FA moderne, efëçente dhe modeste në përmasa e në kosto.

Të konceptuara si pjesë të një aleance ushtarake, Forcat e Armatosura të RSH, në kohë paqeje, nuk planifikojnë krijimin e të gjithë spektrit të kapaciteteve operationale që janë të domosdoshme për arritjen e njëanshme të suksesit ushtarak. Duke llogaritur faktin se, si në planin kombëtar ashtu edhe në kuadër të angazhimeve ndërkombëtare, Forcat e Armatosura do të veprojnë si pjesë e forcave aleate, planifikimi i kapaciteteve operationale orientohet kah profilizimit të këtyre forcave.

Qëllimi i profilizimit të Forcave të Armatosura synon krijimin e atyre kapaciteteve që plotësojnë njëherazi, si nevoja shumë të domosdoshme kombëtare, ashtu edhe nevoja të Aleancës. Në kushtet e një force të vogël, me burime mbrojtjeje shumë të kufizuara, Forcat e Armatosura të Shqipërisë i fokusojnë përpjekjet e tyre tek fuqia njerëzore, më shumë sesa tek fuqia e sistemeve komplekse e të rënda të armatimeve dhe pajisjeve. Për rrjedhojë të këtij orientimi, trupat e këmbëtorisë dhe trupat speciale përbëjnë drejtimin përparësor të zhvillimit të FA, ndërkohë që zhvillimi i kapaciteteve detare mbetet një tjetër drejtim me rëndësi strategjike.

Natyra e kërcënimeve dhe rreziqeve, me të cilat duhet të jenë në gjendje të përballen Forcat e Armatosura, kërkojnë që ato të jenë të afta dhe të gatshme për një mbrojtje ushtarake (ose për të luftuar), për të mbështetur autoritetet civile (ose për të ndihmuar popullin shqiptar) si dhe për t'i shërbyer paqes së përgjithshme (ose për të ndihmuar popujt e tjerë).

Qëllimi kryesor për të cilin mbahen dhe zhvillohen Forcat e Armatosura është angazhimi i tyre në plotësimin e misionit kushtetues për mbrojtjen e vendit. Për realizimin e këtij qëllimi, FA ndërtojnë kapacitete maksimale në pikëpamje cilësore, por dhe optimale në pikëpamje sasiore.

Për realizimin e këtij qëllimi, FA ndërtojnë kapacitete maksimale në pikëpamje cilësore, por dhe optimale në pikëpamje sasiore.

Funksioni i parë që realizojnë FA është mbrojtja e sovranitetit kombëtar, në bashkëveprim me forcat e NATO-s. Ato shërbejnë edhe si një rezervë operationale, e gatshme për t'u angazhuar në përballimin e emergjencave. FA angazhohen në kryerjen e misioneve në përmbushje të detyrimeve si vend anëtar i NATO-s (Neni 5 i Traktatit të Atlantikut të Veriut) apo në kryerjen e misioneve në shërbim të paqes, në kuadër misionesh ushtarake të drejtuara nga NATO, BE, OKB ose struktura të tjera ndërkombëtare.

Trupat e këmbëtorisë dhe trupat speciale të pajisura lehtë, por mirë, të mbështetura nga komponentët më të domosdoshëm të trupave të tjera, mbajnë peshën kryesore në përmbushjen e misionit të FA, si në kuadër të angazhimeve kombëtare ashtu edhe atyre ndërkombëtare.

Koncepti i përdorimit operacional të FA

Një ndër drejtimet më të rëndësishme të zhvillimit të FA është hartimi i një koncepti të ri të përdorimit operacional, i cili duhet të harmonizohet me parimet doktrinale të NATO-s.

Forcat e Armatosura të RSH organizohen dhe funksionojnë si një strukturë e bashkuar me përbërje të forcave tokësore, forcave detare, forcave ajrore dhe forcave mbështetëse.

Përdorimi operacional i FA bëhet i bazuar në konceptin e grupimeve operacionale për detyrë (*task force*), të cilat ngrihen si një bashkim kapacitetesh ushtarake në përputhje me natyrën e misionit që duhet zgjidhur. Si rregull, grupimet operacionale për detyrë të FA organizohen mbi bazën e një batalioni të këmbësisë, i cili mbështetet dhe përfordhet me kapacitete të tjera nga strukturat e FA në përputhje me nevojat operacionale.

Komandimi dhe kontrolli operacional i FA realizohet përmes një sistemi unik nga Shtabi i Përgjithshëm i FA përmes Qendrës së Bashkuar Operacionale të FA (QBO). Zbatimi i një modeli të tillë të komandimit dhe kontrollit konsolidon sistemin, shkurton kohën e reagimit, si dhe shmang dublikimet e pasiguritë.

Drejtimi, komandimi dhe kontrolli operacional i FA realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe bazohet në parimin e unitetit të komandimit. Uniteti i komandës ose uniteti i komandimit, si një ndër parimet më të vjetra dhe më të padiskutueshme të funksionimit të forcave të armatosura, kërkon që drejtimi, komandimi dhe kontrolli të realizohen sipas linjës hierarkike. Zbatimi i këtij parimi bazohet në rregullin që asnjë vartës nuk mund të marrë urdhra nga më shumë se një epror, dhe se si epror me të drejtë urdhërdhënie, konsiderohet vetëm eprori i drejtpërdrejtë në linjën hierarkike.

Eprorëve ushtarakë u njihet e drejta që vetëm në raste përjashtimore, të kapërcejnë hallkën e vartësisë së drejtpërdrejtë dhe të japin urdhra për vartës të vartësve. Parakusht për ushtrimin e një kompetence të tillë duhet të jetë pamundësia për të ndjekur rrugën normale të komandimit. Në raste të tilla eprori që jep urdhër si dhe vartësi që merr urdhër në rrugë të veçantë, duhet të njoftojnë eprorin e shmangur nga procesi i komandimit në kohën më të shkurtër të mundshme. Parimi i unitetit të komandimit realizohet me rigozitetin maksimal edhe në rastin e përdorimit operacional të FA.

Eprorëve ushtarakë u njihet e drejta që vetëm në raste përjashtimore, të kapërcejnë hallkën e vartësisë së drejtpërdrejtë dhe të japin urdhra për vartës të vartësve.

Angazhimi i FA në operacione të të gjitha llojeve realizohet përmes grupimeve operacionale (*task force*). Grupimet operacionale krijohen mbi bazën e një njësie apo strukture kryesore, e cila mban dhe barrën kryesore të operacionit. Kjo njësi përfordhet dhe mbështetet me struktura të tjera, roli i të cilave është kompletimi i gjithë setit të kapaciteteve të nevojshme për plotësimin me sukses të misionit. Çdo grupim operacional strukturohet në përshtatshmëri me natyrën e misionit që do të përballohet. Grupimet operacionale komandohen nga komandantët e përcaktuar në urdhrin përkatës operacional të SHSHPFA.

Grupimet operacionale vendosen në vartësi dhe drejtohen, komandohen e kontrollohen prej SHPFA/QBO. Sistemi i komandim-kontrollit dhe i ndërlidhjes mbështetet në këto elementë kryesorë:

- Shtabi i Përgjithshëm i FA (Qendra e Bashkuar Operacionale);
- Komanda e Operacionit;
- Komandat e trupave pjesëmarrëse në grupimin operacional për detyrë (*task force*);
- Trupat e përfshira në operacion.

Në trajtë principiale, skema e organizimit të sistemit të komandim-kontrollit operacional jepet më poshtë:




Figura 1: Skema kryesore e organizimit të sistemit të komandim-kontrollit në FA

Roli i Komandës së Forcës dhe njësive të tjera, në veprimtarinë operative të FA

Përdorimi operacional i forcave dhe njësive të tjera kryesore të FA është përgjegjësi e Shtabit të Përgjithshëm të FA. Në rastet kur kërkohet angazhimi në operacione ushtarake ose jo ushtarake, brenda ose jashtë vendit, përgjegjësia e komandave të forcave dhe njësive të tjera kryesore të FA është vendosja në dispozicion të Shtabit të Përgjithshëm të FA (Qendrës së Bashkuar Operacionale të FA) e kapaciteteve dhe strukturave të kërkuara, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat në drejtim të gatishmërisë, motivimit, disiplinës, armatimit dhe të mbështetjes logjistike.

Si rregull njësitë e FT shërbejnë si bërthama rreth të cilave organizohen grupimet e bashkuara operative të FA (*joint task force*).

Por komandat e forcave dhe të njësive të tjera kryesore të FA në kohë paqeje kanë disa përgjegjësi të drejtpërdrejta me natyrë operative. Mbajtja dhe demonstrimi i nivelit të kërkuar të pranisë ushtarake, si dhe drejtimi i veprimtarisë operative që realizon mbrojtjen dhe sigurinë e instalimeve ushtarake, përbëjnë një përgjegjësi operative me karakter të përhershëm për të gjitha komandat.

Krahas detyrave të mësipërme, Forca Detare dhe Forca Ajrore kryejnë edhe disa detyra operative specifike që lidhen me vetë natyrën e këtyre strukturave.

Forca Detare

FD është përgjegjëse edhe për:

- Kontributin kryesor për kryerjen dhe mbështetjen e operacioneve për vëzhgimin e hapësirës detare;
- Kryerjen e veprimtarisë operacionale që realizon funksionimin e shërbimit hidrografik kombëtar.

Përdorimi operacional i njëjrive të FD për kryerjen e detyrave të Rojës Bregdetare është përgjegjësi e Qendrës Ndërinstitucionale të Operacioneve Detare.



Figura 2: Koncepti i vendosjes së grupeveve operative të FD

Për plotësimin optimal të misionit të FD, mjetet lundruese organizohen në kuadër të një flotiljeje detare, e cila e ka qendrën në Gjirin e Vlorës.

Përdorimi operacional i njësive të FA do të bëhet nga pesë baza operacionale detare, të cilat janë të shpërndara përgjatë gjithë bregdetit të Shqipërisë: Shëngjin, Durrës (Kepi i Palit), Sazan, Porto Palermo dhe Sarandë. FD do të organizojnë prani operacionale, kryesisht me qëllime të asistencës dhe ndihmës ndaj përdoruesve të ujërave të brendshme territoriale, nëpër të cilat kalojnë kufij shtetërorë të RSH. Për këtë qëllim, FD do të jenë prezente dhe do të ofrojnë shërbime të rojës ujore në Liqenin e Pogradecit, në Liqenin e Kukësit dhe në Liqenin e Shkodrës.

Zgjerimi i pranisë së FD në të gjithë vijën bregdetare të vendit dhe përmirësimet e strukturës synojnë:

- mbulimin më të mirë të ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë me shërbime të rojës bregdetare, shërbime të kërkim shpëtimit dhe shërbime të ruajtjes së mjedisit dhe burimeve ujore;
- shkurtimin dhe thjeshtëzimin e linjës së komandimit të njësive detare për shkak të konsolidimit të të gjitha mjeteve lundruese detare në një strukturë të vetme;
- zvogëlimin e kohës së reagimit të mjeteve lundruese detare dhe rritjen e nivelit të bashkëpunimit me struktura të tjera që operojnë në det, nën koordinimin unik të Qendrës Ndërinstitucionale të Operacioneve Detare (QNOD);
- reduktimin e strukturave mbështetëse jo operacionale.

Forca Ajrore

Forca Ajrore është përgjegjëse për:

- kontributin kryesor në kryerjen dhe mbështetjen e operacioneve për vëzhgimin e hapësirës ajrore si dhe të policimit ajror, në bashkëveprim me strukturat e NATO-s;
- kryerjen e veprimtarisë operacionale që realizon funksionimin e shërbimit meteorologjik.

Rolet e reja të Strukturave të FA në Sistemin e Komandim Kontrollit

Përdorimi operacional i FA kryhet në interes të dy përfituesve kryesorë: autoriteteve civile kombëtare qendrore dhe lokale, në kuadër të operacioneve për përballimin e emergjencave civile, si dhe autoriteteve të NATO-s, në kuadër të angazhimeve të Shqipërisë në Aleancë.

Në raport me përfituesit e kontributeve operacionale, si në planin kombëtar ashtu dhe në atë ndërkombëtar, FA luajnë rolin e gjeneruesit të forcës (*force provider*). Sipas këtij koncepti, FA krijojnë dhe mbajnë në gatishmëri kapacitete operacionale ushtarake për t'i vënë në dispozicion të përdoruesve potencialë kombëtarë apo ndërkombëtarë, të cilët kryejnë funksionin e përdoruesit të forcës (*force user*). Në këtë rast, si përdorues force mund jenë autoritetet kombëtare të emergjencave civile, NATO, BE, OKB.

Në kuadrin e brendshëm, komandat e forcave, njësite dhe strukturave të tjera të FA kryejnë funksionin e gjeneruesit të forcës (*force provider*) dhe Shtabi i Përgjithshëm i FA kryen funksionin e përdoruesit të forcës (*force user*).




Figura 3: Paraqitje skematike e konceptit të përdorimit operacional të FA

Koncepti i përdorimit të FA në Emergjencat Civile

Përballimi i emergjencave civile përbën një ndër detyrat themelore të FA, të cilat përfaqësojnë njërën nga strukturat më të organizuara, të stërvitura, të pajisura dhe të gatshme në nivel kombëtar. Angazhimi i tyre në përballimin e emergjencave civile bëhet në kuadër të përpjekjeve kombëtare dhe në mbështetje e përforsim të autoriteteve përgjegjëse civile, të parashikuara me ligj. Angazhimi i FA në emergjenca civile bëhet me kërkesë të autoriteteve përgjegjëse, në raste kur përdorimi i aseteve të tjera civile ka rezultuar i pamjaftueshëm ose i paefektshëm. Strukturat e FA futen në veprim në kuadër të operacioneve të ndryshme me natyrë civile, si rregull, kur autoritetet civile si prefekturat, autoritetet lokale, policia, strukturat e emergjencës civile, strukturat zjarrfikëse, etj., kanë ezauruar kapacitetet e tyre në përballimin e situatave të caktuara.

Koncepti i përdorimit operacional të FA në emergjenca civile presupozon që strukturat e FA hyjnë, si rregull të dytat, në operacion, por kur ndërhyjnë ato shpalsin një kapacitet të lartë si në forca, ashtu dhe në mjete.

Pjesë e rëndësishme e konceptit të përdorimit operacional të FA, në ndihmë të autoriteteve dhe popullsisë civile, është edhe parimi i kontributit kundrejt rimbursimit. Autoritetet civile qendrore apo lokale mund të përfitojnë nga

angazhimi operacional i strukturave të FA, si rregull, **vetëm kundrejt rimbursimit financiar të shpenzimeve** të kryera nga ana e FA në interes të tyre.

Struktura kryesore e FA që kontribuon në plotësimin e misionit të FA për përballimin e emergjencave civile është Brigada e Mbështetjes Rajonale. Të gjitha strukturat e tjera të FA stërviten dhe mbajnë në gatishmëri forca dhe mjete për të kontribuar në përballimin e emergjencave civile.

Koncepti Logjistik i FA

Mbështetja logjistike në FA organizohet sipas këtyre parimeve:

- Përqendrimi i mbështetjes për mallrat dhe shërbimet të cilat nuk mund të realizohen në mënyrë eficiente nga njësitë e vartësisë së FA;
- Krijimi i autonomisë operationale për strukturat të cilat angazhohen drejtpërdrejt në operatione. Si rregull, autonomi logjistike kanë njësitë e nivelit batalion këmbësorie, bazë ajrore dhe flotilje detare.

Mbështetja logjistike ndërtohet në trajtën e një sistemi të plotë sipas parimit që mbështetja shkon nga **lart-poshtë**.

Zbatimi i këtij parimi siguron efikasitet maksimal të sistemit dhe kursen mjetet e domosdoshme. Kështu për shembull, nëse furnizimi me një artikull të caktuar do të realizohej në rrugën e kundërt, nga poshtë lart, pra nëse strukturat e vartësisë do të duhej të tërhiqnin vetë pranë strukturave eprorë artikujt për të cilët kanë nevojë, kjo do të sillte nevojën që gjithkush të kishte edhe mundësitë përkatëse për të realizuar furnizimin.

Ndjekja e rrugës së kundërt do të kërkonte që njësitë e FA të kishin mjete, personel, infrastrukturë, etj. për qëllime furnizimi, ndërkohë që nevojat për shërbime të tilla do të ishin jo të shpeshta. Për rrjedhojë, zbatimi i parimit nga poshtë-lart, në këtë rast, do të sillte pasojën e pajisjes me më shumë mjete e me më shumë personel, të cilat gjithsesi do të përdroreshin në mënyrë ekstensive.




Figura 4: Skema kryesore e konceptit të mbështetjes logjistike në FA

Mbështetja logjistike e veprimtarisë së përditshme të FA realizohet duke kombinuar shërbimet që kryhen nga vetë sistemi logjistik i FA me shërbimet që sigurohen nga kontraktorët, ku ndiqet parimi që sa më shumë shërbime të jetë e mundur të realizohen nëpërmjet kontraktorëve. Zbatimi i parimit të kontraktimit të shërbimeve synon që FA të ulin koston e shërbimeve të mbështetjes logjistike. Synimi i kontraktimit është që të shfrytëzohen kapacitetet e gatshme të ngritura nga ekonomia, duke eliminuar kështu nevojën e “rikrijimit” të kapaciteteve paralele në FA, për të cilat nuk ekziston realisht një “treg” i mjaftueshëm brenda FA, i tillë që të justifikojë shpenzimet.

Si rregull, FA ndërtojnë dhe mbajnë në funksionim ato shërbime, të cilat tregu ose nuk i ofron, ose i ofron me kosto më të lartë se sa vetë FA.

Mbështetja logjistike e veprimtarisë operacionale të FA realizohet duke kombinuar shërbimet që kryhen nga vetë sistemi logjistik i FA me shërbimet që sigurohen nga kontraktorët, ku ndiqet parimi që sa më shumë shërbime të jetë e mundur të realizohen nga sistemi logjistik i FA. Preferenca për shërbime nga vetë FA, në mbështetje të veprimtarisë operacionale, bazohet në natyrën komplekse të operacioneve dhe në nevojën për garanci absolute në mbështetje, e cila jo gjithmonë mund të ofrohet nga operatorët jo ushtarakë.

Koncepti i Garnizoneve (Kazermave) Ushtarake

Një ndër risitë e fundit në organizimin e FA është vënia në zbatim e konceptit të garnizonit apo kazermës ushtarake. Në kuptimin logjistik, garnizonet (kazermat) ushtarake konceptohen si qendra të banuara në të cilat punojnë, stërviten, jetojnë dhe kryejnë veprimtari të tjera ushtarake, civilë dhe struktura të ndryshme ushtarake.

Si rregull, menaxhimi dhe administrimi logjistik i garnizoneve (kazermave) ushtarake bëhet i veçantë nga mbështetja logjistike operacionale e strukturave ushtarake që janë dislokuar në kazermë.

Menaxhimi i garnizoneve (kazermave) ka për qëllim mbajtjen në gatishmëri dhe mirëfunksionimin e tyre, ndërkohë që mbështetja logjistike operacionale ka për qëllim plotësimin e nevojave të strukturave përkatëse ushtarake në plotësim të misionit.

Menaxhimi i garnizoneve (kazermave) fokusohet kryesisht në mbajtjen në gatishmëri dhe mirëfunksionimin e godinave, të rrjeteve inxhinierike, të shërbimeve komunale (furnizimin me ujë, energji elektrike, pastrimin, gjelbërimin, etj.). Gjithashtu, në këtë fushë përfshihen edhe shërbime të tjera si siguria dhe ruajtja, ushqimi, shërbimi shëndetësor, etj. Në rast se trupat e dislokuara në garnizon (kazermë) largohen prej aty për arsye stërvitore apo operacionale, personeli organik, i ngarkuar me menaxhim, administrim apo shërbime, vazhdon kryerjen e detyrës. Si rregull, trupat që largohen nga kazerma për arsye stërvitore apo operacionale, mbështeten nga strukturat operacionale të logjistikës.

Koncepti i Ndërlidhjes dhe Komunikimit

Mbështetja me shërbime të komandim kontrollit, ndërlidhjes dhe komunikimit

përbën një ndër parakushtet themelore për përmbushjen e misionit të FA.

Shërbimi i ndërlidhjes dhe i komunikimit siguron ndërlidhjen e plotë dhe të shumëllojshme mes strukturave të FA, në interes të funksionimit normal të tyre në kohë paqeje, krize dhe lufte. Agjencia e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe të Komunikimit (ASNI) është struktura që ka përgjegjësinë e sigurimit të ndërlidhjes nga lart deri në nivelin batalion, skuadrilje, flotilje, kompani mbështetjeje ose struktura të tjera të barazvlefshme.

Ashtu si dhe sistemi logjistik, shërbimi i ndërlidhjes dhe komunikimit organizohet nga lart-poshtë. Zbatimi i këtij parimi kërkon që eprorët të mundësojnë ndërlidhjen për strukturat dhe hallkat e vartësisë. Në ndërlidhje zbatohet parimi “*plug and play*”. Që të funksionojë një sistem i tillë duhet që dikush të ofrojë “prizën” me qëllim që abonenti të mund të vendosë “spinën” e tij. Në kushte të tilla eprori është përgjegjës për garantimin e “prizës”, gjë që nënkupton shtrirjen e rrjetit funksional deri tek përdoruesit, ndërkohë që përdoruesi apo vartësi ka përgjegjësinë e përdorimit të “spinës”, gjë që nënkupton aftësinë për t’u lidhur dhe për të operuar në rrjetin përkatës.




Figura 5: Skemë konceptuale e organizmit të sistemit të ndërlidhjes fikse në FA

Strukturat që mbështeten më shërbime ndërlidhjeje nga ASNI kanë statusin e abonentit në raport me të. Si abonentë të ASNI duhet të kuptohen të gjitha strukturat e nivelit batalion këmbësorie/bazë, ajrore/flotilje, detare/kompani mbështetjeje, apo të tjera struktura të barazvlefshme.

Koncepti i Arsimimit të Oficerëve

Vlerësimi i përvojës së gjatë të FA në arsimimin dhe edukimin e shumë brezave të oficerëve, ballafaqimi i kësaj përvoje me ato të vendeve të tjera të NATO-s dhe me perspektivën e zhvillimit të FA në të ardhmen, ka nxjerrë në pah nevojën për përqendrimin e të gjithë sistemit të përgatitjes së oficerëve në një institucion të

vetëm. Përqendrimi duhet të shoqërohet edhe me një rishikim të thellë të vetë sistemit të arsimimit, i cili duhet të ndjekë këto parime:

- Oficerët e FA duhet të kenë një formim të plotë ushtarak, që u mundëson atyre kryerjen me sukses të detyrave drejtuese, në krye të strukturave ushtarake, në të gjitha llojet e misionëve;
- Oficerët e FA duhet të kenë një formim të plotë universitar, i cili jo vetëm plotëson dhe mbështet realizimin e funksioneve drejtuese të oficerëve në fushën ushtarake, por edhe lehtëson integrimin e tyre në shoqëri pas përfundimit të karrierës ushtarake;
- Arsimimi i oficerëve duhet të realizohet në kuadër të një sistemi efikas, i cili të mundësojë përgatitjen e oficerëve me cilësinë më të lartë, në rrugën më të shkurtër dhe me koston optimale.

Realizimi i parimeve të mësipërme duket se mundësohet më së miri përmes rekrutimit të kandidatëve për oficerë nga radhët e atyre që, pasi kanë përfunduar me sukses studimet universitare, kërkojnë të bashkohen me FA. Kjo praktikë sjell si rezultat një ulje të ndjeshme të kohëzgjatjes dhe të koston së arsimimit të oficerëve dhe është në pajtim me shumë përvoja të mira që zbatohen në shumë vende të NATO-s. Pas rekrutimit, përmes rrugës së përshkruar më sipër, kandidatët duhet që gjatë karrierës së tyre ushtarake si oficerë, të kalojnë nëpër një sistem të kombinuar kursesh.

Kursi i Oficerit (KO)

Qëllimi i KO është edukimi dhe përgatitja e oficerëve të rinj për të shërbyer me përkushtim dhe profesionalizëm në FA të RSH.

Kursi i Oficerit, i cili është një kurs intensiv arsimimi, edukimi dhe stërvitjeje, zgjat rreth një vit akademik. Kursi i Oficerit ndiqet nga kandidatë për oficerë, të cilët janë rekrutuar pasi kanë përfunduar studimet e larta universitare dhe stërvitjen ushtarake bazë. Përfundimi i KO i jep kandidatëve për oficerë (kadetëve), të drejtën për të marrë gradën e parë ushtarake të oficerit.

Kursi Special i Oficerit (KSO)

Në KSO marrin pjesë oficerë që sapo kanë përfunduar Kursin e Oficerit (KO). KSO zgjat nga 4 deri në 12 muaj në varësi të llojit të trupës, armës apo shërbimit. KSO i aftëson kandidatët për oficerë për të kryer detyra në bazë të specialitetit ushtarak përkatës. KSO përgatit oficerin si këmbësor, artiljer, xhenier, ndërlidhës, zbulues, pilot, detar, etj. Gjithashtu KSO i përgatit kandidatët për oficerë për drejtimin special të strukturave bazë ushtarake, në nivelin e togës, ekuipazhit apo strukturave të njehsuara me to.

Kursi i Avancuar i Oficerit (KAO)

KAO ka për qëllim përgatitjen e oficerëve për marrjen e detyrës si komandant kompanie ose oficer shtabi në batalion dhe struktura të tjera të barazvlefshme. Ky kurs zgjat rreth 3 muaj. KAO ndiqet nga oficerët që kanë gradën kapiten. Përfundimi me sukses i këtij kursi është parakusht për marrjen e gradës major.

Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP)

KKSHP zgjat rreth një vit akademik. KKSHP ndiqet nga oficerë të përzgjedhur që kanë gradën major. Përfundimi me sukses i këtij kursi është parakusht për marrjen e gradës ushtarake nënkolonel. Gjithashtu, në përfundim të studimeve në KKSHP, për pjesëmarrësit më të suksesshëm mundësohet edhe diploma e nivelit master, në fushën e mbrojtjes.

Kursi i Lartë i Oficerit (KLO)

KLO zgjat rreth një vit akademik. KLO ndiqet nga oficerë të përzgjedhur që kanë gradën nënkolonel. Përfundimi me sukses i këtij kursi është parakusht për marrjen e gradës ushtarake kolonel. Gjithashtu, në përfundim të studimeve në KLO, për pjesëmarrësit më të suksesshëm mundësohet edhe diploma e nivelit master, në fushën e sigurisë.

Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLSM)

KLSM zgjat rreth tre muaj. KLSM ndiqet nga oficerë me gradën kolonel si dhe civilë me gradë ose rang të barazvlefshëm nga institucione të vendit. Në KLSM mund të marrin pjesë edhe ushtarakë e civilë që plotësojnë të njëjtat kushte nga vende të tjera, në kuadër marrëveshjesh dypalëshe.

Koncepti i Arsimimit Special në FA

Për të rritur më tej efektivitetin e arsimimit special në FA, është e nevojshme që seksionet e arsimimit të Shkollës së Trupës të riorganizohen duke u bashkëvendosur me strukturat kryesore të forcave apo trupave përkatëse. Qëllimi i bashkëvendosjes së seksioneve të SHT pranë njësive të FA është shfrytëzimi racional dhe efektiv i kapaciteteve teknike që disponojnë njësitë e FA, duke garantuar në këtë mënyrë një arsimim dhe stërvitje speciale në kushte optimale. Po ashtu, bashkëvendosja e seksioneve të SHT pranë njësive përkatëse të FA mundëson një angazhim më eficient të personelit mësimdhënës të SHT, i cili jo gjithmonë ka ngarkesë të plotë për zhvillim kursesh institucionale speciale. Në kushte të një ngarkese të tillë, krijohet mundësia që personeli mësimdhënës i SHT të mund të angazhohet edhe në detyra të karakterit stërvitor apo operacional, pranë njësive ku është vendosur. Kjo siguron një ndërthurje optimale mes përvojës mësimdhënëse dhe asaj stërvitore e operationale, e cila shkon në favor të një arsimimi dhe përgatitjeje më të mirë të personelit.

Zbatimi i një koncepti të tillë ul ndjeshëm nevojat për investime kapitale në drejtim të krijimit të kapaciteteve mësimore, pasi SHT i krijohet mundësia të përdorë kapacitetet reale të njësive të FA, në interes të procesit mësimor.

Zbatimi i një koncepti të tillë ul ndjeshëm nevojat për investime kapitale në drejtim të krijimit të kapaciteteve mësimore, pasi SHT i krijohet mundësia të përdorë kapacitetet reale të njësive të FA, në interes të procesit mësimor.

Skema e mëposhtme tregon konceptin e bashkëvendosjes së seksioneve të Shkollës së Trupës pranë njësive përkatëse të FA sipas specialiteteve.




Figura 6: Skema e organizimit të SHT sipas parimit të bashkëvendosjes së seksioneve të specialiteteve pranë njësie

Përfundime

Rishikimi i bazës konceptuale të FA ka qenë dhe mbetet një ndër elementët më të rëndësishëm të procesit të transformimit të tyre. Ky rishikim i është nënshtruar një diskutimi dhe konsultimi intensiv brenda FA dhe me partnerët tanë në NATO. Konferenca e V e Integritimit shënoi një moment kulmor, në këtë kontekst. Ajo konfirmoi seriozitetin e punës së bërë deri tani si dhe hapi perspektiva të tjera për vijimin e punës për hartimin e koncepteve të tjera, në shërbim të zhvillimit dhe perfeksionimit të mëtejshëm të FA.

Tashmë, FA kanë ripunuar pjesën më të madhe të koncepteve kryesore strategjike si ato të organizimit dhe funksionimit, të përdorimit operacional dhe të komandim-kontrollit, të gatishmërisë dhe të sigurisë e ruajtjes, të stërvitjes, të logjistikës dhe të ndërlidhjes, të transportit, të shëndetësisë, të garnizoneve ushtarake, të arsimit të oficerëve, të arsimit special, të rekrutimit, të menaxhimit të personelit, etj.. Por, në të njëjtën kohë, mbeten për t'u rishikuar apo për t'u hartuar një sërë konceptesh të tjera si ai për karrierën dhe gradat në FA, për policinë ushtarake, për zbulimin dhe inteligjencën, për rolin e komponentëve rezervë në FA, etj..

Përfundimi i procesit të rishikimit strategjik të mbrojtjes dhe i ciklit të radhës të procesit të planifikimit strategjik të NATO-s, do të hapin perspektiva të tjera për FA për të cilat, stadi i arritur deri tani nuk mund të konsiderohet më shumë se sa një pikënisje për ambicie dhe procese të reja.

Struktura e Re dhe sfidat e KDS-së

Gjeneral Brigade Bardhyl Hoxha,
Komandant i KDS

Trajtesë e shkurtuar. *Me strukturën e re të FA e në bazë të kërkesave që shtron Ligji i Arsimit të Lartë, Akademia e Mbrojtjes tashmë do të quhet Akademia e Forcave të Armatosura. Në përbërje të saj do të ketë dy Fakultete: ai i Arsimit të Përgjithshëm Ushtarak, Fakulteti i Sigurisë dhe Mbrojtjes si dhe Qendra e Gjuhëve të Huaja.*

Domosdoshmëri është shtimi i përpjekjeve për thellimin e bashkëpunimit me Institucionet e Arsimit të Lartë publik e jopublik, në interes të realizimit sa më cilësor të misionit të KDS, gjithnjë në funksion të realizimit të misionit kushtetues të FARSH.

Koha kërkon që përgatitja profesionale të përmirësohet vazhdimisht, mësimet e nxjerra të përdoren për të dritësuar objektivat tona për të ardhmen, baraspesha e duhur mes koncepteve akademike dhe realitetit operacional, të realizohen në një program arsimor efektiv për personelin e FA .

Këto çështje mëton të trajtojë ky shkrim i shkurtër për Revistën Ushtarake

FA-të, prej disa vitesh, janë futur tërësisht në procesin e ndryshimeve rrënjësore për reformimin dhe modernizimin e tyre, duke kaluar në një stad më cilësor. Kërcënimet ndaj sigurisë sot, janë shumë të ndryshme, më të vështira për t'u parashikuar dhe neutralizuar. Në këto kushte kërkohet që institucionet tona të arsimit dhe stërvitjes të përshtaten dhe kjo do të arrihet, në radhë të parë, nëpërmjet punës dhe përshtatjes së programeve të tyre për të përgatitur oficerë, nënoficerë dhe ushtarë, të aftë për të realizuar misionet dhe detyrat që kërkon koha dhe situatat operacionale.

Ndryshimet në mjedisin e sigurisë janë pasqyruar edhe në ndryshimet strukturore, gjithmonë për të siguruar përmbushjen e misionit tonë. Tani diktohet edhe më shumë nevoja e evoluimit të procesit të arsimit dhe stërvitjes, zhvillimit të koncepteve doktrinare dhe mbështetjes së vazhdueshme të procesit të përgatitjes profesionale në FA, ç'ka përkthehet në realizimin e misioneve dhe detyrave të tyre.

Synimi kryesor për ne do të jetë konsolidimi dhe ngritja në një shkallë më të lartë dhe më cilësore e arsimimit dhe stërvitjes në Akademinë e FA e në SHT, në përputhje me legjislacionin përkatës dhe udhëzimet e dhëna, larg “intelektualizmave boshe”, duke bërë të mundur, në radhë të parë, përgatitjen e ushtarakut shqiptar me të gjitha cilësitë dhe dijet e nevojshme profesionale, për t’i shërbyer sa më mirë forcimit dhe konsolidimit të FARSH.

Koha kërkon që përgatitja profesionale të përmirësohet vazhdimisht, mësimet e nxjerra të përdoren për të dritësuar objektivat tona për të ardhmen, barspesha e duhur mes koncepteve akademike dhe realitetit operacional, të realizohen në një program arsimor efektiv për personelin e FA .

Koha kërkon që përgatitja profesionale të përmirësohet vazhdimisht, mësimet e nxjerra të përdoren për të dritësuar objektivat tona për të ardhmen, barspesha e duhur mes koncepteve akademike dhe realitetit operacional, të realizohen në një program arsimor efektiv për personelin e FA .

Forcat e Armatosura dhe ne si KDS, duhet të ndërmarim veprime të vazhdueshme për të përmirësuar aftësitë operationale të trupës, të oficerëve dhe të nënoficerëve, në mënyrë që të vazhdojnë të operojnë në rrugë të efektshme në misionet e ngarkuara, qoftë dhe në mjedise luftime jo të zakonshme.

Procesi i përgatitjes profesionale në FA duhet të japë dhe të ndërthurë njohuri dhe aftësi të veçanta për drejtimin dhe menaxhimin e Forcave të Armatosura në luftë dhe në paqe, referuar në artin dhe në shkencën ushtarake, si për oficerët, për nënoficerët, pse jo, edhe për ushtarët. Zhvillimi me përgjegjësi i programeve dhe kurrikulave të arsimimit ushtarak si dhe puna kërkimore e shkencore në auditorët e KDS, nuk duhet të shihen si qëllim në vetvete e për interesa të ngushta apo “qëllime filantropike” për kontingjente jashtë strukturave të FA. Ato do të shqyrtohen të lidhura ngushtë me interesat, kërkesat dhe nevojat e FA, duke bërë orientimin e duhur dhe të drejtë me rrethanat e reja të krijuara në kuadrin e një mjedisi strategjik dhe operacional e gjithëpërfshirës.

Synimi kryesor në përgatitjen e ushtarëve do të jetë formimi i tyre me aftësitë e nevojshme në detyrat bazë, duke siguruar në radhë të parë transformimin në ushtarë pjesëtarë të FARSH, e më pas suksesi si pjesëtarë të grupeve të vogla e kontribuese në plotësimin e misionit të njësisë.

Roli që luan trupa e nënoficerëve si ndihmës e këshilltarë të oficerit dhe përgjegjës për stërvitjen, do të jetë dhe kushtëzimi bazë në konceptimin e arsimimit dhe stërvitjes profesionale të tyre. Rritja e cilësisë në arsimimin dhe stërvitjen institucionale do të përbëjë dhe rrugën kryesore për rritjen profesionale të kësaj trupe, duke synuar përgatitjen e tyre si drejtues dhe stërvitës të ushtarëve, grupeve të ushtarëve dhe nënoficerëve vartës.

Përgatitja e oficerëve si drejtues dhe luftëtarë, teknikisht e taktikisht kompetentë, zotërues të aftësive të larta drejtuese, që demonstrojnë besim, integritet, gjykim e përgjegjësi të fortë, që veprojnë në një gamë të gjerë misionesh e në një terren

kompleks e të ndryshueshëm, që janë të aftë të ndërtojnë grupe efektive mes ndryshimeve të shpeshta organizative dhe teknologjike dhe që zgjidhin problemet në mënyrë krijuese, do të jetë edhe thelbi i punës në Akademi të Forcave të Armatosura (AFA) dhe i gjithë procesit të arsimimit.

Stafi akademik, çelësi i suksesit

Detyra e KDS është të organizojë dhe të drejtojë përgatitjen, arsimimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm të oficerëve për të tre llojet e forcave. Ajo përpunon dhe sinkronizon konceptet doktrinale bazë për organizimin dhe përdorimin e Forcave të Armatosura, në përputhje me Strategjinë e Sigurimit, Politikën e Mbrojtjes dhe Strategjinë Ushtarake të RSH.

Në përputhje me strukturën e re të FA, e parë kjo mbi bazën e kërkesave që shtrun Ligji i Arsimit të Lartë, Akademia e Mbrojtjes tashmë do të quhet Akademia e Forcave të Armatosura dhe në përbërje të saj do të ketë dy fakultete: Fakulteti i Arsimit të Përgjithshëm Ushtarak dhe Fakulteti i Sigurisë dhe i Mbrojtjes si dhe Qendra e Gjuhëve të Huaja.

Fakulteti i Arsimit të Përgjithshëm Ushtarak-do të ketë objekt të punës së tij përgatitjen si oficerë të kandidatëve që do të rekrutohen nga të diplomuarit në universitetet e ndryshme të vendit apo të huaja, pra që kanë mbaruar programet e ciklit të parë të studimeve dhe do t'i nënshtrohen studimeve për marrjen e njohurive bazë të përgatitjes si ushtarakë. Kandidatët e përzgjedhur do të jenë sipas kërkesave të Forcave tona të Armatosura. Ky fakultet do të hartojë platformën e përzgjedhjes të oficerëve të rinj dhe njëkohësisht, pas miratimit të saj tek MM, do të fillojë punën për akreditimin e programeve në MASH.

Fakulteti i Sigurisë dhe i Mbrojtjes-do të vijojë punën për përgatitjen e kontingjenteve të oficerëve në kurset profesionale të parashikuara, nëpërmjet konsolidimit e përmirësimit të vazhdueshëm të programeve ushtarake (Kursi Themelor i Oficerit, Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm, Kursi i Avancuar i SHIU-t, Kursi i Lartë i Oficerit, Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes), por edhe ato të ciklit të II-të dhe të III-të “Master Profesional”, “Master i Shkencave” dhe në “Doktoraturë”, pasi programet e tyre janë të akredituara nga MASH.

Aktualisht jemi në fazën e fillimit të procesi mësimor në të gjitha nivelet dhe vëmendja jonë është përqendruar në mbarëvajtjen e procesit në të gjitha këto kurse. Kursi i IV i Sigurisë dhe Mbrojtjes, me pjesëmarrje edhe nga vendet e rajonit, tashmë vazhdon normalisht procesin mësimor, duke e kthyer në një institucion që përçon mendimin më të përparuar në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, si dhe promovon vlerat e Akademisë së Mbrojtjes duke e bërë të njohur jo vetëm në mjediset akademike brenda vendit, por edhe jashtë tij.

Një nga drejtimet kryesore do të jetë përzgjedhja e një stafi akademik cilësor, i cili plotëson të gjitha kërkesat që shtrun Ligji i Arsimit të Lartë dhe Ligji për “Gradat dhe Karrierën Ushtarake në FARSH”, pra të ketë mbaruar arsimin e lartë dhe atë pas universitar me rezultate shumë të mira, të jenë me një përvojë si drejtues të nënrepartëve dhe repartëve, me aftësi të spikatura për punën në grup.

Do synohet që stafi akademik të vijë nga trupa e oficerëve nëpër njësi dhe reparte, pasi për ne “laboratorët” e vërtetë janë njësitë dhe repartet e FA.

Do synohet që stafi akademik të vijë nga trupa e oficerëve nëpër njësi dhe reparte, pasi për ne “laboratorët” e vërtetë janë njësitë dhe repartet e FA.

Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, në bashkëpunim me Komandën/Rektoratin e AFA po punojnë dhe janë në përfundim të një Projekt-Udhëzimi “Për kriteret e rekrutimit të trupës akademike”.

Përpunimi i mendimit ushtarak

Kolona tjetër e rëndësishme ku mbështetet KDS, pas arsimimit dhe stërvitjes, është ajo që ka të bëjë me përpunimin e mendimit ushtarak, hartimin e doktrinave të FA, kryerjen e studimeve dhe analizave me subjekte nga fusha e sigurisë dhe e mbrojtjes, menaxhimi i procesit të kërkimit dhe zhvillimit në FA, standardizimit dhe zhvillimit të sistemit të mësimave të nxjerra.

Në stadin aktual të procesit të reformimit të FA, zhvillimi i doktrinës e përpunimi i manualeve të nevojshme si dhe standardizimi i stërvitjes së personelit, shtrohen si një domosdoshmëri që kërkon vëmendje të veçantë nga KDS në të ardhmen.

Qendra e Doktrinës është struktura e vetme “menaxhuese” e gjithë procesit të planifikimit, hartimit dhe miratimit të dokumenteve doktrinarë, të cilët përshkruajnë parimet themelore që udhëheqin FA.

Qendra e Doktrinës është struktura e vetme “menaxhuese” e gjithë procesit të planifikimit, hartimit dhe miratimit të dokumenteve doktrinarë, të cilët përshkruajnë parimet themelore që udhëheqin FA ose komponentët

e saj për arritjen e objektivave të strategjisë kombëtare, së bashku me taktikat, teknikat, procedurat dhe metodologjinë e zbatimit të këtyre parimeve doktrinare, çka përbën dhe bazën në hartimin e materialeve arsimore e stërvitore .

Procesi i hartimit dhe i botimit të doktrinës dhe të materialeve të tjera doktrinare është një proces i standardizuar ku Qendra e Doktrinës është instrument kryesor në këtë proces. Në të duhet të përfshihen të gjitha strukturat e FA, në nivel ekspertësh.

Ndikim të madh në hartimin e doktrinave dhe materialeve të tjera luajnë edhe “mësimet e nxjerra” si dhe konstatimet e bëra në operacione dhe stërvitje. Mësimet e nxjerra identifikohen nga operacionet që janë në zhvillim e sipër, si stërvitjet, kërcënimet aktuale apo dhe shembujt historikë. Mësimet e nxjerra nga operacionet në zbatim e sipër, sigurojnë një standard nga ku mund të gjykohet se çfarë shkon dhe çfarë nuk shkon mirë. Si përfundim logjik del se, raporti i doktrinës me mësimet e nxjerra siguron që doktrina të jetë aktuale dhe e përshtatshme. Sistemi i mësimave të nxjerra kërkon nga ne të shfrytëzojmë në maksimum teknologjinë e informacionit, të shkëmbimit të informacionit “online”, për të dhënë e marrë informacion për t’u përpunuar dhe analizuar.

Kjo Qendër gjithashtu bën vlerësimin dhe koordinimin e Listave të Kërkesave Përparesore për Ratifikim të STANAG/AP-ve të paraqitura, duke bërë vlerësimin

analitik të Raporteve të Vlerësimit të STANAG/AP-ve sipas fushave përkatëse, të hartuara nga komandat/drejtoritë në MM/SHP, në mbështetje të planit vjetor të standardizimit dhe të propozimeve standardizuese që burojnë nga programi i standardizimit i NATO-s.

Qendra e Simulimit (QS) që siguron një aftësi trajnuese të re e moderne e sjell përmirësimin e trajnimit për shtabet e FARSH, do të jetë plotësisht operacionale brenda muajit tetor të këtij viti. Në kuadër të 100 vjetorit, ajo do të zhvillojë stërvitjen e saj të parë të mbështetur me simulim..

Misioni i kësaj Qendre është sigurimi i një trajnimi cilësor dhe real për operacione të kombinuara të përbashkëta, përfshirë këtu edhe operacionet shumëkombëshe e ndërqeveritare, për komandantët dhe shtabet e FARSH-së, në përputhje me doktrinën kombëtare dhe ato të NATO-s.

Përfundime

-Duhet bërë rishikimi dhe përmirësimi i mëtejshëm i bazës ligjore si dhe miratimi i saj, për të siguruar integritimin e plotë të gjithë sistemit arsimor ushtarak, pasi dihet se KDS dhe strukturat e saj nuk kanë paralelizma të plota me strukturat e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Universiteteve. Kjo do të jetë e lidhur me rishikimin dhe përmirësimin e programeve të kurseve në AFA, ANO dhe SHT, duke e vënë theksin në përshtatjen dhe përgatitjen e kurrikulave arsimore, për realizimin e operacioneve në kuadër të NATO-s duke synuar hartimin e programeve të integruara për personelin e FA-së.

-Përzgjedhja e stafit akademik duhet bërë mbi bazë kriteresh akademike, por edhe të përvojës së tyre në njësitë e repartet e FA e, veçanërisht, në operacionet e NATO-s, duke angazhuar prurje të reja që vijnë nga “auditorët” e operacioneve në terren e njëkohësisht duke rritur peshën specifike të leksioneve dhe seminareve në gjuhën angleze, duke filluar këtë vit me 25% të tyre. Kështu do të hapim dritare të re informacioni dhe do t’u përgjigjemi më mirë kërkesave të kohës.

- Standardizimi dhe zhvillimi i sistemit të mësimave të nxjerra (LL), si elemente të domosdoshëm të integritimit në strukturat e NATO-s përbën anën tjetër të kësaj veprimtarie. KDS do të synojë që, nëpërmjet Qendrës së Doktrinës, të krijojë një “Database” të të dhënave elektronike për të gjithë botimet doktrinare të FARSH-së, STANAG, SLL dhe sigurimin e publikimit të tyre “online”.

-Mësimi është i shenjtë dhe kërkon korrektesë, ndjenjë përgjegjësie, bashkëpunim, mirëkuptim, kohezion, rezultate, duke shmangur sëmundjen e intelektualizmit.

Parakusht i realizimit të gjithë këtyre objektivave, është disiplina e hekurt, si ajo formale, ashtu edhe ajo shkencore.

Parakusht i realizimit të gjithë këtyre objektivave, është disiplina e hekurt, si ajo formale, ashtu edhe ajo shkencore.

-Komanda e Doktrinës dhe e Stërvitjes është strukturë bashkëpunuese në mjaft veprimtari të rëndësishme në festimet e 100 vjetorit dhe për botimet e ndryshme sikurse janë: Përgatitja dhe botimi i librit “Dëshmorët e Atdheut”, përgatitja dhe botimi i albumit fotografik “100 vjet Forca të Armatosura Shqiptare”, botimi i

“Doktrinës Ushtarake” (DP-01), “Rregullores së uniformave në FARSH” (RrP-1-4.2).

-Roli i KDS në përkujtimin e ngjarjeve historike që përkojnë me 100 vjetorin e pavarësisë dhe krijimin e Forcave të Armatosura është mjaft i rëndësishëm, pasi Komanda e Doktrinës dhe Stërviçjes është i vetmi institucion i FA, me personel dhe kapacitete të larta intelektuale dhe akademike, njohës shumë të mirë të historisë së Shtetit Shqiptar dhe veçanërisht të historisë e krijimit dhe arritjeve të FA.

Përgatitja e veprimtarive shkencore me tematikë “100 vjet shtet shqiptar-100 vjet Forca të Armatosura Shqiptare”, është konceptuar në dy konferenca shkencore:

Konferenca shkencore ndërkombëtare me titull “Shqipëria dhe shtetet e huaja në 100 vjet Pavarësi Kombëtare” dhe Konferenca shkencore me titull “Siguria në hapësirën shqiptare, FA dhe mendimi ushtarak shqiptar në 100 vjet”. Ngritja e Muzeut të Forcave të Armatosura nxjerr në pah vlerat historike dhe arritjet e FA, në 100 vjet të krijimit të tyre.

Për një Koncept të C2 të Strukturës së Re të FASH

Kol ® Thimi Hudhra,
Shef i Qendrës së Analizave të Mbrojtjes

Kol. Piro Ahmetaj,
Përfaqësues Kombëtar i RSH në SHAPE, NATO

Trajtesë e shkurtuar. *Komandimi dhe Kontrolli i Forcave të Armatosura (ajo që në gjuhën ushtarake shpesh quhet C2) është një pjesë e rëndësishme e artit dhe shkencës ushtarake. Klauzeviçi e shumë teoricienë të tjerë modernë e vendosin liderhipin midis faktorëve më themelorë të arritjes së fitores në luftë apo në një operacion.*

Forcat e Armatosura të RSH sot marrin pjesë në disa operacione të njëhershme brenda dhe jashtë vendit. Në të ardhmen, pritet një pjesëmarrje më e gjerë e tyre në të gjithë spektrin e operacioneve: luftarake, të mbështetjes së paqes, apo të emergjencave civile.

Normalisht vjen pyetja: çfarë ndryshime sjell spektri i ri i operacioneve të FASH në komandimin dhe kontrollin e tyre, sot dhe në të ardhmen? Çfarë duhet të ruhet nga përqsja tradicionale dhe çfarë koncepte të reja duhet të aplikohen në kushtet dhe realitetin konkret të FASH?

Dhe së fundi, meqë Forcat e Armatosura kanë vënë në zbatim strukturën e re të tyre 2012, a kemi nevojë për ndryshime në Ligjin mbi Autoritetet e Komandimit dhe Kontrollit Strategjik të FASH? Ky artikull mund t'i shërbejë hapjes së një debati të tillë nga ekspertët e fushës.

Hyrje

Reformat e mbrojtjes të fillim-shekullit të 21-të kanë një ndryshim thelbësor nga reformat e fund-shekullit të 20-të. Ndërsa ato të fund-shekullit të 20-të u projektuan kryesisht për shkurtime të ndjeshme në sasinë e Forcave të Armatosura, ato të fillim-shekullit të 21-të po konceptohen kryesisht për një rritje të cilësisë së tyre.

Kalimi nga operacionet e Luftës së Ftohtë në operacionet e pas-Luftës së Ftohtë ka sjellë një ndryshim apo larmi edhe të konceptit të Komandimit dhe Kontrollit (C2) të njësive të Forcave të Armatosura të shumë vendeve, në operacione

kombëtare dhe ndërkombëtare. Një transformim të thellë të përqaasjeve të C2 po sjell, sot dhe në të ardhmen, edhe zhvillimi i teknologjisë, kapacitetet e reja të forcës si dhe mjedisi tërësisht në zhvillim ku veprojnë forcat ushtarake.

Pse ndodh kjo? Ndryshe nga e kaluara, njësitë e FASH po marrin sot pjesë njëherësh në shumë operacione ndërkombëtare, nën drejtimin e NATO-s, BE-së, OKB-së apo të koalicioneve të rastit (ad-hoc). Këto operacione po zhvillohen me mijëra kilometra larg vendit tonë dhe shpesh edhe në kontinente të ndryshme. Po ashtu, ato po marrin pjesë dëndur edhe në operacione kombëtare të emergjencave civile, në mbështetje të autoriteteve civile, qendrore apo vendore. Në të gjithë spektrin e operacioneve, brenda dhe jashtë vendit, forcat e armatosura ia transferojnë autoritetin e komandim kontrollit operacional të tyre si organizmave ndërkombëtare ku ne aderojmë, ashtu edhe autoriteteve të tjera kombëtare sipas ligjeve në fuqi.

Larmia operacionale kërkon një këndvështrim të ri, si për planifikimin e forcës ashtu dhe për komandimin dhe kontrollin e operacioneve të FASH. Situata e larmishme operacionale kërkon që shumë asete strategjike duhet të centralizohen në nivel strategjik. Ndër të tjera, këtu mund të përmendim asetet e komandim-kontrollit, të komunikimit, të zbulimit, të transportit strategjik, të mbështetjes logjistike, etj.

Tani, pavarësisht rezistencës normale të atyre që mbështesin komandimin dhe kontrollin tradicional, jemi duke e tejkaluar konceptin e të menduarit në mënyrë të njëanshme për forcën tokësore, ajrore apo detare, apo të kapaciteteve të tjera mbështetëse. Jemi duke bërë

Jemi duke bërë përzgjedhjen midis konceptit tradicional të parcelizimit të shërbimeve dhe atij modern të integritit të kapaciteteve të forcës. Në mendimin tim, çfarë “do të mbjellim” sot në sistemin e planifikimit të forcës, “do të korrin” nesër në sistemin e planëzimit të operacioneve të FASH.

përzgjedhjen midis konceptit tradicional të parcelizimit të shërbimeve dhe atij modern të integritit të kapaciteteve të forcës. Në mendimin tim, çfarë “do të mbjellim” sot në sistemin e planifikimit të forcës, “do të korrin” nesër në sistemin e planëzimit të operacioneve të FASH.

Pa asnjë dyshim, tendencat janë për një koncept të integruar, si të zhvillimit ashtu dhe të përdorimit të kapaciteteve të forcave të armatosura, si një e tërë. Termat e rinj aleatë, tashmë të familjarizuar për personelin tonë ushtarak dhe civil, si ai “*joint-i bashkuar*” dhe “*comprehensive-gjithëpërfshirës*”, janë në axhendën operacionale të planëzuesve të FASH. Nga tradicionaliteti i shërbimeve të mëvetësishme të forcave tokësore, ajrore dhe detare, gjithnjë e më shumë po gjen zbatim koncepti i forcës së bashkuar “*joint*”.

Kur flasim për komandim kontroll kemi parasysh konceptin e Aleancës për këto dy terma¹. Një nga zhvillimet e 10 viteve të fundit në fushën e komandim-kontrollit

¹ **Komandimi** (*Command*). Komandimi është autoriteti që i jepet një individi për të drejtuar, koordinuar ose kontrolluar forcat e armatosura. Ai mund të përshkruhet si procesi me anë të të cilit një komandant shpreh vullnetin dhe synimet e tij tek vartësit për arritjen e objektivave të caktuara. Ai përfshin autoritetin

ka qenë ndarja e funksionit të trajnimit dhe stërvitjes nga funksioni i komandimit dhe kontrollit të operacioneve, nëpërmjet krijimit të komandave të veçanta për operacionet. Ky shembull është ndjekur nga SHBA (*US Regional Commands*), UK (*UK Joint Forces Command*), Gjermania (*Bundeswehr Operations Command*), Italia (*Commando Operative Interforze*), Spanja (*Joint Operations Command*), Hungaria (*Joint Force Command*), Kanadaja (*Canada Joint Operations Command*), Sllovenia (*Slovenia Force Command*), Maqedonia (*Joint Force Command*), etj. Po ashtu, vetë Aleanca ka krijuar komanda të veçanta për operacionet, duke përmendur këtu krahas SHAPË, edhe dy komandat e saj të bashkuara “joint” si JFC në Brunsumm dhe JFC në Napoli, apo krijimin e *Task Forcave* të Bashkuara Multinacionale (CJTF – Combined Joint Task Force).

Sa më sipër do të thotë që, sot e në vijim, si në planifikimin e forcës ashtu dhe në përdorimin e saj në operacion, duhet të udhëhiqemi nga koncepti i përdorimit modular në formacione “*task force*” të të gjithë kapaciteteve të FASH. Kjo do të thotë që nuk është më e nevojshme që forcat tokësore, ajrore dhe detare, të kenë më vete të gjitha kapacitetet që u duhen atyre për të plotësuar misionin e tyre.

Përkundrazi, është më e arsyeshme që Forca e Armatosur të ketë, si një e tërë, të gjitha paketat e kapaciteteve të mundshme për të përmbushur me sukses spektrin e operacioneve të tyre, sot dhe në të ardhmen. Kjo do të sjellë efektivitet më të madh, evitim të dublikimit të kapaciteteve, si dhe kosto më të ulët.

Përkundrazi, është më e arsyeshme që Forca e Armatosur të ketë, si një e tërë, të gjitha paketat e kapaciteteve të mundshme për të përmbushur me sukses spektrin e operacioneve të tyre, sot dhe në të ardhmen.

Kjo qasje po sjell sot një larmi krijimtarije në efektshmërinë e strukturave të komandim kontrollit, nën konceptin “*smart defence*” të Aleancës, duke tejkaluar kuadrin kombëtar të tyre. Në këtë kontekst, edhe ne duhet të mendojmë më thellë për një strukturë sa më të efektshme, sa më të vogël dhe sa më pak të kushtueshme të komandim kontrollit operacional të FASH, dhe përtej tyre.!!!

Ky është dhe qëllimi kryesor i këtij artikulli që mund të shërbejë si nxitës i mendimit për zhvillimin e një Koncepti të shkruar dhe të miratuar të Komandim Kontrollit të operacioneve të Forcave të Armatosura të RSH.

Disa Aspekte të Komandim-Kontrollit

Siç dihet tashmë, Komandimi dhe Kontrolli është i nivelit strategjik, i nivelit operativ dhe i nivelit taktik. Të tre nivelet janë të ndërvarur dhe ndërthurur me njëri tjetrin. Për një forcë të armatosur si e vendit tonë apo si e shumë vendeve të tjera aleate, niveli taktik dhe operativ japin efekte të ndjeshme në nivelin strategjik dhe anasjelltas. Sot, të gjithë po përjetojmë faktin që efektet e pjesëmarrjes në nivelin taktik, brenda dhe jashtë vendit, po japin efekte të ndjeshme në nivelin operativ dhe strategjik.

dhe përgjegjësinë për dislokimin dhe caktimin e forcave për të përmbushur misionet e tyre.

Kontrolli (*Control*). Kontrolli është autoriteti që ushtrohet nga një komandant mbi vartësit e tij. Ai mund të përshkruhet si procesi përmes të cilit një komandant, i ndihmuar nga shtabi i tij, organizon, drejton dhe koordinon veprimtaritë e forcave të caktuara, për të zbatuar urdhrat dhe direktivat.

Duke qenë një çështje tepër delikate, raporti i komandim-kontrollit të forcave të të gjitha niveleve është një çështje që gjithmonë e më shumë po stabilizohet me ligj. Kjo do të jetë akoma më e dukshme në të ardhmen. Mjafton të sjellim në vëmendje faktin që qoftë edhe një ushtar i plagosur në operacion, sot apo nesër, jep efekte të ndjeshme deri në nivelin strategjik.

Sipas doktrinës së NATO-s, në përgjithësi, Komandimi dhe Kontrolli i forcave në operacion mund të jetë komandim dhe kontroll i plotë (FULLCOM/FULLCON), ose komandim dhe kontroll operacional (OPCOM/OPCON)².

Disa nga format e Komandim Kontrollit që mund të kenë njësitë e Forcave të Armatosura në operacione të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, mund të jenë:

- Komandimi dhe Drejtimi nga komandat e njësive eprore prej tw cilave kanë dalë (njësia mëmë), pra që kanë komandimin dhe kontrollin e plotë të tyre (FULLCOM). Ky lloj komandim kontrolli do të jetë kryesisht në veprimtarinë e kohës së paqes, kryesisht gjatë trajnimit dhe stërvitjes së forcës, jashtë veprimtarive operacionale të njësive;
- Komandimi dhe Drejtimi nga një Qendër apo Komandë e Bashkuar Operacionale në nivel Force të Armatosur ose Kombëtar (OPCOM). Ky komandim kontroll do të jetë kryesisht gjatë periudhave të operacioneve kombëtare të njësive të FASH;
- Komandimi dhe Drejtimi nga një Komandë/Qendër Shumëkombëshe Ndërkombëtare që mund të drejtohet nga NATO, BE, OKB, Koalicion, etj. (OPCOM).

Duhet të mbajmë parasysh që me Transferimin e Autoritetit (ToA) të komandim kontrollit operacional të një njësie të vartësisë direkte, ruhen marrëdhënie të caktuara të komandim kontrollit midis të gjithë komandave që kanë lidhje me njësinë në fjalë. Në të tre rastet, mund të ketë një kombinim të marrëdhënieve të komandim kontrollit të plotë dhe të komandim kontrollit operacional të tyre. Në çdo rast, asnjë nga autoritetet/komandat nuk humbet tërësisht autoritetin e saj,

² **Komandim i Plotë (FULLCOM):** Autoriteti dhe përgjegjësia që i jepet një oficeri epror për t'iu dhënë urdhra vartësve të vet. Ai mbulon çdo aspekt të operacioneve ushtarake dhe të administrimit. Komandimi i Plotë ekziston vetëm në nivel kombëtar (AAP-6).

Komandim Operacional (OPCOM): Autoriteti që i jepet një komandanti për t'iu caktuar misione apo detyra komandantëve vartës, për të dislokuar njësitë apo repartet, për të riorganizuar forcat si dhe për të mbajtur apo deleguar kontrollin operacional dhe/ose taktik, kur ai e gjykon të nevojshme. Ai nuk përfshin përgjegjësinë për administrimin (AAP-6).

Kontroll Operacional (OPCON): Autoriteti që i delegohet një komandanti për të drejtuar forcat që i caktohen, në mënyrë që ai të përmbushë misione ose detyra të veçanta, të cilat zakonisht janë të kufizuara nga funksioni, koha, ose vendi; autoriteti për të dislokuar njësitë apo repartet vartëse si dhe për të mbajtur apo për të caktuar kontrollin taktik të këtyre njësive a reparteve. Kontrolli operacional nuk përfshin autoritetin për të caktuar përdorimin e pjesshëm të komponentëve të njësive a reparteve që i përkasin. Ai, gjithashtu, nuk përfshin kontrollin administrativ ose logjistik (AAP-6).

por marrin role specifike në funksion të pozicionit të komandim kontrollit që atyre iu jepet.

Nga ana tjetër, duhet të mbajmë parasysh se jo çdo operacion ndërkombëtar do të kërkojë strukturë të njëjtë të komandim kontrollit. Sipas AJP-1 (D), struktura ushtarake e NATO-s (por edhe e BE-së) mban në konsideratë tre modele komandimi. Secili model ofron një opsion të komandim kontrollit (C2) që mund të jetë i veçantë për çdo operacion të veçantë³

Si përfundim, një gjë është shumë e rëndësishme: në vartësi të variantit që do të përzgjidhet do të ndërtohen edhe strukturat përkatëse për ta aplikuar atë. Pra forma e përzgjedhur e komandim kontrollit jep impakte të konsiderueshme edhe mbi strukturën e FASH në tërësi.

C2 - Rasti i FASH

Në nivel strategjik, Shqipëria ka një ligj specifik në fuqi mbi Komandimin dhe Drejtimin Strategjik të FASH. Po ashtu, në nivel operativ, ne kemi një doktrinë kombëtare si dhe kemi ratifikuar Doktrinën e Komandim Kontrollit të Aleancës (STANAG 2199, ATP-3.2.2). Mbi këtë bazë, mendoj se jemi në kohën e duhur për përmirësimin e ligjit dhe të doktrinës kombëtare të Komandimit Kontrollit të FASH.

Për një forcë të armatosur të vogël si ajo e vendit tonë, gjejkoj që Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm duhet të zhvillohen dhe funksionojnë si një institucion akoma më i integruar se deri tani. Në kushtet e sotme, do të ishte luks të mbahen struktura paralele apo joproductive që shpesh pengojnë punët. Këto janë çështje të një debati profesional që duhet të hapet në institucionet e arsimit dhe kërkimit ushtarak.

Në kushtet e sotme, do të ishte luks të mbahen struktura paralele apo joproductive që shpesh pengojnë punët. Këto janë çështje të një debati profesional që duhet të hapet në institucionet e arsimit dhe kërkimit ushtarak.

³ **Modeli 1 - Plotësisht i Integruar (Fully Integrated).** Ky model i komandimit integron forcat bazuar në “ndarjen proporcionale”. Kjo ndarje mund të rezultojë në një ndërtim dypalësh ose shumëkombësh të shtabeve të nivelit operativ ose në nivel komponenti. Gjuha dhe procedurat e punës bihen dakord midis vendeve kontribuese. Komandantët e formacioneve të tilla shumëkombëshe caktohen kryesisht mbi bazë të rotacionit.

Modeli 2 - Vendi Drejtues (Lead Nation). Ky model i komandimit parashikon që një vend të marrë përsipër përgjegjësinë për planëzimin dhe zbatimin e një operacioni. Komandanti, shtabi, kapaciteti i komandim-kontrollit (C2), kapaciteti i komunikim-informimit, koordinimi i doktrinës dhe logjistikës të forcës bëhet nga një vend (vendi drejtues). Vende të tjera mund të ofrojnë kontributet e tyre për këtë forcë, si dhe të plotësojnë pozicione të stafit brenda shtabit të Vendi Drejtues.

Modeli 3 - Vendi Kuadër (Framework Nation). Ky model i komandimit parashikon që një vend ofron kuadrin e komandim kontrollit (C2). Pozicionet kryesore të shtabit si dhe elementët e mbështetjes së shtabit caktohen nga Vendi Kuadër. Ndërsa, gjuha dhe procedurat e punës bazohen në standardet e Aleancës.

Ky integrim i institucionit nuk do të thotë aspak që pjesët përbërëse të saj të humbasin funksionet e tyre specifike. Përkundrazi, këto funksione specifike duhet të përcaktohen qartë nëpërmjet procedurave standarde të veprimit. Struktura e integruar duhet të ruajë linjat e kontrollit civil, nëpërmjet zhvillimit të politikave, në përputhje me autoritetin që jepet nga kushtetuta dhe ligji si dhe linjat e profesionizmit ushtarak, nëpërmjet zbatimit të politikave, zhvillimit të kapaciteteve ushtarake, si dhe planëzimit dhe drejtimit të operacioneve ushtarake brenda dhe jashtë vendit.

Nga ana tjetër, zhvillimi dhe funksionimi i stafit të integruar të mbrojtjes kërkon kultivimin e një kulture të re të punës në grup, organizim të lartë, promovim të aftësive profesionale civile e ushtarake, si dhe mirëkuptim e mirëbesim midis civilëve dhe ushtarakëve në stafin e integruar.

Strukturimi i Ministrisë së Mbrojtjes në funksion të C2

Organizimi i strukturës së integruar të Ministrisë së Mbrojtjes duhet të përmbushë dy kushte kryesore: së pari ajo duhet të shërbejë si institucion i qeverisë së RSH në fushën e menaxhimit të mbrojtjes së vendit dhe së dyti, ajo duhet të shërbejë si strukturë ushtarake e planifikimit dhe e komandim-drejtimit të operacioneve, në nivel strategjik.

Funksionet e mësipërme mund të përmbushen në disa forma organizimi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm. Një pjesë e funksioneve janë civile, një pjesë janë funksione ushtarake, ndërsa pjesa më e madhe e tyre janë funksione mikse që kërkojnë ekspertizë të kombinuar civile dhe ushtarake. Në këtë rast, mund të shfrytëzohet si ekspertiza e ushtarakëve në rezervë apo ajo e civilëve të arsimuar në institucione të sigurisë, brenda dhe jashtë vendit.

Sipas përvojës së reformës së mbrojtjes, në dy dhjetëvjeçarët e fundit, struktura e MM apo e Forcave të Armatosura nuk ka qenë gjithçka që garanton funksionimin e suksesshëm të saj. Elementi më aktiv që e bën strukturën organizative funksionale ose jofunksionale janë personeli civil dhe ushtarak i saj. Strukturat janë diagrama të vdekura; është personeli që i bën këto struktura të gjalla dhe funksionale. Edhe struktura më e mirë mund të dështojë nëse nuk ka personel cilësor dhe procedura të sakta veprimi, por edhe struktura më e keqe mund të funksionojë me sukses kur ka cilësi profesionale, vullnet të aktorëve të saj dhe procedura pune të përpikta.

Strukturat janë diagrama të vdekura; është personeli që i bën këto struktura të gjalla dhe funksionale. Edhe struktura më e mirë mund të dështojë nëse nuk ka personel cilësor dhe procedura të sakta veprimi, por edhe struktura më e keqe mund të funksionojë me sukses kur ka cilësi profesionale, vullnet të aktorëve të saj dhe procedura pune të përpikta.

Mbi këtë këndvështrim, bazuar në teorinë dhe praktikën e deritanishme të komandimit dhe kontrollit, për kryerjen e misionit dhe funksioneve në nivel strategjik të Ministrisë së Mbrojtjes të RSH, janë përzgjedhur **4 Variante** të ndërtimit të saj. Secili prej rasteve kërkon konceptim, organizim dhe procedura veprimi të ndryshme:

a) Varianti 1: Ministri e Mbrojtjes Plotësisht e Integruar

Ky variant e ndan funksionin e politikave dhe planeve për zhvillimin e kapaciteteve ushtarake të vendit nga funksioni i përdorimit të forcave në operacion. Bazuar në specializimin e roleve, stafi i integruar i MM, kryen planifikimin dhe drejtimin strategjik të FASH, ndërsa një Komandë e Bashkuar Operacionale (KBO) (SHP si komandë unike) merr funksionet e komandim kontrollit të operacioneve të saj. Komandanti i kësaj komande është oficer madhor dhe futet në autoritetet e komandim kontrollit të FASH si zv/shef i SHSHP për Operacionet dhe varet direkt nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm. Zëvendësi tjetër i Shefit të SHP mund të mbulojë fushën e planifikimit të mbrojtjes dhe të jetë zv. Shef i SHP për Planifikimin.

Në këtë variant, stafi i integruar i MM duhet të jetë stafi më i vogël në numër në nivel strategjik dhe do të merret vetëm me planifikimin, zhvillimin, organizimin, koordinimin, monitorimin dhe mbështetjen e FASH në tërësi dhe jo me drejtimin operacional të përditshëm të njësive të tij. Nga ana tjetër, Komandanti i KBO ka një shtab tipik operacional të standardit G1-G9 për përmbushjen e misionit të tij. KBO mban lidhje të forta me stafin e integruar të MM nëpërmjet mesimeve të nxjerra nga operacionet dhe stërvitjet e FA.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FASH në këtë variant merr funksionet e Shefit të Mbrojtjes (*CHoD*). Ai e transferon linjën e komandim-drejtimit direkt të operacioneve aktuale të FA tek Komandanti i KBO. Në fokus të Shefit të Mbrojtjes janë çështjet e këshillimit strategjik të autoriteteve të larta civile, të planifikimit të mbrojtjes dhe të zhvillimit të kapaciteteve ushtarake në nivel strategjik, të planëzimit të kapaciteteve për operacione ndërkombëtare dhe kombëtare, të zbatimit të marrëdhënieve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes, të marrëdhënieve ndërinstitucionale, të zhvillimit të qëndrimeve ushtarake në fushën e mbrojtjes, të dhënies së ekspertizës ushtarake në çështjet e sigurisë, të përfaqësimit ndërkombëtar në forumet më të larta të Shefave të Mbrojtjes, etj.

Ndryshe nga KBO, Shefi i Mbrojtjes nuk ka një staf tipik të komandimit dhe drejtimin strategjik të formatit J1-J9, sepse ky staf është integruar në stafin e MM. Në rastin e një MM/SHP të integruar, stafi civil dhe ushtarak do të jetë i integruar për të përmbushur misionet e mësipërme. Nuk do të ketë departamente të veçanta civile për Ministrin e Mbrojtjes (MM) dhe Departamente të veçanta ushtarake për Shefin e Shtabit të Përgjithshëm (SHSHP). Të gjitha departamentet do të jenë mikse dhe do t'i shërbejnë të dy autoriteteve, mbi bazën e procedurave standarde të veprimit, të përshkuara qartë.

Bazuar në këtë koncept, departamentet e stafit të integruar që do të kenë më shumë funksione të zhvillimit të politikave e të menaxhimit, do të kryesohen nga drejtues civilë, ndërsa ato që do të kërkojnë më shumë ekspertizë ushtarake dhe operacionale, do të drejtohen nga ushtarakët. Për zëvendësit e tyre mund të jetë e kundërta, pra ato që e kanë drejtuesin civil, do ta kenë zëvendësin ushtarak dhe anasjelltas. Po kështu, edhe përbërja dhe ekspertiza e departamenteve duhet të jetë civilo-ushtarake, në përpjesëtim të drejtë dhe në harmoni me funksionet kryesore që ato përmbushin: zhvillim politikash, planëzim, menaxhim, apo zbatim të tyre.

Është shumë e rëndësishme të kuptohet që në këtë variant të stafit të integruar të MM, rolin e disponuesit të forcës (*force provider*) do ta luajnë komandat e forcave (njësive), ndërsa rolin e përdoruesit të forcës (*force user*) për operacion do ta luajë KBO. Pra në një operacion të caktuar, komanda që vë forca në dispozicion (*disponuesi i forcës*) e humbet autoritetin e komandim-drejtimit si njësi mëmë dhe ia kalon atë KBO. Në këtë rast, sipas standardeve të NATO-s, niveli i komandim-kontrollit të Komandës Operacionale ndaj komandave të njësive që i vihen në dispozicion për operacion, quhet komandim-kontroll operacional (*OPCOM dhe OPCON*), ndërsa, autoriteti i komandim-kontrollit të plotë (*FULLCOM dhe FULLCON*) vazhdon të mbetet në komandat që e kanë vënë forcën në dispozicion (*disponuesit e forcës*).

Ky variant i stafit plotësisht të integruar të Ministrisë së Mbrojtjes është strukturë që aplikohet me sukses në vendet europiane me pjekuri dhe përvojë ushtarake dhe me kulturë të lartë demokratike. Si variant që bazohet në specializimin e roleve, ai kërkon trajnim të veçantë të stafeve civile dhe ushtarake dhe procedura të sakta për funksionimin e tij, sipas konceptit të integruar.

b) Varianti 2: Ministri e Mbrojtjes Gjysmë e Integruar

Në këtë variant hibrid, funksionet kryesore civile do të përmbushen nga departamentet civile, funksionet kryesore ushtarake do të përmbushen nga ato ushtarake, ndërsa ato që kërkojnë ekspertizë të integruar do të përmbushen nga një staf i integruar civilo-ushtarak me vartësi të dyfishtë si në variantin e parë.

Me këtë variant, Ministri i Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm do të kenë disa struktura tipike respektivisht në vartësi direkte të tyre, ndërsa disa të tjera nuk do t'i kenë të integruara si në variantin e parë. Ata mund të kenë të integruara vetëm ato departamente që kanë funksione të përafërta apo që mund të integrohen; p.sh. Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të MM me Drejtorinë J1 të SHP; Drejtorinë e Zhvillimit të Plan-Politikave në MM me J5 në SHP, Drejtorinë e Menaxhimit të Buxhetit në MM me J8 në SHP, QKMBM me J9, etj.

Të gjitha departamentet e integruara do të jenë mikse si në variantin e parë, ndërsa të tjerat do të ruajnë linjën e pastër civile apo ushtarake, sipas funksioneve të tyre. Po ashtu, ndarja e funksioneve në këtë variant do të bëhet sipas konceptit të kësaj strukture: pra departamentet civile do të mbajnë përgjegjësi për funksionet civile, departamentet ushtarake për ato ushtarake, si dhe ato të integruara për funksionet e integruara.

Në këtë variant, vetë Shefi i Shtabit të Përgjithshëm do të ketë vartësi direkte vetëm ndaj strukturave tipike ushtarake të SHP dhe vartësi të integruar (ose linja koordinimi) ndaj të gjitha departamenteve të integruara të MM. Ai nuk ka një shtab të plotë sipas formatit J1-J9, por minimalisht, duhet të ketë në vartësi direkte strukturat e J2, të J3/7, të J4, dhe të J6, të cilat kanë lidhje më të afërta me strukturat operacionale. Po ashtu, nëse do të përzgjidhet ky variant, rekomandojmë që Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të ketë në vartësi direkte edhe një Qendër Operacionale të Mbrojtjes (QOM), pra jo një KBO si në rastin e parë.

QOM ka shumë më pak autoritet të komandim-kontrollit mbi njësitë e forcave të armatosura se KBO. Me ligj, në raste të situatave të emergjencave, të krizave apo të gjendjeve të luftës, Qendra Operacionale e Mbrojtjes mund të marrë funksionet e një Komande Operacionale të drejtuar nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, duke e përforcuar sipas roleve përkatëse edhe të gjithë stafin ushtarak të Shtabit të Përgjithshëm (J2, 3/7, 4, 6).

Shefi i QOM është oficer me gradë më të ulët se komandanti i KBO të variantit të parë dhe nuk hyn në autoritetet e komandim-drejtimin strategjik të FASH. Ai ka një shtab të lehtë të drejtimit operacional pa autoritet komandimi dhe vendimmarrje, që ndjek situatat dhe përgatit raporte periodikë operacionale për Ministrin dhe Shefin e SHP dhe stafin e tij. Qendra Operacionale mban lidhje direkte me Shefin e SHP, stafin e tij si dhe me stafin e integruar të MM për çështjet që lidhen me operacionet aktuale të FA.

Nëse përzgjidhet ky variant, MM/SHP duhet të kenë/zhvillojnë struktura shumë të mira civile, të drejtuara nga civilë për menaxhimin dhe zhvillimin e politikave të kontrollit civil mbi FA, po ashtu, duhet të kenë struktura ushtarake të mira për ekspertizë tipike ushtarake të drejtuara nga ushtarakë, si dhe struktura të integruara ku kërkohet ekspertizë e integruar civilo-ushtarake, të drejtuara, sipas rastit, nga civilë apo nga ushtarakë. Për zhvillimin e kësaj strukture nuk mund të jepen receta të arta; ajo ka dinamikën e vet për vende të veçanta, bazohet në realitetin konkret, në traditat, nivelin dhe kulturën, vullnetin politik, punën në ekip, etj.

Midis 4 varianteve të këtij studimi, MM gjysmë e integruar ka një staf me numër mesatar, i cili do të merret jo vetëm me planifikimin, zhvillimin, organizimin, koordinimin, monitorimin dhe mbështetjen e FASH në tërësi, por nëpërmjet QOM, edhe me drejtimin operacional të përditshëm të njësisve të tij. Pra, do të ketë një sy tek zhvillimi i forcës dhe një sy tek operacionet.

Varianti i stafit gjysmë të integruar të MM është strukturë që aplikohet me sukses në disa vende dhe që kërkon trajnim të veçantë të stafeve civile dhe ushtarake dhe procedura të sakta për funksionimin e tij.

Në këtë variant, duke mbajtur parasysh që struktura e FASH ka nën Shtabin e Përgjithshëm direkt njësinë në nivel Force/ Brigade, rekomandojmë që disponuesi i forcës (force provider) të jetë njësi në nivel Force/ Brigade, ndërsa përdoruesi i forcës (force user) të jetë Shtabi i Përgjithshëm, i ndihmuar nga QOM.

Në këtë variant, duke mbajtur parasysh që struktura e FASH ka nën Shtabin e Përgjithshëm direkt njësinë në nivel Force/ Brigade, rekomandojmë që disponuesi i forcës (force provider) të jetë njësi në nivel Force/ Brigade, ndërsa përdoruesi i forcës (force user) të jetë Shtabi i Përgjithshëm, i ndihmuar nga QOM.

c) Varianti 3: Ndarje e Roleve Civile të MM nga Rolet Ushtarake të SHP

Ky është varianti tradicional i FASH si dhe i shumë vendeve të lindjes, para anëtarësimit në Aleancë. Ky variant mbështet parcelizimin e funksioneve dhe është e kundërta e strukturës së integruar. Në këtë rast, Ministria e Mbrojtjes

merr përsipër funksionin e kontrollit civil mbi FASH (personelin, financat dhe ligjet), ndërsa Shtabi i Përgjithshëm është edhe staf strategjik i zhvillimit të forcës si dhe kryen njëkohësisht edhe funksionin e komandës unike të Forcave të Armatosura. Shefi i SHP është edhe komandant i Forcave të Armatosura, si dhe Shtabi i Përgjithshëm është edhe shtab i operacioneve të FASH.

Ky variant, në kohën e vet, ka pasur anë pozitive, por edhe anë negative. Ato mund të jenë të natyrës objektive dhe subjektive. Vendimmarrja për përzgjedhjen e këtij varianti duhet të vlerësojë drejt peshën e tyre në realitetin konkret të vendit tonë. Në gjykimin tonë, ky variant i përket të shkuarës.

Me këtë variant, Ministri i Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm do të kenë struktura tipike nën vartësinë e tyre. Pothuaj e gjithë ekspertiza civile do të kalojë në vartësi të Ministrit të Mbrojtjes dhe e gjithë ekspertiza ushtarake në vartësi të Shefit të SHP. Të gjithë departamentet civile do të jenë në vartësi të MM dhe të gjithë departamentet ushtarake do të jenë në vartësinë e Shefit të SHP. Shefi i SHP do të ketë një strukturë të plotë ushtarake të formatit J1-J9, të përforcuar për zhvillimin e kapaciteteve ushtarake dhe komandimin dhe drejtimin e operacioneve ushtarake kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në këtë variant, Ministri i Mbrojtjes do të ketë ekspertizë të kufizuar ushtarake dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm do të ketë ekspertizë të kufizuar në zhvillimin e politikave e të menaxhimit të çështjeve të mbrojtjes. Këto kufizime do të reflektohen edhe në stafet e tyre respektive. Përvoja ka treguar që struktura të tilla karakterizohen nga ndarja e theksuar e ekspertizës, nga vështirësi të mëdha të natyrës organizative, nga vështirësi të tjera të qëndrimeve subjektive të autoriteteve dhe stafeve përkatëse, të cilat mund të rëndohen në rastet e vendeve me kulturë jo të lartë demokratike.

Ky variant bazohet në konceptin e përjasjes të ndarjes së funksioneve të zhvillimit të politikave të mbrojtjes me funksionet e zhvillimit të kapaciteteve të forcës dhe të kryerjes së operacioneve ushtarake.

Ky variant bazohet në konceptin e përjasjes të ndarjes së funksioneve të zhvillimit të politikave të mbrojtjes me funksionet e zhvillimit të kapaciteteve të forcës dhe të kryerjes së operacioneve ushtarake. Të parat

mund të jenë funksione kryesisht civile dhe të dytat funksione kryesisht ushtarake. Për këtë variant, departamentet civile të MM do të kenë kryesisht ekspertizë civile të zhvillimit të politikave dhe të menaxhimit, ndërsa departamentet ushtarake të SHP do të kenë kryesisht ekspertizë ushtarake të zhvillimit të forcës dhe përdorimit kësaj në operacion. Ky është sistemi klasik i ndërtimit të institucioneve të mbrojtjes dhe i ushtrimit të kontrollit civil mbi forcat e armatosura, por që shpesh karakterizohet nga një punë disi e izoluar e stafeve civile dhe atyre ushtarake, qëndrimin në pritje për direktiva dhe udhëzime të autoriteteve civile, zgjatjen e proceseve, besimin e lëkundur ndaj njëri tjetrit, konkurrencën, etj.

Nëse përzgjidhet ky variant, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm do të ketë në vartësi direkte një Qendër Operacionale të Mbrojtjes (QOM) apo Grup Drejtimi (GD) për ndjekjen e situatës operacionale të FASH. Kjo QOM, me personel të kufizuar,

në raste të situatave të emergjencave, të krizave apo të gjendjeve të luftës, mund të kthehet në Komandë të Bashkuar Operacionale, të drejtuar nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, bazuar tërësisht në strukturën e Shtabit të Përgjithshëm.

Ky variant kërkon një numër më të madh personeli civilo-ushtarak se të gjithë variantet e tjera, sepse si Ministria e Mbrojtjes ashtu dhe Shtabi i Përgjithshëm do të synojnë struktura të plota për të kryer më vete misionin e tyre. Në këtë variant, duke mbajtur parasysh që struktura e FASH ka nën Shtabin e Përgjithshëm direkt njësinë në nivel Force/ Brigade, rekomandohet që disponuesi i forcës (*force provider*) të jetë njësia në nivel Force/Brigadë, ndërsa përdoruesi i forcës (*force user*) të jetë Shtabi i Përgjithshëm i FASH.

d) Varianti 4: MM/SHP me vartësi ndaj një Komande të Forcës së Bashkuar (KFB)

Koncepti i këtij varianti bazohet, nga njëra anë, në ndërtimin e një strukture të integruar të MM/SHP si në variantin e parë dhe, nga ana tjetër, në ngritjen e një Komande të Forcës së Bashkuar (KFB), të fokusuar në Komandimin dhe Drejtimin e Plotë të forcave (*FULLCOM dhe FULLCON*) në kohë paqe, krize dhe lufte (*pra jo vetëm OPCOM/OPCON*). Komanda e Forcës së Bashkuar ka autoritet komandim-kontrolli mbi të gjitha njësitë dhe repartet e FASH. Komandanti i Forcës së Bashkuar varet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm.

Ashtu si në variantin e parë, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm merr funksionet e Shefit të Mbrojtjes (*CHoD*). Linjën e komandim-kontrollit direkt të forcave e ka komandanti i KFB, ndërsa Shefi i SHP merr funksionet e këshillimit strategjik të autoriteteve të larta civile, të planifikimit të mbrojtjes dhe të zhvillimit të kapaciteteve ushtarake në nivel strategjik, të planëzimit të kapaciteteve për operacione ndërkombëtare dhe kombëtare, të zbatimit të marrëdhënieve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes, të marrëdhënieve ndërinstucionale, të zhvillimit të qëndrimeve ushtarake në fushën e mbrojtjes, të dhënies së ekspertizës ushtarake në çështjet e sigurisë, të përfaqësimit ndërkombëtar në forumet e larta të Shefave të Mbrojtjes, etj.

Në këtë variant, Shtabi i Përgjithshëm nuk është komandë unike e FA. Si i tillë, ai nuk është një staf tipik i komandimit dhe drejtimin strategjik të formatit J1-J9, por një shtab i vogël i Shefit të SHP, si pjesë e strukturës së integruar të MM/SHP, i fokusuar në përmbushjen e funksioneve të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

Komandanti i KFB është oficer madhor (gjeneral major) dhe hyn në autoritetet e komandim-drejtimin strategjik të FA. Ai ka një shtab të nivelit operativ të standardit G1-G9 për përmbushjen e misionit të tij. Ai ka në vartësi direkte të gjitha njësitë taktike të FASH-ut, përveç atyre në vartësi direkte të MM/SHP. KFB mban lidhje të forta me stafin e integruar të MM/SHP.

E veçanta e këtij variant është se KFB është njëkohësisht edhe disponues i forcës (*force provider*) edhe përdorues i forcës (*force user*). Ajo, përveç se drejton gjithë aktivitetin e përditshëm të të gjithë forcave në vartësi të drejtpërdrejtë, mban gjithashtu nën komandim dhe kontroll operacional të gjithë forcat në operacion

brenda dhe jashtë vendit, pra ka rol të dyfishtë.

Ky variant është shumë i përshtatshëm për vendet e vogla. Zbatimi i tij kërkon një bazë ligjore të plotë, një procedurë standarde veprimi të qartë, si dhe trajnim të veçantë të stafeve përkatëse në nivel strategjik, operativ dhe taktik.

Përfundime:

- Nga koncepti i komandim kontrollit të FASH do të varet ndjeshëm struktura e FASH. Pra koncepti i C2 duhet të jetë i pari dhe struktura vjen e dyta. Një strukturë force që ndërtohet pa një koncept të C2 ka pak gjasa të funksionojë me sukses;
- Nga të 4 variantet e mësipërme mund të gjenerohen edhe variante të tjera hibride. Të gjitha variantet mund të jenë të pranueshme, me anët pozitive dhe negative që ato mbartin. E vërteta është se tendencat e sotme po shkojnë drejt strukturave të integruara të mbrojtjes. Nga ana tjetër, që të jenë të suksesshme, strukturat e integruara kërkojnë kohë, kulturë dhe trajnim të përbashkët civil dhe ushtarak në të gjitha nivelet;
- Varianti që duhet të përzgjidhet në rastin tonë duhet të jetë ai variant që suportohet më lehtë nga gjendja reale dhe perspektiva e FASH, nga vullneti i autoriteteve politike dhe ushtarake, nga niveli profesional dhe kulturor, interesat, karakteristikat, traditat dhe mbështetja me burime njerëzore, materiale dhe financiare në periudhën afatmesme, etj.;
- Autorët e këtij shkrimi rekomandojnë që e ardhmja e strukturës së komandimit dhe drejtimit të FASH të synojë variantin e parë. Për të bërë që ky variant të jetë i suksesshëm nesër, duhet që të përgatitim suksesin e tij qysh sot. Arritja e suksesit të këtij varianti kërkon një përgatitje të plotë të stafeve civile dhe ushtarake të FASH në nivelin strategjik, operativ dhe taktik.

Bibliografia:

- Ligji mbi Autoritetet e Komandimit dhe Kontrollit Strategjik të FA të RSH Nr. 9194, datë 19.2.2004.
- AJP-1 (D) Allied Joint Doctrine, Dec 2010.
- ATP 3.2.2 STANAG 2199, Command and Control of Allied Land Forces, February 2009.
- Understanding Command and Control, David S. Alberts, Richard E. Hayes, 2006.
- Command and Control Arrangements in United Nations Peacekeeping Operations, Nov 2009.
- David S. Alberts, Ph.D, Richard E. Hayes Ph.D, May 1995 Command Arrangements for Peace Operations May 1995.

RUBRIKA E DYTË

Analiza, Sinteza dhe Vlerësime të Sigurisë

Në këtë Rubrikë më së pari vjen opinioni i Gjeneral Major Viktor Berdo, Zëvendësshef i Shtabit të Përgjithshëm. Ai vjen me një shqetësim jetik tanimë për FA-të. Gjenerali, me përvojën e gjatë që ka me trupat, me stërvitjen e tyre, kryesisht atyre që shkojnë në misione, shtjellon në thellësi çështjen e psikologut dhe të rolit të tij në FA. Është një shtjellim shterues, ku ndër të tjera ai nënvizon: -"Hapat e parë duhen hedhur në njohjen e rolit dhe punës së psikologut, i cili duhet të kryhet njëkohësisht me procesin e rekrutimit."

Opinion tjetër është ai i Gjeneral Brigade Abaz Lleshi, Komandant i BrMR-së. Gjeneral Lleshi sjell vlerësimet e tij, sa i takon një teme që po bëhet domosdoshmëri, sidomos në kushtet kur të gjithë aleatët e NATO-s veprojnë me devizën "*Smart Defense*". Ai shtjellon çështjen e bashkëpunimit dhe bashkëfunksionimit rajonal në përballimin e Emergjencave Civile.

"Koncepti i përballimit të emergjencave civile dhe mbrojtjes nga pasojat e katastrofave të ndryshme nuk do të ishte i plotë nëse ai konceptohet si kompetencë ekskluzive vetëm e një shteti. Kjo pasi emergjencat dhe katastrofat e mundshme natyrore mund të ndodhin jo vetëm brenda territorit të një vendi, por ato mund të kenë një shtrirje rajonale e më gjerë"-nënvizon Gjeneral Abaz Lleshi.

Efektet psikologjike të luftës dhe trajtimi i tyre

Gjeneral Major Viktor Berdo,
Zëvendëseshë i SHPFA

Trajtesë e shkurtuar. *Përfshirja e trupave ushtarake në misionet paqeruajtëse, gjithëherë është shoqëruar me shfaqjen e shqetësime të ndryshme të karakterit psikologjik si: stres posttraumatik; abuzim me substancë; ankth; dhunë fizike dhe psikologjike në familje; izolim social, etj. gjë e cila e bëri të nevojshme hedhjen e fillesave të trajtimit psikologjik të tyre.*

Angazhimet e trupave ushtarake në konflikte, luftëra dhe dislokime ka qenë stres për ushtarakët dhe familjet e tyre. Efektet psikologjike mbi ushtarakët dhe familjet e tyre mund të jenë jashtëzakonisht të vështira për t'u kapërcyer para, gjatë dhe post-dislokimeve ushtarake. Ushtarakët duhen parë si pjesë e rëndësishme e shoqërisë. Ata janë një grup shoqëror i rëndësishëm dhe rritja e problemeve psikologjike tek ky grup shoqëror dhe familjet e tyre, padyshim që ndikon në komunitetin dhe shoqërinë tonë. Kujdesi dhe adresimi për zgjidhje të këtyre çështjeve potenciale është jetike, si për suksesin e familjes, për shëndetin e ushtarakëve dhe të vetë shoqërinë.

Ç'është efekti psikologjik?

Efektet psikologjike të luftës është një koncept që përfshin një shumëllojshmëri të gjerë të proceseve dhe ndikimeve negative, të cilat së bashku duhet të merren parasysh në vlerësimin e kostos me efekte të menjëhershme apo afatgjata që ato japin.

Trajtimi psikologjik i trupave ushtarake në të gjitha ushtritë e botës ka filluar dhe ecur me hapa të ngadalta duke përfutur përvojë nga praktika. Trajtimi psikologjik i trupave ushtarake fillon që nga rekrutimi i tyre .

Në ushtritë perëndimore, gjatë procesit të rekrutimit, kandidatët për t'u bërë pjesë e forcave të armatosura kalojnë nëpërmjet një testimi të gjatë psikologjik, që është i ndryshëm për studentët ushtarakë dhe rekrutët që do të punojnë me kontratë. Për forcat tona të armatosura krahas problemeve që kemi në ngritjen e një

Hapat e parë duhen hedhur në njohjen e rolit dhe punës së psikologut, i cili duhet të kryhet njëkohësisht me procesin e rekrutimit.

praktike të tillë, pengesa fillestare lidhet me mungesën e një kulture të hapur ndaj shërbimit të psikologut. Hapat e parë duhen hedhur në njohjen e rolit dhe punës së psikologut, i cili duhet të kryhet njëkohësisht me procesin e rekrutimit.

Për studentët në shkollat ushtarake, trajtimi psikologjik është i vazhdueshëm dhe duhet të ndiqet nga grupe të specializuara psikologjesh, punonjës socialë dhe specialistë të tjerë të shëndetit mendor. Kjo arrihet nëpërmjet takimeve në grup, takimeve individuale ku specialistët vlerësojnë performancën dhe qëndrueshmërinë psikologjike të studentëve ushtarakë.

Për personelin rekrut i cili hyn për të shërbyer me kontratë, për një kohë të papërcaktuar në Forcat e Armatosura, hapi i parë dhe i përfshirë në testimet e natyrave të ndryshme si: ai fizik; testimi i inteligjencës; është edhe testimi psikologjik. Gjatë këtij procesi, i cili përsëri duhet të udhëhiqet nga një grup i specializuar shumëdegësh, të gjithë rekrutët kalojnë në një “sitë psikologjike” përzgjedhjeje, e cila vërteton qëndrueshmërinë e tyre psikologjike, dhe aftësinë që ata gëzojnë për t’u adaptuar me jetën ushtarake. Ky hap i rëndësishëm shërben jo vetëm për të certifikuar rekrutët, apo studentët ushtarakë, por shërben si pjesë e rëndësishme për t’i njohur ata me rolin e psikologut, për të krijuar tek ata kulturën e domosdoshmërisë së këtij roli si diçka normale. Përfitimi nga trajtimi psikologjik që në hapat e para sjell dy efekte pozitive dhe kyçe për vazhdueshmërinë me sukses të kësaj iniciative, si në përzgjedhjen e një grupi me studentë dhe rekrutë të aftë jo vetëm fizikisht por edhe psikologjikisht, ashtu dhe futjen e kulturës të shërbimit të psikologut.

Problemet psikologjike, të cilat kanë nevojë për trajtim të veçantë, shtrihen gjatë gjithë karrierës ushtarake, por shqetësimet më të mëdha lidhen me rritjen e numrit të rasteve për trajtim, të cilat kanë ardhur pas angazhimeve të trupave në misionet paqeruajtëse. Nga studime të ndryshme me karakter psikologjik vihet re se problemet psikologjike ishin dy herë më të shumta dhe më akute tek trupat ushtarake që kishin eksperiencën e misioneve, sesa tek ata trupa të cilët nuk kishin shkuar në misione. Shqetësimet kryesore, të cilat pothuajse janë të përbashkëta për të gjithë trupat ushtarake lidhen me eksperiencën e tyre gjatë dislokimeve të shumta në misionet paqeruajtëse. Këto shqetësimet reflektojnë me stres dhe ankth, izolimin social, rritjen e dhunës në familje, abuzimin me alkool dhe droga të ndryshme, stresin post-traumatik, depresionin, etj.

Por shqetësimet më të mëdha lidhen me rritjen e numrit të rasteve për trajtim, të cilat kanë ardhur pas angazhimeve të trupave në misionet paqeruajtëse.

Stresi në mision, apo pas një ngjarjeje dramatike të ndodhur, ka trajtën e një rëndese mendore, e cila luhetet në nivele të ndryshme. Stresi shoqërohet me tronditje të fortë psikologjike, për ushtarin apo personin që ka qenë prezent gjatë ngjarjes, por edhe për të tjerët që e përjetojnë atë. Stresi të çon në një performancë sjelljeje të parregullt. Shenjat e para të stresit janë ndjenja e pasigurisë, e cila kalon më pas në frikë dhe ankth, inatosje me veten, kolegët apo edhe eprorët, prishje të regjimit të gjumit dhe të ushqyerjes. Ai shfaqet edhe në forma të tjera

siç mund të jenë: ulja e tolerancës, shpërthimi emocional, nervozizmi pa shkaqe të dukshme dhe objektive, shfaqje të manifestimeve të mungesës së respektit ndaj eprorit në mënyrë të hapur, mosbindje ndaj urdhrave. Sjellja e parregullt, për shkak të stresit çon në mendimin e simulimit në detyrë, për t'iu shmangur rreziqeve, të cilat i përjeton me frikë dhe nivel të lartë ankthi, si dhe shtirje të problemeve shëndetësore. Karakteristikë e kësaj forme të shprehjes së stresit nëpërmjet sjelljeve të parregullta është se për trupat, kufiri mes asaj çfarë duhet bërë dhe asaj çfarë nuk duhet bërë, është i paqartë, është “gri”.

Shqetësim tjetër në natyrë psikologjike është lodhja, ose siç njihet ndryshe lodhja nga lufta. Ky është një shqetësim që mund të ndodhë tek i gjithë personeli në detyrë, përfshi edhe trupat të cilat shquhen për disiplinë dhe guxim të lartë gjatë zbatimit të detyrave. Shenjat e këtij ç'rregullimi nisin me lodhje fizike e mendore gjatë kryerjes së detyrave e sidomos kur këto detyra bëhen monotone dhe mbartin gjithnjë e më shumë rreziqe. Simptomat e lodhjes dhe të stresit të luftës, herë pas here mbivendosen dhe vështirësojnë mundësinë për të kuptuar se cili nga shqetësimet mbizotëron. Por, liderët dhe psikologët në këtë rast, duhet të jenë të vëmendshëm për të kuptuar fillesat e shenjave të stresit, me qëllim që më pas të vihen në lëvizje për t'i dhënë ndihmën e duhur.

Ankthi, është një tjetër problem psikologjik, por më kompleks, i cili mund t'i shoqërojë luftëtarët në rastet kur ata kanë kaluar një operacion apo situatë të vështirë dhe për më tepër kur rreziku ka qenë prezent dhe ka shkaktuar viktima nga radhët e shokëve të tij. Niveli i stresit tashmë ka kaluar normalen dhe shoqërohet me ankth të herëpashershëm, frikë nga çdo gjë, që për trupat konsiderohet si rrezik për jetën. Kjo çon në uljen e aftësive luftuese dhe të performancës gjatë kryerjes së detyrave. Niveli i ankthit të përjetuar nga trupat, varet nga faktorë emocionalë dhe fizikë. Një rol të rëndësishëm në këtë rast për minimizimin, por edhe për përkeqësimin e ankthit dhe frikës tek personeli luajnë liderët, duke filluar nga ata më të rinjtë, komandantët e togave, deri tek eprorët më të lartë, qëndrimi i njësisë, kolegëve, si dhe marrëdhënia e mbështetja e familjes. Gjithashtu, rëndësi ka që nëpërmjet një procesi rehabilitimi nga strukturat e specializuara mjekësore dhe psikologjike, personeli të marrë trajtimin e duhur, për të rifituar aftësitë e humbura përkohësisht.

Por, krahas stresit dhe ç'rregullimeve psikologjike, lufta shkaktonte edhe viktima psikike.

Richard Gabriel ka thënë: “Kombet zakonisht vlerësojnë kostot e luftës në dollarë, prodhimin e humbur, ose numrin e ushtarëve të vrarë ose të plagosur”, por radhë institucionet ushtarake përpiqen për t'i vlerësuar (matur) kostot e luftës në kushtet e vuajtjes individuale. Ç'rregullimi psikik mbetet një nga çështjet më të kushtueshme të luftës të shprehur në aspektin human”. Në të vërtetë, për luftëtarët në çdo luftë kryesore të këtij shekulli, që kanë luftuar, ka patur një probabilitet më të madh për t'u bërë viktima psikike, sesa për t'u vrarë nga zjarri i armikut.

Një viktima psikike është një luftëtar i cili nuk është në gjendje të marrë pjesë në luftime për shkak të dobësisë mendore. Viktimat psikike rrallë paraqesin një dobësim të qëndrueshëm dhe, me kujdesin e duhur, ata mund të kthehen në

gjendjen e mëparshme. Megjithatë, disa hulumtime të studiuesve të Izraelit kanë treguar që, pas luftës, viktimat psikike janë shumë të predispozuara në shfaqjen e përhershme të dobësive dhe çrregullimeve post-traumatike. Dobësitë mund të shfaqen në shumë mënyra, duke filluar nga çrregullime emocionale deri në çrregullime *somatoform*, por trajtimi për shumë shfaqje të stresit të luftës përfshin thjesht largimin e ushtarit nga ambienti i luftimit. Sindromi i “evakuimit” është paradoksi i psikiatrisë luftarake. Vazhdimi i trajtimit mjekësor të viktimave në afërsi të fushë-betejës me pritshmërinë e kthimit të shpejtë të tyre në luftime janë parime të kapërcimit të paradoksit të sindromës së “evakuimit”. Parimet e “afërsisë” dhe “pritshmërisë” janë provuar si mjaft efektive, qysh nga Lufta e Parë Botërore. Por edhe me zbatimin e kujdesshëm të parimeve të “afërsisë” dhe “pritshmërisë”, numri i viktimave psikike ka qenë i madh. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, 504 000 njerëz ishin të humbur nga forcat luftarake të Amerikës, për shkak të kolapsit psikik.

Ashtu si stresi dhe lodhja nga lufta janë probleme të cilat trajtohen në vendin ku personeli kryen misionin edhe ankthi, si problem më kompleks e i ndërlikuar, mund të trajtohet duke marrë shërbimin e duhur të specializuar nga specialistë dhe struktura të shëndetit mendor. Në shumë raste, është provuar se personeli që vuan nga shqetësime të tilla, pas trajtimit të kujdesshëm, është riaftësuar dhe rikthyer në rimarrjen e përgjegjësive të mëparshme.

Nisur nga përvoja dhe statistikat, shikohet se personeli ushtarak që vuan nga ankthi, bëhet shumë më i paafët për zbatimin e misionit. Simptomat e ankthit paralizojnë në masë shumë më të madhe se stresi dhe lodhja, logjikën, vetëdijen e personelit duke ndikuar drejtpërdrejt në performancën e tij.

Stresi post-traumatik është një tjetër shqetësim psikologjik, i cili lidhet drejtpërdrejt me ekspozimin e trupave ndaj ngjarjeve tragjike, të ndodhura gjatë misioneve, siç mund të jenë: vrasjet masive të fëmijëve ose grupeve të tjera të të pafajshmëve; vdekje të kolegëve të tyre; zënia rob dhe vuajtja e torturave të ndryshme, etj. Simptomat e stresit post-traumatik shfaqen pas kthimit të trupave në atdhe dhe rimarrjes së jetës normale. Ato karakterizohen nga rikthime të episodeve të dhimbshme të përjetuara, humbje të gjumit, izolim shoqëror, kujtime të dhimbshme, abuzim me substancat, si tentativë për të shpëtuar nga ndjesia e ankthit dhe përjetimit të ngjarjeve të ndodhura. Ç’rregullimet e mësipërme psikologjiko-emocionale, janë hapat e para drejt deformimit të realitetit dhe vetvetes. Çdo vonesë apo mungesë e trajtimit të tyre mund të çojë në rëndimin e gjendjes shëndetësore drejt ç’rregullimeve më të rënda dhe komplekse.

Ushtritë që kanë përvojë dhe një histori të veçantë në fushën e problemeve të shumta psikologjike që trupat hasin gjatë kryerjes së detyrave në misione, tregojnë se gama e problemeve psikologjiko-shoqërore në trupat ushtarake është mjaft e gjerë. Një përqindje e madhe e tyre abuzojnë me substancat narkotike, përdorin pa masë pijet alkoolike, si një mundësi për t’u larguar nga stresi dhe kujtimet tronditëse. Ata shndërrohen në njerëz të dhunshëm, si në familje, shoqëri dhe në ambientin e punës, ose e kundërta, njerëz që mbyllen në vetvete, jetojnë të shkëputur ndërmjet realitetit dhe episodeve të përjetuara gjatë përvojës së tyre në

misione. Pasoja të ç'rregullimeve psikologjike në trupat ushtarake, vijnë edhe nga kryerja e krimeve ndaj popullsisë civile vendase, duke kryer vrasje mbi grupe civilësh të pambrojtur.

E gjithë kjo gamë e gjerë e problemeve me natyrë psiko-emocionale nuk kursen as liderët dhe eprorët, pasi dhe ata janë pjesë e përjetimit të ngjarjeve në misione. Pavarësisht se pritet që ata të jenë më të fortë dhe të qëndrueshëm, ata mund të vuajnë nga simptoma të njëjta si dhe vetë trupat. Gjithashtu, duke patur për gjegjësi më të mëdha, në veçanti në rastet e humbjes së jetës së njerëzve nën komandën e tyre, pësojnë zhgënjim të madh, humbasin besimin tek vetja dhe tek trupat, shenja këto që çojnë në stres dhe bëhen premisë për kalvarin e shqetësimeve të tjera psikologjike.

Këto probleme psikologjike janë të njëjta për të gjitha trupat ushtarake të cilësdo ushtri qofshin, por sigurisht që përmasat e shqetësimeve dhe format që mund të marrin ndryshojnë në varësi të: përgatitjes para-dislokimit; rrezikshmërisë së misionit; ekspozimit ndaj ngjarjeve traumatike gjatë misionit; aftësive profesionale dhe mbështetjes logjistike të trupave; kushteve në të cilat ndodhen familjet dhe mbështetjes emocionale; trajtimit psikologjik të trupave para, gjatë dhe pas rikthimit, etj.

Trajtimi psikologjik ka si veçori, **nevojën dhe dëshirën për t'u kuruar**. Kjo nënkupton se, nëse një ushtarak ka shqetësime të ndryshme psikologjike, hapi i parë dhe kryesor për kurimin dhe trajtimin e tij është vetndër gjegjësimi dhe pranimi nga ana e tij, për t'u trajtuar nga specialistët. Kjo kërkon që të ekzistojë një shërbim psikologjik profesional dhe që t'u përgjigjet nevojave të trupës ushtarake. Njëkohësisht kërkon ndërmarrjen e një pune informuese, sensibilizuese të trupave, krijimin e besimit në vlerat dhe dobinë e këtij shërbimi.

Shërbimi psikologjik për trupat të cilat përfshihen në misionet paqeruajtëse duhet të jetë i pranishëm në fazat e para-dislokimit; të dislokimit dhe të pas-dislokimit.

Faza para-dislokimit në mision

Faza para-dislokimit në mision, shpesh në aspektin e ndikimeve të stresit, mbetet si e "harruar", por stresi më i dukshëm është në momentin e ndarjes së ushtarakut nga familja e tij. Puna dhe vëmendja në këtë fazë të përgatitjes për mision është kryesisht informuese dhe zgjat për një periudhë kohore të caktuar. Gjithashtu, rëndësi të veçantë në këtë fazë, merr edhe trajtimi i familjarëve të ushtarakëve. Shqetësimet që mund të karakterizojnë njerëzit në këtë fazë janë: stresi i ndarjes nga familja dhe fëmijët; ankthi, shfaqje të sjelljeve agresive; pagjumësi, etj. Puna kryesore që duhet bërë nga strukturat përgjegjëse në këtë fazë është që trupa të marrë gjithë informacionin e duhur për misionin, të ketë arritur parametrat profesionalë, të jetë e pajisur, të ketë mbështetjen e nevojshme logjistike e financiare dhe të gëzojë një gjendje emocionale të mirë dhe pa probleme familjare.

Kjo punë e bërë në këtë fazë, çon në përgatitjen e një trupe të mirëinformuar, të njohur me misionin, vendin, njerëzit, traditat zakonet e popullsisë vendase, situatën e sigurisë, etj. Pra, duhet një trupë e qetë nga ana emocionale, pasi familja e ka marrë informacionin e duhur dhe ka sjelljen e duhur mbështetëse ndaj ushtarakut

që do të mungojë për një kohë të konsiderueshme. Për pasojë, trupat janë të qeta dhe të fokusuar në kryerjen e detyrës, sepse strukturat përgjegjëse ushtarake kanë ofruar një sistem mbështetjeje të prekshëm për familjen dhe kanë rregulluar aspektin ekonomik-financiar të familjes.

Të gjitha këto masa të marra e fokusojnë trupën tek detyra, duke zvogëluar në masë të konsiderueshme rrezikshmërinë për shfaqjen e shqetësimeve psikologjike gjatë misionit. Nga të gjitha studimet dhe sondazhet e bëra prej organizatave psikologjike të ushtrive të ndryshme rezulton se vështirësitë më të mëdha në këtë fazë i kanë trupat, të cilat do të nisen me mision. Prandaj puna kryesisht fokusohet tek ata, për të trajtuar shqetësimet dhe për t'u fokusuar tek detyra.

Faza e dislokimit në vendin ku do të kryhet misioni

Gjatë dislokimit në mision ankthi i ndarjes si dhe mungesa e komunikimit reciprok është stresi më i madh për familjen dhe vetë ushtarakun. Duke mos ditur se çfarë po ndodh, nëse njeriu (ushtaraku) i tyre nuk është i sigurt, kjo mund të japë efekte të mëdha negative tek familjarët. Ushtarakët në mision nuk u tregojnë gjithçka familjeve të tyre, për çfarë ndodh në të vërtetë dhe kjo për shkak të ngurrimit që ata kanë për t'i shtuar stresa të panevojshme familjeve të tyre. Grupet e përkrahjes dhe mbështetja e familjes janë mënyra më e mirë për të përballuar këtë gjendje, ndërkohë që ushtaraku është larg. Stresi që mbërthen ushtarakun, për shkak të të qenit larg familjes është gjithashtu i dukshëm. Por stresi më i madh vjen nga përjetimi i situatës që ai kalon çdo ditë në mision. Streset që përfshijnë ushtarakun dhe familjen e tij janë të pashmangshme, ndaj është e shëndetshme dhe e domosdoshme mbajtja e marrëdhënieve të komunikimit ndërmjet të dy palëve.

Komunikimi i hapur duket të jetë mënyra më efektive për të përballuar këto stresa, në të gjitha rastet.

Komunikimi i hapur duket të jetë mënyra më efektive për të përballuar këto stresa, në të gjitha rastet.

Kjo fazë karakterizohet nga stresi, ankthi, probleme me përshtatjen, të cilat çojnë në pagjumësi, çrregullim të procesit të ushqyerjes, depresion, probleme shëndetësore, etj. Në këtë fazë, puna kryesore orientohet tek trupa. Nëse shqetësimet fillestare psikologjike bëhen më komplekse dhe fillojnë të pengojnë mbarëvajtjen e misionit, puna e psikologut, i cili ndodhet aty për të trajtuar këto raste, mbështetet në dëshirën dhe vullnetin e personelit që ka problemin, për të realizuar sa më mirë trajtimin.

Në këtë fazë shikohen frytet e punës së bërë gjatë rekrutimit dhe para përgatitjes për mision. Liderët dhe eprorët e secilit nivel, në këtë rast, duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë simptomave të cilat flasin për një shqetësim të mundshëm psikologjik tek trupat. Pas sinjalizimit për simptoma të mundshme siç mund të jenë: stresi; mungesë përqendrimi gjatë kryerjes së detyrave dhe veprimtarive normale; mbyllje në vetvete; abuzim me substancat si duhani apo alkooli; pagjumësi; etj., trajtimi duhet të jetë specifik dhe konkret me personin e cili shfaq simptomat e mësipërme. Për këtë duhet aprovimi dhe pranimi i personit për t'u trajtuar nga specialisti i cili, pas vlerësimit të rastit, përcakton nëse ky rast i problemit psikologjik mund të trajtohet njëkohësisht gjatë kryerjes së detyrës

apo problemi është kompleks dhe nuk e mundëson më kryerjen e detyrës, ndaj duhet trajtuar në atdhe, pranë qendrave të specializuara.

Gjithashtu, gjatë kësaj faze, vështirësitë emocionale përfshijnë familjet e misionarëve. Për ata fillon një proces i gjatë përshtatjeje dhe transformim rolesh, si rezultat i mungesës së familjarit të tyre, rritje e përgjegjësisë ekonomike dhe familjare për fëmijët si dhe stres për jetën e familjarit që ndodhet në mision. Fëmijët mund të karakterizohen nga shqetësime psikologjike siç janë: rënia në mësim; mungesë përqendrimi dhe shfaqje të sjelljeve agresive; ankth dhe frikë gjatë gjumit, etj.

Në ushtritë perëndimore, për trajtimin psikologjik në këtë fazë, janë ngritur dhe funksionojnë qendra të ndryshme të cilat merren me shërbimin e familjeve të misionarëve, duke ofruar sisteme mbështetjeje financiare, edukuese (kopshte dhe çerdhe) për fëmijët, trajtime psikologjike për prindërit të cilët përjetojnë stres nga rritja e përgjegjësisë dhe mungesa e partnerit misionar si dhe janë ngritur grupe të gatshme të përbërë nga familjarë të personelit ushtarak, të cilët ndihmojnë njëri-tjetrin sipas radhës kur familjarët e tyre largohen me mision, etj.

Në këtë fazë, shërbimi psikologjik duhet të jetë i dyanshëm. Nga njëra anë psikologu i cili është i atashuar pranë trupave në misione duhet të vazhdojë punën informuese përmes takimeve të herëpashershme me trupën mbi shqetësimet kryesore të tyre, në mënyrë që t'u mundësojë atyre krijimin e besimit tek puna e tij dhe lehtësimin për t'u drejtuar tek ai kur kanë nevojë. Nga ana tjetër, strukturat e tjera që duhet të jenë në atdhe duhet të punojnë vazhdimisht me familjet e ushtarakëve, duke i informuar mbi jetën e familjarit të tyre në mision, gjendjen e tij shëndetësore, duke diskutuar shqetësimet që ata mund të kenë, etj.

Etapa e tretë, kthimi në atdhe

Streset që përfshijnë ushtarakët në periudhën pas-dislokim janë shumë më të diskutueshme. Ushtarakët duhet të merren me përshtatjen në jetën civile, ndërkohë duhet përpjekur për të përballuar çdo stres post-traumatik që mund të lindë. Disa ushtarakë do të përjetojnë një fazë të zgjatur të stresit post-traumatik (PTSD). Shumë ushtarakë nuk dëshirojnë të ndajnë ndjenjat e tyre të dhimbjes apo zemërimit me askënd, për shkak të frikës se mund t'i bëjnë ata të duken të dobët para të tjerëve. Paniku i natës, disponimi i ankthit, frika nga turmat dhe rrethanat e reja, abuzimi me substanca, dhuna në familje dhe tendencat vetëvrasëse, janë të gjitha shenjat e ç'rregullimit të stresit post-traumatik (PTSD). Këto stresse shpesh mund të jenë jashtëzakonisht të vështira që familja të merret me to. Si rezultat, përqindjet e divorcit në këtë fazë janë më të larta.

Kjo është faza më e rëndësishme, sepse tani trupat që kanë kaluar një periudhë disamujore larg familjes, “nuk janë si më parë”. Secili prej tyre ka përjetime, të cilat i percepton ndryshe nga tjetri. Po ashtu, ngarkesa fizike dhe emocionale ka qenë e lartë gjatë kësaj kohe.

Kjo është faza më e rëndësishme, sepse tani trupat që kanë kaluar një periudhë disamujore larg familjes, “nuk janë si më parë”. Secili prej tyre ka përjetime, të cilat i percepton ndryshe nga tjetri.

Ditët e para të kthimit mund të karakterizohen nga emocione gëzimi dhe dëshirë për t'u ç'mallur me familjarët, fëmijët dhe për t'u njohur me realitetin e ri në familje gjatë mungesës së tyre. Këto ditë karakterizohen nga një humor i mirë i ushtarakut, ç'lodhje fizike, përshtatje me ambientin e ri shoqëror. Pas ditëve të para, situata mund të ndryshojë duke kërkuar që secili anëtar, edhe familjari që ka qenë në mision të rimarrë pozitë e mëparshme në familje, vendimmarrje, nw jetën shoqërore dhe atw ekonomike të familjes.

Në këtë fazë, rëndësi ka që ushtarakëve t'u jepet kohë për të pushuar. Ata duhet të shkarkojnë energjitë dhe ngarkesën e mbledhur gjatë misionit. Rikthimi i menjëhershëm në detyrë do të ndikonte në rëndesën emocionale të tyre dhe në rritjen e probabilitetit për ç'rregullime psikologjike. Shumica e problemeve psikologjike shfaqen pas rikthimit në atdhe. Nga përvoja e ushtrive perëndimore, mbi 50 % e trupave shfaqin problemet psikologjike pas kthimit. Kjo ndodh përveç sa më lart, pasi procesi i përshtatjes me realitetin e ri, pas një përvoje e cila mund të ketë qenë edhe me ngjarje tragjike, nuk ecën normalisht.

Rëndësi të veçantë në këtë fazë ka trajtimi shëndetësor dhe psikologjik i personelit. Ky është hapi i parë për t'u njohur me gjendjen psikologjike të tyre, pjesë e cila duhet të ndiqet më pas nga një trajtim i shtrirë në kohë për të gjithë trupën, pasi siç përmenda më lart, shumica e problemeve psikologjike duan kohë të dalin në pah.

Në secilën fazë efektshmëria dhe suksesi i trajtimit varet edhe nga predispozicioni i trupës, qëndrimi i tyre kundrejt shërbimit dhe specialistëve që e ofrojnë këtë shërbim. Puna kryesore e psikologut duhet të fokusohet pikërisht në rritjen e kulturës së shërbimit psikologjik. Kjo arrihet nëpërmjet një marketingu në formë takimesh; krijimit dhe shpërndarjes së broshurave informuese; informimit të trupës mbi rëndësinë e shërbimit psikologjik nëpërmjet medias ushtarake; ngritjes së strukturave përgjegjëse për ofrimin dhe ndjekjen e këtij shërbimi.

Trajtimi psikologjik i trupave ushtarake duhet të ndërtohet si një sistem i tërë

Trajtimi psikologjik i trupave ushtarake duhet të ndërtohet si një sistem i tërë mbështetjeje dhe trajtimi, duke ngritur strukturat të cilat mbështesin këtë shërbim

mbështetjeje dhe trajtimi, duke ngritur strukturat të cilat mbështesin këtë shërbim dhe ato të cilat konkretisht japin shërbimin (trupa e specialistëve, psikologëve, psikiatërve, punonjësve

socialë,etj.). Ndërtimi dhe konsolidimi i këtij shërbimi do të shmangte trajtimin sporadik dhe anësor të problemeve psikologjike dhe do të ofronte e mundësonte një trajtim rrënjësor e profesional, i cili mundëson kthimin e trupave në gjendjen normale psiko-emocionale.

Mundësitë e rikuperimit të trupave të cilat gjatë apo pas kthimit nga misioni kanë shfaqur probleme psikologjike, varen nga shumë faktorë. Siç ndodh me çdo përvojë tjetër dhe të veçantë në jetë, e cila e ndryshon njeriun dhe mënyrën e tij të jetesës, edhe shqetësimet psikologjike sjellin ndryshime të tilla, por gjithsesi nëpërmjet një trajtimi profesional dhe në kohën e duhur, trupat mund t'i rikthehen jetës dhe punës normalisht.

Bibliografia:

- “Psychological effect of combat on troops and their families, as well as psychological treatment.”
- Gabriel, R. A. (1987). *No more Heroes: Madness and psychiatry in war*. New York: Hill and Wang.
- Greene, B. (1989). *Homecoming*. New York: G P. Putnam’s Sons.
- Griffith, P. (1989). *Battle tactics of the (American) civil war*. London.
- Grossman, D. (1995, 1996). *On killing: The psychological cost of learning to kill in war and society*. New York: Little, Brown, and Co.
- Holmes, R. (1985). *Acts of war: the behaviour of men in battle*. New York: The Free Press.
- Keegan, J. (1976). *The face of battle*. Harmondsworth, England: The Chaucer Press.
- Keegan, J., & Holmes, R. (1985). *Soldiers*. London: Hamish Hamilton.
- Marshal, S. LA. (1978). *Men against fire*. Gloucester, MA: Peter Smith.
- Siddle, B. K. (1995). *Sharpening the warrior’s edge: The psychology and science of training*. Millstadt, IL: PPCT Management Systems.
- Swank, R. L., & Marchand, W. E. (1946). *Combat neuroses: development of combat exhaustion*. *Archives of Neurology and Psychology*, 55, 236-247.
- The psychological needs of u.s. Military service members and their families.
- Daniel W. King, et al. “PTSD symptom increases in Iraq-deployed soldiers: Comparison with nondeployed soldiers and associations with baseline symptoms, deployment experiences, and postdeployment stress.” *Journal of Traumatic Stress* 23.1 (2010): 41-51. SocINDEX with Full Text. EBSCO. Web. 24 Feb. 2011.
- Christofer J. Ecklund, et al. “Posttraumatic Stress in U.S. Marines: The Role of Unit Cohesion and Combat Exposure.” *Journal of Counseling & Development* 89.1 (2011): 81-88. Academic Search Complete. EBSCO. Web. 24 Feb. 2011.
- Laser, Julie, and Paul Stephens. “Working with Military Families through Deployment and Beyond.” *Clinical Social Work Journal* 39.1 (2011): 28-38. SocINDEX with Full Text. EBSCO. Web. 24 Feb. 2011.
- Scott A. Miskevics, et al. “Persistence of Traumatic Memories in World War II Prisoners of War.” *Journal of the American Geriatrics Society* 57.12 (2009): 2257-2262. SocINDEX with Full Text. EBSCO. Web. 24 Feb. 2011.

Kapacitetet rajonale të emergjencave, në frymën “Smart Defence”

Gjeneral Brigade Abaz Lleshi,
Komandant i Brigadës së Mbrojtjes Rajonale

Trajtesë e shkurtuar. *Angazhimi i strukturave ushtarake në përballimin e Emergjencave Civile dhe katastrofave të ndryshme natyrore është pjesë e misionit të tyre kushtetues.*

Praktika disavjeçare e sidomos e viteve të fundit, ka treguar se FA e kanë përbushur me sukses këtë mision. Kjo është bërë e mundur edhe për faktin se në përbërje të FA, aktualisht ka njësi e reparte të specializuara dhe profesioniste për kryerjen e këtyre operacioneve.

Duke vlerësuar përvojën e deritanishme të strukturave tona ushtarake në përballimin e emergjencave të ndodhura në vite, kontributin dhe ndihmën reciproke të dhënë nga strukturat e vendeve fqinje, zbatimin e nismës “Smart Defence”, si dhe detyrave që rrjedhin nga Takimi i Strugës në qershor të këtij viti, ky shkrim ndalet në disa përparësi të cilat lidhen me forcimin e bashkëpunimit rajonal me interes të përbashkët

Vendet e rajonit tonë janë vende me rrezik të lartë përsa i përket mundësisë së ndodhjes së emergjencave dhe katastrofave të ndryshme. Kjo mundësi nuk përjashtohet edhe në të ardhmen. Ky fakt është njëra anë e problemit, kurse ana tjetër është se emergjencat nuk njohin dhe nuk kanë kufi. Ato mund të kenë shtrirje rajonale, por edhe më gjerë.

Nga njohja dhe studimi i praktikave dhe përvojave të ushtrive partnere përfshi dhe ato të rajonit, rezulton se çdo shtet i rajonit ka marrë masat e veta për përballimin e emergjencave dhe katastrofave të ndryshme.

Pavarësisht këtij fakti, gjykoj se për përballimin e të gjithë llojeve të emergjencave dhe katastrofave të pritshme, është e domosdoshme ngritja, në një shkallë më të lartë, e bashkëpunimit rajonal të të gjitha strukturave dhe aktorëve që angazhohen në këtë fushë, përfshi dhe rritjen e bashkëpunimit mes strukturave ushtarake.

Kjo diktohet nga disa faktorë si:

- Asnjë vend, i varfër apo i pasur, nuk mund t'i ketë të mjaftueshme kapacitetet operacionale në raste të tilla fatkeqësish dhe aq më tepër për të gjitha llojet e emergjencave;
- Zbatimi i konceptit “*Smart Defence*” nënkupton marrjen e masave dhe përcaktimin e detyrave drejt ndërtimit të kapaciteteve të përbashkëta për emergjencat civile;
- Disa nga fenomenet e shpeshta të përmytjeve, bllokimet dhe shkatërrimet e rrugëve nga bora, tërmetet, zjarret dhe fenomene të tjera të pritshme, kanë ndodhur dhe mund të ndodhin në zonat ndërkufitare. Për rrjedhojë, e njëjta emergjencë apo katastrofë dhe pasojat e tyre mund të prekin jo vetëm një vend, por edhe vendin fqinj. Në një situatë të tillë të mundshme, është domosdoshmëri bashkëpunimi efektiv dhe kontributi i përbashkët rajonal;

Në Deklaratën Përfundimtare të Samitit të Çikagos, nënvizohet: -”Në rajonin e rëndësishëm strategjik të Ballkanit Perëndimor, bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, janë të rëndësishme për paqen dhe stabilitetin e tij”.

Është në interes të përballimit të emergjencave dhe pasojave të tyre, që secili shtet apo strukturë ushtarake e tij të jetë më e specializuar dhe më e perfeksionuar për një lloj emergjence, në raport me një vend tjetër. Kjo mundëson jo vetëm një ndihmë dhe kontribut më efektiv ndaj një vendi, por është edhe me kosto më të ulët, pasi ulet dukshëm sasia e forcave dhe mjeteve të parashikuara për t'u përdorur në këto lloj operacionesh.

Pavarësisht nga puna e bërë dhe masat e deritanishme, mendoj se në radhë të parë, është detyrë e institucioneve shtetërore, e strukturave operacionale aktive, përfshi edhe ato ushtarake, që të gjejnë forma dhe metoda të reja pune për të rritur efikasitetin dhe rendimentin në përballimin e emergjencave dhe katastrofave që mund të ndodhin, duke parë e vlerësuar si përparësi vendosjen dhe rritjen e bashkëpunimit rajonal në këtë fushë.

Duke vlerësuar përvojën e deritanishme të strukturave tona ushtarake në përballimin e emergjencave të ndodhura në vite, kontributin dhe ndihmën reciproke të dhënë nga strukturat e vendeve fqinje, zbatimin e nismës “*Smart Defence*”, si dhe detyrave që rrjedhin nga Takimi i Strugës në qershor të këtij viti, në këtë shkrim do të ndalem në disa përparësi të cilat lidhen me forcimin e bashkëpunimit rajonal me interes të përbashkët, si më poshtë:

- Bashkërendimi dhe informimi i shpejtë reciprok për emergjencat dhe katastrofat e pritshme;
- Njohja e rreziqeve natyrore, studimi dhe planifikimi shkencor për shmangien e pasojave;
- Zhvillimi i stërvitjeve të përbashkëta dhe këmbimi i përvojave;
- Krijimi i kapaciteteve të përbashkëta dhe mbështetja reciproke me forca dhe mjete, bazuar në plane të ndihmës e bashkëpunimit reciprok;
- Përsosja e fuqizimi i strukturave speciale të emergjencave, në mbështetje të popullatës dhe autoriteteve civile, siç është Brigada e Mbështetjes Rajonale.

Bashkërendimi dhe informimi i shpejtë reciprok

Bashkërendimi është mjaft i gjerë dhe i domosdoshëm në të gjitha fazat e një emergjence civile. Rëndësia e bashkërendimit del më në pah, veçanërisht në fazën e reagimit të menjëhershëm, në të cilën nevojitet koordinim efektiv për të minimizuar boshllëqet, për të shmangur dublimet, asistencën dhe ndërhyrjet jo të përshtatshme, vonesat, pengesat si dhe ngadalësitë në reagim e veçanërisht në vendimmarrje. Bashkërendimi i dobët sjell përgjigje jo të kënaqshme ndaj situatës së emergjencës dhe mund të zhgënjë popullatën.

Një element shumë i rëndësishëm që i paraprin marrjes së masave parandaluese është *informimi*. Marrja dhe dhënia e informacionit duhet vlerësuar jo vetëm në planin e brendshëm (brenda një vendi apo shteti). Rëndësi ka edhe shkëmbimi i menjëhershëm i informacionit nëpërmjet Qendrave të Menaxhimit të Emergjencave civile me vendet fqinjë. Kjo rrit efikasitetin e angazhimit brenda vendit, si dhe koordinimin e veprimeve ndërmjet strukturave tona në nivel rajonal, por do të ndihmonte edhe ardhjen në kohë të shpejtë të kontributit e ndihmave.

Ndërgjegjësimi i qytetarëve lidhur me rreziqet, sidomos ato që vijnë nga zjarret, tërmetet, përmytjet, rrëshqitjet e dheut, ndotja e ambientit etj, është një nga detyrat parësore që duhet të merren nga strukturat përgjegjëse për emergjencat civile, në nivel qendror dhe lokal. Nëpërmjet zbatimit të të gjithë formave si seminareve të ndryshëm, fletëpalosjeve, njoftimeve në media, mësimëve në shkollë etj, duhet të jepen të dhëna mbi pasojat që mund të krijohen në emergjencat të ndryshme si dhe mënyra e veprimit të njerëzve, për t’iu shmangur pasojave dhe për të kundërvepruar me efikasitet në këto raste.

Njohja e rreziqeve dhe planifikimi shkencor për shmangien e pasojave

Një aspekt tjetër i rëndësishëm në fushën e emergjencave civile është *njohja e rreziqeve* që mund t’i kanosen vendit apo rajonit. Kur rreziqet njihen mirë, atyre mund t’iu kundërvihesh me sukses. Në vendin tonë, në bashkëpunim me PNUD-in, me institucionet arsimore e shkencore në vend dhe me OJF, me kohë është bërë vlerësimi i rreziqeve dhe, mbi bazën e këtyre rreziqeve, është përgatitur Plani Kombëtar i Planifikimit dhe Përballimit të EC. Gjithashtu, është miratuar dhe funksionon Ligji i EC si dhe ligje të tjera ndihmëse që rregullojnë punën për menaxhimin e strukturave të pushtetit qendror dhe të atij vendor, për përballimin e emergjencave.

Mbi bazën e këtyre dokumenteve kryesore, çdo institucion përgjegjës dhe çdo strukturë operative ka hartuar planin e veprimit në lloje të ndryshme të emergjencave dhe në disa variante veprimi. Këto plane veprimi, në mënyrë periodike, rishikohen dhe përmirësohen për t’iu përgjigjur sa më mirë situatave të krijuara në të gjitha fazat e menaxhimit të emergjencave dhe ndryshimit të strukturave operacionale dhe të pajisjeve të tyre. Në këtë aspekt, është krijuar një përvojë e pasur e cila mund të shfrytëzohet.

Kërkimet shkencore. Në institucionet tona arsimore, përfshi dhe Akademinë e Mbrojtjes, janë përcaktuar disa fusha kryesore të punës kërkimore-shkencore për të ardhmen. Krahas problemeve e fushave të tjera, janë parashikuar edhe çështje

të mjedisit të ardhshëm të sigurisë dhe të ndikimit të tij në jetën e njerëzve, në stërvitje dhe në operacionet e sotme të FA.

Pavarësisht nga puna e bërë dhe përvoja e fituar për problemet e mësipërme, është tepër e rëndësishme që të njohim përvojën e fqinjëve tanë, të ndërmerren studime të përbashkëta për çështje e probleme që shqetësojnë dy apo më shumë vende, në aspektin e emergjencave civile.

Stërvitjet e përbashkëta, si shkëmbim përvojash

Stërvitjet e përbashkëta dhe kualifikimet janë garanci për rritjen e efektivitetit të strukturave operacionale. Përqasja “*Smart Defence*” kërkon programe të studiuara dhe të përshtatura mirë për çdo strukturë, me mision dhe detyrë të veçantë, kërkon një stërvitje cilësore për çdo lloj emergjence dhe të realizuar në një zonë sa më të përafërt me ato reale.

Në njësitë dhe repartet e FA dhe veçanërisht në BrMR, si njësi e specializuar për të përballuar emergjencat civile, është krijuar një përvojë për zhvillimin e stërvitjes për përmbytjet, tërmetet, luftën kundër zjarreve, për kërkim-shpëtimin e njerëzve (shërbimi SAR), etj.

Në këtë kuadër, do të veçoja disa stërvitje të zhvilluara brenda vendit si:

- Pjesëmarrja e strukturave ushtarake në aktivitetet ndër-institucionale për EC, zhvilluar në Tiranë, me Ministrinë e Brendshme në vitin 2009;
- Stërvitja “*Gjinari*”, zhvilluar në vitin 2010, për shuarjen e zjarreve;
- Stërvitja “*Drini*”, zhvilluar në vitin 2010, për përballimin e përmbytjeve dhe katastrofave të tjera natyrore; -Stërvitja për EC “*Reagimi i Përbashkët-2011*”.

Gjithashtu kemi përvojë në përgatitjen dhe pajisjen e poligoneve të stërvitjes, bazës materiale të nevojshme për stërvitje, si dhe specialistëve përkatës për çdo fushë.

Po kështu në fushën e bashkëpunimit rajonal e më gjerë, është fituar përvojë dhe në zhvillimin e stërvitjeve të përbashkëta të cilat kanë patur për objekt Emergjencat Civile, ku do të veçoja:

-Stërvitjen *SESIM* (2009, 2010) për EC, në kuadër të bashkëpunimit dypalësh midis FA Shqiptare me FA të SHBA; -Stërvitjen për EC në kuadër të bashkëpunimit me ushtrinë italiane, zhvilluar në Tiranë në qershor 2011; -Shkëmbim përvoja me struktura të specializuara gjermane, për përdorimin e zjarrfikëseve, zhvilluar në Tiranë në vitin 2011; Stërvitje për tërmetet, zhvilluar në Slloveni në tetor 2011; Stërvitjen “Mbrotjtja Civile në BE dhe në Europën Juglindore”, zhvilluar në Zagreb, Kroaci në maj 2011. në kuadër të veprimtarive me BE-në; Stërvitjen me skenar përmbytjet, zhvilluar në Kroaci në maj 2012; -Stërvitjen e planifikuar për t’u zhvilluar në kuadër të A5 në Shqipëri, në vitin 2013.

Mendoj se jo vetëm BrMR-ja, por dhe gjithë FA duhet të jenë të gatshme të ofrojnë përvojë dhe ekspertizë për zhvillimin e stërvitjeve, për përgatitjen e grupeve të ndryshme operative, në lloje të ndryshme të emergjencave.

Kapacitet e përbashkëta dhe përsosja e kontingjenteve aktive

Mbështetja e njeri-tjetrit në rastet e emergjencave civile, duhet të jetë fusha kryesore e bashkëpunimit dhe zhvillimit të kapaciteteve të përbashkëta kombëtare, dy palëshe apo rajonale. Në takimin e fundit të Ministrave të Mbrojtjes të Kartës A-5, në kuadër të nismës “*Smart Defense*”, ministri Imami hodhi idenë e “...Gjetjes së rrugëve dhe mënyrave të reja për të arritur objektivat në kushtet aktuale”...

Në emergjencat e dy viteve të fundit; atë të Shkodrës dhe të Lezhës në përmblytje dhe në përballimin e reshjeve nga dëbora në shkurtin që kaloi, ekipe të ndryshme turke, italiane, maqedonase, greke, kosovare, të Malit të Zi, të Bosnjës, etj, ofruan ndihmat e tyre me forca e mjete, me ushqime dhe veshmbathje, drejtpërdrejt në zonat e përfshira nga emergjencat.

Në pikun e rënies së zjarreve, ekipe të specializuara greke për fikjen e zjarreve, veçanërisht në jug, kanë dhënë kontributin e tyre me helikopterë zjarrfikës dhe autozjarrfikëse tokësore. Gjithashtu një helikopter turk këtë verë, dha kontribut shumë të madh në përballimin e emergjencave gjatë shuarjes së zjarrit. Këto veprime, sado modeste në dukje, i kanë shërbyer forcimit të besimit reciprok në fushën e sigurisë dhe i kanë afruar më tej vendet tona me njeri-tjetrin, por në fund të fundit, i kanë shërbyer përballimit të emergjencave të ndodhura. Gjithashtu mund të themi se përfshirja e FA në raste si këto që përmenda më lart, i ka shërbyer së tepërmi rritjes së dimensionit shoqëror të FA si dhe rritjes së besimit që publiku në përgjithësi ka tek FA.

Do të ishte mirë që ky angazhim, krahas vullnetit politik të vendeve tona, të ishte i mbështetur me plane të parapërgatitura, të studiuara e të hollësishme, me qëllim që edhe ndihma e ndërsjellë të jetë në kohën e duhur dhe sa më efikase. Përgatitja me kohë e planeve të bashkëpunimit dhe koordinimit është një domosdoshmëri, kjo edhe për faktin se emergjencat e natyrës kërkojnë reagim të menjëhershëm dhe të mirëorganizuar. Në funksion të kësaj, ka ardhur koha që të konkretizohet propozimi i Ministrit të Mbrojtjes për ngritjen e një grupi rajonal ekspertësh të planifikimit të mbrojtjes, grup i cili të shqyrtojë mundësinë e zhvillimit të kapaciteteve të përbashkëta rajonale, bazuar në parimin e specializimit, për përballimin e emergjencave civile.

Krijimi i kapaciteteve të përbashkëta dhe ***mbështetja reciproke*** me forca dhe mjete, bazuar në plane të ndihmës e bashkëpunimit reciprok, është rruga drejt bashkëpunimit të frytshëm rajonal. Është i mundshëm zhvillimi i një përqasjeje sipas konceptit të BE “*sharing and pooling*” (shkëmbimi dhe bashkimi i kapaciteteve) në nivel rajonal. Mund të bashkohen struktura të njëjta të dy apo më shumë vendeve, apo të ngremë kapacitete të përbashkëta duke plotësuar njëri-tjetrin, për të përballuar një emergjencë të caktuar.

Është i mundshëm zhvillimi i një përqasjeje sipas konceptit të BE “sharing and pooling” (shkëmbimi dhe bashkimi i kapaciteteve) në nivel rajonal.

Në këtë kuadër, rëndësi ka sigurimi i kapaciteteve nga vendet e rajonit siç është *Qendra e Trajnimit* në Krivollak, Maqedoni. Kam mendimin se edhe tek ne duhet

të përshpejtohet puna për të përfunduar *Qendrën e Trajnimit* në Bizë, e cila mund të përdoret nga të gjitha vendet e rajonit e më gjerë për këtë qëllim.

Në stërvitjet e përbashkëta të zhvilluara në vend, ne kemi programuar dhe realizuar një pjesëmarrje të gjerë të aktorëve kombëtarë. Këtë përvojë të grumbulluar duhet ta shikojmë në një plan më të gjerë, duke synuar zhvillimin e stërvitjeve të përbashkëta me vendet fqinjë, duke zgjedhur ato vende apo terrene që mund të çenohen nga emergjenca të përbashkëta si zjarret, përmbytjet, tërmetet, etj. Kjo do t'i shërbente shkëmbimit të përvojave dhe ekspertizave, do të rriste besimin reciprok, shkallën e ndërveprimit dhe familjarizimin me situatat e krijuara si dhe mënyrat e veprimit për t'i përballuar me sukses ato.

Bashkëpunimi rajonal ka qenë i shumëllojshëm në kuadrin e Kartës A-5 dhe është kurorëzuar me projekte të suksesshme, në misionet e përbashkëta në Afganistan (ISAF), shkëmbim përvoje për planin e anëtarësimit në NATO, si dhe stërvitje e trajnime të përbashkëta midis FA të këtyre vendeve. Kjo përvojë e mirë duhet të shfrytëzohet në të ardhmen edhe në fushën e emergjencave civile, në nivel rajoni. Vendi ynë nxit bashkëpunimin edhe me vendet e rajonit, në kuadër të nismave të ndryshme rajonale, veçanërisht të Kartës A-5 apo *SEEDM*-it. Në këtë kuadër, Shtabi i Përgjithshëm i FA ka parë e duhet të shikojë me shumë interes zhvillimin e stërvitjes së përbashkët "*Joint Reaction*", e fokusuar në përballimin e emergjencave civile, planifikuar të zhvillohet në vendin tonë në vitin 2013, faza planëzuese e së cilës ka përfunduar 6 mujorin e parë të këtij viti.

Përsosja e fuqizimi i strukturave speciale aktive të emergjencave në mbështetje të popullatës, mbetet sekreti i përballimit të emergjencave të ndryshme.

Përsosja e fuqizimi i strukturave speciale aktive të emergjencave në mbështetje të popullatës, mbetet sekreti i përballimit të emergjencave të ndryshme.

Strukturat vepruese aktive në vendin tonë janë Forcat e Armatosura, Strukturat e PMNZSH-së, Shërbimi i Urgjencës, Policia e Shtetit, policitë e tjera si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit, grupet e specializuara për minierat, për naftën etj., si struktura monitoruese dhe vepruese mbështetëse. Këto struktura kanë role, detyra dhe përgjegjësi të veçanta për të gjitha fazat e menaxhimit të emergjencave dhe kjo është thelbësore. Pozitiv është fakti që ato bashkëpunojnë ngushtësisht me njëra-tjetrën, për të siguruar përgjigje sa më efektive të mundshme.

Përveç strukturave vepruese aktive janë edhe strukturat e OJF-ve si KKSH, PNUD, UNHCR, etj., të cilat kanë bashkëpunuar ngushtësisht me strukturat shtetërore (edhe me FA) në përballimin e emergjencave. Asnjë kontribut nuk është i tepër për të përballuar një emergjencë civile, pasi bashkimi bën fuqinë. Për rrjedhojë, së bashku, detyrat kryhen më mirë dhe me kosto më të ulët.

Është fakt se në emergjencat e viteve të fundit, strukturat e Forcave tona të Armatosura kanë qenë protagonistët kryesorë në përpjekjet për eliminimin e pasojave dhe shpëtimin e jetës së njerëzve. Kështu, Forcat Ajrore, me mjetet që kanë në zotërim, kanë kryer dhe mund të kryejnë transportin ajror aq të domosdoshëm, atëherë kur lëvizja në tokë është e pamundur. Kurse Forcat Detare

kanë kryer dhe mund të kryejnë transportin detar në rast nevoje. Në këtë mënyrë, me individualitetin që kanë, njësitë dhe repartet plotësojnë njëra-tjetrën dhe bëhen hallka të rëndësishme të një zinxhiri të vetëm. Kjo përsa i përket nxjerrjes në pah dhe zhvillimit të kapaciteteve brenda Forcave të Armatosura.

-Brigada e Mbështetjes Rajonale, duke qenë njësi e paracaktuar me mision për përballimin e emergjencave civile, kryen një shumëllojshmëri detyrash në përballimin e emergjencave në rast tërmeti, përmytjeje, zjarri, ndotjeje kimike e bakteriologjike, aksidentesh tokësore, etj, kurse njësitë dhe repartet e tjera, me veçoritë që kanë në përbërjen e tyre në forca e në mjete, shumë mirë mund të plotësojnë kuadrin e llojeve të veprimeve dhe të emergjencave.

Siç u tha më lart, në përballimin e emergjencave civile apo katastrofave natyrore të pritshme, kanë detyrat specifike shumë struktura të një shteti. Operacionet e EC paraqesin një veprimtari të gjithanshme joluftarake që si në kohë paqeje, edhe në kohë lufte, janë me rëndësi parësore.

Pjesë shumë e rëndësishme e këtij angazhimi janë dhe FA te vendeve të tjera. Por ato nuk janë instrumenti kryesor për përballimin e fatkeqësive të ndryshme natyrore e njerëzore. Ato janë në ndihmë dhe mbështetje të drejtpërdrejtë të strukturave civile. Kjo pasi me burimet që zotërojnë, me shkallën e lartë të organizimit, të gatishmërisë dhe aftësisë për dislokime të menjëhershme, FA janë të afta qysh në momentet e para të japin një kontribut të madh.

Në kuadër të Planit Kombëtar të Përballimit të Emergjencave Civile në vendin tonë është detyrë e përvitshme e të gjithë aktorëve kombëtarë (dhe sa herë që ka ndryshime në strukturë) të deklarojnë kapacitetet e tyre në SHP të FA, (të dhëna që shkojnë edhe në Drejtorinë e Përgjithshme të planifikimit dhe përballimit të EC).

Evidentimi i kapaciteteve operacionale në çdo forcë, njësi e repart të FA dhe njohja e mundësive që kanë njësitë e repartet, është hapi i parë për të kontribuar në përballimin e emergjencave civile më tipike për vendin tonë, si tërmeti, përmytje, bllokim të rrugëve

Evidentimi i kapaciteteve operacionale në çdo forcë, njësi e repart të FA dhe njohja e mundësive që kanë njësitë e repartet, është hapi i parë.

nga dëbora, evakuimi i popullsisë dhe shpërndarjen e ndihmave, zjarret, etj.

Si në çdo fushë tjetër edhe në fushën e emergjencave civile, me rëndësi janë: *prioriteti, specializimi dhe bashkëpunimi ndërmjet strukturave. Në kuadrin e zbatimit të “Smart Defence” është e nevojshme që kapacitetet e evidentuara të konfirmuara në fushën e “betejës” të përsosin më tej cilësitë e tyre, të ristrukturohen për të qenë më efikas dhe më profesionalë në fushën e veprimit.*

Ashtu siç ka theksuar Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Rasmusen, duhet... *“Të heqim dhjamërat e tepërta dhe të forcojmë muskujt”*. Kjo nuk duhet parë thjesht vetëm në aspektin numerik, por është e rëndësishme të konceptohet në aspektin cilësor, në rritjen e rendimentit dhe efektivitetit të grupeve, nënreparteve deri tek individët e veçantë, për të vepruar me intensitetin më maksimal dhe në kushtet më të vështira.

Në këtë kontekst, një nga detyrat kryesore të njësisve dhe reparteve në FA është evidentimi i vazhdueshëm i kapaciteteve kritike, ruajtja e aftësive operacionale dhe krijimi i kapaciteteve të tjera të nevojshme, që mund të përdoren për të përballuar një lloj emergjence, duke eliminuar njëkohësisht kapacitete të tepërta, jo vepruese apo që përdoren rrallë.

Përfundime:

Veçanërisht në fushën e emergjencave, vendet e rajonit tonë kanë sfida të përbashkëta. Ato përballen me rreziqe dhe kërcënime rajonale të njëjta, të cilët mund të përballohen më mirë me politika, kapacitete dhe zgjidhje të përbashkëta.

Koncepti i përballimit të emergjencave civile dhe mbrojtjes nga pasojat e katastrofave të ndryshme nuk do të ishte i plotë nëse ai konceptohet si kompetencë ekskluzive vetëm e një shteti. Kjo pasi emergjencat dhe katastrofat e mundshme natyrore mund të ndodhin jo vetëm brenda territorit të një vendi, por ato mund të kenë një shtrirje rajonale e më gjerë.

Ne na duhet një “mbrojtje e mençur” në fushën e mbështetjes së njëri-tjetrit edhe për rastet e emergjencave civile. Emergjencat civile duhet të jenë fusha kryesore e bashkëpunimit dhe zhvillimit të kapaciteteve të përbashkëta kombëtare, dypalëshe apo rajonale.

Bashkëpunimi rajonal në fushën e EC dhe sipas konceptit “mbrojtje e mençur”, kërkon mbështetje politike. Është e domosdoshme të bëhen rregullime ligjore të reja për të sanksionuar e mundësuar angazhimin e përbashkët në përballimin e këtyre emergjencave, duke synuar përgatitjen e legjislacionit në përputhje me standardet e ushtrive homologe e partnere të NATO-s.

Për përballimin e emergjencave dhe katastrofave të pritshme me sa më pak kosto dhe më me efektivitet është e rëndësishme zhvillimi i kapaciteteve operacionale më kritike, duke eliminuar kapacitetet e tepërta, të vjetra dhe ato që nuk përdoren.

Ka shumë rëndësi të tregohemi parashikues, të bashkëpunojmë ngushtë kur veprojmë bashkë, si dhe të zhvillojmë kapacitete të përbashkëta, të cilat janë të nevojshme për të përballuar rreziqet dhe kërcënimet e përbashkëta rajonale. Është fakt që në situata kritike është i nevojshëm dhe produktiv rajonalizimi i kapaciteteve për përballimin e EC. Në këtë kuadër duhet të bëhet njohja dhe deklarimi i kapaciteteve të vendeve tona për të gjitha emergjencat e pritshme. Dhe jo vetëm kaq por dhe të deklarohet se për ç’lloj emergjence ofrohet *ndihma më e kualifikuar dhe e specializuar në kuadrin rajonal*.

Është shumë e rëndësishme evidentimi i përvojës në emergjencat e ndodhura vitet e fundit në secilin vend dhe në rajon dhe pasqyrimi i këtyre eksperiencave në manualët, skenarët, planet dhe programet stërvitore. Në këtë kuadër duhet të synohet në plotësimin e setit të plotë të doktrinave dhe manualeve taktike e teknike në lidhje me emergjencat civile.

Është me shumë rëndësi dhe interes për të gjithë njohja e përvojës dhe eksperiencave që ka secili shtet në organizimin dhe kryerjen e operacioneve për përballimin e emergjencave civile. Këtu ka vend edhe për shkëmbimin e ekspe-

riencës së ushtrisë sonë me ato të vendeve të rajonit partnere e më gjerë.

Studimi me vëmendje i praktikave të ushtrive homologe për të gjitha llojet e Emergjencave. Rishikimi i të gjithë sistemit të EC në territorin e vendeve tona duke analizuar rreziqet dhe skenarët e mundshëm, burimet dhe kapacitetet, planifikimin e bërë nga gjithë institucionet dhe gjithë nivelet.

Hartimi dhe zbatimi i programeve dhe planeve stërvitore në interes të rritjes së profesionalizmit dhe përgatitjes së personelit forcave për përballimin e EC. Arritja e standardeve të NATO-s për këto lloj operacionesh kërkon shkëmbimin e eksperiencës dhe zhvillimin e stërvitjeve të përbashkëta edhe për emergjencat civile.

Bibliografia:

- Koncepti Strategjik i NATO-s, miratuar nga krerët e shteteve dhe qeverive të vendeve të Aleancës.
- “The New Strategic Cocept-Three different perspectives”, Kolegji i NATO-s në Romë, RevistaVoxCollegei, Janar 2011.
- “Security policy in area of budgetary constraint”, 21Qershor 2010. Fjala e Anders Fogh Rasmussen në Konferencën e Sigurisë dhe të Mbrojtjes në Bruksel.
- Benjamin Bloom, Taxonomy of Learning and Research.
- Probleme të dala nga takimi rajonal në Strugë, Qershor 2012.

Qendra e rëndesës në operacionet COIN

Kolonel Riza Zaja,
Shef i Shtabit të KDS

N/Kolonel Dëfrim Haxhia,
Pedagog për Operacionet e Mbështetjes së Paqes,
Akademia e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”

Vijon nga Numri i kaluar (RU, Nr. 2/2012, Qershor 2012)

Pikërisht si atje ku s’ka armë që të garantojnë epërsinë në luftën konvencionale, po ashtu nuk ka as “plumb të argjendtë” për garantimin e suksesit kur vjen puna tek aksionet COIN. Ekziston një boshllëk ndërmjet doktrinës dhe rezultateve taktike në luftën COIN. Ky shkrim synon plotësimin e një boshllëku, duke paraqitur atë që ne e quajmë një mjet i përshtatshëm për planëzimin:

Analiza e Qendrës së Rëndesës e integruar, si një hap kulmor i Përgatitjes Zbuluese të Fushës së Luftimit (PZFL) në COIN. Analizimi i Qendrës së Rëndesës në COIN përkthen teorinë në praktikë nga poshtë-lart, duke treguar rrugët e veprimeve të kryengritësve dhe sugjeron kundërveprime ndaj tyre. Ky proces e afron COIN në një perspektivë të dyfishtë, në atë të natyrës njerëzore (popullsisë) dhe të kryengritjeve.

Analiza e PZFL dhe Qendrës së Rëndesës në COIN

Qëllimi ynë është të kuptojmë strategjinë specifike të armikut, të vendosemi në brendësi të ciklit të vendimeve të tij dhe gjithashtu të parashikojmë veprimet e mundshme të tij. Për të bërë këtë, ne përdorim 4 hapat e PZFL në COIN:

1-Njohja e mjedisit; 2-Përcaktimi se si armiku do të shfrytëzojë çështjen kryesore për të gjeneruar konfliktin duke rritur urrejtjen e popullsisë dhe më vonë për ta manipuluar atë; 3-Përcaktimi i strategjisë së kryengritësve dhe veprimeve të mundshme të tyre; 4-Konkretizimi i hapave 1-3, me një analizë të Qendrës së Rëndesës në COIN.

Ky përfaqësim fokuson operacionet në shmangien e rrënjëve të konfliktit të një veprimtarie kryengritëse rebele, vlerëson bashkëveprimin me vendin pritës (VP),

përgjatë të gjithë linjave të operacionit (LO) dhe bashkon synimet afatshkurtër dhe ato afatgjata. Produkti i këtij procesi mund të ndihmojë shtabet në përgatitjen e informacionit kritik të kërkuar për komandantin, shpërndan mjetet për neutralizimin e operacioneve të informacionit (INFOPS) të kryengritjes si dhe përcakton veprimet specifike të armikut. Në mënyrë kritike, procesi prodhon matricën që mund të ndihmojë në vlerësimin e një kursi të mundshëm veprimi. Të marra së bashku, përgatitja zbuluese e fushës së luftimit (PZFL) dhe Analizimi i Qendrës së Rëndësës në COIN, është një proces i integruar që rrjedh nga perspektiva e popullsisë dhe ajo e kryengritjes.




Fig. 1.1 Cikli i PZFL në COIN

Njerëzit janë situata

Për arsye që popullsia është çelësi i suksesit kundër kryengritjes, PZFL në COIN duhet të fillojë për popullin dhe për problemet e tyre. Të dy, si kryengritësit ashtu edhe kundërkryengritësit ndërmarrin strategji për të shpëputur njeri-tjetrin nga popullsia, ndërkohë që e tërheqin popullsinë aktive ose pasive në mbështetje të tyre. Njerëzit duhet të zgjedhin për mbështetjen e njërës ose tjetrës palë; kontrolli i vullnetit të tyre është më i rëndësishëm se kontrolli i territorit. Sipas *Klausewitz*, një Qendër Graviteti (Rëndese) është “një pikë drejt së cilës duhet të drejtohen të

*gjitha energjitë*¹. Për kundërkryengritjen, të gjitha energjitë duhet të drejtohen në sigurimin dhe vendosjen e kontrollit mbi popullsinë dhe fitimin e mbështetjes nga ana e saj. Fuqia buron nga populli, pa mbështetjen e tij, as kryengritja dhe as kundërkryengritja nuk mund të arrijnë fitoren.

Në hapin e parë të PZFL në COIN, ne marrim parasysh 6 kategori të konsideratave civile të cilat analizohen nga këndvështrimi i popullsisë, kryengritësve dhe luftës kundërkryengritëse, të cilat janë:

1-Zona (vendi); 2- Strukturat; 3-Kapacitetet; 4-Organizatat; 5-Popullsia; -Ngjarjet.

ZSKOPN ose (**ASCOPE**) në zonën e operacionit, identifikon lidhjet ndërmjet veprimeve fizike dhe popullsisë. Me fjalë të tjera ne lëvizim nga “*çfarë*” tek “*kush*”. Elementi njerëzor është shumë i rëndësishëm në këtë pjesë. Analiza e ASCOPE ndihmon kundërkryengritjen të kuptojë popullsinë dhe marrëdhëniet kulturore, shoqërore dhe ato fizike, në të cilat ata jetojnë.

Zbulimi i rrënjëve të konfliktit

Objektivi kryesor në kundërkryengritjen (COIN) duhet të drejtohet në asgjësimin e rrënjëve të konfliktit. Rrënjët e konfliktit parashikojnë lindjen e kryengritjes si dhe përcaktojnë se çfarë qëllimi kanë ata. Këtu konsiston hapi i dytë i PZFL të kundërkryengritjes (COIN IPB). Duke e krahasuar me një metaforë mjekësie, ky proces shpjegohet si më poshtë: “*Rrënja është plaga e shkaktuar, kryengritja është infeksioni që del nga kjo plagë. Kundërkryengritja duhet ta trajtojë këtë infeksion për të shëruar plagën dhe më pas të gjejë dhe pastrojë çfarëdo pasojë që ka shkaktuar kjo plagë në trup (popullsi)*”.

Doktrina e Kundërkryengritjes (COIN) jep trajtime të përgjithshme për sëmundjet që sjell kryengritja, por ilaçi për sëmundje specifike duhet të jetë gjithashtu specifik: kundërkryengritja duhet të zbulojë, në secilën fushë, rrënjët (shkaqet) e sëmundjes, përpara se kryengritja të materializohet (shpërthejë).

Kundërkryengritja duhet të bëjë më tepër sesa mundësitë e një grupi kryengritësish, duke asgjësuar rrënjët të cilat sjellin më pas një kryengritje në shkallë të gjerë. Është shumë e nevojshme të identifikosh taktikat speciale të kryengritësve, por çelësi i suksesit është të kuptosh qëllimin që fshihet pas operacioneve të saj. Pyetja që kërkon përgjigje është jo çfarë lloj kryengritje është, por çfarë po e shkakton atë². Nëse shkaqet janë politiko-shoqërore, kryengritja do të shkaktojë pasojat të rënda reale në popullatën vendase. Kryengritja do të përdorë forma të ndryshme taktike për krijimin e këtyre shkaqeve.

Duke iu drejtuar rrënjëve të konfliktit dhe rrugëve që e sjellin atë, forcat kundërkryengritëse (COIN), mund të arrijnë qëllimin përfundimtar duke ia hequr forcave kryengritëse mbështetjen e popullsisë vendase.

Një analizë e kujdesshme, e hollësishme dhe e kuptueshme e veprimtarive specifike operacionale, është një shans i mirë për të fituar mbështetjen e popullsisë. Është

¹ Carl Von Clausewitz (1780 - 1831) “On war”.

² Counterinsurgency Warfare: Theory and Practice, David Galula, 1964 fq 10.

më se e kuptueshme që vendosja e këtyre aktiviteteve të bëhet që në nivele të ulëta njësie komandimi si p.sh nivel toge, pasi ky nivel është vendi më i mirë për të filluar. Megjithatë, edhe pse kryengritjet janë unike (origjinale në lloje), ato përsëri kanë disa karakteristika të përbashkëta. Në thelb, tre janë kërkesat bazë të nevojshme për një kryengritje: një popullsi e prekshme (e pambrojtur dhe problematike në aspektin shoqëror, politik dhe ekonomik); një udhëheqës në drejtim (një person, grup me ideale të njëjta); mangësi në qeverisje një qeveri pasive ose shtypëse³. Analiza e Qendrës së Gravitetit në COIN shtron kërkesa paraprake në kontekstin e strategjisë së kryengritjes dhe vendit të rrënuar ekonomikisht.

Kundërkryengritja (COIN) fiton besimin dhe mbështetjen e popullsisë dhe iu mohon kryengritësve këtë mbështetje jetësore, duke mbështetur ose ndërmarrë nisma legjitime ndaj rrënjëve të konfliktit, në mënyrë efçente. Veprimet taktike si zbulimi i pajisjeve eksplozive të improvizuara (IED), kapja e materialeve dhe pajisjeve që përdoren për to, pastrimi i zonave, asgjësimi i celulave ku përgatiten IED-të dhe shkatërrimi i infrastrukturës së tyre, janë aspekte të luftës antiguerrile dhe, si të tilla, janë pjesë e një ndër shtyllave të operacioneve COIN ndaj rrënjëve të konfliktit, jo në mënyrë të drejtpërdrejtë. Pa një mënyrë afatgjatë të shkëputjes nga popullsia, forcat e kundërkryengritjes do të jenë duke goditur një armik me aftësi të rigjenerueshme të pafundme. Për të qenë të sigurtë, kundërkryengritësit duhet të përballen me forcat guerrile dhe taktikat e tyre, por në të njëjtën kohë ata nuk duhet të lenë pas dore nevojën e një kurimi afatgjatë të problemeve politiko-shoqërore. Operacionet efektive COIN që, në rrënjët e konfliktit, synojnë në zhvillimin e veprimtarive që parandalojnë aftësitë e armikut për të fabrikuar, transportuar, vendosur dhe aktivizuar IED-të që në fillim.

Strategjia e kryengritjes përballë natyrës së saj

Tipi ose natyra e kryengritjes (ajo çfarë kërkohet) nuk duhet të ngatërrohet me vetë strategjinë e saj (si duan ata të arrijnë qëllimin e tyre). Për të pasur sukses, operacionet kundërkryengritëse (COIN) duhet të fokusohen kryesisht në strategjinë e armikut dhe në atë se si i shtrin ai veprimet e tij në kohë dhe hapësirë, jo në ideologjinë ose qëllimin e tij përfundimtar. Keqkuptimi ndërmjet vlerësimit të tipit (llojit) dhe strategjisë, tek ky nivel i analizës, do të drejtojë keq veprimet tona të kundërkryengritjes.

Duke konsideruar natyrën e problemit ose tipin e tij përballë strategjisë është si të konsiderosh separatistët kurdë, FARC kolumbianë, *Al-Qaeda*-n etj, që kanë natyra të ndryshme, por përdorin të njëjtën strategji: terrorizmin urban, që është përdorur edhe nga liderët revolucionarë si *Fratz Fanon* në Algjeri apo kreu i *Tupamaro*-s uruguajane në vitet 60-70. Këto grupe sulmonin qeverinë për të provokuar urrejtje dhe për shkaktuar dëme anësore në popullsinë lokale, me qëllim që të arrinin një ndarje ndërmjet qeverisë dhe popullit.

Duke kuptuar strategjinë e kryengritjes, si dhe çfarë është ajo në gjendje të bëjë, ne mund të zhvillojmë një ide të qartë se çfarë qëllimi përfundimtar kanë

³ Field Manual (FM) 90-8, Counter guerrilla Operations, Gusht '86, Kapitulli II, fq 1-4

operacionet e tyre. Ekzaminimi i këtyre qëllimeve dhe tentativat e kryengritësve për t'i arritur ato nëpërmjet luftës guerrile, na lejojnë ne të jemi në krye të ciklit të tyre të vendimmarrjes. Qëllimi i operacioneve kryengritëse mund të zbehet ose të kundërreklamohet. Ato mund të kenë pasoja të menjëhershme, ose efekte ngadalësuese për objektivat e tyre afatgjata. (për shembull: autobombat në popullsi lokale, mund të duken kundër-produktive sepse shkaktojnë urrejtje të menjëhershme ndaj bombave dhe atyre që i kryejnë ato, por kanë qëndrueshmëri në fushatën masive të dhunës e cila ka rezultate afatgjata; mund të zgjojë mosmbështetje popullore për qeverisjen si dhe ta bëjë popullsinë që të besojë se kryengritësit mund t'i mbrojnë ata më mirë se qeveria). Cilido të jetë qëllimi i kryengritjes, nëse ne e kapim problemin në perspektivën e popullsisë dhe fushatës planëzuese të saj, ne mund t'i kundërvihemi në sasi dhe në nivel. Analiza e Qendrës së Gravitetit (COIN COG) nxit kundërkryengritjen të ndërmarrë veprime taktike që drejtohen në rrënjët e fillimit të një konflikti si dhe e lejon atë të ketë sukses edhe gjatë ndërrimit të njësive të tjera (rotacionit).

Shtatë shtyllat e kryengritjeve (rebelimeve)

Doktrinat e sotme kanë identifikuar shtatë aspekte kyçe në dinamikën e kryengritjes:

Lidershipi; Ideologjia; Objektivat; Mjedisi dhe gjeografia; Mbështetja e jashtme; Sinkronizimi i fazave me kohën; Vijat operacionale dhe organizative.

Kundërkryengritja (COIN) mund t'i përdorë këto dinamika për të identifikuar strategjinë e kryengritjes si dhe të parashikojë kurset e tyre të veprimit. Këto analiza duhet të bëhen për çdo rajon në veçanti, pasi faza të ndryshme të këtyre kurseve të veprimit mund të zhvillohen në vende të ndryshme. Ky hap (hapi 3 në PZFL e COIN, analiza e rrezikut), konsideron në hollësi se si kryengritja dhe popullsia janë të lidhura me mjedisin.

Analiza e Qendrës së Gravitetit të armikut gjatë COIN

Në COIN Qendra e Rëndesës përgjithësisht është një aspekt i popullsisë (bashkë-etni, besime të përbashkëta që janë zbuluar në hapat 1 dhe 2 të PZFL) që shfrytëzon armiku (hapi 3) për të përfutur mbështetje aktive apo pasive nga popullsia. Analiza e Qendrës së Rëndesës (Gravitetit) të armikut (COIN COG), ndryshe e njohur si Kursi i Veprimit të kryengritjes (hapi 4), sjell thjeshtë së bashku tre hapat e para të PZFL; vendos të dhënat e dala në kontekst planëzues dhe i përdor për të kuptuar kompleksitetin e mjedisit, zbulon se si armiku përdor rrënjët e konfliktit për të fituar mbështetjen ose për të vendosur kontroll ndaj popullsisë. Analiza është e parashikuar për të nxjerrë e kuptuar lidhjet ndërmjet popullsisë dhe kryengritësve. Shkaqet e konfliktit ndikojnë në hapjen e bashkëveprimit të popullsisë me kryengritjen. Populli, si shkëmbim, i mbështet veprimet e kryengritjes dhe ruan ekzistencën e saj për arsyen se beson se kryengritja mund të përmbushë më së miri nevojat e tij, ndërsa qeveria jo, cilado qofshin nevojat, materiale, fizike, kulturore, shpirtërore apo ideologjike.

Analiza e Qendrës së Rëndesës të armikut (COIN COG) i jep mundësi njësisë të mendojë dhe të veprojë, në mënyrë jo konvencionale, për të zbuluar strategjinë

dhe qëllimet operacionale të armikut si dhe të zbulojë planet e tij për të arritur qëllimin me anë të veprimeve taktike.

Ashtu siç u përmend më sipër, analiza e Qendrës së Rëndesës së armikut, është ai aspekt i popullsisë që shfrytëzon armiku për të arritur qëllimet e veta operacionale. Kryengritja shfrytëzon atë grup specifik të shkaqeve për të fituar mbështetje aktive ose pasive. Qendra e Gravitetit e mundshme për armikun është një lider zyrtar ose jo zyrtar, një mesazh informacioni operacional specifik ose një korridor i ngushtë që mundëson dhe lejon kryengritjen të shfrytëzojë Qendrën e Gravitetit të Forcave Kundërkryengritëse. Analiza e Qendrës së Rëndesës (Gravitetit) të armikut shqyrton veprimet se si të shkëpusë fizikisht dhe ideologjikisht kryengritjen dhe kryengritësit nga popullsia. Ajo përngjan me një fragment të lojës luftarake, me konsiderata, me parashikime veprimesh dhe kundërveprimesh. Ky proces i ndihmon planëzuesit për të kuptuar kompleksitetin e mjedisit operacional, efektet, rreziqet dhe kundërveprimet për çdo veprim ose reagim specifik; mundëson kundërkryengritjen të zhvillojë më tepër se një kurs të thjeshtë veprimesh, që i përgjigjet një veprimi të kryengritjes; shtjellon shkaqet e konfliktit dhe lejon kundërkryengritjen të dalë në krye dhe me përparësi ndaj kryengritjes, duke kryer operacione që ndërtojnë një marrëdhënie me komunitetin lokal, përmes linjave logjike të operacionit. Në vend që të fokusohen vetëm tek EID dhe grupi që e vendos atë, analiza e Qendrës së Rëndesës, vlerëson gjithashtu edhe mjedisin që ndihmon në lindjen dhe zhvillimin e këtij grupi.

Analiza e Qendrës së Rëndesës të forcave tona

Analiza e Qendrës së Rëndesës në COIN, nuk përfundon me armikun, por ka gjithashtu edhe një komponent të forcave mike. Ndërsa analizat e mëparshme synonin në mohimin e mbështetjes së popullsisë ndaj kryengritjes, me vonë ato na ndihmojnë në gjetjen e kurseve të veprimeve më të mira për ta tërhequr këtë mbështetje popullore drejt kundërkryengritësve dhe, për më tepër, ndaj qeverisë vendase. Përdorimi i qëllimeve operacionale të armikut dhe rrënjëve të konfliktit për të parashikuar se si do të reagojë armiku, ndihmon planëzuesit të zhvillojnë nismat e forcave mike. Në analizat e QG të forcave mike në COIN, planëzuesit duhet të zhvillojnë lojë luftarake specifike për COIN, të bazuar në popullsinë dhe kryengritjen. Loja luftarake konvencionale nuk mund të parashikojë aksionet e kryengritësve.

Lidhja nga poshtë-lart

Kuptimi i mjedisit në COIN që përftohet nëpërmjet PZFL, i jep kundër kryengritësve epërsi në operacione, nivele dhe numër. Analiza e Qendrës së Rëndesës (Gravitetit), edhe një herë si hapi 4 i PZFL në COIN, lidh zbulimin e strategjisë së armikut nga poshtë-lart, duke ndihmuar komandantët në dizenjimin e kontureve dhe koncepteve operacionale të veprimeve të armikut, studion popullsinë dhe prekshmërinë e saj dhe bën që popullsia të zgjedhë e të mbështesë qeverinë vendase. Decentralizimi i operacioneve COIN kërkon përsëri një nivel të lartë shtabi dhe komandimi që të koordinojë përpjekjet si dhe të vëzhgojë, mbulojë dhe parashikojë veprimet operacionale. Analizat ndihmojnë gjithashtu për përmbushjen e këtyre detyrave. Ashtu si hapi i 4 i PZFL-së në veprimtaritë

COIN, Analizat e Qendrës së Rëndesës (Gravitetit), janë përdorur për të integruar afrimin tonë me operacionet. E ndërmarrë në perspektivën e popullsisë dhe e fokusuar tek natyra e kryengritjes, kjo analizë ndërton detaje metodike në nivelet e ulëta dhe ndihmon planëzuesit të formulojnë Informacionet Kritike, të kërkuara për komandantin (CCIR) që janë vendimtare në arritjen e qëllimeve strategjike. Analizat e Qendrës së Rëndesës (Gravitetit) drejtojnë identifikimin nga ana jonë të nismave të armikut dhe të operacioneve specifike të tij, sipas fushave të mëposhtme:

- Përcaktojnë çështjet kryesore të diskutimit me liderët e komunitetit, të cilët mund të sjellin informacionin që ka të bëjë me unitetin dhe diversitetin e popullsisë;
- Ndhijmojnë në identifikimin e liderëve jo zyrtarë të komunitetit dhe mundësitë e tyre, në vend të strukturave apo asetëve të tyre;
- Zbulojnë cilët janë rekrutuesit ose zëdhënësit e armikut, ku janë vendet që veprojnë dhe si ndërveprojnë me popullsinë;
- Ndhijmojnë planëzuesit të formojnë/ngrenë kurset e veprimeve taktike të mundshme të armikut;
- Identifikojnë projektforma ekonomike, shoqërore dhe politike për secilin lider si dhe sigurojnë ndihmë për secilin prej tyre, në mënyrë që t'i bëjnë ata të mbështesin qeverisjen;
- Nënvizojnë lidhjen ndërmjet kryengritësve, organizatave kriminale dhe mbështetjes vendase;
- Promovojnë ndërveprimin ndërmjet përpjekjeve të koalicionit shoqëror-ekonomik dhe politik me elementet e qeverisjes në vend, tregojnë sesi ky bashkëveprim është i nevojshëm për metodën e punës.

Si përfundim mund të themi se, Analiza e Qendrës së Rëndesës (Gravitetit) në COIN maksimizon burimet, përgatit shtabin dhe përmirëson ndërveprimin. Ajo siguron mesazhe specifike të përshtatura për shqetësimet e përbashkëta të njerëzve drejt një mënyre/rruge të komunikimit normal. Ekzaminimi i problemeve në COIN, nëpërmjet perspektivës së popullsisë dhe armikut, i mundëson kundërkryengritësve të bashkojnë burimet me fushat specifike në mënyrë moderne dhe të balancuar.

Duke kryer, në mënyrë kritike, Analizat e QG në COIN brenda fazës së PZFL, ne normalisht përdorim Linjat Operacionale të armikut për t'i dhënë formë fushatës sonë në kontrollin më mirë të popullsinë dhe për të fituar mbështetjen dhe besimin e saj. Për të përballuar ciklin e vendimmarrjes së armikut, ne duhet të kuptojmë se si ata planëzojnë për të arritur qëllimet e tyre operacionale. Nëse ne mendojmë vetëm faktikisht (p.sh., veprimet guerile), ne do të jemi të detyruar të kryejmë detyrën tonë brenda një mënyre të vetme reaguese (p.sh., taktikat, teknikat dhe procedurat e kalimit para dhe mbrapa, kryerjen e analizave standarde, ndjekjen e kryengritësve deri në zonat e bazimeve të tyre, etj.). Duke parë përmes spektrit të qëllimeve operacionale të armikut dhe duke kuptuar marrëdhëniet e tyre me popullsinë, si edhe përpjekjet e tyre për t'i shfrytëzuar ato, kjo iu mundëson

komandantëve të ndërtojnë plane aktive kundërkryengritëse afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata.

Analizat e Qendrës së Rëndesës, si për armikun dhe për forcat tona në operacionet COIN, janë një qasje gjithëpërfshirëse ndërmjet forcave ushtarake dhe agjencive të tjera qeveritare, të cilat duhet te veprojnë bashkërisht dhe me efektshmëri në një mjedis ekstrem sfidues, që zakonisht kërkon vite për t'u kuptuar.

Bibliografia:

- STANAG 2611, AJP-3.4.4 COIN Operations, 2011.
- ISAF (COIN) Mission Specific Training
- Guidelines, 2010.FM 3-24 Counterinsurgency, 2006.
- AJP-3.4 Non Article 5 Crises Response Operations, 2005.
- USA FM 3-24/1 COIN TTPs.
- Bi-SC JOG 10/01 Joint Operational Guidelines (JOG) COIN, May 10
- AJP-9 Allied Joint Doctrine for Civil-Military Cooperation, 2003.
- AJP-3.10.1 Allied Joint Doctrine for Psychological Operations, 2007.
- ATP-3.4.4.1 Guidance for the Application of Tactical Military Activities in COIN Study
- Counterinsurgency, David Kilcullen (2010).
- COIN Handbook - Cutting the Gordian Knot, LTC Mark Ulrich, Oct 2010.
- Counterinsurgency Warfare: Theory and Practice, David Galula, 1964.

Qendra e Simulimit, një Aftësi e Re Stërvitore

Dee Esplin,
Përfaqësues i CUBIC në Qendrën e Simulimit, KDS

Trajtesë e shkurtuar. *Kur kryhet në mënyrë korrekte dhe në standardet moderne, stërvitja ushtarake është një veprimtari e shtrenjtë ekonomikisht që kërkon menaxhim të saktë, mjetet e duhura dhe zbatimin e procedurave të vërtetuara më parë.*

Krijimi i Qendrës së Simulimit siguron një aftësi trajnuese të re, moderne dhe më të mirë për të përmirësuar trajnimin kudo në FARSH. Kjo qendër është e vendosur në KDS dhe do të jetë plotësisht operacionale në tetor të vitit 2012. Ajo do të zhvillojë stërvitjen e saj të parë të mbështetur me simulim në nëntor. Qendra është e projektuar, kompletuar dhe pajisur për t'iu siguruar njësisve dhe liderëve të FARSH-së një mjedis trajnues të shekullit të 21, në të cilin do të bëhen praktika dhe mësim. Duke u përdorur siç duhet, Qendra do të përmirësojë në mënyrë domethënëse trajnimin, zhvillimin e liderëve dhe gatishmërinë e njësisve kudo në FARSH.

Misioni i Qendrës së Simulimit të FARSH-së është që të sigurojë një trajnim shumëkombësh, ndërqeveritar, të përbashkët dhe real, me armë të kombinuara për komandantë, shtabet dhe liderët e FARSH-së, në përputhje me doktrinën Kombëtare dhe të NATO-s, në mënyrë që të përgatiten njësitë për sukses në spektrin e plotë të kërkesave operacionale, të rrisë mësimin, inovacionin dhe përmirësimin në mbarë Forcën.

Çfarë është simulimi?

Stërvitja efektive është organi më i rëndësishëm i çdo njësie ushtarake dhe guri i themelit të mbijetesës në fushëbetejë. Stërvitja e fortë dhe reale i ndihmon liderët, njësitë dhe ushtarët/detarët të arrijnë ekspertizën taktike dhe teknike që nevojitet për operacionet luftarake të suksesshme, si pjesë e NATO-s gjatë operacioneve të ruajtjes së paqes dhe në mbështetje të popullsisë. Kur kryhet në mënyrë korrekte dhe në standardet moderne, stërvitja ushtarake është një veprimtari e shtrenjtë ekonomikisht që kërkon menaxhim të saktë, mjetet e duhura dhe zbatimin e procedurave të vërtetuara më parë.

Për të arritur rezultatet më të mira, me koston më të vogël të mundshme, përdoret një mjedis stërvitor i integruar i cili përfshin udhëzime që jepen në klasë, trajnim të bazuar në simulim si dhe stërvitje reale. Brenda këtij konteksti ushtarët/detarët dhe liderët e tyre duhet të zotërojnë detyrat themelore individuale dhe kolektive të misionit. Për më tepër, individët, ekipet, seksionet dhe njësitë e plota duhet të trajnohen në standarde të përcaktuara si pjesë e një ekipi me armë të kombinuara.

Thënë në mënyrë të thjeshtë, simulimi përsërit realitetin, por me një kosto më të vogël. Teknologjia e simulimit është e përdorur në mbarë botën nga organizata ushtarake, industri dhe akademi, për të zgjeruar

Thënë në mënyrë të thjeshtë, simulimi përsërit realitetin, por me një kosto të vogël.

aktivitetet e trajnimit, arsimimit, analizave dhe procesit të blerjes. Përfitimet nga përdorimi i simulimit për trajnimin ushtarak janë të dokumentuara mirë. Simulimi:

- Mund të përsërisë spektrin e plotë të operacioneve ushtarake.
- Mëson aftësi para përdorimit të tyre në një mjedis stërvitor real dhe të shtrenjtë.
- Redukton kostot e trajnimit që vijnë nga municionet, karburanti, pjesët e këmbimit, furnizimet, udhëtimi, etj.
- U jep ushtarëve një mënyrë për t'u trajnuar në mënyrë efektive kur siguria teknike ose kompleksiteti operacional do ta ndalonte atë veprimtari.
- Mundëson trajnim kur hapësira e manovrimit është e kufizuar.
- Përdor procesin e Rishikimit Pas Veprimeve (AAR) për të lehtësuar mësimin nëpërmjet rishikimit.
- Mundëson ritrajnimin e menjëhershëm nëse nevojitet.
- Simulon bisedat profesionale kudo në Forcë në lidhje me doktrinën dhe procedurat ushtarake, duke krijuar kështu një katalizator për inovacionin dhe ndryshimin.

Detyrat themelore të misionit të saj janë:

- Të lehtësojë trajnimin e vështirë/real të bazuar në simulim për komandantët, shtabet dhe liderët në përputhje me doktrinën/standartet e FARSH-së dhe të NATO-s.
- Të planifikojë, projektojë, përgatisë, ekzekutojë dhe të vlerësojë përvoja stërvitore me cilësi të lartë të cilat janë të bazuara në Listën e Detyrave Themelore të Misionit (METL), janë të orientuara drejt zbatimit të detyrës dhe të udhëzuara nga metoda, teknika dhe procedura stërvitore të provuara më parë.
- Të përdorë mjete dhe teknologji stërvitore të avancuara duke përfshirë Simulimin Taktik dhe të Konfliktit të Përbashkët (JCATS), Hapësirën Virtuale të Betejës 2 (VBS2) si dhe Modulën e Menaxhimit të Stërvitjes së Përbashkët (JEMM) për të krijuar mjedise stërvitore efektive dhe reale me koston më të ulët.
- Të shërbejë si katalizator për mësimin, inovacionin dhe përmirësimin në mbarë Forcën me anë të përdorimit të sinkronizuar të të gjitha burimeve.

Procesi i Rishikimit Pas Veprimeve (AAR) është një element themelor dhe i rëndësishëm i trajnimit në Qendrën e Simulimit. Sidoqoftë, Qendra nuk vlerëson gatishmërinë e njësisë (ashtu si procesi i NATO CREVAL), por siguron një mjedis mësimi dhe vlerësimi. Trajnimi i bazuar në Simulim mbështet nismën dhe inovacionin dhe i lejon liderëve të bëjnë gabime të ndershme pa u bërë paragjykes. Rishikimet Pas Veprimeve (AAR) reale dhe gjithëpërfshirëse iu mundësojnë pjesëmarrësve dhe vëzhguesve të diskutojnë lirshëm se çfarë shkoi mirë dhe çfarë shkoi keq, të kuptojnë çfarë të bëjnë më mirë në stërvitjet trajnuese dhe operacionet ushtarake të ardhshme. Qendra e Simulimit e FARSH-së përfshin praktikatat më të mira dhe mësimet e nxjerra nga Forcat e Armatosura të SHBA-së dhe të vendeve të tjera të NATO-s në më shumë se 30 vitet e shkuara.

Trajnimi i bazuar në Simulim mbështet nismën dhe inovacionin dhe i lejon liderëve të bëjnë gabime të ndershme pa u bërë paragjykes.


Nga perspektiva e sistemeve, Qendra e Simulimit është rregullimi i personelit, programeve kompjuterike të simulimit, rrjeteve elektronike, proceseve dhe procedurave të trajnimit, objekteve dhe pajisjeve, siç tregohet më poshtë.



Personeli. Staf i Qendrës së Simulimit të FARSH-së, i përbërë nga 24 oficerë, nënoficerë dhe civilë shqiptarë, është rritur nga tre këshilltarë dhe një përkthyes të CUBIC. Ekipi u rekrutua dhe u zgjodh nga të gjithë komponentët e Forcës për të zbatuar funksionet themelore të përshkruara si më poshtë.

Stafi i Qendrës u formua pranverën e kaluar dhe ka qenë në trajnim intensiv për të zhvilluar aftësitë e domosdoshme individuale dhe kolektive. Aktualisht ekipi mund të kryejë funksionet bazë të mbështetjes së simulimit dhe zhvillimit të stërvitjes dhe vazhdon të mësojë, rritet dhe zhvillohet përditë.

Simulimet. Qendra do të përdorë dy simulime të



fuqishme. Këto përfshijnë Simulimin Taktik dhe të Konfliktit të Përbashkët (JCATS) si dhe Hapësirën Virtuale të Betejës 2 (VBS2). Të dy programet janë sisteme të vërtetuara më parë dhe të përdorura nga NATO, SHBA dhe shumë vende të tjera.

JCATS siguron një simulim të përbashkët dhe të shumanshëm (forcë ajrore, tokësore dhe detare) me rezolucion të lartë dhe me përshtatshmëri në të gjithë spektrin e kërkesave operacionale. JCATS është shumë efektiv kur përdoret për të trajnuar komandantë dhe shtabe njësisish, nga nivel kompanie deri në nivel brigade dhe përdoret, në mënyrë intensive, nga SHBA për të përgatitur njësitë e veta për luftim.

VSB2 është platformë trajnuuese ndërvepruese e bazuar në ushtrime tredimensionale, me cilësi të lartë, e cila u lejon ushtarëve dhe njësitë të vogla të trajnohen në mjedise që pasqyrojnë situata të botës reale. VSB2 trajnon ushtarë individualë dhe njësi të vogla deri në nivel toge. Të dyja programet e simulimit janë të instaluar, operacionale dhe gati për t'u përdorur në Qendrën e Simulimit të FARSH-së.

Objektet, Rrjetet dhe Pajisjet. Qendra ka një komplet të fuqishëm pajisjesh kompjuterike dhe mbështetëse, duke përfshirë tryeza pune, servera blade, radio dore, etj. Kjo Qendër është plotësisht funksionale dhe e përshtatshme për trajnim të bazuar në simulimin e cilësisë së lartë.


Doktrina, Proceset dhe Procedurat. Procedurat operuese të Qendrës së Simulimit të FARSH-së rrjedhin nga një numër burimesh, duke përfshirë Direktivën Stërvitore të NATO-s Bi-SC 75-3. Ky publikim është udhëzuesi gjithëpërfshirës i NATO-s për mënyrën se si planifikohet, ekzekutohet dhe analizohet një stërvitje ushtarake. Qendra përdor gjithashtu një seri publikimesh të projektuara për stërvitjen e Ushtrisë së SHBA-së. Trajnimit i shtohen dhe përvojat, mësimet e nxjerra dhe praktikatat më të mira të këshilltarëve të ekipit CUBIC.

Si kryhet një Stërvitje e Asistuar me Kompjuter?

Grafiku më poshtë jep një përmbledhje të procesit të planifikimit dhe ekzekutimit të një Stërvitjeje të Asistuar me Kompjuter (CAX). Aktivitetet e Qendrës së Simulimit tregohen poshtë shigjetës blu dhe aktivitetet parapërgatitore të trajnimit të njësisë që merr pjesë në stërvitje tregohen poshtë shigjetës.

Udhëzuesi i Stërvitjes Vjetore i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm do të përfshijë kalendarin stërvitor të Qendrës së Simulimit dhe do të identifikojë njësitë që do të trajnohen. Procesi i planifikimit të stërvitjes do të fillojë me publikimin e Specifikimeve të Stërvitjes (EXSPEC) 180 ditë para Stërvitjes së Asistuar me Kompjuter (CAX). Procesi i planifikimit do të lëvizë drejt ciklit të Planifikimit-Përgatitjes-Ekzekutimit-dhe Vlerësimit (PPEA).

Kur Stërvitja e Asistuar me Kompjuter të ketë përfunduar, ajo do të pasohet menjëherë nga një rishikim i detajuar i rezultateve sipas Direktivës Stërvitore të NATO-s Si-SC 75-3. Njësisë që merr pjesë në Stërvitjen e Asistuar me Kompjuter i jepet informacion, *feedback* i detajuar me gojë dhe me shkrim, si dhe një CD dhe materiale të tjera si materiale referënce për rishikim dhe trajnim të mëtejshëm në shtëpi.



Pergjate ketij procesi, stafi i Qendres se Simulimit do te punoje nga afër me komandantin e njesisë, Oficerin qe kryen Shteritjen (OCE), me Ekipin Kryesor te Planifikimit (CPT), si dhe personel te tjerë kyç, per te krijuar dhe ndertuar një skenar simulimi real dhe kerkuar, ne menyre qe te plotsohen objektivat stervitore te njesisë. Ndërsa Qendra e Simulimit pergatit skenarin stervitor, njësia gjithashtu pergatitet per Shteritjen e Asistuar me Kompjuter duke kryer trajnim individual, kolektiv, te liderit kryesor dhe trajnim shtabi ne betejë, sipas nevojës. Ekipi i Vezhguesve-Trajnuesve (O-T) te Qendres se Simulimit eshte i disponueshem per te asistuar ne trajnimin e njesisë qe nevojitet. Koordinimi i afert midis palëve te interesuara vazhdon pergjate ciklit te planifikimit-pergatitjes-ekzekutimit-dhe vleresimit (PPEA).

Per te ekzekutuar Shteritjen e Asistuar me Kompjuter (CAX), pjesetarë te pergjedhur te njesisë (Audienca Primare Shteritore: PTA) dislokohen ne Kompleksin e KDS-së, krijojnë një vend- komandë, njësor si ne një shteritje fushore dhe pergatiten per operacionet, duke perdorur pajisjet dhe procedurat e njesisë. Kompjuterët e Qendres se Simulimit do te sigurojnë dhe ekzekutojnë skenarin stervitor dhe njësia qe shteritet do te provojë dhe do t'u pergjigjet te gjithave ngjarjeve ashtu sikur ato te ishin duke ndodhur me te vertetë.

Per shembull, ne një skenar operacioni luftarak batalioni qe shteritet (PTA) merr urdhra nga komanda dhe shtabi i tij me i larte (HICON) si dhe ndërvepron me te. Drejtuesit e batalionit zbatojne Procesin e Vendimmarrjes Ushtarake (MDMP), drejtuesit e njësive vartese brifojne dhe ekzekutojne planet e tyre kundra një Force Kundershtare jo-bashkepunuare qe mendon dhe qe perdoret ne simulim.

Duke zbatuar të njëjtin proces, stërvitjet mund të projektohen gjithashtu për të mbështetur autoritetet civile, operacione në mbështetje të paqes ose çdo pasiguri tjetër.

Ekipi i Vëzhguesve-Trajnuesve të Qendrës së Simulimit përbëhet nga nëntë oficerë (nënkolonelë deri tek kapitenë) të cilët janë ekspertë në shtatë Sistemet Operuese të Fushëbetesjes. Misioni kryesor i këtij ekipi është të mbështesin trajnimin e Audiencës Primare Stërvitore (PTA) duke vëzhguar, regjistruar dhe vlerësuar veprimet dhe aktivitetet e kësaj audience si dhe për të siguruar *feedback*. Në mjediset e Qendrës së Simulimit, Rishikimet *feedback* zhvillohen përgjatë stërvitjes, si dhe një Rishikim Pas Veprimeve zhvillohet në fund. Kjo gjë i lejon pjesëmarrësve në stërvitje të bëjnë veprime korrigjuese të menjëhershme.

Me Qendrën e Simulimit, FARSH tashmë kanë një mjet trajnimi të ri të fuqishëm që u siguron njësisë dhe liderëve një mjedis trajnimi modern .

Me Qendrën e Simulimit, FARSH tashmë kanë një mjet trajnimi të ri të fuqishëm që u siguron njësisë dhe liderëve një mjedis trajnimi modern në të cilin ata mund të praktikojnë,

mësojnë dhe të rishikojnë aftësitë themelore. Qendra zgjeron aftësitë e liderëve, komandantëve dhe shtabeve, përmirëson efektivitetin stërvitor dhe gatishmërinë e njësisë të FARSH-së si dhe mbështet trajnimin e FARSH-së në të gjithë spektrin e kërkesave operacionale. Rezultati përfundimtar është një gatishmëri e rritur e njësisë.

Përkthyer nga anglishtja nga: N/Kol. Robert Kodra

Menaxhimi i Dijeve, domosdoshmëri në kohën e informacionit

Doktor i Shkencave Ekonomike, Gaqo Tanku,
Pedagog në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës

N/Kolonel MSc. Editson Zarka,
Drejtorja e Politikave të Mbrojtjes, MM

Trajtesë e shkurtuar. *Dija, duke u menaxhuar mirë, kthehet në një vlerë të shtuar për një rendiment më të lartë në të gjitha sferat e jetës. Ajo në vetvete vjen si rezultat i kalimit në disa shkallë. Ato fillojnë me të dhëna të përgjithshme, empirike, ku futen faktet, vëzhgimet, pra çdo gjë që merret si “lëndë e parë” e papërpunuar nga truri i njeriut. Përmbajtja e këtyre të dhënave përbëjnë atë që ne e quajmë informacion. Jo çdo informacion është i nevojshëm për zhvillimin e dijes, por vetëm ai që përmban sens dhe ka kuptim. Dija është shkalla e parafundit e “Piramidës së Informacionit”, në kulm të së cilës qëndron urtësia.*

Pranimi në NATO dhe procesi i mëtejshëm i integrimit të vendit tonë janë shoqëruar me një “bum” informacioni, i cili u shpërndahe të 28-vendeve të NATO-s. Ky informacion është një pasuri e madhe për marrjen e dijeve, përvojave, praktikave më të mira. Menaxhimi i këtij informacioni është i rëndësishëm, ndërsa menaxhimi i dijeve që vijnë nga përpunimi i këtij informacioni është akoma më i rëndësishëm. Për këtë gjykojmë se kërkohet të shfrytëzohen në maksimum strukturat ekzistuese, por edhe inicimi i elementeve, bërthamave apo qelizave të tjera, të domosdoshme për trajtimin e kësaj fushe relativisht të re.

Dija merret në kushte të caktuara, ndaj edhe trajtimi i saj është detyrë për strukturat përkatëse të burimeve njerëzore.

Menaxhimi i Dijeve, homosdoshmëri

Menaxhimi i Dijeve përbëhet nga dy fjalë të së njëjtës medalje. Në njërin anë qëndron dija, ndërsa në anën tjetër qëndron menaxhimi i saj. Dija është zhvilluar gjatë të gjitha fazave të historisë njerëzore, por ajo ka marrë përmasa të reja gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit. Sot ekziston një degë e re e filozofisë që quhet epistemologji dhe që merret me kuptimin e dijes. Dija është një proces individual dhe kolektiv. *Nonaka dhe Takeuchi*, (1995) i ndajnë dijet në dy drejtime, *explicit*

(të drejtpërdrejta) dhe *tacit* (të nënkuptuara)¹. Dija e drejtpërdrejtë është ajo pjesë e dijes e cila shprehet shumë lehtë, apo që shkruhet me një gjuhë të thjeshtë, për shembull, manualët, raportet për projekte të ndryshme, harta e një qendre qyteti, etj. Nga ana tjetër, dija e nënkuptuar është ajo dije, e cila është bërë pjesë e njeriut, që mishërohen tek ai, të arritura përmes përvojës njerëzore. Kjo nuk mund të artikulohet, pasi është njohuri e gjallë që nuk mund të mbijetojë jashtë sistemit njerëzor, nëpërmjet të cilit qëndron dinamika e saj. Për shembull, një ushtarak i vjetër dhe me përvojë, është në gjendje të kuptojë menjëherë gjendjen e trupave, apo një mjek me përvojë, në mënyrë intuitive, është në gjendje të kuptojë nëse një pacient mund të shërohet apo të vdesë nga sëmundje të tilla si malaria, tensioni i lartë apo sëmundje të zembrës.

Dy autorë të tjerë, *Davenport* dhe *Prusak* (1998) argumentojnë që në organizatë, dijet bëhen pjesë e saj jo vetëm nëpërmjet dokumenteve dhe mbajtjes së tyre nëpër arkiva, por edhe në veprimtarinë e përditshme, në proceset, praktikën dhe normat që zbatohen². Si shembull përmendim, programet dhe kurset e ndryshme që zhvillohen në Komandën e Doktrinëve dhe Stërvitjes, të cilat janë pasqyrë e dijeve dhe njohurive që ofrohen. Po kështu edhe puna e Qendrës së Gjuhëve të Huaja, që tregon për ndihmesën e jashtëzakonshme që jepet për rritjen e aftësive gjuhësore në FA.

Menaxhimi është një qasje e disiplinuar dhe sistematike e planëzimit, koordinimit dhe zbatimit të detyrave në një sferë të caktuar.

Menaxhimi është një qasje e disiplinuar dhe sistematike e planëzimit, koordinimit dhe zbatimit të detyrave në një sferë të caktuar.

Kështu për shembull kemi menaxhim të strategjive të caktuara, menaxhim të ndryshimit, menaxhim të burimeve njerëzore, menaxhim projekti, menaxhim informacioni, menaxhim dokumentacioni, etj. Ndërsa termi “menaxhimi i dijes” është një term i ri i zhvilluar fuqishëm pas viteve ’90. Në vitin 1999, kemi futjen e termit “menaxhimi i dijeve personale”, pra të menaxhimit të dijeve në nivel individual (*Wright* 2005). Përdorimi i këtij termi në ndërmarrjet dhe organizatat e ndryshme është vënë fillimisht përmes përmbledhjeve studimore lidhur me dimensionet e menaxhimit të strategjive, proceseve dhe mënyrës së matjes së rezultateve të dijeve (*Morey, Maybury & Thuraisingham* 2002)³.

Autorë të shumtë e kanë përcaktuar MD në këndvështrime të ndryshme. Kjo ka ardhur si rrjedhojë e perceptimeve, kuptimeve, përvojave dhe objektivave të organizatave të ndryshme. Të gjitha këto përkufizime kanë dy të përbashkëta: ato i japin një kuptim botës ku ne jetojmë si dhe rekomandojnë zgjidhje efikase në të. MD përbëhet nga një serë strategjish dhe praktikash që përdoren në një organizatë

¹Nonaka and Takeuchi (1995), “The Knowledge Creating Company: How Japanese Companies Create the Dynamics of Innovation”, p. 355-360 New York: Oxford University Press.

² Davenport and Laurence Prusak (1998), *Working Knowledge: How Organisation Manage, What they know*, p.280-285, Boston : Harvard Business School Press.

³ Morey, Maybury & Thuraisingham *Knowledge Management in Communities of Practice: Being True to the Communicative Character of Knowledge Management Communication Quarterly*, November 2002, p.259-266.

për të përcaktuar, krijuar, paraqitur, shpërndarë dhe mundësuar mprehtësinë dhe përvojat e ndryshme. Mprehtësia dhe përvoja përbëjnë njohuri të mishëruara si tek individët ashtu edhe tek organizatat, si procese apo praktika të ndryshme. *Harrison* (2000) argumenton që MD është një koncept kompleks që kërkon, përfshin, ndan dhe përdor dijet, kudo ku ato ndodhen e përdoren. Qëllimi kryesor është rritja e të mësuarit dhe performancës së organizatës⁴. *Willard* (1999) argumenton se përcaktimi i MD, si mjet lehtësues dhe zhvillues për të punuar në ekip, njeh dhe pranon natyrën bashkëpunuese të njeriut, proceset dhe informacionin, në organizatat që tashmë kanë karakter global apo rajonal⁵.

Një përcaktim tjetër është ai i Departamentit të Forcave Detare të SHBA-ve, ku thuhet se MD ka të bëjë me integrimin e njerëzve dhe proceseve, të ndihmuara nga teknologjia, për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit dhe ekspertizës së duhur operacionale, për të rritur performancën e organizatës. Ndërsa NATO, vitet e fundit, e ka përcaktuar MD si një qasje shumëdisiplinëse, e kërkuar për realizimin e objektivave të organizatës, duke përdorur sa më mirë informacionin, ekspertizën, mprehtësinë dhe praktikatat më të mira. Pra, siç shihet nga të gjitha këto përcaktime, fokusi i MD është identifikimi dhe përfshirja e asetëve e njohurive të organizatës. Në këtë mënyrë, dija do të trajtohet si burim, si aset, si një levë dhe vlerë e kapitalit njerëzor (*Scarborough dhe Swan* 1999)⁶. *Walton* (1999) shpjegon se MD është një argument më shumë se të mësuarit për veprimtaritë kyçe të organizatës (FA) që gjendet në përvojën e individëve⁷. Kjo përvojë humbet kur shumica e njerëzve largohen. Për shembull, në rast se studentët ushtarakë të cilët ndjekin studimet e tyre jashtë shtetit nuk kthehen pas studimeve, apo mospërdorimi i tyre në vendin e duhur, bën që të mos merret përvoja përëndimore dhe të zbatohet ajo në praktikë.

Për më tepër, menaxhimi i dijes fokusohet në shpërndarjen e saj në grup, me qëllim që ajo të transferohet nga individi tek grupi, duke u kthyer në dije për shoqërinë. Në këtë mënyrë, ajo ndihmon vazhdimin e novacionit dhe zgjidhjen e problemit në organizatë (*Harrison* 2000)⁸. Për shembull, hedhja e një produkti të ri në treg, si rezultat i menaxhimit të dijes, bën të mundur vazhdimin e suksesit. Në kontekstin ushtarak, marrja e përvojës së trupave që kthehen nga operacionet paqeruajtëse, e bën më të lehtë kryerjen e misionit për ata që shkojnë për herë të parë.

Në mbështetje të këtyre përcaktimeve, mund të themi pa frikë se MD është kërkesë dhe gjen përdorim brenda organizatës dhe jashtë saj. Ai është një burim i pashtershëm që ndikon në rritjen e performancës së organizatës. Këto përcaktime

⁴ Harrison, R. (2000), *Employee Development*, p.199-200 2nd ed. Wiltshire: The Cromwell Press.

⁵ Willard, N. (1999), "Knowledge Management: Foundation for a Secure Structure, *Journal of Managing Information*", Vol.16 No.5 p.135-140.

⁶ Scarborough and Jasky Swan (1999), "Issues in People Management: Case Studies in Knowledge, Wiltshire" p.315-318), The Cromwell Press.

⁷ Walton, J. (1999), "Strategic Human Resource Development", p.70-73 Trowbridge: Redwood Books Limited.

⁸ Harrison 2000, *ibid.* p. 210-212.

gjykojmë se janë po aq të vlefshme edhe për FA, ku njohuritë kthehen në art dhe shkencë për zhvillimin dhe fitimin e luftërave të mundshme si dhe në suksesin e pjesëmarrjes në operacionet ushtarake, si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

MD-një mjet efikas për rritjen e efektivitetit në organizatë

Ka dy aspekte të MD, personalizimi dhe kodifikimi (*Hansen dhe Tierney 1999*)⁹. Personalizimi ka të bëjë me kontaktet person-person për shpërndarjen e dijes përmes dialogut dhe zhvillimit të ideve. Teknologjia informative (e-maili, intraneti) dhe telefoni janë përdorur dhe përdoren gjerësisht për zgjidhjen e problemeve të ndryshme.

Kodifikimi është procesi i MD, i cili mbështetet në lidhjen midis njeriut dhe dokumentit (*Hansen, Noriah dhe Tierney 1999*)¹⁰. Kjo dije thelbësore ka ardhur si rezultat i punës së bërë dhe që është ruajtur në kompjuter ose në mjete të tjera, të tilla si CD-ROM dhe Internet ku ndodhen shumë dije për çështje të ndryshme, të cilat njerëzit mund t'i përdorin. Në një nga qendrat mjekësore të SHBA theksohej: “*Ne nuk po përdorim një mënyrë të re për të kuruar sëmundjen. Ne jemi duke marrë dijet më të vlefshme dhe shpikim një proces për t'i përdorur ato sa më mirë.*” (*Hansen 1999*)¹¹. Anë e dobët e kësaj metode është se nuk jep mundësi për përfshirjen e dijeve të reja.

MD përfshin katër fusha kryesore, të cilat janë: krijimi, trupëzimi (bërja e tyre si pjesë e pandarë e njeriut), përhapja dhe përdorimi (*McAdam dhe Reid 2000*)¹². Nga këto, krijimi i dijes përfshin dy fusha: shkencore dhe shoqërore. Dija shkencore është dije tashmë e vërtetuar dhe që ka marrë natyrën e ligjit. Të tilla përmendim ligjin e gravitetit, apo ligje të tjera të ngjashme me të. Ndërsa dija shoqërore formësohet nga praktika e gjatë e një komuniteti (*Baumard 1992*) si shkencëtarët, inxhinierët, konsulentët e ndryshëm dhe studiuesit¹³. Në këtë kategori mund të fusim për shembull dijet e krijuara në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore nga *Teilor, Elton Mayo* në fushën e kapitalit njerëzor, etj.

Dija e trupëzuar (*embodiment*) është dija e krijuar si rezultat i ndërveprimit dhe këmbimit shoqëror brenda organizatës¹⁴ (*McAdam dhe Reid, 2000*). Kjo ka ardhur si rezultat i aktiviteteve menaxheriale të dijes, shpërndarjes tek njerëzit, takimeve jo zyrtare, dialogëve, diskutimeve, shkëmbimeve të mendimeve dhe pikëpamjeve, vëzhgimeve të ndryshme, konferencave si dhe përdorimit të teknologjisë së informacionit, ku futen e-mailët, intraneti, etj. Për shembull, akademistët dhe studentët në Komandën e Doktrinës dhe Stërviçjes (KDS) mund të shkëmbejnë ide të ndryshme për çështje që ata trajtojnë me qëllim rritjen e performancës së tyre. Qëllimi i tyre është të kalojnë testet e provimit me rezultate sa më të larta.

⁹ Hansen, Nohria, and Tierney (1999), “What is your strategy for Managing, Knowledge”, p.170-175 Harvard Business Review, March-April.

¹⁰ (Hansen, Noriah dhe Tierney 1999,) p.190-192.

¹¹ Hansen 1999, p. 195-196.

¹² McAdam and Reid (2000). “A Comparison of Public and Private Sector Perception and use of Knowledge Management. Journal of European Industrial Training”, Vol.24, p. 185-187

¹³ Baumard, P., Tacit Knowledge in Organisation. London: Sage Publication 1992,p.145-147.

¹⁴ McAdam dhe Reid, 2000, ibid. f.205-210.

Përhapja e dijes është transferimi i saj nga një person tek tjetri, nga njëri grup tek tjetri dhe në varësi të natyrës dhe qëllimit që ka organizata. Ndër këto përvoja do të theksonim atë të *“Lessons Learned”* (Përvoja e Fituar), ku trupat që kanë qenë në misione paqeruajtëse, transmetojnë përvojën e fituar tek trupat që do të shkojnë në mision në forma dhe metoda të ndryshme. *Baumard* (1999) argumenton se fakultetet në vetvete janë organizata ku krijohen dije¹⁵.

Ndryshimi i mjedisit strategjik dikton nevojën për njohje sa më të thella të tij, për të pasur mundësi në përcaktimin e rreziqeve, kërcënimeve si dhe mjeteve më të efektshme për përballimin e tyre. Në nivelin strategjik, NATO njeh gjashtë fusha kryesore që merren në konsideratë në një mjedis kompleks operacional. Këto fusha janë: politike, ushtarake, ekonomike, shoqërore, infrastrukurore dhe ajo e informacionit. Përmes një analize të thellë të objektivave, fuqisë, dobësisë si dhe ndërvarësisë të aktorëve kryesorë që veprojnë brenda këtyre gjashtë fushave, zhvillohet edhe dija. Kjo dije e përfituar përdoret më tej nga vendimmarrësit në të gjitha nivelet për të përcaktuar mënyrat për arritjen e objektivave strategjike të Aleancës.

Zhvillimi i dijeve u siguron komandantëve dhe stafeve të tyre njohuri të plota të mjedisit kompleks, ku përfshihen edhe marrëdhëniet dhe ndërvarësitë midis sistemeve e aktorëve brenda hapësirës së angazhimit të forcave. Për këtë arsye, zhvillimi i dijeve është një element thelbësor i cili kontribuon në gjithë procesin e planifikimit të mbrojtjes dhe në atë operacional.

Ashtu si menaxhimi i informacionit ka ciklin e vet jetësor, përpjekje janë bërë edhe po bëhen për përcaktimin e këtij cikli edhe për menaxhimin e dijeve. Cikli jetësor i informacionit kalon nëpër katër faza kryesore, të tilla si: (1) grumbullimi, krijimi apo gjenerimi i tyre; (2) organizimi; (3) korigjimi, përdorimi, mundësia e hyrjes dhe transmetimi; (4) shpërndarja e tij. Ndërsa cikli jetësor i dijeve kalon nëpër këto faza: krijimi i dijes; kapja dhe përfitimi i dijeve; organizimi i dijeve; pranimi, kërkimi dhe shpërndarja e dijeve; përdorimi dhe zbulimi i dijeve; si dhe ndarja e dijeve me të tjerët.

Aspekte të Menaxhimit të Dijeve

Prurjet e MD kanë shkaktuar një reaksion kompleks. Sipas *Scarborough* dhe *Swan* (1991): *“Nuk ka asnjë dyshim që ne i kemi futur njohuritë ekonomike. Ajo që organizatat dinë është se dija është bërë më e rëndësishme sesa burimet tradicionale të fuqisë ekonomike të kapitalit si toka, fabrika dhe puna”*¹⁶. Megjithatë, *Ruggles* (1998) argumenton se përkundër rritjes, MD është më shumë se një treg shitjeje, që shton vlera nëpërmjet aktivizimit të levave si: dija, përvoja dhe gjykimet jashtë dhe brenda organizatës¹⁷. *Davenport* dhe *Prusak* (1998) argumentuan se krijimi i postit të shefit të zyrës së MD ishte përgjigja më e mirë¹⁸.

¹⁵ McAdam dhe Reid, 2000. Po aty.

¹⁶ Scarborough dhe Swan, 1991, p.315-318.

¹⁷ Ruggles, The state of Notion, California Management Review, 1998, p.80-89.

¹⁸ Davenport dhe Prusak, Working Knowledge, 1998, p.290-295.

Një nga aplikimet më të rëndësishme në NATO për menaxhimin e dijes është krijimi i strukturave “*Fusion Center*”, të cilat ndërtohen në bërthamat e seksioneve/departamenteve të zbulimit. Roli i tyre nuk është më ai klasik për zbulimin e synimeve dhe idesë së veprimeve të kundërshtarit. Jo, ky rol është më i gjerë, duke marrë informacion e dije për një serë subjektsh e fushash të ndryshme, përpunimi i të cilave ndikon në performancën e njësive dhe reparteve ushtarake.

McAdam dhe *Reid* (2000) kryen një studim krahasues në lidhje me perceptimin e sektorit publik dhe privat për MD¹⁹. Për këtë qëllim, ata studiuuan 97 burime informacinesh dhe 8 *workshop*-e. Gjetjet nga ky kërkim treguan se MD ishte pranuar në sektorin publik si e kundërta e sektorit privat. Megjithatë, MD ende nuk ka zënë vendin e duhur që të menaxhohet në mënyrë sistematike. Në përfundim, ata theksuan se MD është emergjencë për organizatat. Drejtuesit e ekipeve dhe punëdhënësit duket sikur kanë një rol më të vogël. Gjetjet e *McAdam* dhe *Reid* janë konfirmuar edhe nga zyrat përkatëse shtetërore.

Kjo nënkupton që MD, si një model menaxherial, është plotësisht i integrueshëm me sistemin e menaxhimit në këto kompani. Për analogji, ky parim dhe zbatimi i tij në praktikë, vlen që të merret në konsideratë edhe për FA-në.

Ngritja dhe ulja e modelit menaxherial-të mësuarit në organizatë (*Scarborough* dhe *Swan* 1993), menaxhimi shkencor dhe menaxhimi i marrëdhënieve njerëzore, tregojnë që modelet shpesh ndryshojnë dhe vlera e tyre përcaktohet nga koha²⁰. *Scarborough* dhe *Swan* argumentojnë se dhënia e popullaritetit të këtij “*stili*” në literaturën menaxheriale, është pothuajse e ngjashme në shumë vende. Ndërkohë interesi në MD aktualisht po ecën me shpejtësi të paparë. *Buchanan* dhe *Huczynski* (1997) argumentojnë se MD është një manifestim i modelit të organizatës, i cili lëviz nga mënyrat e vjetra në të reja, me interes të veçantë tek njerëzit, si një forcë potenciale për produktivitetin ekonomik ose shërbimin²¹. Kjo nënkupton që ndryshimet në ambientin ekonomik-shoqëror bëjnë që shkencëtarët të vazhdojnë të përsosin modelin e ri si një mekanizëm të domosdoshëm.

Menaxhimi i dijes si pikë reference për operacione efektive. Tashmë MD dhe shpërndarja e saj është bërë shumë e prekshme dhe e dukshme. Ajo siguron pika të forta duke i ndihmuar njerëzit që të operojnë me efektivitet në organizatë. Sipas *Rosenzweig* (1998), fuqia punëtore përfshin njerëz me pikëpamje dhe përvoja të ndryshme²². Kjo krijon mundësinë që idetë të diskutohen dhe shpërndahen më lehtë. Në këtë mënyrë lehtësohet zgjidhja e problemeve. Gjykojmë se kësaj i përshtatet më mirë fjala e urtë popullore që thotë se “*një mendje është hiç mendje ndërsa dy janë një mendje e vetme*”.

¹⁹ McAdam dhe Reid, 2000, ibid.

²⁰ Scarborough dhe Swan 1993, p.330-335.

²¹ Buchanan and Huczynski (1997). *Organisational Behaviour: An Introductory Text*, 3rd ed. Gosport: Ashford Colour Press Limited.

²² Rosenzweig P., *Managing the new global workforce: - Fostering diversity, forging consistency* European Management Journal, Volume 16, Number 6, December 1998, p. 644-652(9), Elsevier.

Duke iu referuar teorisë së të mësuarit, dallojmë dy drejtime: të mësuarit formal dhe jo formal. Arsimimi formal është ai që mësohet në shkolla, kolegje, universitete dhe institucione të ndryshme të trajnimit. Metoda kryesore e të mësuarit është mësimdhënia dhe leksionet. Nga ana tjetër, mësimi jo formal bëhet i mundur nëpërmjet krijimit të klimës shoqërore brenda grupit. Suksesi i organizimit të mësimit në grup varet në planifikimin sa më mirë të strategjisë, harmonisë dhe lidhjeve reciproke brenda tij, në rritjen në maksimum të dijeve, aftësive dhe përvojës së pjesëtarëve të grupit. Gjatë një stërvitjeje me efektivat e zbulimit, procesi i të mësuarit kaloi nëpërmjet disa fazave si vijon: (a) mbështetje e aftësisë së njëri tjetrit për të realizuar detyrën; (b) kalimi i pengesave ujore që u diktua nga transferimi i dijes nga ata individë të cilët kishin përvojë, pasi kishin marrë pjesë më parë në stërvitje të tilla dhe kalimi i tyre te ata me më pak përvojë. Në vijim, zhvillimi i ideve nëpërmjet diskutimit në grup: (c) stërvitje malore-shpërndaja e informacionit dhe instruktimi me njëri tjetrin; (d) ndërtimi i fuçive për lundrim-zhvillimi i ideve nëpërmjet diskutimit në grup.

Menaxhimi i dijes kërkon një vizion të qartë për drejtimin e organizatës. *Web* (1998) argumenton se praktika e MD në organizatë kërkon deklaram të qartë nga instancat më të larta te ato më të ulëta, mekanizmat e domosdoshme të komunikimit për shpërndarjen e saj, mirëkuptimin dhe përfshirjen për qëllimin e caktuar, planifikimin e kujdesshëm dhe programet e trajnimit, sistemet dhe procedurat e përshtatshme si dhe monitorimin e vazhdueshëm për të qenë të sigurt se gjithçka është në vendin e duhur²³. Në forcat e armatosura kjo kërkesë realizohet nëpërmjet strategjive shumëvjeçare, direktivave të mbrojtjes, udhëzimeve afatgjata, etj.

Menaxhimi i dijes dhe roli i burimeve njerëzore

Nisur nga problemi kryesor se zhvillimi i burimeve njerëzore do të varet nga procesi i të mësuarit, nga aftësitë e duhura, dalja e MD në organizatë ka nxjerrë në plan të parë rolin e strukturave përkatëse. Disa nga këto role janë si më poshtë :

- *Protagonisti i menaxhimit të dijes.* Menaxhimi i dijes i ka vendosur këto struktura si kyç në këtë proces. *Walton* (1999) argumenton se është detyrë dhe përgjegjësi e strukturave përkatëse, pasi ato janë përgjegjëse për ta lehtësuar sa më shumë këtë proces, bile duke u përfshirë vetë në trajnimin e njerëzve të organizatës dhe në zhvillimin e procesit²⁴.

- *Lehtësimi i procesit të krijimit të dijeve.* Strukturat përkatëse kanë për detyrë të lehtësojnë sa më shumë që të jetë e mundur krijimin e dijeve brenda organizatës. Kjo kërkon përqendrim në ato dije që i duhen asaj për të përmbushur misionin e së ardhmes. *Nonaka* dhe *Takeuchi* (1995) argumentojnë se menaxherët e nivelit të mesëm luajnë rol kryesor në lehtësimin e procesit të krijimit të dijeve në organizatë. Ata shërbejnë si një nyje lidhëse strategjike, e cila lidh menaxherët e

²³ Webb, S. (1998), "Knowledge Management: Linchpin of Change, p.129-130 London: Aslib Staple Hall".

²⁴ Walton, J. (1999), "Strategic Human Resource Development", Trowbridge: Redwood Books Limited. p.76-84.

nivelit më të lartë me menaxherët e nivelit të parë. Ata janë një urë lidhëse midis vizionarëve idealë në nivelet më të larta dhe realiteteve që shfaqen në aktivitetin e përditshëm me njerëzit.

- **Rol këshillues për menaxherët e burimeve njerëzore.** Specialistët për zhvillimin e burimeve njerëzore kanë për detyrë të këshillojnë rreth personelit me qëllim që të shmangen largimet e panevojshme nga puna. Lester (1998) argumenton që një specialist i zhvillimit të burimeve njerëzore duhet të përfshihet në procesin e përzgjedhjes, motivimit dhe largimit të njerëzve dhe të këshillojë organizatën për nevojat në fushën e dijeve që i duhen në të ardhmen²⁵. Kjo patjetër që duhet të pasqyrohet në planet strategjike për rekrutimin, trajnimin dhe ecjen në gradë e karrierë. Nga ana tjetër, tregon domosdoshmërinë e përfshirjes të specialistëve përkatës në planifikimin e burimeve njerëzore dhe administrimin e tyre.

Kur pakësohet numri për shkak të reformave, duhet që specialistët e burimeve njerëzore të jenë këshilltarë të mirë. Roli kryesor i tyre është përcaktimi i individëve-potencial për të ardhmen.

Kur pakësohet numri për shkak të reformave, duhet që specialistët e burimeve njerëzore të jenë këshilltarë të mirë. Roli kryesor i tyre është përcaktimi i individëve-potencial për të ardhmen. Kjo merr një rëndësi të dorës së parë sidomos në periudhën e kalimit në strukturën e re. Monitorimi i vazhdueshëm i karrierës dhe potencialeve të personelit të forcave të armatosura, vendosja e njeriut në pozicionet e duhura, në bazë të dijeve të fituara gjatë viteve, do të sjellë sukses të vetë organizatës së FA.

- **Ndërtues të infrastrukturës së MD.** Roli i specialistëve të zhvillimit të burimeve njerëzore është të sigurojnë dhe ndërtojnë infrastrukturën e nevojshme për MD në organizatë. Sipas Cannell (1999)²⁶, sikundër përmendet nga Harrison (2000)²⁷, specialistët e BNJ nuk kanë asnjë zgjidhje tjetër përveçse të integrojnë të mësuarit “on line” në kurrikulumin e punonjësve. Është e nevojshme që të kuptohen anët e forta dhe të dobëta të teknologjisë së re, si dhe të identifikohen kur dhe ku ata mund të ofrojnë një zgjidhje me kosto të ulët. Sipas Lank (1997)²⁸ janë katër fusha kryesore: (1) përcaktimi i dijeve të nënkuptuara dhe të drejtpërdrejta, aktuale dhe të nevojshme për organizatën; (2) zhvillimi i mekanizmave të nevojshme për grumbullimin e dijeve, shpërndarjen e tyre dhe të proceseve për njohuritë bazë; (3) përcaktimi i boshllëqeve në fushën e dijes dhe mekanizmat e nevojshme për plotësimin e tyre përmes trajnimit; (4) menaxhimi i procesit të investimeve, teknologjisë informative dhe roli për më shumë dije dhe ekspertizë në organizatë si dhe vendosja e masave të duhura në mënyrë që këto investime të kthehen në produkt.

²⁵ Lester, T. (1998) Knowledge Management .

²⁶ Cannell Incentive PayImpact and Evolution, Institute of Personnel Management, London, 1999, p. 58-60.

²⁷Harrison, R., Employee Development, 2nd ed.Wiltshire: The Cromwell Press, 2000, p.235-240.

²⁸ Lank, E. 1997, Leveraging invisible assets: the human factor, Long-Range Planning, Vol.30, p. 406-412.

- **Nismëtarë të shpërndarjes së dijes.** Së fundi, specialistët e zhvillimit të burimeve njerëzore janë nismëtarë të dijeve (Davenport dhe Prusak, 1998) në organizatë²⁹. Nga ata shpresohet që të nisin shpërndarjen e dijes dhe përfitimet që ka organizata si dhe çdo punonjës. Davenport (1998)³⁰ argumenton që drejtuesit e BNJ, nën ndikimin e specialistëve përkatës kanë tre role për të luajtur. Këto role janë: ngritja e kulturës së dijes në organizatë; menaxhimi i marrëdhënieve me siguresit e informacionit jashtë organizatës, akademikët, kompanitë që kanë bankën e të dhënave etj; sigurimi që ky investim do të kthehet nëpërmjet rritjes së treguesve ekonomikë e të shërbimeve për organizatën. Duke marrë si shembull institucionin e mbrojtjes, theksojmë se Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, nëpërmjet specialistëve të saj, bën të mundur sigurimin e lidhjeve me vendet e NATO-s, BE-së etj, me synim sigurimin e kurseve të niveleve të ndryshme për integrimin e plotë në këto organizata.

Suksesi i specialistëve të menaxhimit e arsimimit që shtrihen në tërë piramidën hierarkike të institucionit dhe që janë ndër kryesorët në menaxhimin e dijeve, do të varet nga shumë faktorë. Menaxhimi i dijeve kërkon përfshirjen e politikave në nivelet më të larta. Ajo kërkon mbështetjen e menaxherëve kryesorë dhe vullnetin e të tjerëve për të dhënë atë që ata dinë. Konkretisht, menaxherët e nivelit më të lartë krijojnë vizionin, menaxherët e nivelit të mesëm zhvillojnë konceptet konkrete që punonjësit t'i kuptojnë dhe zbatojnë ato. Për sa më sipër, është e kuptueshme që nëse mungon vullneti i menaxherëve të nivelit më të lartë dhe vendosmëria e niveleve të tjera për të shpërndarë dijet e tyre që ato të përvetësohen nga strukturat përkatëse, specialistët e zhvillimit të burimeve njerëzore nuk mund të realizojnë detyrat dhe të luajnë rolin e tyre në organizatë.

Përfundime

Menaxhimi i Dijeve është një proces zhvillimi, kërkesash, përfshirjesh dhe përdorimesh të njohurive të punonjësve për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e organizatës. Ai përfshin katër dimensione: krijimin e dijes, bërjen pjesë të individit, shpërndarjen dhe përdorimin e saj. Qëllimi i MD është përhapja e dijes nëpërmjet personalizimit dhe kodifikimit. Personalizimi është procesi i përhapjes së dijes që mbështetet në faktorët njerëzorë të një ekipi. Ndërkaq, kodifikimi qëndron në ekstraktet dhe vendosjen e dijeve *explicite* në CD-ROM, kompjuterë, manuale dhe vende të tjera për t'u ruajtur. Në këtë mënyrë, organizata ka mundësitë praktike për t'i përdorur ato nëpërmjet manualeve të ndryshme.

MD është ende një koncept i ri e në zhvillim. Studimet tregojnë se ende nuk ka gjetur shtrirjen e duhur si në sektorin privat, ashtu edhe në atë shtetëror. Strukturat përkatëse të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore kanë një rol të pazëvendësueshëm në menaxhimin e dijeve, duke luajtur rolin e protagonistit të shpërndarjes së dijeve si dhe krijimin, këshillimin e menaxherëve të niveleve të ndryshme. Ata do të jenë ndërtues të infrastrukturës së nevojshme me qëllim që punonjësit të mësojnë dhe fitojnë aftësitë e duhura. Megjithatë, efikasiteti i këtyre strukturave do të

²⁹Davenport and Laurence Prusak, Working Knowledge: How Organisation Manage, What they know. Boston : Harvard Business School Press, 1998, p.300-301.

³⁰ Davenport (1998) ibid. p.250-260.

varet në mbështetjen e menaxherëve të nivelit të lartë. Kjo sepse menaxhimi i dijes kërkon mbështetje politike e cila kërkon vizion të qartë në organizatë.

MD është i rëndësishëm edhe për strukturat e sigurisë dhe mbrojtjes. Të gjitha sa u përshkruan më sipër kërkohet të shtrihen e të gjejnë zbatim në këto struktura, me synim kryesor rritjen e performancës dhe efektivitetit të tyre. Përpunimi i dijeve, kalimi në të gjitha fazat e menaxhimit të tyre kërkon padyshim njerëz të përgatitur profesionalisht, pozicione të përshtatshme në tabelat e organizimit dhe pajisjeve si dhe gjithëpërfshirje për një rezultat sa më pozitiv. Mjetet e menaxhimit të informacionit, teknologjitë e ndryshme të avancuara, programet kompjuterike të posaçme, shfrytëzimi i përvojave të vendeve aleate e partnere, në këtë drejtim, do të “shkurtonin” rrugën për përfutimin dhe përhapjen e dijeve. Të dish t’i shfrytëzosh përvojat më të përparuara, do të thotë të bësh të mundur rritjen e efektivitetit të organizatës si dhe arrijen e rezultateve të suksesshme në një kohë sa më të shkurtër.

Bibliografia:

- Baumard, P. (1999). Tacit Knowledge in Organisation. London: Sage Publication.
- Buchanan and Huczynski (1977). Organisational Behaviour: An Introductory Text, 3rd ed. Gosport: Ashford Colour Press Limited.
- Davenport, and Laurence Prusak (1998). Working Knowledge: How Organisation Manage, What they know. Boston : Harvard Business School Press.
- Harrison, R. (2000). Employee Development, 2nd ed. Wiltshire: The Cromwell Press.
- Hansen, Nohria, and Tierney (1999), “What is your strategy for Managing, Knowledge”, Harvard Business Review, March-April.
- Lester, T. (1998) Knowledge Management.
- Megginson and Jenifer (1999). Human Resource Development 2nd ed. London: Kogan Page Limited.
- McAdam and Reid (2000). “A Comparison of Public and Private Sector Perception and use of Knowledge Management. Journal of European Industrial Training”, Vol.24.
- Nonaka and Takeuchi (1995). “The Knowledge Creating Company: How Japanese Companies Create the Dynamics of Innovation”, New York: Oxford University Press.
- Scarbrough and Jasky Swan (1999), “Issues in People Management: Case Studies in Knowledge, Wiltshire”, The Cromwell Press.
- Webb, S. (1998), “Knowledge Management: Linchpin of Change, London: Aslib Staple Hall”.
- Walton, J. (1999), “Strategic Human Resource Development”, Trowbridge: Redwood Books Limited.
- Willard, N. (1999), “Knowledge Management: Foundation for a Secure Structure, Journal of Managing Information”, Vol.16 No.5.
- Blodgett Chris, LTC, CAN AF, Presented to: “Knowledge Development&Management Course” in Partnership for Peace Training Centre, Ankara/Turkey 12-23 April 2010.
- Thomesen, Terje, CDR, Staff Officer in Norway Navy. Presentation on “NATO Planning Processes and Knowledge Development”, in Partnership for Peace Training Centre, Ankara/Turkey 12-23 April 2010.
- www.wikipedia.com, the free encyclopedia, Knowledge Management.
- Lank, E. 1997, Leveraging invisible assets: the human factor, Long-Range Planning, Vol.30.

RUBRIKA E TRETË

“Pranvera Arabe”

Ngjarjet tronditëse, që shpërthyen në mbi njëzet shtete të Lindjes së Mesme, Afrikës, Azisë e deri në Australi, me sulmet vandale kundër misioneve diplomatike amerikane dhe europiane, janë nga ato zhvillime, të cilat kërkojnë një hulumtim përtej sipërfaqes së ngjarjeve. Janë nga ato zhvillime, të cilat kërkojnë racionalizmin e të kërkuarit, jashtë emocioneve, në thellësinë e komplikacioneve të interesave dhe të strategjive të shteteve dhe të forcave, që përfitojnë nga këto lëvizje dramatike dhe të shteteve e të forcave, që humbasin prej tyre.

Që do të thotë të kërkojë përtej shenjave fetare të skenës së ngjarjeve.

Duhet nënvizuar se nga këto ngjarje nuk fitojnë dy aktorët kryesorë të skenës së përplasjes, që shihet, as SHBA dhe as popujt arabë e forcat demokratike arabe. SHBA-të janë mbështetësi kryesor i revolucioneve demokratike popullore arabe të vitit të kaluar të cilat, jo vetëm përmbysën disa regjime autokratike, por i hapën rrugën një transformimi shoqëror, ideologjik dhe politik properëndimor në Lindjen e Mesme.

Në këtë Rubrikë paraqiten dy kërkime mbi këtë “botë”: I pari, në këndvështrimin ligjor, nga Kolonel Dr. Agim Q. Sula-Komandant/Rektor i Akademisë së Forcave të Armatosura, -siç do të quhet tani e tutje... I dyti, në këndvështrimin gjeopolitik nga Kol(R) Zeno Jahaj, në formën e një Esseje të shkurtër domethënëse.

Aspekte ligjore të ndërhyrjes ushtarake në Libi

Kolonel Dr. Agim Q. Sula,
Komandant i Akademisë së Mbrojtjes “Spiro Moisiu”

“Ne ishim të ballafaquar me mundësinë e dhunës të një shkalle të llahtarshme. Ne patëm një mundësi unike për të ndaluar dhunën: një mandat ndërkombëtar për të vepruar, një koalicion të gjerë për të bashkëvepruar, mbështetjen e vendeve arabe dhe lutjen për ndihmë nga vetë populli i Libisë. Po ashtu ne patëm aftësitë të ndalojmë sulmet e forcave të Gaddafiit pa dërguar trupa tokësore amerikane.”¹

Barak Obama

Trajtesë e shkurtuar. Janë bërë dhe vazhdojnë të bëhen shumë analiza e diskutime mbi kryengritjen që solli fundin e regjimit 40-vjeçar të kolonelit Muammar Gaddafi në Libi. Për shkak të shtypjes brutale nga ana e regjimit, episodet e revoltave popullore u përshkallëzuan në një konflikt të armatosur dhe luftë civile që i mori jetën 35 mijë libianëve dhe që përfundoi pas vrasjes së diktatorit, në tetor 2011. Në luftën e tyre për të rrëzuar regjimin, kryengritësit u mbështetën edhe nga ndërhyrja ushtarake ndërkombëtare, e drejtuar nga NATO.

Një nga arsyt kryesore që çuan në kurorëzimin me sukses të kësaj kryengritjeje, ka të bëjë me të ashtuquajturin “proces i shpejtë që të lë pa frymë”², me të cilin aktorët kryesorë politikë e ushtarakë të bashkësisë ndërkombëtare vunë themelet ligjore për miratimin e ndërhyrjes ushtarake ndërkombëtare në Libi. Diskutimet e nxehta ligjore, pro edhe kundra, kanë të bëjnë me legjitimitetin e autorizimit të ndërhyrjes ushtarake për arsye humanitare, për të mbrojtur civilët e zonat civile të populluara, ngjashmëritë me ndërhyrjen ushtarake humanitare në Kosovë si dhe me zhvillimin e vënien në praktikë të teorisë së “përgjegjësisë për të mbrojtur”.³

¹ VOA- Zëri i Amerikës, shqip-lajme, 08:00, 29/03/2011. Fjalimi i Presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në Universitetin e Mbrojtjes Kombëtare, Uashington.

² Amsterdam, Robert, “International Law and the Libya Intervention”. on March 24, 2011 www.robertamsterdam.com/2011/03/inter..

³ Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara përshtati parimin e “përgjegjësisë për të mbrojtur”- ose “RtoP”, (shkurtimi për Kombet e Bashkuara, - shënim i autorit)- më 2005, në një rezolutë unanime.

Në këtë trajtesë, do të ndalemi në analizën e disa aspekteve ligjore të kësaj ndërhyrjeje ushtarake ndërkombëtare, të cilat mendoj se ndikuan jo vetëm në suksesin e saj, por do të ndikojnë edhe në trendin e zhvillimit të ligjit ndërkombëtar për të ardhmen.

Procesi ligjor nga fillimi i revoltave deri në hartimin e Rezolutës 1973 të Këshillit të Sigurimit

Procesi me anën e të cilit bashkësia ndërkombëtare, përfshirë këtu Ligën Arabe, Bashkimin Europian, Kombet e Bashkuara dhe NATO-n, vunë themelet ligjore për miratimin e ndërhyrjes ushtarake në Libi, është nga më të shpejtët në praktikën ligjore ndërkombëtare. Brenda një harku kohor prej një muaji, kur konflikti në Libi u përshkallëzua në një kryengritje të armatosur kundër regjimit të Gadafit, deri në miratimin e rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB, u angazhuan shumë

faktorë, u zhvilluan një sërë takimesh ndërkombëtare, u miratuan një sërë dokumentesh, me një shpejtësi dhe efikasitet të jashtëzakonshëm. Ndryshe nga rastet e tjera, aktorët kryesorë të politikës ndërkombëtare u kujdesën në mënyrë të veçantë, që çdo veprim ndërkombëtar të ecte përpara duke u mbështetur në një shtrat legjitim.

Ndryshe nga rastet e tjera, aktorët kryesorë të politikës ndërkombëtare u kujdesën në mënyrë të veçantë, që çdo veprim ndërkombëtar të ecte përpara duke u mbështetur në një shtrat legjitim.

Në rrafshin e brendshëm, nisma për ndërhyrje u bë nga vetë libianët. Më 21 shkurt 2011, zëvendës përfaqësuesi i përhershëm i Libisë në OKB, ambasadori *Ibrahim Dabbashi*, u kërkoi Kombeve të Bashkuara të impononin një zonë ndalim-fluturimi mbi Tripolin, për të prerë të gjitha furnizimet me armë dhe mercenarë për regjimin.⁴ Më pas, ishte përfaqësuesi kryesor i kryengritësve, Kryetari i Këshillit Kombëtar Kalimtar të Libisë, *Mustafa Abdul Jalil* i cili, më 9 mars 2011, i kërkoi komunitetit ndërkombëtar të lëvizte më shpejt, për të imponuar një zonë ndalim-fluturimi mbi Libi. Tre ditë më vonë, ai deklaroi se nëse forcat pro-Gadafit do të arrinin në qytetin e Bengazit, ku ishte qendra kryesore e kryengritësve, atëherë ata “do të vrasin gjysmë milioni” njerëz, duke shtuar se “nëse nuk i imponohet një zonë ndalim-fluturimi regjimit të Gaddafit dhe nëse nuk kontrollon anijet e tij, ne do të kemi një katastrofë humanitare në Libi”.⁵

Në rrafshin rajonal, kemi angazhimin dhe kërkesën nga Lidhja Arabe, anëtare e së cilës ishte Libia. Në vazhden e përpjekjeve për të ndaluar shtypjen e forcave të Gadafit, u bashkua edhe Lidhja Arabe. Më 12 mars 2011, nëntë nga 22 anëtarë të

⁴ “*Libyan Ambassador to U.N. Urges International Community To Stop Genocide*”. Global Arab Network. 21 February 2011. <http://www.english.globalarabnetwork.com/201102219941/Libya-Politics/libyan-ambassador-to-un-urges-international-community-to-stop-genocide.html>. Retrieved 10 March 2011.

⁵ McGreal, Chris (12 March 2011). “*Gaddafi’s Army Will Kill Half a Million, Warn Libyan Rebels*”. The Guardian. Archived from the original on 12 March 2011.

Lidhjes Arabe i bënë thirrje Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara “për të imponuar një zonë ndalim-fluturimi mbi Libinë, në një përpjekje për të mbrojtur civilët nga sulmet ajrore”.⁶

Liga Arabe i intensifikoi më tej kërkesat e saj politike dhe ligjore, kur më 15 mars 2011, u propozua nga ambasadori i Libanit në Kombet e Bashkuara, një rezolutë për një zonë të ndalim-fluturimit në Libi. Rezoluta u mbështet menjëherë nga Franca dhe Mbretëria e Bashkuar.⁷

Mbështetja e nismave nga BE dhe SHBA. Më 23 shkurt 2011, presidenti francez Nikola Sarkozy nxiti Bashkimin Europian për të kaluar sanksionet kundër regjimit të Gaddafi (ngrirja e fondeve të familjes Gaddafi jashtë vendit) dhe kërkesën/kërkoi/duke kërkuar që ai të ndalte menjëherë sulmet kundër civilëve. Pas dy ditësh, ai e zgjeroi më tej presionin e tij duke deklaruar se Gaddafi “duhet të ikë”.⁸ Ndërsa më 28 shkurt 2011, kryeministri britanik, *David Cameron* propozoi idenë e një zone ndalim-fluturimit, për të parandaluar Gaddafi të përdorë linjën ajrore mercenare, “duke përdorur aeroplanë dhe helikopterë ushtarakë të blinduar kundër civilëve”.⁹ Këto qëndrime u mbështetën nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Më 1 mars 2011, Senati amerikan kaloi njëzëri një rezolutë jo-detyruese, duke i bërë thirrje Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për të imponuar një zonë ndalim -fluturimi në Libi si dhe për të nxitur Gaddafi të jpte dorëheqjen.¹⁰

Proces paralel në Kombet e Bashkuara. Aktorët kryesorë ishin Liga Arabe, e mbështetur fuqimisht nga anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Franca, Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, me anë të një rezolute unanime (nr. 1970, datë 26 shkurt 2011), mbështetur në Kreun VII/neni 41, pasi konstatonte, ndër të tjera, “shkeljet bruto dhe sistematike të të drejtave të njeriut” dhe theksonte se “sulmet e përhapura dhe sistematike kundër popullatës civile mund të përbëjnë krime kundër njerëzimit në Libi”, i ish-in referuar Gjykatës Ndërkombëtare Penale që më 15 shkurt, vendosi embargon e armëve, imponoi një ndalim-udhëtimi mbi emrat e 16 personave të lartë të regjimit, vendosi një ngrirje aktive në të gjitha fondet, asetet e tjera financiare dhe burimet ekonomike që ishin në pronësi apo nën kontrollin e drejtpërdrejtë ose jo të familjes Gaddafi si dhe krijoi një komitet për të monitoruar zbatimin e këtyre sanksioneve.¹¹

⁶ “BREAKING: Arab League calls on U.N. to impose No Fly Zone on Libya”. LibyaFeb17.com. 12 March 2011. Archived from the original on 12 March 2011. <http://www.webcitation.org/5x8RVOCHJ>

⁷ Denselow, James (16 March 2011). “Libya and Lebanon: a troubled relationship”. The Guardian (UK). <http://www.guardian.co.uk/commentisfree/2011/mar/16/libya-lebanon-un-security-council-resolution>.

⁸ “As It Happened: Libya Uprising February 25”. The Times. 25 April 2011. <http://www.thetimes.co.uk/tto/news/world/middleeast/article2926163.ece/>.

⁹ Macdonald, Alistair (28 February 2011). “Cameron Doesn't Rule Out Military Force for Libya”. The Wall Street Journal. http://online.wsj.com/article/SB10001424052748704615504576172383796304482.html?mod=googlenews_wsj. Retrieved 28 February 2011.

¹⁰ <http://thomas.loc.gov/cgi-bin/bdquery/z?d112:S.RES.85>:

¹¹ <http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N11/245/58/PDF/N1124558.pdf?OpenElement>

Meqenëse edhe pas kësaj rezolute, dhuna në Libi u shkallëzua më tej, më 1 mars 2011, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, e pezulloi Libinë nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut për shkak të dhunës e saj të vazhdueshme shtetërore kundër protestuesve antiqeveritarë. Koordinimi i të gjithë aktorëve të mësipërm dhe sinkronizimi i veprimeve të tyre politike dhe ligjore, bëri të mundur përgatitjen e kushteve të nevojshme për miratimin e një rezolute që do të legjitimonte ndërhyrjen ushtarake ndërkombëtare në Libi.

Rezoluta nr. 1973, datë 17 mars 2011, e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara

Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, nisur nga fakti se regjimi i Gadafit “nuk kishte bërë asgjë për të zbatuar kërkesat e Rezolutës 1970”, nuk kishte respektuar “deklaratat e armëpushimit” por kishte shkallëzuar më tej dhunën dhe “kërcënimin e vazhdueshëm të forcës kundër popullatës civile”, duke vepruar nën autoritetin e Kreut VII të Kartës së OKB-së dhe duke përsëritur referencat për abuzimet bruto të të drejtave të njeriut, miratoi më 17 mars Rezolutën nr. 1973 për situatën në Libi. Rezoluta e Këshillit të Sigurimit u propozua nga Franca, Libani dhe Mbretëria e Bashkuar.¹²

Dhjetë shtete anëtare të Këshillit të Sigurimit që votuan pro rezolutës ishin Bosnjë Hercegovina, Kolumbia, Gaboni, Libani, Nigeria, Portugalia, Afrika e Jugut dhe tre prej anëtarëve të përhershëm, Franca, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pesë shtete të tjera anëtare Brazili, Gjermania, India dhe dy prej anëtarëve të përhershëm Kina dhe Rusia abstenuan, pa paraqitur asnjë kundërshtim. Rezoluta formoi bazën ligjore për ndërhyrje ushtarake në luftën civile të Libisë, duke kërkuar “një armëpushim të menjëhershëm”, duke autorizuar bashkësinë ndërkombëtare “për të krijuar një zonë ndalim-fluturimi” dhe “për të përdorur të gjitha mjetet e nevojshme për të mbrojtur civilët”.¹³

Anëtarët e përhershëm, Kina dhe Rusia, kishin rezerva në lidhje me zonën e ndalim-fluturimit, përfshirë dhe praktikat e zbatimit në një zonë, si edhe shqetësime në lidhje me përdorimin e forcës, kur mjetet e tjera nuk ishin shterur e, për këtë arsye, abstenuan.¹⁴ Interesant ishte fakti se Gjermania, një nga vendet kryesore të NATO-s, abstenoj dhe qeveria e saj vendosi të mos marrë pjesë në ndonjë operacion ushtarak kundër Libisë si dhe tërhoqi të gjitha forcat nga operacionet e NATO-s në detin Mesdhe. Lidhur me këtë, Kancelarja gjermane Angela Merkel, u shpreh se Gjermania nuk do të marrë pjesë në operacionin ushtarak, por shtoi: “Ne përkrahim pa rezerva qëllimet e kësaj rezolute dhe abstenimi ynë nuk duhet të ngatërrohet me neutralitetin.”¹⁵ Megjithatë, Gjermania lejoi përdorimin e instalimeve ushtarake në territorin e saj për ndërhyrjen në Libi dhe, më vonë,

¹² UN (17 March 2011). “Security Council authorizes ‘all necessary measures’ to protect civilians in Libya”. UN News Centre. <http://www.un.org/apps/news/story.asp?NewsID=37808&Cr=libya&Cr1=>

¹³ Po aty.

¹⁴ “UN Security Council adopts resolution on Libya”. RIA Novosti. 18 March 2011. <http://en.rian.ru/world/20110318/163067336.html>.

¹⁵ BBC (retrieved 18 March 2011)

zyrtarët gjermanë sugjeruan se Gjermania, potencialisht, mund të kontribuojë me trupa, për të “siguruar me mjete ushtarake ndihmat humanitare për ata që kanë nevojë”.¹⁶

Rezoluta 1973, e miratuar sipas Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara kërkonte vendosjen e menjëhershme të një armëpushimi dhe ndalimin e plotë të dhunës dhe të të gjitha abuzimeve dhe të sulmeve mbi civilët; ajo vendosi një zonë ndalim-fluturimi mbi Libinë; autorizoi përdorimin e të gjitha mjeteve të nevojshme për të mbrojtur civilët dhe zonat e populluara civile, me përjashtim të një “force të huaj pushtimi”; kërkonte forcimin e embargos së armëve dhe sidomos të veprimit kundër mercenarëve, duke lejuar masat për inspektime force të anijeve dhe të avionëve; impononte ndalimin e të gjitha fluturimeve të caktuara libiane; vendosi ngrirjen e pasurive nga aktivet/aktivitetet/veprimtaritë në pronësi të autoriteteve libiane dhe riafirmoi se pasuri të tilla duhet të përdoren për të mirën e popullit të Libisë; zgjeroi më tej masat shtrënguese të Rezolutës 1970 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për ndalimin e udhëtimit dhe ngrirjen e pasurive të një numri individësh (13 persona, kryesisht anëtarë të familjes Gaddafi dhe zyrtarë kryesorë të regjimit) dhe subjektësh të tjera të Libisë (5 subjekte përfshirë këtu Autoritetin Libian të Investimeve dhe Korporatën Kombëtare Libiane të naftës) si dhe krijoi një panel ekspertësh ndërkombëtarë për të promovuar dhe për të monitoruar zbatimin e sanksioneve.¹⁷

Rezoluta solli zhvillime edhe përsa i përket çështjes së armatosjes së forcave anti-Gaddafi. Embargo e armëve, e diktuar nga paragrafi 9 i Rezolutës 1970, pengonte furnizimin me armë për të gjitha forcat ndërluftuese në Libi. Patur parasysh pasojat që sillte kjo për forcat anti-Gaddafi si dhe faktin se nuk parashikohej përdorimi i një force pushtuese në terren, rezoluta 1973 kualifikonte rezolutën 1970 me fjalët “të gjitha masat e nevojshme, pavarësisht nga paragrafi 9 i rezolutës 1970”, nëse duke bërë këtë ajo do të mbrojtë civilët”. Sekretarja amerikane e shtetit *Hillary Clinton* argumentoi se, edhe pse armatosja e forcave anti - Gaddafi nuk ishte duke u propozuar për momentin, do të ishte ligjore për ta bërë këtë më vonë.¹⁸

Ndërsa forcat opozitare në Bengazi të Libisë e pritën miratimin e rezolutës me ovacione, duke shtirë me armë dhe fishekzjarrë në ajër¹⁹, disa orë para se të jepte përgjigjen e tij, Gaddafi paralajmëroi opozitën me një fjalim, duke thënë: “Ne jemi duke ardhur sonte dhe nuk do të kemi mëshirë”.²⁰ Duke parë se ndërhyrja ishte e paevitueshme, më pak se 24 orë më vonë, Libia njoftoi se do të ndalonte të

¹⁶ “*Libya Live Blog – April 8*”. Al Jazeera English. 8 April 2011. <http://blogs.aljazeera.net/live/africa/libya-live-blog-april-8>. Retrieved 9 April 2011.

¹⁷ “*U.N. security council resolution on Libya – full text*”. The Guardian (UK). 17 March 2011. <http://www.guardian.co.uk/world/2011/mar/17/un-security-council-resolution>. - <http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N11/268/39/PDF/N1126839.pdf?OpenElement>

¹⁸ <http://www.bbc.co.uk/news/world-africa-12900706> “*Obama not ruling out arming Libya rebels*”

¹⁹ “*UN backs action against Colonel Gaddafi*”. BBC News. 18 March 2011. <http://www.bbc.co.uk/news/world-africa-12781009>. Retrieved 22 October 2011.

²⁰ Time. 17 March 2011. <http://globalspin.blogs.time.com/2011/03/17/gaddafi-warns-benghazi-rebel-city-we-are-coming-and-therell-be-no-mercy/>.

gjitha operacionet ushtarake, në përgjigje të rezolutës së Këshillit të Sigurimit²¹ por, nga ana tjetër, bombardimet me artileri e mortaja vazhduan ndërsa trupat në terren hynë në rrethinat e qytetit të Bengazit.

Ndërhyrja ushtarake dhe justifikimi ligjor

Më 19 mars, dy ditë pas miratimit të rezolutës, një koalicion ndërshtetëror filloi një ndërhyrje ushtarake në Libi, për të zbatuar rezolutën e mësipërme të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Njësi ajrore dhe detare të Francës, Britanisë së Madhe dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës filluan operacionet ushtarake nëpërmjet goditjeve me raketa “*Tomahawk*” si dhe ndërmorën mësymje ajrore në të gjithë Libinë dhe një bllokadë detare në ujërat e saj. Sulmet ajrore u përqendruan kryesisht kundër tankeve dhe automjeteve të ushtrisë së Libisë por edhe kundër objekteve të tjera ushtarake.²²

Koalicioni fillestar u zgjerua në pak ditë, në afro 19 shtete, të cilat dhanë ndihmën e tyre kryesisht në zbatimin e zonës së ndalim-fluturimit, të bllokadës detare si dhe në dhënien e ndihmës ushtarake logjistike. Operacioneve, të udhëhequra fillimisht nga Franca, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara, iu bashkuan forcat e NATO-s të cilat, më 23 mars, morën kontrollin e embargos së armëve, me anë të operacionit të quajtur “Operacioni i Unifikuar Mbrojtës”.

NATO pranoi, më 24 mars, të marrë kontrollin e zonës së ndaluar për fluturime. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s *Anders Fogh Rasmussen* deklaroi se “Aleatët e NATO-s kanë vendosur të marrin përgjegjësinë për të gjithë operacionin ushtarak në Libi,” duke vazhduar me tej se “Bazuar në rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ...qëllimi ynë është të mbrojmë civilët dhe zonat me popullsi civile nga kërcënimet e sulmeve të regjimit të Gaddafit. Sulmet ajrore të NATO-s bazohen në nenin 4 të rezolutës së OKB-së për Libinë. Në të, trupave të NATO-s iu jepet e drejta që, për mbrojtjen e popullsisë civile, të ndërmarrin të gjitha hapat dhe të përdorin të gjitha mjetet e domosdoshme, me përjashtim të pushtimit të vendit me trupa tokësore.”²³ Në vijim, më 31 Mars 2011, NATO mori komandën e plotë të operacioneve mbi Libi.

Kryeministri shqiptar Sali Berisha mbështeti vendimin e koalicionit për të mbrojtur civilët nga regjimi libian i Gadafit. “Këto operacione, në zbatim të ligjit dhe të drejtës ndërkombëtare, janë plotësisht legale dhe legjitime dhe kanë si qëllim kryesor mbrojtjen, nga sulmet e egra të regjimit të Gaddafit, të jetës së qytetarëve libianë, lirive dhe të drejtave universale që ata meritojnë, mundësisë për të përcaktuar, me vullnetin e lirë, fatin e tyre”²⁴ - deklaroi ai në një deklaratë për

²¹ “Libya declares ceasefire but fighting goes on-Africa”. Al Jazeera English. 18 March 2011. <http://english.aljazeera.net/news/africa/2011/03/2011318124421218583.html>. Retrieved 19 March 2011.

²² “Gunfire, explosions heard in Tripoli”. CNN. 21 March 2011.

<http://www.cnn.com/2011/WORLD/africa/03/19/libya.civil.war/index.html?hpt=T1&ieref=BN1>. Retrieved 20 March 2011.

²³ <http://www.dw-world.de/dw/article/0,,14949867,00.html>

²⁴ Abc news TV, 19 mars 2011 Publikuar dhe transmetuar më 29 Mars, 2011 Ora 20:27 <http://lajme.shqipëria.com>

shtyp. Më 29 mars, Shqipëria ofroi gjithashtu ndihmën e saj për të lehtësuar veprimet e koalicionit ndërkombëtar, duke deklaruar se do të hapte hapësirën e saj ajrore dhe ujërave territoriale, forcave të koalicionit dhe se portet dhe aeroportet e saj ishin në dispozicion të aleancës, sipas kërkesës, duke shtuar se Shqipëria mund të japë një kontribut “humanitar” në përpjekjet ndërkombëtare.²⁵

Fillimi dhe vazhdimi i ndërhyrjes ushtarake ngjalli, siç pritej, debate të ashpra si në planin politik ashtu dhe në aspektet ligjore të operacionit. Njëra palë dënoi ndërhyrjen si jo legjitime duke u kapur fort pas nocionit të shteteve sovrane dhe në parimin e mosndërhyrjes, sipas së drejtës ndërkombëtare. Nga ana tjetër, shumica mbrojti si të drejtë dhe legjitime ndërhyrjen, duke theksuar fort se misioni, në rastin e Libisë, është mbrojtja e civilëve nga të gjitha mjetet e nevojshme dhe qëllimi i ndërhyrjes ishte për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe parandalimin e dhunës në masë.

Rusia “iu bëri thirrje vendeve pjesëmarrëse në operacionet ushtarake të ndalojnë përdorimin e shfrenuar të armëve”, ndërsa Kina shprehu keqardhje ndaj ndërhyrjes ushtarake, duke deklaruar se “për Kinën, është gjithmonë i papranueshëm përdorimi i forcave ushtarake në marrëdhëniet ndërkombëtare...”²⁶ Juristë ndërkombëtarë arritën deri atje sa, një profesor i ligjit në universitetin juridik *Santa Clara* në *Silicon Valley* e quajti ndërhyrjen humanitare në Libi - “një patologji ligjore”.²⁷

Presidenti amerikan Barak Obama zgjodhi Universitetin e Mbrojtjes Kombëtare, në kryeqytetin amerikan Uashington, për një fjalim të rëndësishëm drejtuar vendit mbi vendimin që mori për Libinë. Presidenti tha se Shtetet e Bashkuara dhe aleatët ndërhynë për të ndaluar shtypjen brutale dhe masakrimin e civilëve nga forcat besnike të Moamar Gadafit si dhe rrezikun e një krize humanitare. Ndër të tjera, ai theksoi se “*Ne ishim të ballafaquar me mundësinë e dhunës të një shkalle të llahtarshme. Ne patëm një mundësi unike për të ndaluar dhunën: një mandat ndërkombëtar për të vepruar, një koalicion të gjerë për të bashkëvepruar, mbështetjen e vendeve arabe dhe lutjen për ndihmë nga vetë populli i Libisë. Po ashtu ne patëm aftësitë të ndalojmë sulmet e forcave të Gadafit pa dërguar trupa tokësore amerikane.*”²⁸

Në pak rreshta kemi sintezën e plotë të mbrojtjes së legjitimitetit të operacionit. Por pa u mjaftuar me kaq, Presidenti Obama e përdori fjalimin e tij për të shpjeguar pse ai vendosi që ndërhyrja në Libi ishte e rëndësishme, në sfondin e valës së ndryshimeve në Afrikën Veriore dhe Lindjen e Mesme, duke shtuar më tej se “*Impulset demokratike që po lindin përgjatë rajonit do të eklipsoheshin nga forma më e errët e diktaturës ndërkohë që udhëheqësit shtypës do të nxirrnin përfundimin*

²⁵ “*Albania supports international coalition on Libya*”. Southeast European Times. 30 March 2011. http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/newsbriefs/setimes/newsbriefs/2011/03/30/nb-09. Retrieved 24 April 2011.

²⁶ china radio international crienglish-March 21, 2011

²⁷ stephen-diamond.com / 3Fp/ 3D3408, April 3, 2011

²⁸ Uashington, 29 mars, VOA, 08:00 on 29/03/2011

se dhuna është strategjia më e mirë për të mbajtur pushtetin. Rezoluta e Kombeve të Bashkuara do të ishte dukur më pak se fjalë boshe, duke dëmtuar besimin për të ruajtur paqen globale dhe sigurinë. Ndërkohë që asnjëherë nuk do të zvogëlojë koston nga veprimet ushtarake, kam bindjen se dështimi për të mos vepruar në Libi do t'i kishte kushtuar më shumë Amerikës.”²⁹

Gati një muaj pas fillimit të operacioneve, më 15 prill, udhëheqësit e SHBA-së, Britanisë së Madhe dhe Francës (tre vendeve perëndimore anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara), e panë të arsyeshme për të shpjeguar pozicionin e tyre kolektiv për ndërhyrjen dhe të ardhmen e Libisë, me anë të një letre të botuar në gazetën kryesore botërore. Ata theksuan se “Rezoluta 1973 e kishte penguar një gjakderdhje në Bengazi”. Ata gjithashtu theksuan se “detyra dhe ... mandati nën Rezolutën 1973, është për të mbrojtur civilët ... Kjo nuk është për të hequr Gaddafin me forcë... Por është e pamundur të imagjinohet një e ardhme për Libinë me Gaddafin në pushtet ... Është e pamendueshme që dikush që është përpjekur të masakrojë popullin e tij, mund të luajë një rol në qeverinë e tij në të ardhmen ... Kolonel Gadafi duhet të shkoni dhe shkoni për ‘të mirë.’”³⁰

Debatet politike dhe ligjore u ashpërsuan edhe në opinionin brenda vetë shteteve udhëheqëse të ndërhyrjes. Kështu, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhjetë deputetë amerikanë nga të dyja partitë ngritën akuzë kundër Presidentit Barak Obama, për shkak të pjesëmarrjes amerikane në ndërhyrjen ushtarake në Libi. Sipas tyre, në bazë të një ligji të vitit 1973, Obama ka qenë i detyruar që të marrë miratimin e kongresit për misionin ushtarak. Sipas dy anëtarëve republikanë të kongresit, *Kucinich* dhe *Jones*, nuk ka dhe nuk do të ketë kurrë “justifikime kushtetuese dhe ligjore për ndërhyrjen ushtarake amerikane në Libi”. Por *Shtëpia e Bardhë* argumentoi se ndërhyrja nuk ka pasur nevojë për lejen e kongresit, sepse ajo ka qenë e kufizuar vetëm me një rol mbështetës. Zëdhënësi i *Shtëpisë së Bardhë*, *Jay Carney* ka hedhur poshtë të gjitha akuzat: “Kur urdhëroi për ndërhyrjen në Libi, Presidenti nuk ka shkelur asnjë ligj”. Ndërkaq, Presidenti u detyrua të shpjegojë, në një letër të gjatë, arsyet e kësaj ndërhyrjeje pas akuzave të deputetëve amerikanë. Presidenti ka nënvizuar në letër se “forcat e armatosura amerikane e kanë nisur ndërhyrjen e tyre me kërkesë të Ligës Arabe dhe autorizim të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Qëllimi ynë ishte evitimi i një katastrofe humanitare dhe të mbronim popullin e Libisë nga regjimi i Gadafit”.³¹

Justifikimi ligjor i ndërhyrjes ushtarake u bë më i plotë kur, krahas ndërhyrjes ushtarake nga ajri, nisi një hetim ndërkombëtar për krime lufte dhe krime kundër

²⁹ Po aty.

³⁰ Qureshi, Khawar “Basic law for intervene on Libya”. Friday May 6, 2011. <http://www.lawgazette.co.uk/features/legal-grounds-intervention-libya> <http://www.gazeta-shqip.com/bote/c9d3c2bfc2e4e08712cdd07235cd144d.html>

³¹ Saif al-Islam Gadafi u kap me datë 19 nëntor në jug të Libisë ndërsa po përpiqej të arratisë jashtë vendit, ndërsa Abdullah al Senussi, një ditë më pas. Autoritetet libiane kanë deklaruar se ato do të gjykohen në Libi. Gjithsesi, për këtë priten negociata dhe marrëveshje me Gjykatën ndërkombëtare Penale se kush dhe ku do të gjykohen ata.- shënim i autorit.

njerëzimit në Libi. Më 16 maj, prokurori i Gjykatës Ndërkombëtare Penale *Luis Moreno-Ocampo* i kërkoi kësaj gjykate që të nxirrte urdhra arresti për udhëheqësin libian, Moamar Gadafi, një nga djemtë e tij Saif al-Islam Gadafi dhe shefin e shërbimeve sekrete Abdullah al Sanussi. Pa kaluar një muaj, Gjykata Ndërkombëtare Penale e miratoi këtë kërkesë, duke lëshuar një urdhër-arrest ndërkombëtar për të tre të akuzuarit për krime kundër njerëzimit. Udhëheqësi i revolucionit libian Gaddafi është i dyti kryetar shteti, kundër të cilit Gjykata Penale Ndërkombëtare (ICC) ngre urdhër-arrest. Në fakt, arrestimi i Muamar Gadafit nuk u bë i mundur, pasi ai u vra më 20 korrik 2011 nga kryengritësit, kur u kap i fshehur në një vendstrehim, ndërsa, Saif al-Islam Gadafi dhe Abdullah al Sanussi u kapën dhe u arrestuan më pas, kur regjimi i Gadafit ishte rrëzuar.

Pa përsëritur argumentet e mësipërme, arrijmë në përfundimin se ndërhyrja ushtarake ndërkombëtare në Libi ishte plotësisht legjitime. Ajo u mbështet në ligjin ndërkombëtar në fuqi dhe të gjitha veprimet u mbështetën në procedura të qarta ligjore. Nga pikëpamja ligjore, mund të themi se era e ndryshimit të ligjit ndërkombëtar në favor të mbrojtjes humanitare apo “përgjegjësisë për të mbrojtur”, që nisi me ndërhyrjen në Kosovë në marsin e vitit 1999, u përforcua 12 vjet më pas me rezolutën e marsit 2011, me ndërhyrjen në Libi. Mbrojtja e të drejtave njerëzore po merr gjithnjë e më shumë përparësi mbi sovranitetin kombëtar.

Bibliografia:

- Amsterdam, Robert, “*International Law and the Libya Intervention*”. on March 24, 2011 www.robortamsterdam.com/2011/03/inter...
- “*Libyan Ambassador to U.N. Urges International Community To Stop Genocide*”. Global Arab Network. 21 February 2011. <http://www.english.globalarabnetwork.com/201102219941/Libya-Politics/libyan-ambassador-to-un-urges-international-community-to-stop-genocide.html>. Retrieved 10 March 2011.
- McGreal, Chris (12 March 2011). “*Gaddafi's Army Will Kill Half a Million, Warn Libyan Rebels*”. The Guardian. Archived from the original on 12 March 2011.
- “*BREAKING: Arab League calls on U.N. to impose No Fly Zone on Libya*”. LibyaFeb17.com. 12 March 2011. Archived from the original on 12 March 2011. <http://www.webcitation.org/5x8RVOCHJ>
- Denselow, James (16 March 2011). “*Libya and Lebanon: a troubled relationship*”. The Guardian (UK). <http://www.guardian.co.uk/commentisfree/2011/mar/16/libya-lebanon-un-security-council-resolution>.
- “*As It Happened: Libya Uprising February 25*”. The Times. 25 April 2011. <http://www.thetimes.co.uk/tto/news/world/middleeast/article2926163.ece/>.
- Macdonald, Alistair (28 February 2011). “*Cameron Doesn't Rule Out Military Force for Libya*”. The Wall Street Journal. The Wall Street Journal.
- http://online.wsj.com/article/SB10001424052748704615504576172383796304482.html?mod=googlenews_wsj. Retrieved 28 February 2011.
- <http://thomas.loc.gov/cgi-bin/bdquery/z?d112:S.RES.85>:
- <http://www.gazeta-shqip.com/bote/c9d3c2bfc2e4e08712cdd07235cd144d.html>
- <http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N11/245/58/PDF/N1124558.pdf?OpenElement>

- UN (17 March 2011). “*Security Council authorizes ‘all necessary measures’ to protect civilians in Libya*”. UN News Centre. <http://www.un.org/apps/news/story.asp?NewsID=37808&Cr=libya&Cr1=>.
- “*UN Security Council adopts resolution on Libya*”. RIA Novosti. 18 March 2011. <http://en.rian.ru/world/20110318/163067336.html>.
- “*Libya Live Blog – April 8*”. Al Jazeera English. 8 April 2011. <http://blogs.aljazeera.net/live/africa/libya-live-blog-april-8>. Retrieved 9 April 2011.
- “*U.N. security council resolution on Libya – full text*”. The Guardian (UK). 17 March 2011. <http://www.guardian.co.uk/world/2011/mar/17/un-security-council-resolution>.
- <http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N11/268/39/PDF/N1126839.pdf?OpenElement>
- <http://www.bbc.co.uk/news/world-africa-12900706> “*Obama not ruling out arming Libya rebels*”
- “*UN backs action against Colonel Gaddafi*”. BBC News. 18 March 2011.
- <http://www.bbc.co.uk/news/world-africa-12781009>. Retrieved 22 October 2011.
- Time. 17 March 2011. <http://globalspin.blogs.time.com/2011/03/17/gaddafi-warns-benghazi-rebel-city-we-are-coming-and-there-ll-be-no-mercy/>.
- “*Libya declares ceasefire but fighting goes on – Africa*”. Al Jazeera English. 18 March 2011. <http://english.aljazeera.net/news/africa/2011/03/2011318124421218583.html>. Retrieved 19 March 2011.
- “*Gunfire, explosions heard in Tripoli*”. CNN. 21 March 2011.
- <http://www.cnn.com/2011/WORLD/africa/03/19/libya.civil.war/index.html?hpt=T1&ieref=BN1>. Retrieved 20 March 2011.
- <http://www.dw-world.de/dw/article/0,,14949867,00.html>
- Abc news TV, 19 mars 2011 Publikuar dhe transmetuar me 29 Mars, 2011 Ora 20:27 <http://lajme.shqipëria.com>
- “*Albania supports international coalition on Libya*”. Southeast European Times. 30 March 2011. http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/newsbriefs/setimes/newsbriefs/2011/03/30/nb-09. Retrieved 24 April 2011.
- [stephen-diamond.com / 3Fp/ 3D3408](http://stephen-diamond.com/3Fp/3D3408), April 3, 2011.
- Qureshi, Khawar “*Basic law for intervene on Libya*”. Friday May 6, 2011. <http://www.lawgazette.co.uk/features/legal-grounds-intervention-libya>
- <http://www.gazeta-shqip.com/bote/c9d3c2bfc2e4e08712cdd07235cd144d.html>

Siria, Nyja Gordiane

Kol. ® Zeno Jahaj,
Ministria e Mbrojtjes

Trajtesë e shkurtuar. *Ankthi Sirian po e mban peng botën prej afro dy vjetësh: Si do të zgjidhet nyja e konfliktit të përgjakshëm në këtë vend? Nuk kemi të bëjmë thjeshtë me gjendjen e një krize humanitare, por me një luftë të pastër civile, madje nga më makabret që ka parë njerëzimi. Një tunel që nuk i duket fundi. Siguria e tërë rajonit, madje edhe më gjerë, është gjithashtu në rrezik. Këshilli i Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, si jo rrallë herë të tjera, gjendet i paralizuar, madje pikërisht për shkak të procedurave “demokratike”. NATO nuk di ç’të bëjë. SHBA ndjehet më shumë jashtë sesa brenda. Rusia më shumë se kudo, brenda...*

Përse Siria?

E gjendur në bregdetin lindor të Mesdheut, pikërisht në qendër të të ashtuquajturit Levant-i cilësuar si rrugëkryqi që lidh Azinë Jug-Perëndimore, Mesdheun Lindor dhe Afrikën Veri-Lindore dhe që ka në dorë çelësat e hyrjes në Lindjen e Mesme e më tej në Azinë Qendrore, Siria ka privilegjin e hyrjes relativisht të gjerë nga deti në kontinent. Por ç’ka është më e rëndësishme, Siria zotëron hyrjen më të butë në tokë për shkak të terrenit të hapur dhe në lartësi të vogël mbi nivelin e detit. Infrastruktura e bollshme rrugore e hekurudhore, si dhe largësitë më të shkurtëra për të kapur Bagdatin, përbëjnë një avantazh tjetër të madh të pozicionit të saj gjeostrategjik.

Ky pozicion i leverdisshëm gjeostrategjik, do mund të ishte një fat për Sirinë, tërë rajonin, Europën e më gjerë. Por, megjithë *look*-un european të familjes *Assad* dhe të elitës së tij sunduese, megjithë trashëgiminë perëndimore që ruan populli sirian, Siria renditet ndër vendet me gjendjen më të rëndë të të drejtave njerëzore, ku censura, ndalimet, tortura, diskriminimi ekonomik e politik, papunësia dhe korrupsioni janë “pasaportat” politike të vendit. Lufta civile që po zhvillohet prej afro dy vjetësh, zbuloi pikërisht “kallajin” e *look*-ut european: agjensitë e lajmeve llogarisin rreth 20 000 të vrarë, mijëra të tjerë të masakruar, të pastrehë e qindramijë të detyruar të nisen me dhe pa rrugë në mërgim jashtë vendit.

Një regjim i ardhur në fuqi me grusht gjakatar shteti, që sundon vendin në sistem dinastie prej afro gjysmë shekulli, nuk mund të vepronte ndryshe.

Një regjim i ardhur në fuqi me grusht gjakatar shteti, që sundon vendin në sistem dinastie prej afro gjysmë shekulli, nuk mund të vepronte ndryshe. Për më tepër,

pushteti oligarkik nuk kishte tjetër alternativë. Struktura shtetërore e Sirisë i ngjansikurse e kanë shprehur aq bukur analistë të ndryshëm¹ -një lëmshi të madh akulli, ku bërthama e pakicës sunduese Shiite e Alevit (13%) të Assadit nuk mund të mbahet përveçse me koston e shkrirjes së periferisë, që përbëhet nga shumica dërmuese Sunite (rreth 74%). Dhe shkrirje periferie do të thotë vrasje masive njerëzish të pambrojtur, thjeshtë për faktin se janë revoltuar. Assadi llogarit vetëm një rrugëdalje: luftë deri në vdekje. Përndryshe, ai përsëri është i vdekur për shkak të frikës së hakmarrjes nga shumica Sunnite.

Stacioni i radhës së Pranverës Arabe....

Kryqëzatat për Bagdatin e patën përcaktuar shumë mirë rrugëkalimin për në këtë kryqëndër: kapje e brigjeve veriore të Afrikës, zbarkim në Mesdheun Lindor, pushtim i fushave të naftës të Lindjes së Mesme, me objektiv Bagdatin. Kështu ëndërroi Franca e Bonapartit (Prej këtej vjen edhe trashëgimia, interesimi i veçantë dhe qëndrimi i ashpër i politikës së sotme franceze, edhe pse nuk i shkon edhe aq shumë për shtat!); kështu ëndërroi e veproi me armatën e vet tankiste Romeli i Gjermanisë², e po këtej i erdhi fundi nga anglo-amerikanët, gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Në kohët moderne, amerikanët e harruan përvojën e kryqëzatatave më të hershme për Bagdatin. Ata goditën, me fuqinë e ashpër, drejtpërdrejt në Azinë Qendrore: në fillim për Kuvajtin, më vonë për Afganistanin e pastaj për Irakun, duke mbetur kështu në qendër të ciklonit për gati një dhjetëvjeçar dhe duke e paguar shumë shtrenjtë, me kosto tepër të madhe njerëzore, financiare, e madje edhe prestigji por, mbi të gjitha, me koston e mendimit të dyshuar strategjik. Ish Sekretari Amerikan i Mbrojtjes, *Robert Gates*, duke evokuar frazën e famshme të Gjeneral *MacArthur*, do ta shprehte në mënyrë të skajshme qortimin për një ndërmarrje të tillë: “Sipas mendimit tim, çdo Sekretar Mbrojtjeje që e këshillon përsëri Presidentin të dërgojë një forcë të madhe tokësore amerikane në Azi, në Lindjen e Mesme, apo në Afrikë, ai ‘duhet të egzaminohet nga koka’ sikurse e ka shprehur me delikatesë Gjeneral *MacArthur*”.³

Dhjetë vjet nuk janë shumë për të nxjerrë mësim për luftërat që ngjasin një herë në brez njerëzor. Por nuk janë edhe pak, në këtë epokë informacioni global ku

¹ <http://www.stratfor.com/ëeekly/considering-sunni-regime-syria>

² Erëin Johannes Eugen Rommel (1981-1944), Feld Marshall Gjerman, Komandant i Korpusit të blinduar Gjerman që u përdor për pushtimin e brigjeve Verioer të Afrikës gjatë Luftës së Dytë Botërore, i njohur si “Dhëlptra e Shkretëtirës” për dhuntitë dhe aftësitë e spikatura drejtuese për luftën në shkretëtirë.

³ <http://www.defense.gov/Speeches/Speech.aspx?SpeechID=1539>, United States Military Academy (West Point, NY), As Delivered by Secretary of Defense Robert M. Gates, West Point, NY, Friday, February 25, 2011.

njerëzit, edhe nën diktaturën më të egër, mund të burgosen “*off line*”, por është e pamundur të burgosen “*on line*”. Ky qe kryemësimi nga dhjetëvjeçari i parë i shekullit. Ky qe edhe burimi i *Pranverës Arabe*. Erdhi natyrshëm, u shty, u nxit apo u pleksën të gjitha format-kjo është tjetër çështje. E rëndësishme është që *Pranvera Arabe* duhej të vinte dhe erdhi. Por më e rëndësishme është që mendimi strategjik u rikthye në mësimet e kryqtarëve: pikënisja dhe rrugëkalimi për t’i çuar popujt arabë drejt fitores, për të promovuar aspiratat demokratike të tyre dhe për të filluar një paqe të gjatë e të qëndrueshme në Lindjen e Mesme dhe Azinë Qendrore, do të duhej të ishte saktësisht Afrika Veriore. Pak rëndësi kishte forma: me fuqi të butë si në Tunizi apo Egjipt, apo me fuqi të ashpër si në Libi. Në të pastajmen do të niste kryeura siriane. Një nismë e tillë strategjike, e filluar tashmë dhe e zhvilluar me sukses në tre vende, nuk mund të ndërpritet. Prandaj radhën e kishte dhe e ka Siria.

Një nismë e tillë strategjike, e filluar tashmë dhe e zhvilluar me sukses në tre vende, nuk mund të ndërpritet. Prandaj radhën e kishte dhe e ka Siria.

Implikimet për sigurinë rajonale e më gjerë

Nëse shpresohet për një zgjidhje nga brenda në Sirinë e sotme, edhe negociatori më i aftë nuk di se me kë të bashkëbisedojë. Me regjimin e Assadit, jo se jo, sepse ai e ka “ndarë mendjen”. Çfarëdo qëndrimi të mbajë, davanë e ka të humbur. Në radhë të parë ka humbur legjitimitetin moral dhe juridik: ka ushtruar mbi popullin e vet genocidin më të rëndë në kohët moderne, me instrumentet “legale”, për më tepër me Forcat e Armatosura. Nga ana tjetër, opozita progresiste është e ndarë dhe e copëtuar në orientime, bindje, besime dhe ha në “sahanë” të ndryshëm. I urti *Kofi Annan* nga Gana e Afrikës dështoi, në misionin e tij negociator, edhe për këtë arsye. Tanimë e ka radhën mjeshtri algjerian i negociatave Lakhdar Brahimi.

Detyrën, mundësinë, interesin dhe rrezikun më të madh e ka Turqia. Nga 2 253 km vijë kufitare që ka Siria, 822 km i ndan me Turqinë, 605 km me Irakun, 375 km me Libanin, po kaq me Jordaninë dhe vetëm 76 km ndan me Izraelin. Por ajo që e bën më interesante çështjen është fakti se pjesa dërmuese e kufirit Siri-Turqi është zonë me popullsi kurde. Nëse marrim parasysh që Kurdistani është plaga e hapur dhe bomba e vërtetë atomike, jo vetëm e Turqisë, por e tërë rajonit të Azisë Qendrore, atëherë problemi bëhet edhe më i mprehtë. Një përshkallëzim i konfliktit-apo më keq, dalja jashtë kontrollit e tij, do të çonte në shkallë dramatike pasigurinë e një rajoni të tërë. Nëse llogarisim edhe shkaqe të tjera pasigurie me të cilat është aq “i pasur” ky rajon, atëherë merret me mend se sa e mprehtë bëhet gjendja.

Turqia është i vetmi vend anëtar i NATO-s, organizatë e cila, më shumë sesa për mbrojtjen, është e angazhuar për sigurinë rajonale e globale.

Turqia është i vetmi vend anëtar i NATO-s, organizatë e cila, më shumë sesa për mbrojtjen, është e angazhuar për sigurinë rajonale e globale. E vërteta është që NATO ka përfunduar, apo

thujse ka përfunduar punë në Lindje të saj. Të paktën nuk mund të vijojë më tej,

pasi ngacmon të gjithë ekuilibrat. Ukraina, Gjeorgjia, etj. janë të mjafta për të mos iluzionuar, mbase edhe për një të ardhme afatgjatë. Në Jug të saj, ajo e bëri lehtësisht detyrën: operacioni në Libi ishte një sukses dhe një mësim i madh i saj. Krahu Jugor tanimë është siguruar. Instalimi i Aleancës në largësi të mëdha strategjike dhe të shkëputura në pikëpamje gjeografike, siç është rasti në Afganistan, rezultoi me kosto të madhe dhe me perspektivë të paqartë. Nën këtë gjykim, për të ruajtur vitalitetin dhe për të ushtruar përgjegjësinë e misionin e saj, NATO ka vetëm një rrugë: të zhvillojë operacione “me ruajtje kontakti”, domethënë në vijim të zonës së saj të mbrojtjes. Operacioni në Kosovë, i suksesshëm edhe për këtë arsye, e vërtetoi këtë përzgjedhje. Në rastin e Sirisë, NATO i ka edhe detyrimet, edhe mundësitë: të plotësojë sigurinë e Mesdheut, duke siguruar edhe Mesdheun Lindor.

Prania e hekurit e Rusisë në Siri, nuk është thjeshtë çështja e një baze ushtarake. Natyrisht Baza Ushtarake në Tartus, për nga pozicioni ku është vendosur, asetet që zotëron, misionet dhe detyrat që ka në “Program Pune”, është një facilitet strategjik. Është e vetmja bazë ushtarake e Rusisë në ujëra të ngrohta. Por një bazë ushtarake nuk është vetëm ajo që duket. Rajoni përreth Sirisë përbën majën e shigjetës së drejtimit të ekspansionit historik të Rusisë. Le të sjellim në kujtesë se afro tre dhjetëvjeçarë më parë, një diplomat i shquar italian, *Roberto Ducci*, do të evokonte çfarë kishte dëgjuar, bashkë me kolegët e tij të NATO-s, nga Kryeministri i atëhershëm i Kinës për planet e sovjetikëve: “Sovjetikët nuk do t’ju sulmojnë në fushat e Gjermanisë: ata fillimisht do t’ju hipnotizojnë mendjen dhe shpirtin tuaj me këtë kërcënim. Pastaj ata do të jenë të lirë të zbatojnë një strategji të rrethimeve të gjera dhe të njëpasnjëshme të Europës. Rrethimi i parë që kalon përmes Angolës dhe Mozambikut do t’ju kërcënojë rrugët tuaja të furnizimeve me Hemisferën Lindore. Një unazë e dytë do të krijohet për të parambyllur Perëndimin nga pllajat e larta të Etiopisë, Adenit dhe Afganistanit e, ndoshta, Iranit dhe Gjirit Persik. Ndikimi juaj në Indi do të pakësohet aq shumë sa do të bëhet thujse zero; Pakistani do ta gjejë veten në një situatë të vështirë. Ndërsa, do ta kenë përfunduar të gjithë këtë, udhëheqësit sovjetikë do të fillojnë të ndërtojnë një unazë të tretë rrethimi. Këtë herë, ata do të synojnë të futin nën kontrollin e tyre Gadishullin Ballkanik dhe Mesdheun Lindor...”⁴

Por menjëherë lind pyetja: Çfarë do të bëjë Kina, e cila i shtrin interesat e veta tepër të rëndësishme strategjike pikërisht deri në këto rajone? Çfarë do të bëjë Irani nëse i del jashtë loje Siria-aleati numër një në rajon?

Nga ana tjetër, si i do të jetë angazhimi i SHBA në një luftë apo operacion të dytë kaq të koklavitur dhe pikërisht në valën e zgjedhjeve presidenciale? Po Europa, e cila duhet të mendojë më shumë për për grigjën e hallakatur të oborrit të saj?

Këto janë vetëm pak nga të panjohurat. Gjithsesi Nyja Siriane do të zgjidhet. Problemi nuk është vetë zgjidhja. Problem është vetëm koha, mënyrat dhe rrugët e zgjidhjes. Një kauzë që i ka ardhur koha nuk mund të ndalet. Ajo që duhet

⁴ Roberto Ducci, *The Atlantic Monthly*; February 1985; Volume 255, No. 2; pages 16-26. The spark that may cause a fire. Why the Soviets might want to invade Albania: a scenario.

Ilogaritur është se ku do të trokasë nesër kjo kauzë. Gjeografikisht, Nyja Gordiane që njohim nga historia⁵ u zgjidh (më saktë: u pre) shumë pranë Sirisë, diku në zemër të Turqisë së sotme. Por paralajmëroi një epokë të tërë transformimesh...

Bibliografia:

- <http://www.stratfor.com/ëeekly/considering-sunni-regime-syria>
- <http://www.defense.gov/Speeches/Speech.aspx?SpeechID=1539>, United States Military Academy (West Point, NY), As Delivered by Secretary of Defense Robert M. Gates, West Point, NY, Friday, February 25, 2011
- Roberto Ducci, *The Atlantic Monthly*; February 1985; Volume 255, No. 2. The spark that may cause a fire. Ëhy the Soviets might want to invade Albania: a scenario.

⁵ Nyja Gordiane, sipas legjendës, i atribuohet Aleksandrit të Madh i cili, në vendin e quajtur Gordium, diku në Azinë e Vogël, u përpoq të zgjidhte një nyje litarësh, të cilën vendasi nuk po e zgjidhnin dot. Por duke qenë se lidhja ishte tej e koklavitur, atëherë Aleksandri i Madh, thjeshtë e preu atë me shpatë duke e arritur gjithsesi qëllimin. Legjenda evokon më së shumti që nyja e Azisë së Vogël duhej kaluar me çdo kusht për të krijuar terrenin e nevojshëm për pushtimin e të gjithë Azisë Qëndrore.

Bashkësia ndërkombëtare dhe kriza në Libi

Plator Kalakula,
Ministria e Punëve të Jashtme

Trajtesë e shkurtuar. *Gjatë vitit të kaluar u bëmë dëshmitarë të Pranverës Arabe, siç u quajt lëvizja popullore më e madhe mbarërajonale në botën arabe që prej viteve '50, e cila preku ekzistencën e miliona njerëzve në Afrikën e Veriut dhe Lindjen e Mesme, si dhe ndryshoi në mënyrë dramatike fatin e pak dinastive apo klaneve sunduese.*

Pranvera Arabe solli një riformësim shumëdimensional të botës arabe. Kjo lëvizje masive popullore ndikoi edhe mbi Politikën e Jashtme dhe Sigurinë, duke prekur elementë themelorë si pan-arabizmi apo përqasja ndaj Izraelit, siç u dëshmuua konkretisht nga mbështetja e autoriteteve të reja arabe ndaj përpjekjes palestineze të vitit të kaluar, për t'u njohur si shtet i pavarur në OKB. Kjo mbështetje, në një farë mënyre e ka komplikuar pozitën e tyre me Perëndimin.

Pranvera Arabe paraqet gjithashtu një sfidë madhore për Bashkësinë Ndërkombëtare dhe aktorët e saj politikë dhe financiarë. Ndërkohë që Perëndimi po përpiqet të kuptojë natyrën e ndryshimeve që po ndodhin në zonën strategjike të Lindjes së Mesme dhe të Magrebit, ekziston rreziku konkret që, pa një konceptim të qartë dhe udhëheqje arabe të përshtatshme, kjo lëvizje madhështore popullore të sjellë efekte negative, dhe rrjedhoja dramatike në fushën e sigurisë rajonale e më gjerë.

Në këtë kontekst, një vend të veçantë zë padyshim, shtjellimi dramatik i krizës libiane të vitit të kaluar. Në fakt, ndërhyrja graduale e Bashkësisë Ndërkombëtare që kulmoi në përdorimin e forcës ndaj regjimit të Gadafit, përbën një ilustrim të metodologjisë së përdorimit të instrumenteve politikë e ushtarakë në dispozicion të Bashkësisë Ndërkombëtare, kur kjo e fundit vendos të reagojë ndaj krizave të tilla. Për këtë arsye, reagimi i Bashkësisë Ndërkombëtare ndaj krizës libiane meriton të studiohet me vëmendjen e duhur nga të gjithë ata që trajtojnë apo hulumtojnë lëmin e politikës ndërkombëtare.

Reagimi i OKB-së

Jo rastësisht, OKB-ja ishte e para që reagoi ndaj krizës në Libi, duke shprehur

shqetësimin në rritje të Bashkësisë Ndërkombëtare ndaj dhunës që qeveria e Gadafit po ushtronte kundër protestave popullore. Kështu, pas javësh përplasjesh të ashpra të popullatës libiane me forcat qeveritare të Gadafit, të nxitur nga Franca dhe Britania e Madhe, anëtarë të përhershëm të Këshillit të Sigurimit, me mbështetjen amerikane e të mjaft vendeve arabe, e kryesisht pa një kundërshtim të vendosur të Rusisë dhe Kinës, OKB-ja arriti që në më pak se një muaj, të miratonte dy rezoluta specifike mbi krizën libiane, Rezolutën 1970 dhe Rezolutën 1973.

Më 26 shkurt 2011, Këshilli i Sigurimit të OKB-së, miratoi Rezolutën 1970. Në momentin e hartimit të projektit të parë të kësaj rezolute, dhuna brutale e forcave qeveritare ishte dënuar paraprakisht nga Liga Arabe, Unioni Afrikan, Organizata e Konferencës Islamike si dhe Këshilli i të Drejtave të Njeriut të OKB-së. Ky bashkëpunim krijoi edhe kushtet e duhura për miratimin e shpejtë të saj. Për më tepër, vetë Përfaqësuesi i Përhershëm i Libisë në OKB, nëpërmjet një letre drejtuar Presidentit të Këshillit të Sigurimit në muajin shkurt, kërkonte qëndrime më të qarta nga ana e KS dhe dënimin e asaj që po ndodhte në Libi.

Në thelbin e saj, Rezoluta 1970 shprehej për:

- ndalimin e menjëhershëm të dhunës nga ana e qeverisë si dhe marrjen e masave për plotësimin e kërkesave të popullsisë;
- respektimin e të drejtave të njeriut, të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare dhe lejitimitet të vëzhguesve ndërkombëtarë nga ana e autoriteteve libiane. Po ashtu, rezoluta kërkonte edhe lejitimitet të largimit të të gjithë qytetarëve të huaj që donin të iknin nga Libia, si dhe lejitimitet të furnizimeve humanitare nga jashtë, heqjen e çdo kufizimi mbi mediat, etj.;
- referimin e situatës nga ana e Këshillit të Sigurimit, duke përdorur autoritetin e tij tek Prokurori i Gjykatës Ndërkombëtare Penale (ICC);
- vendosjen e embargos së armëve ndaj Libisë, si masë e detyrueshme për t'u respektuar nga secili shtet i OKB-së, me efekt të menjëhershëm. Vendet anëtare të OKB-së, e sidomos ato fqinje, u autorizuan të sekuestronin dhe raportonin pranë KS-së, çdo material i cili thyente këtë embargo;
- vendosjen e ndalim-udhëtimit për disa individë, zyrtarë të lartë të regjimit, të cilëve iu ndalua hyrja apo kalimi tranzit në secilin vend anëtar të OKB-së, si dhe ngrirjen e menjëhershme të asetëve financiare dhe pronave të paluajtshme të tyre, që ndodheshin në territoret e vendeve anëtare të OKB-së.

Siç shihet, me miratimin e kësaj rezolute, OKB-ja nuk kishte arritur ende të binte dakord për një qëndrim akoma më të ashpër ndaj regjimit të Gadafit, përfshirë këtu mundësinë që kundër tij të mund të përdorej forca e armatosur.

Si pasojë e përkeqësimit të situatës humanitare në Libi, mungesës së reagimit pozitiv të autoriteteve libiane ndaj kërkesave të Rezolutës 1970, si dhe mbështetjes që Franca e Britania e Madhe morën nga vendet arabe për domosdoshmërinë e një qëndrimi politik dhe diplomatik më aktiv, Këshilli i Sigurimit, mundi të miratojë më 17 mars 2011 Rezolutën 1973, e cila në kërkesat e saj, shkante më

tej se rezoluta paraardhëse, duke kërkuar mes të tjerash edhe:

- ndalimin e menjëhershëm të çdo lloj sulmi qeveritar, të dhunës dhe abuzimit ndaj civilëve;
- marrjen e masave mbrojtëse ndaj civilëve libianë nga ana e shteteve anëtare të OKB-së të pranishme në Libi, nëpërmjet organizatave joqeveritare ose ndërkombëtare;
- vendosjen e zonës së ndalim-fluturimit, duke ndaluar çdo lloj fluturimi në hapësirën ajrore të Libisë, veç atyre për qëllime humanitare, evakuimi apo për qëllime të tjera që gjykoheshin të nevojshme nga shtetet e autorizuar sipas paragrafit 8 të kësaj rezolute;
- autorizonte shtetet anëtare të OKB-së, qoftë të vetëm apo në kuadrin e ndonjë organizate rajonale ndërkombëtare që, pasi të kishin njoftuar më parë Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së dhe atë të Ligës Arabe, të merrnin të gjitha masat e nevojshme për të imponuar respektimin e ndalim-fluturimit dhe mbrojtjen e civilëve në Libi. Praktikisht, në thelb, ishte pikërisht ky autorizim që lajti një rol vendimtar në mundësimin e përdorimit të forcës nga ana e Bashkësisë Ndërkombëtare.

Operacioni *Odyssey Dawn*

Menjëherë pas miratimit të Rezolutës 1973, më 19 mars 2011, nën udhëheqjen e Francës dhe Britanisë së Madhe dhe me pjesëmarrjen masive amerikane, si në asetet kryesore sulmuese dhe në ato të komandë-kontrollit, filloi operacioni luftarak "*Odyssey Dawn*", i cili zgjati nga data 19 deri më 31 mars që konsistoi në ndërmarrjen e sulmeve ajrore kundër forcave të Gadafit, kryesisht në zonën e Bengazit. Ky operacion, i tipit "koalicion i vullnetit", ishte disi atipik ndërkohë që kishin nisur diskutimet për një përfshirje të NATO-s në vendosjen e zonës së ndalim fluturimit mbi Libi. Në praktikë, operacioni "*Odyssey Dawn*" përbëhej nga një seri misionesh të pavarura të vendeve pjesëmarrëse si SHBA-të, Franca, Britania e Madhe, Italia, kontingjentet e të cilëve nuk ishin plotësisht të integruara dhe kontributi ajror amerikan ishte ai me peshë kryesore.

Në të njëjtën kohë, për të nxitur më tej vendosmërinë e Bashkësisë Ndërkombëtare për domosdoshmërinë e vazhdimin të përdorimit të forcës kundër regjimit libian si dhe për të përcaktuar piketat kryesore politike të së ardhmes së Libisë pas Gadafit, u mbajt më 29 mars 2011 në Londër Konferenca mbi Libinë, e organizuar nga Qeveria britanike, e cila synonte të arrinte këto qëllime kryesore:

- Riafirmimin e vendosmërisë së angazhimit ndërkombëtar në zbatim të rezolutave 1970 dhe 1973 të KS-së të OKB-së, për t'i dhënë fund sulmeve të dhunshme mbi popullsinë civile të Libisë;
- Miratimin e një deklarate të përbashkët në mbështetje të popullit libian dhe nxitjen e një procesi politik ndihmues, me qëllim krijimin e kushteve që populli libian të mund të zgjidhte vetë të ardhmen e tij;
- Rikonfirmimin e mbështetjes dhe koordinimit të vazhdueshëm të ndihmës

humanitare si dhe nxitjen e diskutimeve mbi mbështetjen ndërkombëtare për popullin e Libisë, në tranzicionin e tij drejt të ardhmes.

Në Konferencën e Londrës, me prani të gjerë ndërkombëtare, përfshirë rajonin e Magrebit, u krijua edhe Grupi i Kontaktit mbi Libinë, me synim që të shërbente:

- Si bazë për gjykimet dhe propozimet ndërkombëtare, lidhur me mbështetjen e ardhshme për Libinë;
- Si forum për angazhimin e të gjithë rajonit në mbështetje të popullit libian;
- Si pikë kontakti për popullsinë libiane me Komunitetin Ndërkombëtar.

Po ashtu, gjatë Konferencës së Londrës, u mbajt edhe një takim i përbashkët i Ministrave të Punëve të Jashtme të vendeve anëtare të NATO-s dhe të vendeve të tjera të interesuara, ku u diskutuan kontributet individuale të vendeve të pranishme në Konferencë, kryesisht në formën e shprehjes së gatishmërisë për pjesëmarrje aktive ose mbështetje për operacionet ushtarake mbi Libi. Në kuadrin e kësaj konference, Shqipëria shprehu gatishmërinë për të vënë në dispozicion të NATO-s hapësirën e saj aeroportuale, në rast se do të nevojitej nga autoritetet ushtarake të Aleancës.

Aspekte kryesore të ndërhyrjes së NATO-s në Libi

Në planin e politikës ndërkombëtare, angazhimi i NATO-s në operacionin ushtarak ajror mbi Libi, vendoset në suazën e reagimit të lartpërmendur të Bashkësisë Ndërkombëtare ndaj shkallëzimit të dhunës kundër civilëve nga ana e forcave të Gadafit dhe shqetësimit ndërkombëtar për përmasat që po merrte kriza në Libi.

Vlen të theksohet se miratimi i Rezolutës 1973 të KS të OKB-së dhe sulmet ajrore që u ndërmorën në kuadrin e operacionit “*Odyssey Dawn*”, bënë të mundur që Aleanca e Traktatit të Atlantikut të Veriut të merrte gradualisht mbi vete veprimet aktive për imponimin e embargos detare e kryesisht Zonën e Ndalim Fluturimit mbi Libi. Kështu, më 22 mars, pas vendimit përkatës të Këshillit të Ambasadorëve, NATO filloi operacionin për vendosjen e embargos së armëve në Libi, nëpërmjet patrullimit të anijeve të përfshira në operacionin “*Active Endeavor*” në Mesdhe.

Më 24 mars, në zbatim të rezolutës 1973, Këshilli i Ambasadorëve të NATO-s miratoi ekzekutimin e planit operacional për vendosjen e zonës së ndalim-fluturimit mbi Libi, në mënyrë që të sigurohej mbrojtja e civilëve dhe zonave të banuara nga sulmet ajrore.

Përfundimisht, më 31 mars, NATO mori vendimin që të merrte komandën e operacionit “*Odyssey Dawn*”, operacion ky, që nën udhëheqjen e NATO-s u shndërrua në “*Unified Protector*”. Ky operacion i ri u strukturua që në fillim si një operacion ajro-detar, duke përjashtuar kategorikisht një ndërhyrje të mundshme tokësore.

Në planin e të Drejtës Ndërkombëtare, vendimi i adoptuar nga Aleanca u mbështet në mandatin e dhënë nga OKB-ja, në kuadrin e rezolutave të lartpërmendura, duke përmbushur kështu një nga kushtet kryesore që NATO kishte vënë për

përfshirjen e saj në operacionet ajro-detare në Libi. Sa më sipër, vlen të theksohet se Aleanca Atlantike kishte përcaktuar paraprakisht tre kushte kryesore për përfshirjen e saj në operacionin mbi Libi:

- ekzistencën e një baze të qartë ligjore;
- sigurimin e mbështetjes rajonale;
- nevojën e qartë për parandalimin e sulmeve me artileri të rëndë dhe aviacion në Bengazi dhe Misrata.

Përsa i përket kushtit të parë, NATO gjykoj se miratimi i Rezolutës 1970 dhe kryesisht i Rezolutës 1973, përbënte një bazë të qartë ligjore sipas të Drejtës Ndërkombëtare. Plotësimi i kushtit të dytë u arrit me përfshirjen në operacionin e udhëhequr nga Aleanca të 5 vendeve jo anëtare të Aleancës, që përveç Suedisë, ishin vende arabe si Jordania, Maroku, Katari dhe Emiratet e Bashkuara Arabe. Po ashtu, zhvillimet tragjike në zonat e sulmuara me armë të rënda nga forcat e regjimit libian në Bengazi dhe Misrata, të përhapura globalisht dhe në kohë reale nga mjetet e informimit masiv, plotësuan pa vonesë edhe kushtin e tretë të NATO-s.

Në planin praktik, operacioni i NATO-s u strukturua mbi tre komponentë kryesorë:

- vendosjen e embargos së armëve në ujërat ndërkombëtare të Mesdheut, për të penguar furnizimin me armë dhe mercenarë të Libisë;
- vendosjen e zonës së ndalim-fluturimit, në mënyrë që t'u jepej fund sulmeve ajrore ndaj civilëve;
- goditjen nga ajri dhe deti të forcave ushtarake libiane, që kishin në shënjestër popullatën civile.

Pas fillimit të operacionit, debati politik i Aleancës u përqendrua në strategjinë e daljes nga konflikti, pas kryerjes së misionit. Për këtë qëllim, gjatë takimit të Ministrave të Punëve të Jashtme të NATO-s, më 14 prill 2011 në Berlin, u përcaktuan tre kriteret që do të mundësonin përfundimin e operacionit "*Unified Protector*":

- Përfundimi i të gjitha sulmeve ndaj civilëve dhe zonave të banuara nga ata;
- Rikthimi i trupave ushtarake dhe paraushtarake të Gadafit në kazerma;
- Lejimi nga regjimi i Gadafit i ndihmës humanitare për popullatën e Libisë.

Këto kriteret u rikonfirmuan edhe gjatë takimit të Ministrave të Mbrojtjes së Aleancës në Bruksel, më datë 8 gusht 2011, gjatë të cilit u ra dakord gjithashtu për:

- Mbajtjen nën trysni ushtarake të regjimit të Gadafit deri në përfundimin e krizës;
- Ftesën që organizatat e rëndësishme ndërkombëtare si OKB-ja, BE-ja, Liga Arabe dhe Unioni Afrikan, të përfshiheshin në fillimin e planifikimit të fazës së pas-konfliktit në Libi.

Pra, ishte e dukshme që NATO nuk synonte të luante ndonjë rol thelbësor në periudhën pas përfundimit të konfliktit në Libi. Kjo u bë plotësisht e qartë disa javë më vonë, kur gjatë vizitës së tij në Tripoli, më 22 gusht 2011, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Rasmussen, deklaroi se do të ishin OKB-ja dhe Grupi i Kontaktit për Libinë, ata që do të luanin rolin kryesor për periudhën e pas-konfliktit dhe se Aleanca Atlantike do të angazhohej vetëm nëse diçka e tillë do t'i kërkohej.

Në rrafshin politik, vlen të përmendet gjithashtu edhe vendimi i datës 27 qershor 2011 i Gjykatës Ndërkombëtare Kriminale për lëshimin e një urdhër-arresti për krime kundër njerëzimit për udhëheqësin e Libisë, Kol. Gadafi dhe ndihmësit e tij më të afërt, djalin e tij, Saif al-Islam dhe Shefin e Sigurisë, Abdullah al-Senussi. Veç aspekteve juridike, ky vendim kontribuoi në izolimin politik të mëtejshëm të lidërshpit politik të Libisë, në rrafshin ndërkombëtar.

Me ecurinë e situatës në Libi, u bë e qartë se po krijoheshin të gjitha premisat që regjimi i Gadafit të rrëzohej dhe që angazhimi i NATO-s të përfundonte brenda një kohe të shkurtër. Kështu, lindi nevoja që Bashkësia Ndërkombëtare të njihte si palë në dialogun e fazës së pas konfliktit, Këshillin Nacional Tranzitor (NTC) të Libisë dhe të legjitimonte përfaqësimin e Libisë në OKB.

Për këtë qëllim, më 1 shtator 2011, u mbajt në Paris Konferenca Ndërkombëtare e Krerëve të Shteteve dhe Qeverive të “Miqve të Libisë”, me qëllim që:

- të bëhej e qartë se angazhimi për mbrojtjen e civilëve në Libi, nuk do të zgjaste përtej kuadrit të parashikuar nga Rezolutat 1970 dhe 1973;
- t'i jepej mbështetje ndërkombëtare Këshillit Kombëtar Tranzitor, për formimin e një qeverie të përkohshme, e cila do të udhëhiqte daljen e vendit nga kriza dhe do synonte krijimin e një shteti të ri, pluralist dhe demokratik, që do të garantonte të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, rendin ligjor dhe ndarjen e pushteteve;
- të çlirohej një pjesë e aseteve të ngrira të Libisë (6 miliard dollarë amerikanë), në mënyrë që Këshilli Kombëtar Tranzitor i Libisë të mund të administronte të ardhurat financiare, për t'u përdorur për nevojat e ngutshme dhe për rindërtimin e vendit;
- të shkrihej “Grupi i Kontaktit”, duke qenë se kishte kryer funksionin e tij dhe të zëvendësohej me “Grupin e Miqve të Libisë së Re”.

Më 21 tetor 2011, pra një ditë pas ekzekutimit të Gadafit në Sirtë, NATO mori vendimin paraprak për ta përfunduar zyrtarisht operacionin e saj mbi Libi, më 31 tetor. Vlen të theksohet se pavarësisht se ky vendim i NATO-s, nuk duhet konsideruar si parakusht i vënë nga Aleanca për përfundimin e operacionit “*Unified Protector*”. NATO e kishte bërë disa herë të qartë publikisht se, largimi i Gadafit nga pushteti, nuk hynte në objektivat e deklaruara të operacionit të NATO-s. Po ashtu, Aleanca kishte deklaruar zyrtarisht se ajo nuk kishte vënë në shënjestër persona të caktuar nga udhëheqja Libiane.

Më 28 tetor 2011, Këshilli i Ambasadorëve të NATO-s konfirmoi vendimin për të përfunduar më 31 tetor operacionin në Libi, duke u shprehur se misioni i

përcaktuar nga mandati i OKB-së, nuk kishte më arsye të vazhdonte dhe se ishte koha që populli i Libisë ta merrte vetë në dorë të ardhmen e tij.

Disa konsiderata mbi operacionin “*Unified Protector*”

Duhet theksuar fillimisht se Operacioni “*Unified Protector*” u strukturua si një operacion ushtarak ajror me një intensitet jo të lartë. Kështu, ai shënoi një mesatare prej 45-100 fluturimesh në ditët më aktive. Kjo bëhet akoma më e qartë po të kihet parasysh se operacioni ajror i NATO-s, “*Allied Force*”, mbi Republikën Federative të Jugosllavisë më 1999, shënoi një mesatare prej 487 misionesh në ditë. Po ashtu, gjatë 78 ditëve të operacionit mbi Jugosllavi, Aleanca kreu 38 mijë misione, 14 mijë prej të cilave misione bombardimi, ndërsa gjatë 200 ditëve të operacionit “*Unified Protector*” mbi Libi, NATO kreu rreth 26 mijë misione, prej të cilave pak më shumë se 9 mijë ishin misione bombardimi.

Megjithatë, “*Unified Protector*” rezultoi të ishte më i avancuar teknologjikisht se “*Allied Force*”. Kështu, numri i avionëve zbulues elektronikë SIGINT mbeti i pandryshuar gjatë gjithë ecurisë së tij, ndërkohë që u pakësuan gradualisht avionët sulmues dhe rol parësor luajtën avionët modernë pa pilot (UAV).

Në planin praktik, “*Unified Protector*” u përqendrua kryesisht në zonën e populluar bregdetare të Libisë, fillimisht në zonat e qyteteve që rrezikoheshin të kapeshin nga trupat e Gadafit, si Bengazi, Ajdabia, Brega e më vonë Misrata. Pra, planifikimi i tij ushtarak u duk se u bë hap pas hapi, në përputhje me rrethanat. Kështu, operacioni i NATO-s u shtri gradualisht drejt perëndimit duke ndjekur lëvizjen e vijës së luftimit mes palëve në terren. Në përgjithësi, mund të thuhet se misionet ajrore të “*Unified Protector*” arritën dy qëllime të rëndësishme dhe përcaktuese për suksesin e misionit të Aleancës:

- Mbrojtjen e popullatës civilëve nga sulmet;
- Degradimin e forcave të Kadafit në një stad të tillë që nuk mund të ndërmerrnin më ofensiva ajrore.

Vlen të theksohet se mënyra e ekzekutimit të operacionit shtroi mjaft pikëpyetje në gjirin e ekspertëve ushtarakë ndërkombëtarë. Kështu, mjaft prej tyre vunë në dukje se, me gjithë përdorimin e armëve të teknologjisë së fundit, avionëve pa pilot, gjuajtësve modernë, avionëve radarë dhe raketave kruiz, dhe pavarësisht se nuk pati rezistencë në ajër, operacioni i NATO-s, zgjati më shumë se sa pritej.

Po ashtu, analistët vunë në dukje se kur NATO mori komandën e operacionit mbi Libi, u desh të kalonin shumë javë deri sa të përcaktohej se ishte më e dobishme goditja e kapaciteteve furnizuese të forcave të Gadafit, sesa e çdo mjeti të tij të blinduar. Po ashtu, u desh mjaft kohë të bëhej e qartë se mund të kishte qenë më rezultativ përqendrimi i goditjeve tek depot e armatimit nga furnizoheshin forcat e Gadafit në fazën fillestare të konfliktit, dhe jo goditja sistematike e rreth 4 mijë depove të armatimit që ekzistonin në Libi.

Ndërkohë që kryengritësit libianë e kritikuan NATO-n për maturi të tepruar, vlen të theksohet se Aleanca Atlantike u përpoq t’i qëndronte strikt zbatimit të Rezolutës 1973, duke goditur forcat e Gadafit vetëm kur kërcënonin direkt popullsinë civile.

Në kufizimet e NATO-s, ndikuan edhe rregullat strikte të angazhimit të vendeve partnere pjesëmarrëse si dhe përpjekjet për të shmangur maksimalisht dëmet anësore. Po ashtu, efikasitetin e plotë të goditjeve ajrore të NATO-s, e pengoi edhe mospasja e trupave në terren që të shërbenin si kontrollorë të avancuar ajrorë (FAC) si dhe mungesa e një procedure standarde komunikimi me kryengritësit.

Nga ana tjetër, operacioni nxorri qartë në pah se misionet të tilla luftarake kërkojnë kapacitete moderne dhe të kushtueshme në shumë drejtime, si p.sh. më shumë avionë çisternë apo avionë radarë. Në fakt, kontributi më i çmuar amerikan në operacionin e NATO-s, nuk përbëhej nga avionët gjuajtës apo goditës, por pikërisht nga avionët radarë apo ata çisternë, që furnizuan avionët aleatë në ajër me miliona litra karburant.

Në këtë kontekst, operacioni “*Unified Protector*”, dëshmoi edhe efektet negative që pakësimi i buxheteve të mbrojtjes të vendeve aleate, ka sjellë në aftësitë luftarake të Aleancës. Po ashtu, operacioni nënvizoi edhe një herë domosdoshmërinë e kontributeve amerikane në operacionet e NATO-s.

Mbi sa më sipër, vlejné të theksohen kritikata e ashpra të bëra nga Sekretari i Mbrojtjes amerikan, *Gates*, para largimit të tij nga detyra, ndaj aftësive të NATO-s dhe europianëve, duke u shprehur mes të tjerash se efikasiteti i pakët i fushatës ajrore, po e çonte Aleancën drejt pakësimit kolektiv të rëndësisë së saj luftarake. Po ashtu, *Gates* përmendi se SHBA-ve iu desh të luanin një rol madhor në këtë operacion dhe se 11 javë fushatë ajrore e Aleancës ushtarake më madhështore në histori, kundra një regjimi të keqarmatosur, mjaftuan që shumë aleatëve t’u mbaronin bombat.

Megjithatë, duke pasur parasysh se kritika të ngjashme u bënë më se një dhjetëvjeçar më parë edhe në kontekstin e operacionit “*Allied Force*” mbi Jugosllavinë e atëhershme, operacioni “*Unified Protector*”, duhet konsideruar efektivisht si një tjetër sukses politik dhe ushtarak gjurmëlënës i NATO-s në lëmin e vendosjes së paqes, nëpërmjet një operacioni ajro-detar kompleks, në një rajon të ndërlikuar.

RUBRIKA E KATËRT

Shkrime Historike

Në këtë Rubrikë, Kolonel Dr. Edmond Braneshi, vjen me një studim për rolin e Akademisë Ushtarake ndër vite, qysh nga themelimi i saj, referuar edhe bazës ligjore e deri në ditët e sotme.

Në një farë mënyre, ky shkrim është plotësimi i studimit të Kol. Braneshit për Arsimin Ushtarak në Shqipëri, pjesa e parë e të cilit është botuar në Revistë në Numrin e Marsit 2012, me titull “Një vështrim historik mbi arsimin ushtarak”.

Shumë ujëra kanë rrjedhur qysh atëherë, por siç thekson ai... “Shumë vite punë mësimore e shkencore për një institucion si Akademia Ushtarake përbëjnë një përvojë të vyer në fushën pedagogjike, studimore e shkencore ushtarake shumëplanëshe”.

Duke e zhveshur këtë rrugë e përvojë, nga kufizimet e kohës e të sistemeve nëpër të cilat kaloi institucioni, vërehet se, në thelb, qëllimi dhe misioni i kësaj Akademie ishte kurdoherë përgatitja dhe kualifikimi i oficerëve profesionalisht të aftë për të drejtuar reparte e njësi të Ushtrisë Shqiptare, detyrë kjo tepër e rëndësishme.

Kurse në shkrimin tjetër me titull “100 vjetori i Pavarësisë dhe Çështja Kombëtare”, autori bën një kalim në histori për fillesat e shtetit shqiptar, vjen tek shpallja e Pavarësisë dhe e vendos theksin kryesisht tek Çështja Kombëtare, parë kjo në aspektin e Marrëveshjes që duhet arritur në të gjitha gjymtyrët dhe segmentet institucionale të Kombit.

Kjo, për të realizuar atë objektivi që shqiptarët e kanë shpallur në Preambulën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë...

Akademia Ushtarake, vatër shkencore e formimit të oficerit

Kolonel Dr. Edmond Braneshi,
Drejtor i Arkivit Qendror dhe Muzeut të FA

Trajtesë e shkurtuar. *Krijimi i Akademisë Ushtarake ishte ngjarja më e rëndësishme në historinë e arsimit ushtarak, të kulturës dhe të shkencës ushtarake. Me krijimin e saj, u realizua një nga ëndrrat më të shenjta të popullit tonë. Ajo u krijua si një institucion shtetëror, në vartësi të Ministrisë së Mbrojtjes, me status të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Akademia u quajt institucion i lartë mësimor-educativ e shkencor që shërben për kualifikimin e kuadrove të lartë të FA. Vendimi përbënte një vlerësim për shkollën, por edhe një dukuri të re në fushën e arsimit dhe të kualifikimit të oficerëve. Ishte kjo një arritje e nxitje për rritjen e cilësisë e të veprimtarisë mësimore, pedagogjike dhe studimore e shkencore të këtij institucioni. Të gjitha këto u pasqyruan në format organizative, në plan-programet mësimore, në rritjen e kërkesave profesionale ndaj metodave të mësimdhënies nga trupa pedagogjike si dhe në zbatimin e kritereve bashkëkohore të pranimit të akademistëve që ndiqnin studimet në akademi.*

Veprimtaria shkencore dhe e drejta që iu dha Akademisë Ushtarake për kualifikimet pasuniversitare solli një hop cilësor në punën shkencore. Një rritje të ndjeshme pati cilësia dhe kërkesa drejt një pune të pavarur në situata të ndryshme ushtarake. Duke qenë qendër e rëndësishme për punën shkencore, Akademia Ushtarake u vu gjithnjë e më mirë në shërbim të përmirësimit të punës mësimore dhe të zgjidhjes së problemeve që kishte ushtria.

Një vështrim i shkurtër

Ideja për të ngritur një akademi ushtarake ishte hedhur në vitin 1936, por ajo mbeti e porealizuar. Oficerët më të zgjedhur shqiptarë, të shkolluar në shkollat ushtarake të vendit, vijuan të kualifikoheshin e specializoheshin nëpër akademitë ushtarake kryesisht në Itali, Austri, Greqi e deri në Francë. Pas çlirimit të vendit nga pushtimi i huaj nazifashist, kjo ide do të rishfaqej dhe do të bëhej më “tunduese”. Qeveria shqiptare po tregonte një kujdes të veçantë për forcimin dhe modernizimin e gjithanshëm të Forcave tona të Armatosura. Një ndër problemet më të rëndësishme për ushtrinë ishte përgatitja dhe kualifikimi i personelit. Ky

problem, në fund të viteve '50-të bëhej më i domosdoshëm për shkak të "klimës" jo të ngrohtë që po krijohej midis vendit tonë dhe ish BS, i cili në ato vite ishte shteti, ku mbi 90% e personelit oficerë ishin arsimuar në akademitë e larta ushtarake sovjetike. Në këtë klimë marrëdhëniesh të nxehta nevojitej një shkollë ushtarake shqiptare që do të përgatiste oficerë të një niveli të lartë apo taktiko-operativ. Kështu, në maj 1958 u vendos krijimi i Shkollës së Lartë Ushtarake.¹ Në bazë të vendimit të Byrosë Politike dhe të urdhrat të ministrit të Mbrojtjes Popullore, filloi puna për organizimin e shkollës, për përgatitjen e bazës materiale të gjithanshme dhe të programeve për fillimin e vitit të parë mësimor. Vendndodhja ishte tek Rrapi i Treshit, i cili përmbushte kërkesat minimale për mësim, ku kishte zyra, klasa, kabinete, mensë, kuzhinë, etj. Përveç pajisjes së ambienteve me orëditë e nevojshme, një ndër detyrat kryesore ishte hartimi i programeve mësimore, i leksioneve dhe i metodikave. Për këtë nevojiteshin kadro të tjerë, të cilët u emëruan në korrik 1958. Këto funksione ishin; -instruktorë për taktikën, zjarrin, artilerinë, artilerinë kundërajrore, xhenion, ndërlihdjen, kiminë, etj. si dhe shefa në administratë (financë, transport, intendencë, etj.). Më 24 shtator 1958 administrata e shkollës së lartë filloi rregullisht nga puna, duke u pajisur me vulën zyrtare.

Fillimisht krijimi i kësaj shkolle synonte rritjen e kulturës dhe të aftësive komanduese të oficerëve të ushtrisë nga ana taktiko-operative, duke u përqendruar në një program të shkurtër akademie ushtarake. Kjo shkollë, 4-5 vitet e para, ishte trevjeçare. Në vitin e parë të saj u zhvilluan lëndë të kulturës së përgjithshme, e më pas do të kthehej në dyvjeçare. Me qëllim përforcimin e punës për organizimin e saj, në hartimin e programeve, në ndërtimin e fakulteteve të ndryshme dhe të të gjithë strukturës organizative të këtij institucioni, një grup oficerësh u dërgua në Bashkimin Sovjetik, pranë Akademisë "Frunze" për përvojë. Ky grup udhëhoqej nga Komandanti i shkollës, Gjeneralmajor Thoma Xhixho. Në periudhën dyjavore (12 deri 27 nëntor 1958), ata u njohën me programet mësimore të Akademisë "Frunze", të Akademisë së Artilerisë në Leningrad dhe të shkollës ushtarake "Vistrell", afër Moskës. Ata i kushtuan vëmendje problemeve të organizimit, të procesit të programeve mësimore² dhe sidomos raportit mes lëndëve për kursin e parë dhe të dytë. Pasi u kthyen në atdhe, ky grup së bashku dhe me kuadrot e tjerë të emëruar në funksionet përkatëse, përgatiti hapjen e vitit të parë mësimor. Kështu, në janar të vitit 1959 u hap Shkolla e Lartë Ushtarake³, e cila filloi me një kurs përgatitor që vazhdoi gjatë atij viti. Fillimisht ishin dy grupe mësimore, një gjitharmësh dhe një artilerie tokësore.

Në shtator 1961, Shkolla e Lartë Ushtarake mori emrin Akademia

Në Vendimin nr. 381, datë 28.10.1961 të K.M. për krijimin e Akademisë Ushtarake, theksohej që mbi bazën e Shkollës së Lartë të Oficerëve të krijohej Akademia Ushtarake e RPSH, me program akademik trevjeçar.

¹ Vendimi nr. 136 i Byrosë Politike, datë 10 maj 1958.

² AQFA, Fondi Reparti Ushtarak nr. 2002, Dosja nr. 2, Viti 1958, faqe 1.

³ AQFA, Fondi Reparti Ushtarak nr. 2002, Dosja nr. 1, Viti 1958.

Ushtarake.⁴ Në Vendimin nr. 381, datë 28.10.1961 të K.M. për krijimin e Akademisë Ushtarake, theksohej që mbi bazën e Shkollës së Lartë të Oficerëve të krijohej Akademia Ushtarake e RPSH, me program akademik trevjeçar. Në Akademinë Ushtarake, me urdhër të MMP, u hapën fakultete për të gjitha llojet e armëve e shërbimeve, sipas nevojave të Ministrisë së Mbrojtjes Popullore dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Më 21 prill 1963, me urdhër nr. 0173 të MMP, Akademisë Ushtarake i jepet distinktivi i saj. Në urdhër theksohej që distinktivi i jepej oficerëve që mbaronin me sukses studimet në Akademi dhe që merrnin diplomën. Ky distinktiv shoqërohej me certifikatën përkatëse, të lëshuar nga Komanda e Akademisë. Shpërndarja e tyre bëhej me ceremoni. Në atë periudhë, në Akademi po krijohej një përvojë e re si në mësimdhënie ashtu edhe në krijimin e një fondi materialesh teorike.

Nga viti në vit shtohesh numri i studentëve, i pedagogëve dhe i fakulteteve. Kështu, ndërsa në vitin e parë mësimor (1959) studiuan 50 vetë dhe dhanë mësim 14 pedagogë, vitin mësimor 1965-1966 e ndoqën 340 dëgjues, 60 pedagogë dhe kishte 7 fakultete⁵ (gjitharmësh, AT, AKA, prapavijë, ndërlihdje, kimi, inxhinieri ushtarake).

Në janar 1966 Akademia Ushtarake kaloi në program dyvjeçar⁶. Në muajin maj të po atij viti, në Akademi u zhvillua stërvitja komando-shtabi me kurset e dyta me temë “BrK në mbrojtje në sistem tunel në skalion të parë në drejtimin kryesor të KK”. Kjo stërvitje tregoi se pjesëmarrësit në stërvitje njihnin në përgjithësi mirë teorinë e luftimit mbrojtës dhe ishin në gjendje ta organizonin dhe ta drejtonin atë. Komandantët dhe shtabet treguan njohuri të mira praktike në organizimin dhe drejtimin e luftimit. Në këtë stërvitje, për herë të parë, u bënë përpjekje për të kombinuar luftën e ushtrisë së rregullt me atë partizane.⁷ Gjithashtu u bënë disa ndryshime në dokumente, duke kaluar në ato grafike.

Në kushtet e atëhershme të organizimit të Forcave të Armatosura dhe të zhvillimit të shpejtë të koncepteve të artit ushtarak, përgatitja operative e kuadrit të lartë oficerë, të cilët kishin mbaruar studimet në BS, apo e kuadrit të ri të ngarkuar me funksione komanduese të larta, pa mbaruar arsim të lartë ushtarak-gjë që nuk i përgjigjej kërkesave të kohës-solli si domosdoshmëri hapjen e Kursit të Lartë Gjitharmësh pranë Akademisë Ushtarake. Për këtë, në qershor 1967, komanda e Akademisë i dërgoi MMP një relacion për hapjen e këtij kursi dhe pasqyrën e lëndëve e të orëve të mësimin. Në këtë kurs do të përgatiteshin oficerë me njohuri operative për komandant Korpusi e Brigade dhe shef Shtabi Korpusi. Kursi do të përbëhej nga një grup mësimor prej 10-12 vetash, me detyra të larta e me moshë jo më shumë se 40 vjeç. Mendohej që programi mësimor të përmbante tema operative si Korpusi i Këmbësorisë në mbrojtje e në mësimje, Grupimi Operativ

⁴ Urdhër nr. 313, datë 15.09.1961 i MMP.

⁵ “Shënime mbi Historikun e Akademisë Ushtarake 1958-1975” punuar nga Xhemal Punavia, ekzemplar nr. 2 me numër regjistri 119 datë 06.06.1979, faqe 29.

⁶ AQFA, Fondi Shtabi i Përgjithshëm, Dosja nr. 30, Viti 1966.

⁷ Xhemal Punavia, Po aty, faqe 33.

(dy-tre Korpuse) në mbrojtje e mësymje. Zgjatja e programit do të ishte 10 muaj dhe në fund të kursit do të kishte diploma. Hapja e Kursit të Lartë u bë më 15 shtator 1967.

Në një shkresë të MMP⁸, në qershor 1968 u dha porosi që të hiqej fjala “dëgjues” dhe ajo të zëvendësohej me fjalën “akademist”. Kjo u diskutua në Institutin e Gjuhësisë, i cili ra dakort për këtë.

Në mars 1969, efektivitë i Akademisë Ushtarake mori pjesë në detyrën e ndërmjetësve në stërvitjet me trupa “Shpiragu”. Kjo ishte një formë e mirë për të lidhur teorinë me praktikën dhe për të testuar veten se sa zbatues ishin në detyra konkrete, në rolet përkatëse që kishin në të tilla stërvitje.

Gjatë viteve '70-të, vëmendja kryesore e katedrave ishte kthyer në drejtim të hartimit të teksteve e rregulloreve. Kështu, gjatë asaj periudhe u përfunduan tekste me vlerë, si “Veprimet luftarake të BrK në llojet e ndryshme të luftimit”, “Ushtrime të taktikës AT”, “Veprimet e artilerisë të BrK”, “Grupi dhe artileria e bk në luftim”, “Rregullore e drejtimit të zjarrit”, “Topografia e artilerisë”, “Drejtimi i zjarrit të GrA”, “Radioteknika”, “Elektroteknika”, “Objekte të fortifikuara tip tunel”, “Konstruksione beton-arme”, “Sigurimi xhenier në mbrojtje”, “Kimia organike”, “Matematika”, “Arma bërthamore”, “Mbulimi i AKA”, “Bazat e elektroteknikës”, “Drejtimi i zjarrit me armët e këmbësorisë”, “Ushtrime qitjeje AKA”, etj.

Në atë periudhë, për të unifikuar dhe standardizuar ecurinë në procesin mësimor, komanda e Akademisë nxori një urdhër të brendshëm, ku përcaktoi kriteret e mëposhtme: Viti mësimor të llogaritej 11 muaj; katedrat të caktonin sasinë e orëve dhe përmbajtjen e mësimave për çdo temë; provimet vjetore të zhvilloheshin për lëndët marksizëm-leninizëm, për gatitje taktiko-operative, përgatitje speciale, histori arti ushtarak; për provimet të liheshin 4 ditë kohë dhe 1 ditë provim; kurset e dyta të zhvillonin provim shteti për marksizëm-leninizmin dhe mbrojtjen e detyrës kursore; kursi i lartë të kishte vetëm mbrojtjen e detyrës kursore; koha për përgatitjen e provimit të marksizëm-leninizmit të ishte 6-7 ditë.⁹ Gjithashtu, vëmendje iu kushtua shmangies së përsëritjeve të lëndëve dhe temave që zhvilloheshin në Shkollën e Bashkuar. U vendos një raport më i drejtë midis përgatitjes taktiko-operative gjitharmëshe dhe asaj speciale, u përpunuan një seri temash të luftës popullore. Përsa i përket përgatitjes dhe kualifikimit të kuadrit pedagog, ai u vlerësua si faktor bazë për rezultate më të mira. Gjithashtu u shtua dhe u përmirësua dukshëm literatura teorike e mësimore. Në mënyrë të veçantë, vëmendja e Komandës së Akademisë u fokusua në ripunimin e programeve të saj; në hartimin e organikës së re; intensifikimin e përgatitjes së pedagogëve; ripunimin e gjithë bazës materiale teorike; intensifikimin e ndihmës dhe kontrollit; dërgimin në Korpuse të pedagogëve kur kishte stërvitje; studimin e problemit të kuadrit pedagog, mundësinë e zëvendësimit të tij dhe dërgimit për përvojë në trupa; rishikimin e punës ushtarako-shkencore.¹⁰ Akademia Ushtarake ishte

⁸ Shkresa nr. 69, datë 21 qershor 1968 e MMP.

⁹ AQFA, Fondi Shtabi i Përgjithshëm, Dosja nr. 27, Viti 1969, faqe 65.

¹⁰ Xhemal Punavia, Po aty, faqe 76.

institucioni më i lartë ushtarak dhe shkencor. Kjo dukej në misionin e saj, në nivelin e temave dhe në produktin që nxirrte. Në këtë kuadër, edhe liria akademike e institucionale duhej të ishte më e gjerë. Por, si institucion ushtarak, funksiononte sistemi i qendërimit nëpërmjet urdhrin e kontrollit dhe për këtë kërkohej dhe një shtab akademie që të ishte më kompetent në lidhje me problemet e procesit mësimor. Kështu, në akademi, u propozua që të krijohej shtabi me këtë përbërje: shef shtabi, ndihmës shef shtabi për planëzimin si dhe shef dege, instruktor për përgatitjen fizike, ndihmës për punën ushtarako-shkencore, redaktor dhe korrektor.

Gjithashtu, që puna ushtarako-shkencore të vihej mbi baza më të shëndosha, propozohej që njëri nga zëvendëskomandantët të mbulonte punën shkencore. Në përgjigje të saj, MMP lëshoi një Urdhër¹¹ për forcimin e mëtejshëm të punës në Akademi. Në Urdhër theksohej që detyra kryesore e Akademisë ishte përgatitja e kuadrit oficer për nivelin Brigadë-Korpus dhe programet të ripunoheshin mbi

Në Urdhër theksohej që detyra kryesore e Akademisë ishte përgatitja e kuadrit oficer për nivelin Brigadë-Korpus dhe programet të ripunoheshin mbi këtë bazë

këtë bazë. Drejtoria politike dhe komanda e Akademisë bënë një studim të hollësishtëm të kuadrit pedagog. Oficerët që caktoheshin të ndiqnin Akademinë duhej të kishin arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe Shkollën e Bashkuar të Oficerëve. Gjithashtu, u morën masa për kualifikimin e kuadrit pedagog dhe u bë projekt-rregullorja e re.

Në prill 1975, komanda e Akademisë nxori urdhrin për organizimin, përgatitjen dhe zhvillimin e stërvitjes komando-shtabi me kurset e dyta. Në këtë urdhër, përveç udhëzimeve organizative, u parashikuan dhe vlerat e qëllimet mësimore: të rriteshin e përmirësoheshin njohuritë teorike dhe aftësitë praktike të oficerëve akademistë, të organizoheshin, planëzoheshin dhe drejtoheshin veprimet luftarake në mësimje dhe në mbrojtje. Stërvitja u zhvillua në fillim të qershorit, në rajonin Priskë-Petrelë-Rrogzhinë, me metodën stërvitje komando-shtabi dyshkallëshe Brigadë-batalion, e njëanshme në terren.

Gjatë viteve '70-'90, në akademi u zhvilluan veprimtari mësimore pedagogjike dhe studimore-shkencore që lidheshin me përgatitjen e programeve të reja mësimore, metodika, rregullore luftimi, tekste mësimore, bazë materiale-didaktike¹². Gjithashtu u realizuan një numër botimesh cilësorë dokumentarë për historinë ushtarake dhe artin ushtarak të periudhave të ndryshme. Vend të rëndësishëm zë një numër i konsiderueshëm titujsh, artikujsh shkencorë e studimesh të shumta.

Në këto vite, Akademia pësoi transformime cilësore në organizim dhe në përmbajtje, gjë që u pasqyrua në rritjen e nivelit të mësimdhënies, sidomos në formimin profesional të akademistëve. Në të vërtetë, u bënë përpjekje të ndjeshme për t'i dhënë një natyrë tipike prej oficeri drejtues akademistëve gjitharmësh, ku përfshiheshin edhe oficerë të Flotës Luftarake Detare, të Aviacionit dhe të Ministrisë së Brendshme. Njëherazi, gjatë veprimtarisë së Akademisë Ushtarake

¹¹ Urdhër nr. 0303, datë 7 gusht 1973 i MMP.

¹² Dr. B. Zotaj, Y.Cani, "50 vjet Akademi e Mbrojtjes" SHBU, Tiranë 2008, faqe 21.

u bënë përpjekje që krahas kurseve 2-vjeçare, që përbënin bazën e këtij institucioni mësimor, t'i jepnin frymëmarrje dhe horizont më të gjerë misionit të saj. Kjo u synua përmes ngritjes dhe vënies në punë të kurseve të ndryshme, si ai i oficerëve të lartë, i perfeksionimit të oficerëve të artilerisë, të prapavijës, kurseve të korrespondencës, atij të komandantëve të grupeve vullnetare, të funksionarëve partiakë e të pushtetit, etj.

Gjatë veprimtarisë mësimore 1959-1990, në Akademinë Ushtarake u diplomuan 3542 oficerë dhe 40 % e tyre ishin gjitharmësh.

Akademia, vatër e shkencës

Akademia nuk ishte vetëm një institucion arsimor e mësimdhënës, por dhe një qendër ku përpunohej mendimi shkencor. Ndër vite, MMP bashkëpunonte me Akademinë për trajtimin e temave shkencore si “Pengesat fortifikuese kundër desantit detar”, “Organizimi dhe zhvillimi i luftimit të bk në mbrojtje të fortifikuar tip tunel”, etj. (1966); “Veprimet luftarake të BrK”, “Artileria e BrK në llojet e luftimit”, “Drejtimi i zjarrit të artilerisë”, “Veprimet luftarake të AKA”, “Sigurimi xhenier”, “Luftimi gjitharmësh” etj. (1968). Gjithashtu, me rastin e 25 vjetorit të çlirimit të atdheut, pranë Akademisë u mbajt një sesion shkencor, ku referati kryesor ishte: “Mbi përvojën e kryengritjes së armatosur të popullit shqiptar”. Në sesion u përgatitën 46 kumtesa nga të cilat një pjesë u mbajtën dhe pjesa tjetër u dha për shtyp. Edhe në vitin 1970 u mbajtën dy sesione shkencore me temë “Format e manovrës në luftimin mësymës dhe mënyra e realizimit të tyre” dhe “Masat e sigurimit xhenier për asgjësimin e desantit ajror”. Gjithashtu u punua projekt-rregullorja e BrK, u redaktua dhe u botua projekt-rregullorja e bk, u bë teksti “Maskimi i trupave” si dhe një seri temash e tekstesh, në funksion të procesit mësimor.¹³

Por, puna ushtarako-shkencore u bë pjesë e pandarë e veprimtarisë së akademisë dhe fitoi të drejtën e “qytetarisë” në mesin e viteve '70-të, kohë kur u krijua Dega Shkencore. Mbi këtë bazë, u ngrit Sektori i Studimeve Shkencore Ushtarake, që përbënte një strukturë më vete. Shefi i sektorit u emërua zëvendëskomandanti i Akademisë për anën shkencore. Sektori Shkencor i Akademisë Ushtarake drejtonte tërë veprimtarinë shkencore në shkallë ushtrie dhe bashkëpunonte ngushtësisht me Akademinë e Shkencave dhe institucionet shkencore që vareshin prej saj (si Instituti i Historisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Instituti i Arkeologjisë, Instituti i Studimeve Pedagogjike, etj.). Bashkëpunonte gjithashtu me Universitetin Shtetëror të Tiranës (Fakultetin Histori-Filologjisë, Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Fakultetin e Inxhinierisë, Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Fakultetin Ekonomik etj.), me Bibliotekën Kombëtare, me Muzeun Historik Kombëtar, me Muzeun e Skënderbeut në Krujë, me Muzeun e Armëve në Gjirokastër dhe me të gjitha bibliotekat e muzetë e rretheve.

Sektori Shkencor organizoi disa konferenca shkencore në shkallë ushtrie, të cilat vunë në lëvizje jo vetëm aparatën e MMP dhe të SHPU, por të gjitha institucionet mësimore dhe shkencore ushtarake (si Institutin e Topografisë Ushtarake, Institutin 6, Institutin e Studimeve dhe Projektive të veprave Mbrojtëse) si dhe të gjitha

¹³ AQFA, Fondi Shtabi i Përgjithshëm, Dosja nr. 27, Viti 1969, faqe 61.

shtabet e njësisve dhe reparteve të FA. Sektori pati një veprimtari të gjerë studimore dhe botuese. Kështu përfundoi teksti i *Historisë së Artit Ushtarak të Popullit Shqiptar* nga Lashtësia deri në vitin 1939, teksti i *Historisë së Artit Ushtarak të LANÇ-it*, Historikët e 24 Brigadave Sulmuese dhe libri i parë me nivel të lartë i Artit Ushtarak Shqiptar. Gjithashtu u hartuan me dhjetëra buletine informative të literaturës ushtarake nga seksioni përkatës. Sektori shkencor bëri studime me vlerë edhe për metodat e mësimdhënies, në bashkëpunim me Shkollën e Bashkuar të Oficerëve dhe me Shkollën Ushtarake “Skënderbej”.

Nga fundvitet '70-të e në vazhdim, Akademia u përcaktua edhe si qendra e vetme e ushtrisë, ku bëhej mbrojtja e disertacioneve për gradën “Kandidat i Shkencave” dhe “Doktor i Shkencave”. Pas vitit 1992, të gjithë kandidatët e shkencave, me vendim të Këshillit të Ministrave u kthyen, pa procedura të tjera, në Doktorë të Shkencave. Në vitet '90-të iu dha edhe e drejta e propozimeve për tituj shkencorë: “Asistent Profesor” dhe “Profesor” si dhe “Drejtues Kërkimesh Shkencore”.

Shumë vite punë mësimore e shkencore për një institucion si Akademia Ushtarake përbëjnë një përvojë të vyer në fushën pedagogjike, studimore e shkencore ushtarake shumëplanëshe. Duke e zhveshur këtë rrugë e përvojë, nga kufizimet e kohës e të sistemeve nëpër të cilat kaloi institucioni, vërehet se, në thelb, qëllimi dhe misioni i kësaj Akademie ishte kurdoherë përgatitja dhe kualifikimi i oficerëve profesionalisht të aftë për të drejtuar reparte e njësi të Ushtrisë Shqiptare, detyrë kjo tepër e rëndësishme.

Shumë vite punë mësimore e shkencore për një institucion si Akademia Ushtarake përbëjnë një përvojë të vyer në fushën pedagogjike, studimore e shkencore ushtarake shumëplanëshe.

Pas vitit 1990, shkollat ushtarake shqiptare, përfshirë edhe Akademinë, iu nënshtuan një procesi shndërrues dhe përmirësimi në formë, në përmbajtje dhe në mision, për t'u integruar në sistemin arsimor dhe në strukturat ushtarake euro-atlantike.

Bibliografia:

- AQFA, Fondi Reparti Ushtarak nr. 2002, Dosja nr. 1, Viti 1958 – Urdhër nr. 400 i MMP, datë 19.12.1958 mbi formimin e Shkollës së Lartë Ushtarake.
- AQFA, Fondi Reparti Ushtarak nr. 2002, Dosja nr. 2, Viti 1958 - Raporte të Akademisë Ushtarake dërguar MMP mbi punën dhe përvojën e fituar në BS nga një grup oficerësh të AU.
- AQFA, Fondi Shtabi i Përgjithshëm, Dosja nr. 30, Viti 1966 -Vendimi nr. 5 datë 12 janar 1966 mbi kalimin në program dyvjeçar të Akademisë Ushtarake dhe të Shkollës së Bashkuar të Oficerëve.
- AQFA, Fondi Shtabi i Përgjithshëm, Dosja nr. 27, Viti 1969-Urdhër nr. 0141 datë 27 qershor 1969 i Ministrit të Mbrojtjes Popullore mbi krijimin e Kursit të Perfeksionimit të Artilerisë pranë Akademisë Ushtarake.
- “Shënime mbi Historikun e Akademisë Ushtarake 1958-1975” punuar nga Xhemal Punavia, ekzemplar nr. 2 me numër regjistri 119 datë 06.06.1979.
- Dr. B. Zotaj, Y.Cani, “50 vjet Akademi e Mbrojtjes” SHBU, Tiranë 2008.

100 vjetori i Pavarësisë dhe Çështja Kombëtare

Pano Hallko,
Shef i Degës së Botimeve, QAM

“Kombi është plebishit i përhershëm”...

Ernest Renan

Trajtesë e shkurtuar. *Ky numër i Revistës, siç është programuar ndër vite, i takon të botohet afro dy muaj para se shqiptarët të festojmë 100 vjetorin e Pavarësisë, pra të shtetit tonë. Një shekull, nuk është shumë në histori, por nuk mund të jetë pak, nëse kemi parasysh periudhën kohore dhe rrethanat historike në të cilat u desh të krijohet dhe të vijonte jetën e tij, ky shtet, 100 vjetorin e të cilit ne festojmë më 28 Nëntor të këtij viti.*

Tre emra kanë përcaktuar, në formë konferencash, fatin tragjik të shqiptarëve: Berlioni, Londra dhe Jalta.

Objekt i pjesës së parë të titullit të këtij shkrimi është ajo që u konsiderua si Konferenca e Londrës e cila, siç do ta shohim të shkruar prej vetë atyre që e bënë dhe e emërtuan si të tillë, vetëm Konferencë nuk ka pasë qenë. Megjithatë, ajo e la vulën e saj përmes produktit të saj: Shqipërisë së sotme, e cila jo më kot është mbiquajtur “Shqipëria londineze”. Kurse në pjesën e dytë të shkrimit, në pamundësi të autorit për të dhënë rekomandime për probleme kaq madhore, shtjellohen dy nocione të rëndësishme: Gjuha dhe Tryeza e bisedimeve.

Hyrje

Ndoshta do të ishte me vlerë që tani, në prag të 100 vjetorit të shtetit shqiptar, për qëllime studimore dhe jo vetëm, të sillnim në vëmendje se qysh në vitin e largët 1272, në kohërat e Dantes, edhe pse nën siglën konvencionale anzhuiniane, krijimi i “Regnum Albania”, “...I dha vendit ndjenjën e bashkimit të cilën s’e pati kurrë më parë...”¹ Pra, kjo është gjurma e parë e organizimit të shtetit, kuptohet me parametrat e kohëve për të cilat flasim.

¹ Faik Konica, “Shqipëria, kopshti shkëmbor i Ballkanit”, faqe 25.

Gjergj Kastrioti- Skënderbeu, ndër të paktat figura të ndritura të mëdha të Rilindjes Europiane, ideoi, organizoi dhe udhëhoqi Kuvendin e Lezhës të vitit 1444. Ai i dha Shqipërisë kodin e rezistencës sonë homerike të shekullit XV, por edhe Europës një mesazh tejet novator, sfidues, plot të ardhme- bashkimin kombëtar, për të mbijetuar dhe për të realizuar veten si komb.

Në planin e brendshëm, Kuvendi i Lezhës që marrëveshja më e madhe për t'u ngritur mbi dasitë, pra shënon fundin e epokës së principatave. Rreziku i luftës, interesat kombëtare dhe ekzistenciale të përbashkëta krijuan projektin e përqendrimit të forcave. Skënderbeu si "*primus inter pares*" u zgjodh Kapiteni i Përgjithshëm ("*Capitaneus generalis*"). Princat shqiptarë krijuan me të, atë raport që kishte dhe Dhimitri i Arbërit kur i quante bujarët e shekullit XIII "*homines mei*". Ky raport, për shkak të përmasave të luftës, do ta lartësonte përherë e më shumë Skënderbeun si Zot i Shqipërisë ("*Domines Albaniae*").

Ideja e bashkimit është ideja e konvergimit, e krijimit të shteteve kombëtare, ide kjo tepër novatore e fundit të Mesjetës dhe epokës së Rilindjes Europiane. Që më përpara se Makiaveli ta bënte formulimin e shteteve kombëtare si teori për Europën, Kuvendi i Lezhës e mbartte mesazhin e vet, duke e bërë flamurin e shqiptarëve dykrenorë të Skënderbeut, simbolin heraldik të krejt kombit shqiptar. Rreziku i luftës, interesat kombëtare dhe ekzistenciale të përbashkëta, krijuan projektin e bashkimit të forcave. Prandaj Milan Shuflaj shkruante: "Luftëtari më i tmerrshëm që krijoi përgjithësisht përleshja e Europës me turqit, ishte Gjergj Kastriot Skënderbeu. Ky edhe për së gjalli u madhërua prej Europës Perëndimore me legjenda të ndryshme burrërie". Skënderbeu krijoi lidhjet me qytetërimin evropian në rrafshin kulturor, njerëzor, por edhe në aspektin fetar të krishterë.

Ishte i tillë përfitimi prej këtij Kuvendi, sa që mund të thuhet, pa hiperbolizuar aspak, se ndoshta nuk do të kishte komb shqiptar pa Kuvendin e Lezhës. Por kryesorja ishte fryma që mbolli ai kuvend. Sepse janë "filiale" të tij, ngjarjet madhore si: Lidhja e Prizrenit, Kuvendi i Vlorës, Konferenca e Pezës, të cilat janë stacione të ndërdijës sonë kombëtare.

Si platformë, teoria e krijimit të shteteve kombëtare u formulua për herë të parë në Europë nga Makiaveli, por plot një shekull më vonë sesa gjesti madhështor i Heroit tonë Kombëtar. Copëtimi mozaikal i Italisë u shndërrua në shtetin e bashkuar kombëtar italian, shumë vonë, prej Garibaldit, për të cilin poeti ynë i madh Zef Serembja, në një poezi të tijën shkruante: "Garibaldi, trim me fletë/ Skënderbeut tonë i ngjet"!...

E vërteta është që asnjë komb në botë, si ky i yni, nuk ka jetuar kaq gjatë nën struktura kozmopolite shtetërore të huaja (romake, bizantine, osmane, austriake, italiane, etj.), sa kombi shqiptar.

Rrjedhja e kësaj të vërtete historike është fakti që tek shqiptarët u ushqye një kundërshti e vetë-

Rrjedhja e kësaj të vërtete historike është fakti që tek shqiptarët u ushqye një kundërshti e vetëkuptueshme dhe e shpjegueshme ndaj shtetit si koncept juridik. Kjo për arsyen se shteti, jo vetëm që kurrë nuk ishte i shqiptarëve, por edhe sepse ishte kundër shqiptarëve.

kuptueshme dhe e shpjgueshme ndaj shtetit si koncept juridik. Kjo për arsyen se shteti, jo vetëm që kurrë nuk ishte i shqiptarëve, por edhe sepse ishte kundër shqiptarëve.

Shekulli i XX ishte për shqiptarët shekulli i shtetit të tyre. Mirëpo edhe ky shtet, në fakt fillimisht i projektuar si përputhje e njësisë etnike me njësinë shtetërore, kurrë nuk arriti të bëhej i tillë. Doemos që copëtimi etnik vetiu do të sillte si pasojë mbijetesën e paradoksit të gjatë mijërvjeçar të kundërshtisë së shqiptarëve kundrejt strukturave të reja shtetërore, por etnikisht të huaja. Vetë shteti amë-ai i *Shqipërisë londineze*, më se një herë iu nënshtrua konceptit kolonial të protektoratit.

Megjithë të mirat dhe të këqijat, anët pozitive dhe negative që ka, historia njëqindvjeçare e shtetit shqiptar, është fitorja më madhore e afirmimit të kombit tonë...

Shpallja e Pavarësisë

“Shpresa e kombëtarisë, Ismail Qemali me 47 delegatë t’ardhur nga viset e tjera shqiptare, për të vënë në veprim qëllimin e shenjtë kombëtar, me nxitim u mblodh më 15 allaturka/28 allafrënga të vjeshtës së III 1912/1328, ditën e bardhë, të Mërkurën ora më 11 e ½, më 5 e ½ pasdreke allafrënga, kur u shpall vetëqeverimi Shqiptar duke ngritur Flamur` e shenjtë, i cili kish 445 vjet në robëri, i shkëlur prej armikut barbar”.² “Si e kërkon rregulla e zakoni, filluan më parë në këqyrjen e vërtetimit të kartërave të Delegatëve, të cilët janë këta më poshtë:

- Nga *Berati*: Ilias Vrioni, Haredin Cakrani, Xhelal Skrapari, Dudë Karbunara, Taq Tutulani dhe Sami Vrioni.
- Nga *Dibra*: Myfti Vebiu, nga Durrësi Abas, Mustafa, Jaja dhe Dom Nikolla Kaçorri nga ana e Arqipeshkopit të Durrësit, për të gjithë shqiptarët katolikë.
- Nga *Elbasani*: Shefqet Daiu, Lef Nosi, Qemal, dhe Midhat Frashëri.
- Nga *Gjirokastra*: Azis, Veli, Elmas dhe nga Ipeku (Peja): Rexhep, Bedri, Sali Xhuka dhe Midhat Frashëri. Këta janë edhe delegatët e Gjakovës, Plavës dhe Gusinës (Gucisë).
- Nga *Kruja*: Abdi Toptani, Mustafa Asimi dhe nga *Lushnja* Qemal, Ferit Vokopola e Nebi Sefa.
- Nga *Ohri e Struga*: Zyhdi, Dr. Myrtezai, Nuri Sojli dhe nga *Shijaku*: Xhemal, Imer dhe Ibrahim; nga *Tirana*: Abdi Murat Toptani.
- Nga *Vlora*: Smail Qemali, Zihni, Aristidhi, Qazim Kokoshi, Jan Minga dhe Eqeremi e Syrjai.
- Nga Kolonia e shqiptarëve të *Bukureshtit*: Dhimitër Zografi, Dhimitër Mborja, Dhimitër Berati dhe Dhimitër Ilua.

² Sali Hallkokondi, “Historia e Shqipërisë së Re” faqe 121, botim i vitit 1923, Shtypshkronja “Vlora”.

Pas vërtetimit të kartërave, Sali Xhuka mori fjalën...³... “Përfundimi i Mbledhjes Kombëtare, e cila formoi qeverinë e përkohshme zgjodhi për krye Ministër dhe Ministër i Punëve të Jashtme Ismail Qemal benë, Mehmet Pashë Kallkandeleni Ministër i Luftës nga Tetova, Poga Ministër i Drejtësisë, Myfyt Libohova Ministër i Punëve të Brendshme, Gurakuqi Ministër i Arësimit, Abdi Toptani Ministër i Financave, Pandeli Çali Ministër i Bujqësisë, Mithat Frashëri Ministër i Punëve të Botore, dhe Lef Nosi Ministër i Postës”⁴.

Në emër të... “paqes europiane”

Nuk është rastësi fakti që në vitin 1913, viti i projektimit dhe zbatimit të copëtimit të tmerrshëm të kombit shqiptar, famëkeqi Vlladan Gjeorgjeviq botoi librin e tij inkuizionist kundër shqiptarëve. Ky libër ishte (ndoshta edhe vazhdon të jetë), Abetarja e shovinizmit më të skajshëm të të gjithë armiqve të kombit tonë. As më pak e as më shumë, ai i quante shqiptarët... “*Indianët ose evgjijtët pezhorativë të Europës*”. Në kohërat e reja, u takon pikërisht serbëve titulli turpi *honoris causa* për të ndërtuar doktrinën e aparteidit dhe segregacionit për shqiptarët. Veçse nuk doli ndonjë europian t’i thoshte: -A dini gjë zotëri, prej sa kohësh fara juaj ndodhet në Ballkan, dhe kë gjetet këtu kur erdhët?!? Ekziston një maksimum në këtë botë: -”Kombi që shtyp një komb tjetër, kurrë nuk mund të jetë i lirë vetë”. Kjo vazhdon ende të ndodhë me Serbinë e sotme, e cila vërtitet mes ëndrrës europiane dhe ëndrrës së (ri)pushtimit të Kosovës. Me pak fjalë, Serbia ende nuk është çliruar nga...Serbia!

Mbledhja e fundit e qeverisë së Vlorës u zhvillua më datën 4 dhjetor 1912. Nuk vonoi 12 ditë dhe, më 16 Dhjetor, nisi ajo ç’ka u quajt “Konferenca” e Londrës që vendosi, në mënyrën më të padrejtë, për fatet e kombit shqiptar dhe të territoreve të tij. Siç do të shikojmë më poshtë, përmes dokumentesh që i kanë shkruar faktorët e saj në atë kohë, nuk bëhet fjalë për Konferencë, por për takime ambasadorësh-miq të gjashtë Fuqive të Mëdha të cilët, duke pirë çaj pasditeve, ndanin me gjakftohtësi territoret shqiptare, deri më 29 Korrik 1913.

Njohësi dhe studiuesi më i mirë i saj, Profesor Arben Puto, nënvizon: -Është për t’u theksuar që Konferenca, gjatë zhvillimit të punimeve të saj, nuk mbajti procesverbale, ç’ka do të thotë se nuk kanë mbetur raporte të rregullta zyrtare mbi punimet e Konferencës. Megjithatë, u bë praktikë që ambasadori francez Pol Kambon, të hartonte në gjuhën frënge përmbledhjen koncize të diskutimeve të takimeve më të rëndësishme në formë shënimesh dhe ato t’u dërgoheshin për njoftim kancelarive.⁵

Vetë drejtuesi i “Konferencës”, ish-ministri i Jashtëm britanik *Grey* shkruan në *Kujtimet* e tij. Ja pohimi i tij lidhur me këtë çështje: ... “Ne ishim gjashtë: *Lichnowsky, Mensdorff* dhe *Imperiali*,- respektivisht ambasadorët e Gjermanisë,

³ Sali Hallkokondi, Po aty, faqe 125.(*Një pjesë e emrave nuk janë shoqëruar nga mbiemrat, të cilët edhe ashtu, janë të njohur prej shqiptarëve. Këtu janë sjellë ashtu siç janë shkruar në atë kohë, për besnikëri ndaj dokumentit.-shënim i autorit*).

⁴ Sali Hallkokondi, Po aty, faqe 124.

⁵ Arben Puto, “Shqipëria Politike”, faqe 55.

Austrisë dhe Italisë; *Cambon* dhe *Benckendorff*,-ambasadorët e Francës dhe të Rusisë, dhe unë për Britaninë e Madhe. Më takoi përgjegjësia e drejtimit, por ne vendosëm t'i thjeshtojmë procedurat dhe të bënim një komitet miqsh, ashtu siç edhe ishim. Ne mbledheshim pasditeve, zakonisht pas orës 4 dhe diskutonim deri rreth orës 6 ose 7, me një pushim të vogël çaji. Konferenca vazhdoi deri më gusht 1913, por ne mbledheshim vetëm kur e kërkonin rrethanat dhe raportet e miqësisë që kishim. Miqësia jonë nuk i pengoi debatet të vazhdonin të papërcaktuar në mënyrën më të bezdisshme...⁶

Mbledhja e ambasadorëve të 6 Fuqive të Mëdha në Londër nuk u thirr për të diskutuar për kombin shqiptar, por për të zgjidhur mosmarrëveshjet midis 4 fuqive ndërluftuese ballkanike: Serbisë, Greqisë, Malit të Zi dhe Bullgarisë me Turqinë, pas Luftës së dytë ballkanike. Një nga pjesëmarrësit e kësaj mbledhjeje, ambasadori francez Pol Kambon e pohon një gjë të tillë. Ai shprehet se: "...Pas nënshkrimit të paqes midis Turqisë dhe Italisë, marrja e vendimeve që do t'u imponoheshin shteteve ballkanike dhe Turqisë, iu besua trupit diplomatik në Londër. Ai kishte për detyrë hartimin e marrëveshjeve midis shteteve të ndryshme ndërluftuese të Ballkanit. Mbledhja e Londrës u hap më 16 dhjetor 1912".⁷

Po këtë fakt e pohon edhe vetë drejtuesi i mbledhjes *Grey* i cili shprehet se: ... "Ta mendosh mirë, roli im personal në këtë Konferencë dukej pa ngjyra dhe shumë banal. Interesat britanike nuk ishin të afektuara nga fati i Gjakovës, Shkodrës apo fshatrave të tjera shqiptare, dhe nuk më takonte të merrja as iniciativa të ndonjë politike, as ta formuloja, por të veproja si një Moderator i nevojshëm dhe i durueshëm midis Rusisë dhe Austrisë, të isha gati për të gjetur terrenin e konsensusit dhe të mbuloja pikat e mosmarrëveshjeve..."⁸

Pra e ashtuquajtura Konferencë e Londrës, u mbledh 12 ditë pasi ishte shpallur pavarësia e Shqipërisë Natyrale nga Ismail Qemali. Në datën 29 Nëntor 1912, ministritë e jashtme të 6 fuqive të mëdha u njohën me Aktin Juridik të shpalljes së Pavarësisë.

Në këto takime që zgjatën 6 muaj, territoret shqiptare u përdorën për të qetësuar dhe kënaqur orekset shovene të palëve ndërluftuese, që ishin fqinjët e Shqipërisë. Vetë Grey e pranon një gjë të tillë. Ai pohon në "Kujtimet" e tij se: "...Aleatët ballkanikë ishin të verbuar nga fitorja; Serbia donte të kishte dalje në Adriatik, dhe kishte shumë mundësi që ajo dhe Mali i Zi të dëshironin të merrnin disa rajone të Shqipërisë duke i konsideruar pjesë të plaçkës së luftës..."⁹

"Për të kënaqur Greqinë, krahina shqiptare e Çamërisë iu aneksua asaj, megjithëse shumica dërrmuese e popullsisë ishte shqiptare. Sipas Memorandumit të qeverisë shqiptare të Vlorës në vitin 1913, në Çamëri jetonin 75 mijë shqiptarë nga të cilët 18 mijë shqiptarë të greqizuar, të vendosur në kazanë e Reshadijes

⁶ Edwards Grey, *Memoires*, faqe 248, botimet *Payot*, 1927.

⁷ Pol Kambon, "Korrespondenca", faqe 31, botimet *Grasset*, viti 1946.

⁸ Grey, *Po aty*, faqe 254.

⁹ Grey, *Po aty*, faqe 254.

(Igumenicës), 16 mijë shqiptarë në kazanë e Margëlliçit, 25 mijë shqiptarë në kazanë e Filatit, 20 mijë shqiptarë në kazanë e Paramithisë, 13 mijë shqiptarë në Kazanë e Luros, 100 përqind shqiptarë...”.¹⁰

Për të kënaqur Serbinë, krahina shqiptare e Kosovës me mbi 90 përqind popullsi shqiptare iu dha Serbisë. Vetë Grey e pohon një gjë të tillë duke folur me përbuzje për trojet shqiptare. Në “*Kujtimet*” e tij ai pranon se “...Ne nuk mund të bënim luftë për disa fshatra si Gjakova...”¹¹ Ndërkaq, territori që iu dha Serbisë përbënte 19 mijë kilometra katrore troje shqiptare. Ndërsa trojet shqiptare nga Plava deri në Ulqin iu dhanë Malit të Zi.

Për hir të së vërtetës, përfaqësuesit e 6 fuqive të mëdha, nuk u morën asnjëherë me Aktin e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë në 28 Nëntor 1912 prej politikanëve shqiptarë, me shtrirje që nga Kosova deri në Çamëri, që nga Durrësi deri në Shkup. Kemi të bëjmë me një Akt juridik, i cili u injorua përgjatë çdo takimi.

Përfaqësuesit e 6 fuqive të mëdha, ndaj kombit shqiptar mbajtën një qëndrim tipik kolonialist, duke i përdorur territoret shqiptare si plaçkë tregu për të kënaqur fqinjët e saj, duke quajtur Shqipëri, atë që mbeti. Dy vjet më pas, po këta ambasadorë me Traktatin e fshehtë të Londrës vendosën ta copëtojnë sërish, duke quajtur Shqipëri vetëm një krahinë përgjatë lumit Shkumbin dhe duke ia dhënë territoret e tjera Italisë dhe Serbisë.

Këtë e thotë Grey në fillim të vitit 1914. Ja pohimi i tij: “...Marrëveshja ndërmjet fuqive lidhur me kufijtë veriorë të Shqipërisë u arrit pas një përpjekjeje diplomatike të gjatë dhe të vështirë. U vendos që bregdeti dhe Shkodra t’i mbeten Shqipërisë, ndërsa Peja, Prizreni, Dibra dhe pas shumë bisedimesh, Gjakova të lihen jashtë Shqipërisë. Kjo marrëveshje le një pjesë të madhe territori për t’u ndarë mes Serbisë dhe Malit të Zi si fryt i fitores së tyre...Unë e di fare mirë se kur gjithçka do të bëhet e njohur, kjo zgjidhje do të japë shkas në shumë pika për kritika të forta nga kushdo që e njuh vendin...Por ne e bëmë këtë për të ruajtur paqen europiane...”¹²

Por në “*Kujtimet*” e tij, të botuara në vitin 1927, është po ky Grey i cili shprehet se kishte mashtruar, lidhur me atë që kishte pohuar në Dhomën e Komunave në 1914. Ja pohimi i tij i botuar: “...Lufta në Ballkan nuk e rrezikoi paqen europiane nga rihapja e çështjes së Kostandinopojës apo të Ngushticave (Detroiti), sepse as Austria dhe as Rusia, dy fuqitë më ngushtësisht të interesuara, nuk kishin ndër mend të ishin aktive për të ndikuar në kushtet që Greqia, Bullgaria dhe Serbia mund t’i vendosnin Turqisë duke prekur Maqedoninë. Çështja e rrezikut dhe e përplasjes ishte Shqipëria, ku dominimi turk u thye pas Luftës...”¹³

¹⁰ Memorandum i qeverisë së Vlorës, drejtuar Konferencës së Londrës, firmosur nga Mehmet Konica, Rashih Dino dhe Filip Noga, Kaliopi Nasko, “Dokumente për Çamërinë”, botim i Akademisë së Shkencave viti 1990, faqe 50.

¹¹ Grey, Po aty, faqe 249.

¹² Fjalimi i Grey-t në Dhomën e Komunave, shkurt 1914.

¹³ Grey, Memoires, Botimet Payot, viti 1927, faqe 246.

Pjesëmarrësit e asaj që u konsiderua padrejtësisht Konferencë, pranojnë me pohimet e tyre, se ata nuk morën asnjë vendim. Takimi midis tyre të ngjan më shumë me një Kazino Politike, në tavolinën e së cilës ishin trojet shqiptare. Ja disa nga pohimet:

“Serbia kërkonte fshatin e Gjakovës; Austria pretendonte t’i mbetej Shqipërisë. Rusia nuk donte të ndërhynte në mënyrë që Serbia të tërhiqej; Austria qëndronte e palëkundur. Ishim në një situatë të bllokuar. Kjo vazhdoi me ditë e me javë; ishte e pamundur që të rrinim pa bërë gjë, por megjithatë e dinim shumë mirë që presioni vazhdonte të rritej, sepse valvula e sigurisë që përfaqësonte Konferenca nuk po funksiononte më...Një mëngjes të bukur mora në shtëpi një mesazh nga Ambasadori Austriak i cili dëshironte të më takonte me urgjencë. I thashë të vinte menjëherë tek unë. Disa minuta më pas, *Mensdorff* ishte aty. Dhoma në të cilën e prita ishte e vogël, kishte një tavolinë të vogël në mes, me vazo të gjata me narcize që vinin nga *Fallodon*. *Mensdorff* hyri si era, dhe i merrej pak fryma ngaqë kishte nxituar, i lumtur nga lajmet e mira që sillte, dhe bërtiti:-Ne heqim dorë nga Gjakova!... Më pas, ne u morëm me rehati me Gjakovën”...”.¹⁴

“Nuk pati asnjëfarë mbylljeje solemne, ne nuk bëmë fotografi grupi, nuk na dhanë asnjë falenderim apo fjalim lamtumire; thjesht ndaluan së takuari. Ne nuk kishim përcaktuar asgjë, as detajet e kufijve shqiptarë, e megjithatë ne kishim bërë një punë të dobishme: ne kishim qenë mjeti i mbajtjes së gjashtë fuqive të mëdha në kontakt direkt dhe miqësor”.¹⁵

Pol Kambon, ish pjesëmarrës në mbledhjen e Londrës... “Ballkanikët tanë ikën, por mbetën pa u zgjidhur problemet më të rënda, kufijtë e Shqipërisë dhe ishujt e Detit Egje”.¹⁶

Ndarja e dhimbshme e Atdheut, ndonëse kanë kaluar afro 100 vjet, është po aq absurde, madje mund të përshkruhet më mirë me thënien e Tertulianit: “*verum est, quia absurdum est*”(është e vërtetë, se është absurde).

Çështja Kombëtare dhe Europa e re...

Njëri prej intelektualëve më të mëdhenj të Europës së asaj kohe, poeti francez Gijom Apoliner (Guillaume Apollinaire), kontaktet e para me botën shqiptare i pati në vitin 1903, përmes faqeve të revistës dinjitoze “Albania”. Ai mbeti i habitur nga niveli i lartë i saj, por po kaq edhe prej erudicionit të Faik Konicës. Në vitin 1917, një publiciste e njohur e Europës së kohës, Liza Obri (Elise Aubry), botonte një broshurë me emrin “Shqipëria dhe Franca” (“L’Albanie et la France”). Broshurës i paraprinte një Parafjalë e poetit të madh francez Apoliner, në të cilën ai deklaronte: -“Çështja e shqiptarëve u duket diplomatëve të mëdhenj shumë e vogël përballë çështjeve të mëdha, që u tërheqin vëmendjen në botën e tallazitur. Diplomatët e mëdhenj, ndoshta gabohen”....

¹⁴ Grey, Po aty, faqe 256.

¹⁵ Grey, Po aty, faqe 253.

¹⁶ Pol Kambon, Po aty, faqe 51.

Nga sa thamë më sipër, del nga vetë deklaratat, kujtimet dhe shënimet, të thëna e të deklaruara në kohë të tjera e në të tjera kushte, para 100 vitesh, prej atyre që realizuan ndarjen e Shqipërisë, se kemi të bëjmë me një rast *sui generis*, madje tipik gjenocidist.

Sot, 100 vjet më vonë, kemi të bëjmë me një Europë tjetër, me të tjera mentalitete e rregulla funksionimi, një Europë e cila mëton që Bashkim i saj të jetë një edhe Bashkim i Kombeve europiane, një Europë e cila për njëmijë e një arsye që nuk është rasti t'i analizojmë në këtë shkrim, në përgjithësi ka tjetër vizion, pse jo edhe tjetër qëndrim, për shumë çështje, ndër to, edhe për çështjen shqiptare. Europa vetëm në një gjë nuk ka bërë dhe nuk mund të bëjë pas: në identitetin e saj. Shtetet themeluese të saj, ato që janë lokomotivat ekonomike dhe politike të saj, nuk kanë lëshuar “asnjë gram” nga identiteti i tyre kombëtar, e për pasojë edhe nga interesat e tyre kombëtare. Ashtu siç kemi aleatin tonë më të madh, SHBA-të, të cilat qysh në vitin 1921, përmes Presidentit Uillson, mundësuan ruajtjen e tërësisë fizike të kësaj Shqipërie që është sot brenda hartës administrative.

Njëri prej politikanëve më të mëdhenj britanikë, ish ministri i jashtëm Robin Kuk e pranon një gjë të tillë kur thotë se: “...Ne po zhbëjmë padrejtësitë që bëmë në shekullin që shkoi ndaj kombit shqiptar...”¹⁷

Dialogimi i shumëfishtë rreth çështjes kombëtare na çon drejt një logjike karteziante, si ajo e formulave dhe teoremave gjeometrike. Dualiteti: -“një realitet apo një ëndërr”, nuk është as fatal, as i pazgjydhshëm. Hamletizimi i çështjes kombëtare i takon sferës politike, e jo popullit komb.

Ne, mes realitetit dhe dualiteteve

“Ne, Populli i Shqipërisë, krenarë dhe të vetëdijshëm për historinë tonë, me përgjegjësi për të ardhmen, me besim te Zoti dhe/ose te vlera të tjera universale, me vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, me frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare, me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor, si dhe për prosperitetin e të gjithë kombit, për paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror, me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar, me bindjen e thellë se drejtësia, paqja, harmonia dhe bashkëpunimi ndërmjet kombeve janë ndër vlerat më të larta të njerëzimit...”¹⁸

Dualiteti “romantizëm” dhe “realizëm” është një keqkuptim, një ngatërrim (pse jo konfondim) i strategjisë me taktikat, kur strategjia dhe taktikat nënkuptojnë një unitet. Dualiteti “komb” dhe “kombësi” (ose disa kombësi), është shpikje djallëzore, është vetë albanofobia që në ditët tona paraqitet si një mit politik arkaik. Hegjemoniteti i kombit shqiptar është i padiskutuueshëm, me pasaportë universale arkeologjike, historike, njerëzore si dhe gjeografike. Diversitetet brenda

¹⁷ Robin Kuk, Diskutim në Dhomën e Komunave, 3 prill 1999.

¹⁸ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë-Preambula.

një kombi nuk janë aq, një bashkim i përbërë, sesa një sintezë origjinale, vetë individualiteti i posaçëm i kombit.

Dualiteti “Lindje-Perëndim” nuk është figura e humnerës, por është figura e Urës, nuk është një antagonizëm i paragjykuar, por një mundësi e mrekullueshme, nuk është ndarje, por bashkim, është një metaforë gjeopolitike dhe shans i përhershëm.

Statusi i dyfishtë i kombit shqiptar: europian dhe ballkanik njëherazi, është i përshtatshëm, si për të ardhmen e konceptit “Europa pa kufij”, ashtu edhe për derivatin e tij: “Ballkani pa kufij”.

Midis kombit de fakto dhe kombit de jure, shtrihet hapësira e veprimit të përbashkët të shqiptarëve. Kjo është vetë alternativa mbarëkombëtare, e cila kur është e programuar konceptualisht, realizon përputhjen e homogjenitetit të pikëpamjeve me homogjenitetin e kombit.

Midis kombit de fakto dhe kombit de jure, shtrihet hapësira e veprimit të përbashkët të shqiptarëve. Kjo është vetë alternativa mbarëkombëtare, e cila kur është e programuar konceptualisht, realizon përputhjen e homogjenitetit të pikëpamjeve me homogjenitetin e kombit.

Idea e bashkimit kombëtar nuk mund të jetë monopol i kurrkujt që flet në emër të kombit, pasi një mandat i tillë nuk ekziston. Atë mandat e ka vetëm kombi, për vetveten e tij. Asnjë parim i së drejtës ndërkombëtare, por edhe asnjë teori universale e humanizmit, nuk bie ndesh me kombin unik shqiptar, e as nuk mund të justifikojë copëtimin e përrjetshëm të tij “*in finitum*”.

Nuk është ideologjia mbi kombin, por e kundërta ndodh. Socializmi totalitar tentoi të vendoste ideologjinë komuniste edhe mbi kombin, në emër të internacionalizmit. Demokracia është një pluralizëm ideologjish, e për pasojë ky pluralizëm nuk mund të jetë mbi kombin, qoftë edhe në emër të globalizmit. Sepse kodi kombëtar identifikon dhe afirmon vetveten, jashtë çdo ksenofobie, pa rënë në kundërshtim me parimet universale të humanitetit mbarënjëzëror.

Kjo do të thotë se kombi nuk mund të jetë aspak çështje ekskluzive: as e diktaturave, as e demokracive. Është shumë më tepër, është shumë më shumë se rendet dhe sistemet ekonomiko-shoqërore.

Kjo do të thotë se kombi nuk mund të jetë aspak çështje ekskluzive: as e diktaturave, as e demokracive. Është shumë më tepër, është shumë më shumë se rendet dhe sistemet ekonomiko-shoqërore, edhe kur ato janë

institucionale. Ai është para së gjithash subjekt i vetvetes, i barabartë me të gjitha subjektet e tjera në komunitetin botëror.

Demokracia normale dhe reale; në dallim nga diktaturat, e rilind kombin. Ka qarkulluar në këto 20 vite edhe teza:- “Le të krijohet më parë një shoqëri demokratike, e në kuadrin e saj të zgjidhet edhe çështja kombëtare”. Kjo tezë ka qenë kontradiktore, për një arsye shumë të thjeshtë:-Nuk duhet të harrojmë se të drejtat kombëtare kanë qenë shumë më të hershme se shumica e të drejtave të njeriut. Kështu, mund të kujtojmë se shumë kombe në Europë janë formësuar

dhe institucionalizuar si shtete-kombe në Mesjetë, kur as në ëndrrat më të bukura nuk mund të bëhej fjalë fare për të drejtat e njeriut, pa lere në kuptimin që ne i njohim sot.

Në çdo vend, raporti i partive politike me kombin është i tillë që përjashton çdo lloj partikracie mbi të. Sepse kudo në botë është vërtetuar katërcipërisht se kombi është jetëgjatë, kurse partitë linden dhe janë të vdekshme.

Po kështu; fakti që kombi shqiptar ka edhe pluralitetin e tij fetar, në analizë të fundit do të thotë që institucionalizimi i feve kurrë nuk mund të ngrihet mbi kombin, ashtu siç ka ndodhur me vende të ndryshme, të afërta dhe të largëta me vendin tonë. Pasi edhe fetë; në fund të fundit; janë internacionale e prandaj; për të shmangur çdo tentativë përçarjeje, sentenca:- “Feja e shqiptarit është shqiptaria”, duhet të jetë për ne një Ligj Kopernikjan i moralit tonë të veprimit.

Nuk duhet të harrojmë fjalët e arta të Konicës: “E doni independencën, që të mund të mbeteni zullunj, por duhet të mos mbeteni zullunj, nëse doni të fitoni independencën”.

Kodi kombëtar i shqiptarit mban parasysh faktin se ekziston një raport real mes të drejtës civile dhe të drejtës etnike. Por e drejta civile do të ishte thjesht një ornament zbukurues, pa të drejtën etnike si një e drejtë e vjetër. Për më tepër kodi ynë kombëtar nuk është nacionalizmi i skajuar në ksenofobi e as në ksenomani, por është thjesht logjika e një realiteti kombëtar. E ky realitet është një komb unik, e jo dy gjysma kombi, të cilat vërtiten si ato sferat në sistemin e Ptolemeut,-secila për hesap të saj. Madje njëra gjysmë e kombit është e ndarë në katër pjesë, në ish Jugosllavi, me formula politike të propozuara që nuk sigurojnë njësimin e tyre,-të paktën gjysmë etnike, me vijimësi gjeografike.

E drejta jonë etnike është ajo e subjektit të barabartë etnik para tërë subjekteve etnike të Europës dhe nuk përbëhet nga dy të drejta etnike:-Njëra e veçantë për njërën gjysmë të kombit, dhe tjetra e drejtë “e kombësive” për gjysmën tjetër të kombit, kombit që është mozaikuar në katër pjesë. Të drejtat dhe liritë themelore nuk mund të kenë një diversitet kaq absurd. Përkundrazi, ato synojnë një integrim dhe unifikim paneuropian, në të cilin konceptet “Europa pa kufij”, - por dhe “Ballkani pa kufij”-si derivatë të tij-mundësojnë jo vetëm teorikisht, edhe një të ardhme civile të kombit shqiptar, duke konvencionalizuar apo zhdukur kufijtë e sotëm politikë. Kombi shqiptar,

duke pohuar veten nuk mohon kombet e tjerë. Por edhe kombet e tjerë, duke pohuar kombin shqiptar, e kanë pohuar edhe më shumë veten e tyre. Ka dy kohësi për zgjidhjen e çështjes shqiptare. Njëra parakupton parimin kokëfortë të gradualitetit dhe tjetra zgjidhjen e menjëhershme: si punë ditësh apo muajsh. Praktikisht çështja jonë kombëtare i ka

Kombi shqiptar, duke pohuar veten nuk mohon kombet e tjerë. Por edhe kombet e tjerë, duke pohuar kombin shqiptar, e kanë pohuar edhe më shumë veten e tyre. Ka dy kohësi për zgjidhjen e çështjes shqiptare. Njëra parakupton parimin kokëfortë të gradualitetit dhe tjetra zgjidhjen e menjëhershme: si punë ditësh apo muajsh. Praktikisht çështja jonë kombëtare i ka të dyja këto kohësi të konceptuara.

të dyja këto kohësi të konceptuara.

Kushtetuta e Gjermanisë e vitit 1949, në Nenin nr. 43 të saj, shpallte bashkimin e ideuar të Gjermanisë, gjë që u realizua më 3 Tetor 1989, me rënien e Murit simbolik të Berlinit.

Thuhet se politika është arti i të mundshmes. Lind pyetja: Bashkimi i shqiptarëve, nuk hyn tek aspiratat e mundshme? Pse nuk qenka arti i të mundshmes? Natyrisht, duke njohur dhe zbatuar parimin e gradualitetit.

Roli i intelektualëve të kombit tonë nuk është që ata të “hanë” njëri-tjetrin, ca më keq kur bien prë e “kryqëzimit të shpatave të “alternativave” politike”. Për intelektualët e mëdhenj, në botë (po këtu, pse jo!?) ndodh mrekullia vetë:-Sa më shumë që japin, aq më shumë fitojnë (jo para dhe prona). Egoja vetjake e tyre humbet përgjithnjë, pasi ata vetë përbëjnë alter-egon e kombit të tyre.

Doemos që parakusht i domosdoshëm për “mjeljen” e mendjeve të intelektualëve, është funksionimi meritokratik i shtetit, tërheqja prej tij në mënyrë institucionale të mendimeve dhe ideve të tyre. Naimi ynë i madh thoshte:-“Një komb, atë notë që i vë vetes së tij, atë notë merr edhe nga të tjerët”...

Se si mund të realizohet kjo, le t’i referohemi një shembulli të gjallë të Europës së viteve ‘50-të. Askush më shumë dhe më ashpër sesa filozofi dhe shkrimtari i madh francez Zhan Pol Sartr, nuk e kritikonte atëbotë Presidentin Dë Gol. E megjithatë, Dë Goli e çmonte shumë Sartrin.

Me Urdhër të Presidentit, u ishte shpërndarë të gjitha rajoneve dhe postave të policisë në të gjithë Francën, fotografia e Sartrit. Por (kujdes!!!) fotografitë nuk ishin shpërndarë që ai të njihej e të arrestohej. Përkundrazi, ai duhet të njihej nga çdo polic e të respektohej, t’i krijoheshin lehtësitë e mundshme të kërkuara për të lëvizur apo për probleme të tjera. Dë Goli thoshte: “Sartri është nderi i Francës dhe i epokës”...

Ky nderim e vlerësim e motivonte Sartrin të ishte edhe më objektiv në kritikën e tij, ta donte edhe më shumë Francën e tij, dhe doemos të mbështeste më fort Presidentin e tij, qoftë edhe duke e kritikuar rreptë atë. Realiteti i sotëm shqiptar i ka pak “Sartr-a”, qoftë edhe dy-tre, në të gjithë hapësirën tonë kombëtare. Shumë nuk kemi, por nuk janë pak për një komb si yni. Minimumi që duhet bërë, është t’i dëgjojmë me respekt, qoftë edhe duke mos u krijuar asnjë lehtësi.

Realiteti i sotëm shqiptar i ka pak “Sartr-a”, qoftë edhe dy-tre, në të gjithë hapësirën tonë kombëtare. Shumë nuk kemi, por nuk janë pak për një komb si yni. Minimumi që duhet bërë, është t’i dëgjojmë me respekt, qoftë edhe duke mos u krijuar asnjë lehtësi.

Fjala shqipe me peshë, në Shën Tryezë...

Fjala...

Dualizmi rreth dualitetit gjuhësor të dialekteve, është më tepër një fantazmë linguistike e politizuar. Ky dualizëm nuk mohon aspak gjuhën unike kombëtare,

e cila është Kushtetuta e Parë dhe e Pazëvendësueshme e kombit shpirtëror dhe kulturor, e cila çon pashmangshmërisht tek kombi i vetëm politik. Kombi gjuhësor dhe kombi kulturor i paraprijnë kombit politik. E këtë ne e kemi arritur. Mendoj se duhen analizuar disa çështje kontradiktore që kanë qarkulluar në 20 vitet e fundit. Është arritje monumentale (edhe pse vonë), fakti që fëmijët shqiptarë, pavarësisht se në cilin “shtet” lindin e rriten, në të gjithë “sinisinë” e Ballkanit, kanë një Abetare. Vetiu do të vijë e koha do ta sjellë, që ata të kenë Një tekst Gjuhe dhe Një tekst Historie.

Gjuha letrare mbiquhet kombëtare, sepse është mbidialektore. Kjo është një e vërtetë e pakundërshtueshme dhe universale, që edhe afirmon, po edhe mohon. Ose do ta pranojmë këtë të vërtetë, ose ajo nuk do të na pranojë vetë ne. Nuk ka zgjidhje ekuivoqe. Rregulli eklektik “edhe ashtu” “edhe kështu” nuk ka asnjë vlerë. Zgjidhja historike tashmë është bërë. Ishte një proces jashtëzakonisht interesant dhe i gjatë i cili, dilemat hamletiane të gjuhëtarëve dhe dualizmin e tyre, i ka përcaktuar me një rezultat të gjallë të një rëndësie epokale. Gjuha e njësuar kombëtare nuk është më vetëm një realitet *de facto*, po edhe një realitet *de jure*. Kombi shqiptar duke qenë prej kohësh një realitet *de facto* ende nuk është një realitet *de jure*. Kjo është një kontradiktë tragjike.

Në kuptimin e realizimit të vetvetes, Gjuha që është simboli e thelbi më i pazëvendësueshëm i kombit, paraqitet si një e ardhme strategjike, madje si kushti më i parë dhe më thelbësor i njëjtësisimit politik të kombit. Shqiptarofobia është kthyer në mit politik, madje në gjenocid. Akademikë të ndryshëm të huaj, publicistë, politikanë, etj., janë rrekur të formulojnë dhe të shpallin teorikisht mosekzistencën reale të kombit shqiptar, primitivitetin e tij të kultivuar. Në këtë hulli, argumentet e kobshme dhe alibike, që e shpjegojnë gjuhën origjinale shqipe si një grumbull kaotik të gjuhëve të tjera, ose fataliteti gati frojdian i ndarjes së dialekteve, kanë vendin e tyre në “teorinë” e destruktimit. Dialektet janë alternativa gjuhësore, por brenda një sistemi, e jo dy a më shumë sistemesh më vete, madje të papajtueshme. Pikat e bashkimit janë kryesore në raport me pikat e ndarjes, pra vetë dialektet kanë që në gjenezë lëndën e unikes, të së vetmes, të normës.

Faik Konica e quan dallimin mes toskërishtes dhe gegërishtes jo të rëndësishëm. Ai citon një autoritet të shquar të filologjisë indo-germane Dr. *Holger Pedersen*, profesor në Universitetin e Kopenhagës, i cili ka shkruar: “Gjuha shqipe është një e vetme, nëse nuk i marrim në konsideratë disa dallime të vogla të dialekteve”.¹⁹

Integriteti i gjuhës është integriteti i kombit, nuk mund të kemi dy integritete të një gjuhe ashtu siç nuk mund të kemi dy kombe shqiptare brenda një kombi.

“Zhvillimi i gjuhëve,-ka shkruar prof. Çabej,- karakterizohet nga një proces i dyfishtë: -më një anë thjeshtimi i sistemit gramatikor, thjeshtim progresiv,-më anë tjetër pasurimi i elementëve të leksikut... Pasuria gramatikore, nuk është shenjë kulture. Pasuria gramatikore, pasuria e formave të gramatikës, është shenjë e gjendjeve primitive të gjuhëve”.

¹⁹ Faik Konica, “Shqipëria-kopshti shkëmbor i Europës Juglindore” Shtëpia botuese “Gjon Buzuku” Prishtinë, 1991, f. 139.

Le të marrim si shembull muzikën. Muzikantët kanë vetëm shtatë nota, por krijimet e tyre nuk janë kufizuar kurrë nga numri kaq i paktë i notave. Me ato shtatë nota janë kompozuar melodi dhe Simfonira, deri tek e papërsëritshmja Simfoni e Nëntë e Beethovenit. Gjuha normative bëhet më e thjeshtë, por kjo e shton së tepërmi fuqinë e saj komunikative në hapësirë dhe në kohë. Nga ana tjetër, gjuha normative nuk e pakëson, por e shton pafundësinë e formulave të saj të brendshme gjuhësore, estetike e shprehëse, të metaforizmit të pafund. Këtu spikat madhështia e saj, këtu është realiteti i saj dhe ëndrra.

Gjuhën e flet individi, por e gjeneralizon kolektivi e, në këtë marrëdhënie të shumëfishtë, gjuha gjallërohet, pasurohet. Pra, gjuha është më shumë një “energji”, se sa “*ergon*”. Ky është dhe boshti i filozofisë së gjuhës sipas Humboldt. Kalimi nga faza dialektore në fazën e gjuhës së njësuar është një ndryshim kopernikian.

Gjuha letrare kombëtare, e ngjashme me emblemën tonë, vetëm na bashkon. Dy kryedialektet e krijuan atë, si kokat e së njëjtës shqiponjë të flamurit. Askush nuk ka dyshuar se nga kjo shqiponjë e shenjtë heraldike, duke e ndarë atë, do të krijoheshin dy shqiponja më vete. Ajo është vetëm një dhe do të mbetet vetëm një. Në shekuj. Në Ardhmëri.

...dhe Shën Tryeza

...Kohët e fundit, mediat sollën në vëmendjen e shtetit dhe të gjithë shoqërisë, mungesa të mëdha në Muzeun “Odise Paskali” në Korçë. Para 18 vjetësh, u zhdukën nga Muzeu Historik Kombëtar Epitafi i Gllavenicës, Ikonat e Onufrit, Ikonat e David Selenicasit, -vepra arti të papërsëritshme dhe unikale në Europë, e jo thjesht në Ballkan. Personalisht, po të kisha dëgjuar atëherë, se...”u dogj Banka e Shtetit” (fjala nuk sjell gjë), nuk do të isha shqetësuar aq sa nga lajmi për zhdukjen e ikonave. Sepse kartëmonedhat mund të ribëhen, i jepet komanda makinerisë, dhe...ajo “i pret”. Për ikonat, me gjithë arritjet e artit, nuk po shikojmë të tilla “makina” si Onufri apo si Selenicari, kaq shekuj pas ikjes së tyre...

E vërteta është që jetojmë në një periudhë tranzitore, në të cilën përmbysen mite (që duhen përmbysur), por jo rrallë edhe vlera. Në udhëkryqet e qyteteve vëmë semaforë mitesh, për qarkullimin e miteve. Njerëz të rëndomtë, shpesh me vetëdijë haluçinante, shëtisin me veturat më luksoze-të muajit të fundit.

Sot, thujse kudo në botë, Dollari (pse jo Euro sot), është feja monoteiste mbi tërë pluralizmin fetar, mbi gjithçka, mbi jetën dhe vdekjen e secilit, mbi trupin dhe shpirtin, mbi alfën dhe omegën e moralit.

Tani, ky është fenomeni i përbotshtëm. Por bota i ka zgjidhur hallet e rënda të saj, për pasojë ajo është në gjendje edhe të mjekojë më lehtë shumë plagë të shoqërisë apo të personit.

Në gjykimin tim, mjeti më i dobishëm madje i domosdoshëm për ne, është Tryeza e rumbullakët, Tryeza e dialogut, e mirëkuptimit, e njeriut për njeriun, e vetëdijes qytetare, e domosdoshmërisë, e kulturës, e realizimit, e forcës morale, e vitalitetit kombëtar, e shqetësimeve, kapërditjes së marrëzive, e kthjellësisë mendore dhe e afirmimit.

Tryeza e rrumbullakët (*round table*), e mbretit legjendar Artur ka qenë shumë më e famshme se shpata dhe kali i tij i luftës. Tryeza e rrumbullakët është emblema e parlamentarizmit serioz, është vëllazëria njerëzore mbi konfliktet politike, është mençuria mbi idiotizmin, është frymëmarrja mbi asfiksionë, forca e mendimit mbi vdekjen që pjell krimi.

Tryeza e rrumbullakët është emblema e parlamentarizmit serioz, është vëllazëria njerëzore mbi konfliktet politike, është mençuria mbi idiotizmin, është frymëmarrja mbi asfiksionë, forca e mendimit mbi vdekjen që pjell krimi.

Tryeza e rrumbullakët është sofa popullore për njerëzit e Familjes, është simboli solemn i dasmave dhe kësolleve, është Kuvendi i burrave dhe aula e diskutimeve shkencore, është thelbi i mikpritjes dhe njerzillëkut shqiptar në të gjitha kohërat, është i njëjti gjak që na rrjedh në deje, është i njëjti identitet kombëtar dhe njerëzor. Tryeza e rrumbullakët për subjektet politike është politika e mirëkuptuar, e në të kundërt është moskuptimi i politizuar.

Tryeza e rrumbullakët është sofa popullore për njerëzit e Familjes, është simboli solemn i dasmave dhe kësolleve, është Kuvendi i burrave dhe aula e diskutimeve shkencore, është thelbi i mikpritjes dhe njerzillëkut shqiptar në të gjitha kohërat, është i njëjti gjak që na rrjedh në deje, është i njëjti identitet kombëtar dhe njerëzor. Tryeza e rrumbullakët për subjektet politike është politika e mirë-

kuptuar, e në të kundërt është moskuptimi i politizuar.

Tryeza e rrumbullakët e të gjitha forcave intelektuale dhe morale për Shqipërinë, për kombin tonë është një apel i pakundërshtueshëm.

Tryeza e rrumbullakët i pakëson arkivolet dhe vdekjet, rrit sigurinë dhe vlerat (pse jo çmimin) e shqiptarëve në “Bursën” e kombeve të botës. Tryeza e rrumbullakët është e traditës dhe e deshifrueshme si në Gjirokastër, ashtu dhe në Shkodër, si në Tiranë ashtu dhe në Prishtinë, edhe në Shkup, kudo që ka shqiptarë, kudo ku bukës i thonë bukë, dhe ujit-ujë.

Tryeza e rrumbullakët është bashkimi dhe dihet se vetëm bashkimi i bën të mundshme gjërat e pamundshme, kurse përçarja i bën të pamundshme dhe gjërat e mundshme. Tryeza e rrumbullakët zhduk mitin e egokratit dhe secilin e bën të barabartë në dialog, madje edhe kryeshtetarin e radhës, e çmon vetëm si “*prima inter pares*” (“i pari mes të barabartëve”).

Tryeza e rrumbullakët është kombi i bashkuar, duke rrëzuar mitin e kombit policentrik, të fragmentuar nën shtete etnikisht të ndryshëm, të mallkimit biblik e euroballkanik “të kombit fatkeq”, - dëshmi e një historie bizatiniste e nga më të pabesueshmet të shekullit të XX. Tryeza e rrumbullakët është gjendja më e natyrshme kundër shtazërimit artificial të subjekteve dhe institucioneve. Prandaj quhet edhe Shën Tryeza.

Në vend të mbylljes...

Konica, në vitin 1925, shkruante: -“Vëllezër! Mos dëgjoni njerëz të cekët, mos u

dehni me moskuptime nga njerëz të pa ditur sa ju, më të pa ditur se ju ndofta, të cilët kanë vetëm një guxim barbar dhe të verbër që i shtyn të futen kudo, në mes të talljes së përgjithshme. Bëhuni burra! Rrëmbeni kazmat! Puna është më e lartë se trimëria, kazma më fisnike se palla. Dhe përmbi të gjitha pushoni së foluri. Jo fjalë të shumta, por kazmën. Jo mbledhje të kota, por kazmën. Jo misione, por kazmën. Dhe parmendën, dhe draprin, dhe shoshën, dhe furrën. Por mjaft lavdime. E kam zemrën aqë të mbushur me lot, sa s'qaj dot. Dhe më në fund, aq di, aq them. Jini të lirë të bëni si të doni".²⁰

...Presidenti Nishani, të parën vizitë të tij, siç ishte në nderin e tij, e bëri në Republikën e Kosovës. Aty ku shqiptarët ndjehen jashtë shtetit-brenda Atdheut. Ai dha mesazhe shumë të rëndësishme përmes premtimit të tij solemn: "Ju premtoj se gjatë gjithë mandatit tim, Kosova do të jetë kryefjala dhe në krye të axhendës së aktivitetit tim" ...²¹ Për të tilla mesazhe ka nevojë kombi, për të realizuar detyrën që i ka vënë vetes deri edhe në...Preambulën e Kushtetutës së tij!

Në vitin 1906, njëri nga poetët e pashpallur të këtij vendi, Luigj Gurakuqi, në të famshmen Poemë të tij "Dega e Zanave", në kulmin e mërztisë së tij për Çështjen Kombëtare, shkruante një varg, ku shprehte gjithë brengën e vet: - "E punët e tyne, kanë me pjellë mushkat!!!" Kuptohet, ai u drejtohej shqiptarëve të asaj kohe...

Herakliti thoshte: "Rruga për poshtë, është edhe rruga për sipër"...

Në një udhëtim, nuk ka rëndësi sa zgjat rruga, sa e vështirë është, rëndësi ka mbërritja, dhe...duhet mbërritur-do të shtonim ne, jo pa modesti....

Bibliografia:

- Faik Konica, "Shqipëria, kopshti shkëmbor i Ballkanit".
- Sali Hallkokondi, "Historia e Shqipërisë së Re", botim i vitit 1923, Shtypshkronja "Vlora".
- Arben Puto, "Shqipëria Politike".
- Edwards Grey, Memoires, botimet *Payot*, 1927.
- Pol Kambon, "Korrespondenca", botimet Grasset, viti 1946.
- *Memorandum i qeverisë së Vlorës, drejtuar Konferencës së Londrës, firmosur nga Mehmet Konica, Rashih Dino dhe Filip Noga*, Kaliopi Nasko, "Dokumente për Çamërinë", botim i Akademisë së Shkencave viti 1990.
- Fjalimi i Grey-t në Dhomën e Komunave, shkurt 1914.
- Robin Kuk, Diskutim në Dhomën e Komunave, 3 prill 1999.
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë-Preambula.
- Faik Konica, "Shqipëria-kopshti shkëmbor i Europës Juglindore" Shtëpia botuese "Gjon Buzuku" Prishtinë, 1991, f.139.
- "Albania", Nr. II, 1925.
- Nishani, fjala e mbajtur më 30 Gusht sivjet, në Kuvendin e Kosovës.

²⁰ "Albania", Nr. II, 1925.

²¹ Nishani, fjala e mbajtur më 30 Gusht sivjet, në Kuvendin e Kosovës.

Strategic Concept on AAF New Structure

Brigadier General Sandër Lleshi,
Deputy Chief of AAF General Staff

Short commentary. *A new NATO Strategic Concept published at the Lisbon Summit clears the way to many important processes in the field of Strategic Review in the different countries of the Alliance. NATO new Strategic orientation in face of future challenges has created entire framework to consult reviewing of National Strategies. Albania has not only the opportunity but the obligation to review its Strategic Documents which dated prior becoming member of NATO, in compliance with current Alliance document. This very important process is already in final step.*

Albania membership in North Atlantic Alliance is one of Strategic essential changes that impose realignments of whole security system and national defense. NATO memberships revives direct Washington Treaty with all its effects for Albania. In this condition security and defense of the country are considered as an integral part of NATO general security and defense system both for benefits and engagements and tasks to support Alliance as well.

Significant changes have occurred in regional and global security environment while Albanian Armed Forces (AAF) has executed deep transformation. Already, AAF are transformed into new, small and professional force based on new concepts and tenets and above all one force that is engaged widely in different missions inside country and abroad.

All of these changed factors comprise the base to develop Strategic Defense Review process for AAF which is conducted under direct assistance of USA and in coordination with NATO.

The aim of this article is to present some of the most important conceptual issues, related to future of this process.

New Structure and challenges of TRADOC

Brigadier General Bardhyl Hoxha,
TRADOC Commander

Short commentary. *Under the new structure of the Armed Forces and according to the requirements of the High Education Law, the Defence Academy will already be called the Academy of the Armed Forces. In its composition there will be two faculties: the Faculty of the Military General Education, the Faculty of Security and Defence and the Foreign Language Centre.*

It is necessary to increase the efforts to deepen cooperation with the public and non public institutions of the high education, in the interest of achieving a better quality of TRADOC mission, always in order to meet the constitutional mission of AAF.

The time requires to improve constantly the professional preparation, to use the lessons learned for lighting our goals for the future and to put together, in an effective educational program for the Armed Forces personnel, the appropriate balance between academic concepts and the operational reality.

These are the issues that this short article for the Military Review, aims to deal with.

On a C2 System of the New AAF Structure

Colonel ® Thimi Hudhra,
Centre for Defence Analysis, Chief

Colonel Piro Ahmetaj,
Head of National Representation in SHAPE, NATO

Short commentary. *Command and control of the Armed Forces (often known as C2 by military) is a very important part of the military science and art. Clawsevitiz and other modern scholars have positioned the leadership among the fundamental factors of victory in war or in an operation.*

The Armed Forces of the Republic of Albania are today contributors to several simultaneous operations inside and outside national territories. In the future, expectations are for a wider participation throughout the spectrum of operations: combat, peace support, and civil emergency operations.

In this context, everybody can make a normal question: what are the changes affecting the C2 coming from the new spectrum of operations, today and in the

future? What is to be preserved from the traditional approach and what new concepts are to be introduced in the new reality of AAF?

And last, because the Armed Forces are applying a new organization structure 2012, is there any need for changes in the Law on Strategic Command and Control Authorities of AAF? The aim of this article is to open a fruitful debate of the experts of the area.

Psychological effect of the war and its treatment

Major General Viktor Berdo,
Deputy Chief of AAF General Staff

Short commentary. *The involvement of military troops in peacekeeping missions, always is accompanied by the emergence of various psychological character concerns as: stress posttraumatic; substance abuse; anxiety; physical and psychological violence in the family; social isolation, etc. which necessitated the start of their psychological treatment.*

Troop commitment in conflicts, wars and deployments has been stressful for the military, and their families. Psychological effects on militaries and their families can be extremely difficult to be overcome before, during, and post-military deployments. Militaries should be seen as an important part of society. They are an important social group, where increase of psychological problems to this social group and their families, obviously affects to community and our society. Care and addressing for solution of these potential issues is vital to the success of the family, the health of the militaries and the society itself.

Regional capacities for emergencies, on the “Smart Defence” framework

Brigadier General Abaz Lleshi,
Commander of Regional Support Brigade

Short commentary. *Commitment of Military Structures in facing of Civil Emergencies and various Natural Disasters is part of their Constitution Mission.*

The contribution in years and, especially in recent years, has shown that the Armed Forces have successfully completed this mission. This is made possible due to the fact that currently, within the AF, there are professional and specialized units which carry out these operations.

Considering previous experience of our military structures in facing emergencies in years, and the mutual contribution provided by neighboring structures, the implementation of the initiative “Smart Defence” and duties arising from Struga Meeting on June of this year, this article stops at several advantages related to the strengthening of regional cooperation of mutual interest.

Simulation Center, A New Training Capability

Dee Esplin,
CUBIC Representative at the Simulation Center, TRADOC

Short commentary. *When done correctly, and up to modern standards, military training is an expensive activity that requires precise management, the right tools, and the application of proven procedures.*

The creation of the Simulation Center provides a new, modern, state-of-the-art training capability to improve training throughout the AAF. The Center is located at the TRADOC and is fully operational in October 2012. It will conduct its first simulation-supported exercise in November. The Center is designed, staffed and equipped to provide AAF units and leaders a 21st century training environment in which to practice and learn. Properly employed, the Center will significantly improve training, leader development and unit readiness throughout the AAF.

The mission of the AAF Simulation Center is to provide realistic combined arms, joint (all AAF), inter-governmental, and multinational training for AAF commanders, staffs, and leaders, according to Albanian and NATO operating doctrine in order to prepare units for the full spectrum of operational requirements, enhance learning, innovation and improvement throughout the Force.

Knowledge Management (KM), Crucial in the world of Information

Dr. Gaqo Tanku,
Lecturer at “Aleksandër Moisiu” University, Durrës

LtC. Editson Zarka,
Defence Policies Directorate, MoD

Short commentary. *Knowledge, if managed properly, turns into value and adds*

higher yields in life and work. It comes as a result of time to certain degrees and starts with general empirical data, where facts and observations are “raw material”. Content of such data comprise is what we call information. Not all information is necessary for the development of knowledge, only one that contains sense and meaning. Knowledge is next to the last degree of “Information pyramid” at the top of which is wisdom.

Albania’s integration process is accompanied with a “boom” of information flowing. Such information is a great endowment in acquisition of knowledge, experiences and best practices. Managing this information is important, while knowledge management arising from the processing of this information is even more important. We think that is required maximum exploitation of existing structures. but also the initiation of cell nuclei or other elements necessary for the treatment of this relatively new field.

Knowledge is acquired in allocated conditions and for this its treatment is a job for appropriate structures of human resources management.

Legal aspects of Foreign Military Intervention in Libya

Colonel Dr. Agim Q. Sula,
Commander of the Armed Forces Academy

“We were faced with the possibility of violence to a tremendous degree. We had a unique opportunity to stop violence: an international mandate for action, a broad coalition to interact, the support of Arab countries and plea for help from the Libyan people themselves. We also had the ability to stop Gaddafi forces attack without sending U.S. ground troops”¹

Barack Obama

Short commentary. *Many analysis and discussions have been and continue to be made on the uprising that brought about an end to the 40-year regime of Colonel Muammar Gaddafi in Libya. Due to the brutal repression by the regime, episodes of popular unrest escalated into an armed conflict and civil war that claimed the life of 35 thousand Libyans and ended after the dictator’s assassination in October 2011. In their struggle to overthrow the regime, the rebels were supported by the international military intervention led by NATO.*

One of the main reasons that led to the crowning success of this uprising, has to

¹VOA-Voice of America, Albanian-news, 08:00, 29/03/2011. Speech of the US President, *at the National Defense University, Washington.*

do with the so-called “quick process that takes your breath away”², with which the main political and military actors of the international community laid the legal foundations for the approval of international military intervention in Libya. Legal heated discussions, but also the opposite, deal with the legality of the authorization of military intervention for humanitarian reasons, to protect civilians and civilian populated areas, similar to the humanitarian military intervention in Kosovo, as well as the development of putting into practice the theory of the “responsibility to protect”³.

In this article, we will focus on the analysis of certain legal aspects of this international military intervention, which I think influenced not only its success, but will also affect the development trend of international law for the future.

Syria, The Gordian Node

Kol. ® Zeno Jahaj,
Ministry of Defence

Short commentary. *Syrian anxiety is holding the world hostage for nearly two years: How would be resolved the bloody conflict node in this country? We have to deal not simply with a humanitarian crisis, but a pure civil war, even the most macabre that the humanity has ever seen. A tunnel that does not seem to end. The security of the entire region, and beyond, is also at risk. The Security Council of the Organization of the United Nations is, as not infrequently, paralyzed, even just for pro “democratic” procedures. NATO does not know what to do. U.S. feels more outside than inside. Russia, more than anywhere, inside ...*

Military Academy, scientific heart for the officer’s formation

Colonel Dr. Edmond Braneshi,
Director of the Central Archives and the Museum of the AAF

Short commentary. *The creation of the Military Academy was the most important event in the history of military education, culture and military science. With its creation, one of the most sacred dreams of our people was made a reality. It was established as a public institution dependant from the Ministry of Defense, with*

² Amsterdam, Robert: “International Law and the Libya Intervention“. on March 24, 2011 www.robertamsterdam.com/2011/03/inter...

³ General Assembly of the UN adapted the concept of “the responsibility to protect”- or “RtoP”, (abbreviation for UN – author’s note)- in 2005, in an unanimous resolution.

status approved by the Council of Ministers. The Academy was called the institution of higher learning and scientific education that serves to the qualification of senior staff of the Armed Forces.

The decision was an evaluation for the school, but also a new phenomenon in the field of education and training of officers. It was a stirring achievement to increase the quality of teaching activity, pedagogical and scientific study of this institution. All of these were reflected in the organizational forms, in educational curricula, by increasing professional demands on teaching methods and pedagogical staff, as well as in the implementation of modern criteria for the acceptance academics who attended the academy.

Scientific activity and the right that was given to the Military Academy for the postgraduate qualifications brought about a qualitative step in the scientific work. A significant increase influenced the quality and the request for self-study in various military situations. Being an important center for scientific work, the Military Academy served ever better to improve the teaching and problem solving situations in the army.

100th Independence Anniversary and National Issue

Pano Hallko,
Head of Publications Branch, CDA

“The nation is permanent plebiscite” ...

Ernest Renan

Short commentary. *The current number of the Military Review, as programmed in years, will be published nearly two months before the Albanians celebrate the 100th anniversary of the Independence, therefore of our State. A century is not much in the story, but can not be less, given the time period and the historical circumstances in which it took to create and to proceed his life, this state, whose 100th anniversary we celebrate on November 28 of this year.*

Three names have determined, in the form of conferences, the tragic fate of the Albanians: Berlin, London and Yalta.

The first part of this article title regards what is considered as the London Conference which, as we shall see written by people who did and labeled as such, only conference there had not been. However, she left her stamp through its product: the today Albania, which is not wrongly called “London’s Albania”. While, in the second part of the article, the author considered himself unable to give recommendations on such major issues, there are treated two important notions: the Language and the Negotiating Table.

KUJTESË

PËR BASHKËPUNËTORËT E REVISTËS USHTARAKE

Të nderuar bashkëpunëtorë të Revistës Ushtarake!

“Revista Ushtarake” është një Revistë kërkimore me fokus teoriko-shkencor. Ajo është revistë e elitës ushtarake të FA dhe e analistëve të spikatur civilë që, nëpërmjet shkrimeve të tyre, synojnë jo vetëm të informojnë, por në radhë të parë të ofrojnë zgjidhje për çështjet më të rëndësishme të reformës së Sigurisë dhe të Mbrojtjes në nivel strategjik, operacional dhe taktik. Pra, prioriteti numër një i RU janë vlerat aplikative të krijimtarisë origjinale të autorit.

Edhe njëherë ftojmë studentët e talentuar ushtarakë, akademistët e sistemit të kurseve të larta të AM, instruktorët, pedagogët, punonjësit kërkimorë, analistët, komandantët, shefat dhe trajnuesit e të gjithë institucioneve e njësive të FA të RSH, analistët e pavarur civilë apo ushtarakë në fushën e Sigurisë e të Mbrojtjes. Në vijim, Redaksia e RU jep disa udhëzime e të dhëna teknike për strukturën e artikujve të autorëve të Revistës Ushtarake, të cilat duhet të respektohen prej tyre.

Struktura e artikullit

Titulli. Emërtimi i artikullit, me tre deri në katër fjalë.

Autori, Bashkautori: Shkruhet emri i autorit ose bashkautorëve të artikullit.

Abstrakti: Është pjesa që paraprin një artikull. Tek abstrakti autori shkurtimisht, duhet të paraqesë karakteristikat e artikullit (thelbin apo çështjet themelore të trajtesës, synimet e autorit, këndvështrimin, përfundimet ose rekomandimet, etj). Abstrakti nuk zëvendëson parathënien e vetë artikullit. Ai zë rreth 1/2 e faqes dhe nuk duhet t'i kalojë të 400 fjalët.

Paraqitja, gjatësia: Pjesa kryesore e shkrimit (përfshirë parathënien dhe përfundimet) shkruhet në gjuhën shqipe dhe duhet të jetë maksimumi 6-8 faqe kompjuterike (15 000-25 000 shkronja e shenja, duke përfshirë edhe hapësirat përfshi edhe “endnotes” dhe informacionin shtesë.

Formati: Faqja duhet të jetë e formatit A4; Lloji i shkrimit: “Times New Roman”; Madhësia e shkrimit 11.5. Kryeradha (Paragrafi i ri) përcaktohet me një rresht bosh. Paraqitja e tekstit të jetë e thjeshtë dhe në minimum të alternativave të stileve dhe formatimit. Kapitujt nuk duhet të jenë të numëruar; teksti duhet të jetë një strukturë me maksimumin 3 nivele. Duhet të shmangen tekstet e theksuara me bold apo shkronjat me ngjyra. Shkrimi i pjerrët dhe thonjëzat duhet të përdoren vetëm për citimet e burimeve të përdorura dhe literaturës.

Grafikët, tabelat dhe imazhe të tjera duhet të bëhen të formatuara në grup, duke shmangur shpërbërjen e tyre. Ato duhet të vendosen sa më qartë në një pozicion të përshtatshëm pranë tekstit që i shpjegon ato. Të gjitha imazhet duhet të

pasqyrohen në mënyrë të tillë që lexueshmëria të mos ndikohet nga reduktimi i madhësisë dhe printerat bardhë e zi. Nëse një imazh është marrë nga një burim tjetër, është e domosdoshme që të citohet burimi përkatës i tij.

Artikujt duhet të dërgohen të printuar dhe në mënyrë elektronike dhe me CD në Redaksinë e Revistës Ushtarake. Për ata artikuj që nuk i plotësojnë kërkesat e mësipërme të formatit dhe të gjuhës, Redaksia vendos nëse do t'i rikthehen autorëve për përmirësim, apo do të përjashtohen nga procesi i paraqitjes në Bord.

Dokumentacioni: Redaksia e RU vlerëson me rëndësi të veçantë paraqitjen, nga çdo autor, të artikujve e trajtesave me referenca dhe “*footnote*” si dhe në fund të materialit të vendosë literaturën e shfrytëzuar. “*Footnote*” duhet të respektojnë në mënyrë korrekte rregullat kombëtare e ndërkombëtare ku të përfshihen; Mbiemri, emri (i autorit që i referohet), titulli i materialit të referimit, emri i entit botues, vendi i botimit, viti i botimit, numri i faqeve ku referohet, numri ISBN, *website*-in ku ndodhet artikulli. (*p.sh. Smith, James, Siguria në Shekullin e 21-të: Histori e panjohur. 2nd edition. New York, London: Oxford University Press, 2006. p..235, ISBN 0071448209, <http://www.iir.cz/display.asp?lng=uk&ida=>*).

Biografia: Së bashku me shkrimin, autori të dërgojë edhe një përshkrim të shkurtër biografik me rreth 100 fjalë ku të përfshijë: emrin, mbiemrin, gradën, pozicionin e punës, arsimimin, angazhimet kërkimore, fotografinë, numrin e telefonit dhe adresën elektronike.

Stili: Shkrimi duhet të paraqesë një strukturë të thjeshtë, duke përdorur tituj dhe nëntituj. Është e rëndësishme që në fund të shkrimit, autori ta mbyllë me disa përfundime dhe rekomandime të cilat duhet të jenë zgjidhje të propozuara në realitetin tonë.

Artikulli nuk duhet të përmbajë material të klasifikuar dhe duhet të zbatohet rregullat e klasifikimit të informacionit.

Materiali i shkurtuar për çdo shkrim duhet të vijë në redaksi i përkthyer në anglisht. Artikulli nuk duhet të përmbajë ngjyrimë e as qëndrime politike apo partiake.

Për çdo informacion të mëtejshëm, mund të kontaktoni me:

Dega e Botimeve (Redaksia e RU), Qendra e Analizave të Mbrojtjes, Komanda e KDS

Mail: Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, QAM, Dega e Botimeve
Kutia Postare 24 23, Rruga e Dibrës, Tiranë, Shqipëri

Nr. Tel: 00355(4)23 63 465 ext. 516 /10 37, 516/ 10 76

Nr. Fax: 00355(4)23 69 179

Email: revistaushtarake@aaf.mil.al

Redaksia e Revistës Ushtarake

Shtypur në shtypshkronjën “TOENA”
Rruga “M. Gjollesha”, K. Postare 1420, Tiranë
Tel. : ++ 355 4 22 40 116; ++ 355 4 22 58 893
Fax: ++355 4 22 40 117
Email.: redaksia@toena.com.al
[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

